

BIBLIOTEKA
SHTETIT

BSH-51

B 36

Goditje

RESUL
BEDO

KAPITULLI I PARË

*Kjo lule ishte plot gjallëri e guxim.
Marengleni me sy të mbërthyer mbi
petalet e hapura mbi dëborë vuri re
që në malet s'ka vetëm thëllim, por
edhe jetë.*

Kishte kohë që fshatrat e krahinës malore, në veri të qytetit të Gjirokastrës, çoheshin (mëngjezeve të mbuluara nga brymat dhe ngricat. Gjithshka ishte veshur me një cipë akulli.

Dimri qe i ashpër.

Hera-herës (vinin në këtë krahinë erërat e vakëta të detit, por, sa hynin mes maleve, humbisinin ngrohtësinë dhe largoheshin, të ftohta, pa sjellë ndonjë ndryshim.

Në mbrëmjen e një dite janari, pas përpjekjesh të vazhdueshme me armikun, pas një rruge të gjatë e të lodhshme, një kolonë partizanësh hyri në fshatin Sheper. Një qiell plot pështjellime resh të zeza dukej sikur do të bëhej një me tokën, dhe natën kishte filluar të reshte dëborë. Rreth vatrave të fshatarëve u ndezën biseda të ngrohta, që vazhduan gjer vonë...

Refat Arapi, komandanti i një skuadre partizane, njeriu më hokatar në batalion, i fjalës e i shakasë, atë natë ishte i kursyer në fjalë, nuk bisedonte si ngahera dhe shenjat e dëshpërimit që kishte ja lexoje në fytyrë. Sadë që i zoti i shtëpisë u mundua të këmbente fjalë, Refat Arapi heshti. Si hëngrën darkën, Refatin e zuri gjumi, ndërsa të tjerët bisedonin me të zotin e shtëpisë që herë pas here ja hidhte sytë fytyrës së Refat Arapit të nxirë nga thëllimi dhe era. Dukej sikur flinte, por

Refati me duar të kryqëzuara nën kokë jetonte një ngjarje të afërt nga luftimet e ditës së fundit. Fill mbas asaj ngjarjeje ai qe kritikuar para batalionit dhe qe ngritur për të bërë autokritikë. Këtë autokritikë ishte detyruar ta bënte, sepse si shkak i veprimit të tij ishte plagosur rëndë një nga partizanët më trima të skuadrës, Dardani.

Shokët, që rrinin anës vatrës, e merrnin me mend se me çmendime jetonte në ato çaste komandanti i skuadrës së tyre. Refati hera-herës e lëvizte dhe shtrembëronte fytyrën. Kjo i ra në sy zotit të shtëpisë, i cili bëri të ngrihej, të hiqte nga rafti i rrobave një jastëk dhe t'i fliste Refatit:

— Luaj pak, (shoko. Ke rënë ligisht, hë vëlla!

Refati e mbështeti kokën mbi jastëkun e bardhë dhe të butë dhe bëri sikur flinte, por nga lëvizja e buzëve dukej që nuk flinte.

Në mëngjez partizanët dolën nga shtëpitë dhe u rreshtuan në rrzë të malit. Të gjithë ishin kurreshtarë, deshnin të dinin:

— Ku do të shkojmë? Ç'rrugë do të ndjekim? — pyesnin. Marengleni¹⁾ u shpjegoi vendimin e Shtabit të Përgjithshëm, porosinë e shokut Enver për formimin e një brigade partizane.

Brohoritje, (gëzim!...

— Brigadë partizane!... Rroftë brigada partizane!

— Rroftëëë! — jehoi mali nga zërat.

Refati vuri re si i ndritnin sytë nga gëzimi djaloshit Flamur Sabriu, ngriti më lart flamurin, që skuqte aq shumë mbi bardhësinë e borës. Valavitej flamuri, dukeshin shkronjat, të qëndisura me kujdes nga Bukuria, një nga partizanet e skuadrës së Refatit.

— Bukur e ka qëndisur, xha Refat — i thoshte

1) Pseudonimi i Mustafa Matohitit.

Flamur Sabriu. — Është shkruar emri i brigadës, që do të krijohet.

— Po ç'është brigada partizane? Si është?

— Brigadat janë dallëndyshet e para të ushtrisë sonë.

Ndërhyri Refat Arapi:

— Ç'na thua dhe ti, o shoku Çerçiz! Si, more, krahason brigadën me dallëndyshet? Jo, ore, jo! Brigada është shqiptarë. Me shqiptarët i vjen mirë shqiptarit të masë veten, jo me dallëndyshen!

Ecën kolona partizane me një hap. Ecën edhe Flamur Sabriu me sy të ndritshëm e flokë të verdhë kaçurrelë të rënë mbi ballë. Mban në duar flamurin e kuq të shpalosur. Nauni i bie më me afsh burisë.

— Ç'bori të bukur që ka! — thoshin partizanët.

E re ishte boria e Naunit. Edhe pushka i vetëinte. Thuhej që këtë pushkë ja kishte hequr nga dora një karabinieri, ditën. në drekë. Dhe ku? Midis qytetit!

Kolona filloi marshimin nëpër mal me një marsh partizan.

Refat Arapi, që e kishte hedhur pushkën mbi shpatulla, me të dy duart sipër saj, sikur i kishte vënë ashtu për t'u çlodhur, ecte dhe mudohej që të këndonte edhe ai bashkë me skuadrën e tij. Disa herë e solli zërin, që t'ja niste. Nuk mundi dhe, i inatosur, tha: «Më lanë eshtrat e gojës, u plaka». U foli të tjerëve: «Ashtu, bijtë e xhaxhait, ka lezet të dëgjohet sot kjo këngë, po formojmë brigadë». Kënga jehon:

*«Revolucioni që ka nisë,
tym edhe flakë qielli i Shqipërisë,
po i vjen vdekja robërisë
nga shqiptarët partizanë!»*

Malin e Nemërçkës e goditën si breshër disa herë radhazi rrufetë. Topat e kalibrave të mëdhenj kishin

disa ditë që bombardonin malet. Lajmi që filloi operacioni godiste si një masiv akulli mbi zonat e lira. Këtë lajm e dinte edhe kolona partizane, që ngjitej la e më la në malet.

Në këtë kohë, në mal u dëgjua një gjëmim i thellë. Jehona i solli gjer në Dhëmbel krismat e topave që binin andej nga ana tjetër e luginës. Refati mbajti këmbët e hodhi vështrimin tutje përpjetë. Me zemërim u kthye nga shokët e skuadrës:

— I dëgjoni? — u tha.

— ...

— Hajde Shqipëri, hajde! Tër s'të bën veshi nga gjylet e gjermanit; u plase buzën zabitëve të Evropës. Dhanë e dhanë e dot s'të shtruan!..

Dhe prapë malet oshëtijnë nga gjëmimet.

— Qëlloni sa të doni, o derra, grisni sa të doni grykat ogurzeza. Po e dini kë qëlloni? Shkëmbin! Gjithë kralët e botës, që erdhën, këtë punë bënë, na goditën me gjyle. Po, a tundet dot shkëmbi nga vendi?

Kaluan edhe një copë rrugë.

— Ku je, Refat Arapi? — dëgjoi ai t'i flisnin.

Ktheu kokën dhe shikoi:

— Kush qenka! Muçua! — Nuk i thoshte dot Marenglen, u kthye dhe i ndriti fytyra, e qafoi. Bir, bir — murmuriti.

— Për ku kështu, o Muço — e pyeti.

— Me shokët, o xha Refat.

— Nga brigada jonë, besoj.

— ...

Marengleni e Refati ecnin krah për krah, kuvendnin. Kishin më shumë se një vit që nuk ishin parë me njëri-tjetrin. Duke biseduar, bënë një copë rrugë.

— Lodhesh, xha Refat? — i tha Marengleni, në kohën që morën tërthor dhe rruga filloi të binte më drejt.

— Unë?! Nuk dëgjon trupi im. Po ti, o bir i xhaxhait? Të mundon ajo sëmundje, veç trimi edhe veremin e mposht, dëgjomë mua plakun, tinë, e mposht...

Kur i përmendi sëmundjen, Marengleni ndjeu dridhje në kupat e gjunjëve dhe, për të ndërruar bisedë, e çoi fjalën gjetkë:

— Me se e punon maliherin?

— Deri tani kam gjetur fishekë, por keq e kam, o Muço, s'më bëhet ta heq nga dora, qëllon mirë.

— ...

— Do t'i vë dhe ndonjë fishek Italie, s'ke ç'i bën. Ka ky meluni, që vjen prapa, një mushqetë Italie të shkurtër, një grykëflamosur.

— Do ta prishësh, më mirë ndërroje.

— Me se?

— Belxhik bëje, nuk do të vuash nga fishekët.

— Bah, këtë s'e bëj, më mirë e ndërroj me një patickë Italie të gjatë; edhe ato janë armë të sakta.

Marengleni mendoi të bisedonte me Refatin për ngjarjen që ishte kritikuar, por, duke e njohur si kokëkrisur, do t'i duhej një kohë më e gjatë, prandaj, ndryshe nga sa mendonte, u detyrua të heshtte; kërkoi të lirohej rruga dhe eci përpara duke menduar se, që t'i ndryshojë karakterin Refat Arapit, duhej takt dhe durim. Edhe Refat Arapi donte t'ja tregonte Marenglenit atë ngjarje. Ecte dhe thosh me vete: «Edhe atë punën e gjermanit që zura rob do ja tregoj, si o, i thua robit që me njëmijë rreziqe t'ja heq armën nga dora që të thotë «kaput Hitler» dhe meazallah, për t'i bërë t'ëmën ishte, kokëshkëmb gjermani, po kokëshkëmb edhe unë, ja ngjeshja trurin për një shkëmbi, po ç'e do, ma ngjeshën me kritika shokët. Do ja them Muços, besoj do më kuptojë, për atë s'kam faj, rob ishte, por edhe derr ishte, ndryshe qëndron puna me Dardanin».

U deshën dy orë gjersa të arrinte balli i kolonës partizane te çesma. Dikush doli nga rruga dhe shkroi në borë me germa të mëdha:

«VDEKJE FASHIZMIT»!

Pastaj në gropën e madhe, në të vetmin vend në malin e lartë, që e rrahin më pak erërat, u grumbulluan të gjithë. Xha Refati, i mbështetur në anë të një shkëmbi, nxori nga xhepi strallin.

— Do ta dredhësh një cigare? — i tha shokut që kishte në krah. — Letër nuk kam.

— Unë e pi me çibuk.

Xha Refati i nderi qesen me duhan, pastaj goditi strallin me urorin. Shkëndijat u shpërndanë. E goditi përsëri, kësaj radhe më me shpejtësi. Nga guri i fortë shpërthyen tufa xixash. — Hajde, gur, gur! Sa një kërr lajthi e nuk i mbaron zjarri. Ja, kjo kërkohet nga ne në këtë operacion të madh, o bijtë e xhaxhait, të jemi të fortë si ky gur i vogël, se nga ky gur jemi, të nxjerrim zjarr si ky dhe, kini për të parë si do t'i ulet hunda gjeneralit Fon Gajb¹). Pastaj do t'i ndjekim ne repartet e tij, në vend që të na ndjekin ata. Për kokën time, kjo do të ndodhë!..

Një partizan çohet dhe, duke u fundosur në borë, largohet drejt çesmës.

— Të pihet ujë, djaloo!

— Jo, xha Refat.

— Atëhere rri, a lumëzi, mblidh veten, se do ta kemi më zor këtej e tutje, është më e përpjetë rruga, ka më shumë borë. Pastaj... Aaa, shiko, shiko!.. dashke të na nxjerrësh në surret... për ideal, mirë e ke!

— Mblidhuni, shokë, një fotografi! — tha tjetri.

Rreth çesmës u mblodhën partizanë e partizane.

Dhe sërish zgjatet pa fund në mal kolona partizane...

3

Edhe pak dhe ata ngjiten në qafën e malit. Ja ku janë dredhat e fundit. Sa do të mundohen të parët!

1) Komandant i shtatëdhjetëmijë ushtarëve nazistë gjermanë, që kryen operacionin e dimrit 1943-1944.

Bora çahet me vështirësi. Atyre të kreut u arrin bora në mes... në supe!

— Edhe pak e dolëm, guxim, o burra, ja!.. — dhe Marengleni tregon vendin ku del rruga. U duk sikur kolona mori gjallëri, nga fjalët e komisarit, dhe shpejtoi hapin. Ata në ballë ishin lodhur, zunë të numëronin hapin e tyre: «Një, ... dy, ... tre!» Dihasnin. Përsëri numëronin:

— Një hap... Edhe një tjetër!..

— Shokë, — u dha përsëri zemër Marengleni — durim, se arritëm!

— E shikoni atë malin, që del sipër të tjerëve? Andej do të kalojmë.

Sytë e partizanëve ju kthyen atij që foli, partizanit me sy të bukur, **mustakë të zes dhe ball të gjerë** që mbante në krah një pushkë maliher, veshur me xhakëtë bezhë dhe rrip të kryqëzuar në gjoks, Marenglenit.

Pas pak kolona partizane e mbushi hapësirën e hoveve me zhurmë. Duke shkuar drejt atij mali për të dalë në shtegun e vetëm, që të përcjell në vendin ku do të formohej brigada, ata vështronin se si mali mori një pamje më të frikshme, kërcënuese. Kur ju afruan kresh-tës së malit, era u përplaste borë në fytyrë, kokrrizat e ngrira i shponin si gjilpëra. Dukej sikur në mal sundonte vetëm fishkëllima e asaj ere; por njerëzit bashkoheshin, formonin zinxhirë krahësh, ndihmonin njëri-tjetrin dhe e mposhtnin erën. Në ballë të tyre flakëronte flamuri, flamuri i kuq.

— Durim, xha Refat, edhe pak e dolëm — i tha Marengleni.

— Të mos durojmë ne stuhinë e maleve tona? Pse, o, ku jemi rritur ne, në... — Nuk e mbaroi dot fjalën Refat Arapi, kur gjëmoi mali dhe u dëgjuan zëra:

— Largohuni nga pllaja, orteku!..

Në anë të rrugës, pranë një shkëmbi, ata që kaluan andej, panë një lule. Marengleni ndalet një çast, e shikon me habi. Ç'të ishte kjo lule?!

Lulja dimërore e alpeve e ndjen para kohe pranverën dhe çan e del, s'pyet për borë e thëllim. Kjo lule ishte plot gjallëri e guxim dhe Marengleni me sy të mbërthyer mbi petalet e hapura mbi dëborë vuri re që në malet s'ka vetëm thëllim, por edhe jetë. Me këtë lule donte të krahasonte brigadën e re, që po formohej, sepse ajo formohej në ditët kur operacioni i dimrit ishte në kulm. Mijëra gjermanë sulmonin. Rrugët dhe luginat në Jug të Shqipërisë ishin mbushur me ushtarë gjermanë. Tellallët e të huajve, ballistët, thoshin:

— O burra, lart maleve, u erdhi fundi partizanëve!..

Refat Arapi ecte dhe fliste me vete:

«Vështirë do ta kemi. Luftë e madhe, dimër i madh po bën, dhe në këtë krahurë vjen urdhëri që të formojmë brigadën». I shkoi mendja se mos që më mirë të pritej pranvera për të formuar brigadën, por ndryshoi mendim:

«Pse, o, ushtri kazermash është ushtria jonë? Ajo lindi dhe po rritet në luftë, në përpjekje. Gjithnjë rritet! Le të pëlcasë gjenerali gjerman, do ta formojmë edhe këtë shqiponjë partizane!»

Refat Arapi kishte dëgjuar që gjenerali nazist Fon Gajb kishte thënë se gjatë operacionit do të gjunjëzonte brigadat partizane, ndaj Refati sërish thoshte me vete: «Po tani që do të mësojë se u krijua një brigadë e re mu në qendër të veprimit të regjimenteve të tij, si do t'i duket kjo gjeneralit? Do të habitet me ne, ç't'i bësh, kështu janë habitur të gjithë pashallarët e gjeneralët, që kanë dashur të nënshtronin Shqipërinë. Pse i thonë «Shqipëri çikë stralli», për këtë i thonë, se, po e ngave, nxjerr xixa e flakë!»

Ecën...

Kur u ngjitën në majën e malit dhe filluan zbritjen në drejtim të luginës së Vjosës, ata druheshin të vështronin poshtë. Nën këmbët e tyre, humnerë. Disa herë dredhat e rrugës e çonin kolonën afër një shkëmbi, që

binte thikë mbi dyqind metra. Aty njerëzit ecnin me shumë kujdes. Rrëshqiti Marengleni.

Zëra: — Ra, ra!..

Dhe kolona shtang në vend me sy të mbërthyer te Marengleni që po rrëshqiste drejt si plumb andej nga buza.

Zëra:

— Ngul thembrat e këpucëve! Ngul qytën e pushkës!..

Pas njeriut që rrëshqiste, formohej dhe shkante drejt humnerës një vrugë.

Refat Arapi, kur e pa se ai mbas disa metrash do të shkëputej nga toka, mbylli sytë. Ai nuk donte të shikonte se si njeriu, të cilin e donte aq shumë, do të përplasej në gur, në shkëmb. Në këtë kohë dikush u hodh rrëmbimthi drejt Marenglenit, në rrëpirë. Xha Refati e njohu dhe tha: — Çerçizi! — Të gjithë partizanët kishin qëndruar në vend me vështirim të mbërthyer poshtë në humnerë. Por Marengleni nuk qe nga ata që në çaste kritike i mbërthen hutimi. Duke u munduar të mbante ekuilibrin, e hoqi aq me rrëmbim nga supi maliherin, saqë Refat Arapi s'arriti ta vërente.

— Ngule armën — thirrën qindra zëra.

— Ngule armën — jehoi shpella, drejt së cilës shkante si një gur Marengleni. Dhe maliheri u fut në borë thellë gjer në afërsi të shulit, te gusha e fishekut. Për pak i dolën shpatullat nga vendi, aq forcë ju desh Marenglenit që të ndalej. Edhe këmbët ju fundosën. Dëllënjat degëgjera mbulonin atë vend, por ato qëndronin shtrat nën dëborë. Nga pesha e dëborës degët e tyre qenë ngjeshur edhe më fort me njëra-tjetrën. Marenglenit i qe futur këmba e djathtë midis tyre dhe, sado që mundohej, qe e pamundur ta hiqte. Përpëlitej, por nuk mundi të ngrihej, gjersa i shkoi në ndihmë Çerçizi. Edhe ky e pati të zorshme. Zbriti gjer atje duke u mbajtur pas një litari. Më në fund druri e lëshoi. Marenglenit ju duk sikur ja lëshoi këmbën një çark i çuditshëm. Në fillim ndjeu dhembje të forta. U

mundua të ngrihej më këmbë, ndaj qëndroi duke u mbështetur mbi armën e duke shtrënguar fort litarin. Këmba ju mpi nga dhembja. I dukej sikur trupin mbështetej në një copë dru, aq shumë që vrrarë. Megjithatë ai shtrëngoi me forcë litarin dhe filloi të ngjitej drejt shokëve.

Pas pak kolona vazhdoi të ecte përsëri.

4

Të gjithë, të lodhur pamasë, mbërritën në bregun e lumit Vjosa. Binte edhe shi, një shi i përzier me dëborë.

— More, na lagu në palcë? Ç'bëhet akoma? Kur do të ndahemi në baza? — tha Refati.

Në baza? Ku qenë bazat, në ç'strehë mund të shkolin. Kudo mure të rrëzuara njëri mbi tjetrin, pullaze, që nxinin si fantazma në muzgun e mbrëmjes. Edhe guri i madh i qytetit nxinte. Edhe atë e kishin lëpirë flakët e mëdha të zjarrit, i kishin dhënë atë ngjyrë të zymtë, të shëmtuar!

Nëpër rrugë, ujë e baltë. Në baltë laskaroheshin këmbët e partizanëve. Këta prisnin të shpërndaheshin nëpër baza, përmetarët e fshehur nëpër shpella e guva kishin ardhur t'i merrnin.

— Mirë thotë partia, rrënjët tona janë në popull, ore, atje janë! Ja, mendo një herë sikur të mos që populli. Ku do të haje sonte, nesër, pasnesër?.. Do të mbaheshe (sa do të mbaheshe dhe... Populli është ndryshe, o vëlla, është si ky mali, populli! A tundet mali nga vendi?

— Mjaft, o xha Refat! Sa more vesh që do të flesh pranë zjarrit, zunë të të rrjedhin fjalët si një burim.

Shtabi i brigadës: Marengleni, Vogli, Goliku dhe disa komandantë e komisarë nga batalionet e çetat, që

kishin vajtur në Përmet, qenë mbledhur dhe bisedonin për situatën, njiheshin me detyrat që i kishte vënë brigadës Shtabi i Përgjithshëm. Ndërsa partizanët pak e nga pak po ndaheshin nëpër baza, në anë të Vjosës disa mjeshtra nga qyteti punonin. Refat Arapi, që prishte radhën të caktohej në ndonjë bazë, duke soditur anën e Vjosës, erdhi gjer te vendi ku punonin mjeshtrat.

— Punë e mbarë! — u tha.

— O, mbarë paçi, vëllezër! — u përgjegj Gole Përmetari, njëri nga mjeshtrat, një burrë në moshën e Refat Arapit, por më i pakët në trup, që u ngrit nga vendi.

— Si ngutshëm e keni filluar — tha Refati.

— Na dhanë urdhër që deri në mbremje ta mbarojmë.

— Kush?

— Marengleni.

— Aha, çështja paska rëndësi. — Refati s'tha gjë tjetër.

Mjeshtri vuri sqeparin në mes dhe nxori qesen e duhanit.

— Dridhe një duhan!

— ...

— Është pak i rëndë duhani ynë. — Refat Arapi drodhi një duhan, e ndezi dhe ja ktheu qesen të zotit.

— Si është, të pëlqen duhani?


— I mirë.

— Mbaje, zbraze në tënden — i tha mjeshtri Gole Përmetari duke i zgjatur përsëri qesen. — Nuk më ndodhet më shumë. Në kalibe kam tjetër.

Refati nuk kundërshtoi. Ai duronte pa bukë, po kurrë pa duhan.

Skuadra e Refat Arapit u njoh dhe u miqësua me Gole Përmetarin, gjithë partizanët e partizanet ja mësuuan emrin Gole Përmetarit, që po hidhte një urë mbi Vjosë për të kaluar brigada.

Dëgjohen tingujt e borive. Partizanët e çetave të tjera që vijnë grumbullohen, rreshtohen; do të ndaheshin në baza për fjetje. Mjeshtrat rrahin me forcë sqe-



parët mbi telat e çelikut, mbërthejnë dërrasa, pregatisin urën nga do të kalojë në veri të Vjosës brigada partizane. Shpeshherë ata merren me kësi punësh, por atë ditë ju desh të punonin me më shumë ngulm, të derdhnin më shumë djersë, të mbaronin sa më parë.

— Pasarela¹⁾ duhet të bëhet gati sonte, me çdo kusht! — u kishte thënë Marengleni.

— Fjala e partisë s'bëhet dy, shoku Marenglen — i qenë përgjegjur mjeshtrat dhe kishin vazhduar punën në shi e llohë.

5

Ditën e nesërme, në bregun e Vjosës zbritën të tjera çeta e batalione, që do të rreshtoheshin në brigadë.

Në luginë këngë, flamuj, popull dhe partizanë, që të gjithë të grumbulluar në vendin ku do të formohej brigada.

Brohoritje:

— Rroftë brigada partizane!

— Rroftëëë! — jehonte mali nga zërat.

Tutje nga Këçoku, nga vinte oshëtima e topit, bëheshin luftime.

Forcat partizane u jepnin goditje kolonave armike.

Goditje!... Kudo. goditje!

Por brigada e re, që po formohej, ç'do të bënte?

Një çift aeroplanash kaloi luginës së Vjosës. Uturi-
ma në qiell e në tokë... Plasje predhash në Dhëmbel
dhe në borën e bardhë njolla... Shumë njolla të zeza.

Partizanët shpejtojnë, duan të rreshtohen, të çojnë
në vend fjalën e partisë, të thonë:

BRIGADA U FORMUA!

— Në stuhi po krijohet brigada? Hë? Ka mendje
në krye të luftës sonë, o vëllezër! — u thoshte shokëve
të skuadrës Refat Arapi. — Në ditë si këto, ne duhet të
jemi më pranë njëri-tjetrit, më të bashkuar — flet Refat

1) Urë teli e varur.

Arapi e ndërron fytyrë. I kujtohet jeta si hamall që në kohë të rinisë, derisa u bë burrë i vjetër. S'ka lënë skelë pa punuar. Ka kallo jo vetëm në duar, por edhe në këmbë, edhe në shpinë. «Dola në jetë si i verbëri, o bijt' e mi», u thoshte të tjerëve «po tani e shoh rrugën. Do të ndjek, sa të jem gjallë, dritën e pushkës, që të dal në jetë e në dritë».

Marengleni që ishte midis partizanëve ktheu kokën andej, i pëlqyen fjalët e Refatit, ndaj ua përsëriti të tjerëve ato fjalë që dëgjoi dhe, me vete tha: «Qartësia politike e njerëzve që bëjnë luftën është forca e forcave, mbi të cilën duhet ta mbështesim gjithë punën tonë».

Refati përsëri belbëzon, diçka flet me vete. Hamalli, që shumicën e kohës e kalon në vetëmi, duke rëndur rrugëve, e di se është e nevojshme të kuvendosh me veten. Fjala e imbyllur përbrenda të ther e të bren si krimbi drurin. Nga partizanët që këndonin të mbledhur kokë më kokë njohu zërin e Çerçiz Fejzos e foli:

— E dëgjoni atë këngë?

— ...

— Është kënga jonë. Është e rreptë se ka krisma pushke brenda. Ashtu i kemi këngët ne shqiptarët. Ashtu do të jenë këngët tona gjithnjë!.

Dhe Çerçiz Fejzua që i vogël u fut midis këngëve që buronin nga ndjenja shqiptare, nga zemra shqiptare. Midis këtyre maleve, ku u përplasën erërat gjatë shekujve, shtrëngon radhët e saj brigada e re partizane, këtu Çerçizi me zë të lartë këndon:

*«Do të kthehem, a do vritem,
nuk pyes.*

*Për atdheun, edhe unë si të tjerët
do të vdes.»*

Refati kthente kokën e vështronte brigadën e rreshtuar.

Dëgjon komanda, bilbilë, borie!.. Dhe në rresht, marrin drejtimin, mbulojnë njëri-tjetrin. Thonë: «Jemi ushtri dhe ushtria ka rregulla, jemi brigadë partizane

dhe brigada ka rregulla» Komandant Goliku dha komandën.

— Brigada! Gati-tu!

U gatit me radhë të ngjeshura brigada partizane. Përpara batalioneve qëndronte flamuri, pranë tij djalo-shi syshkruar me flokë kaçurrel, Flamur Sabriu. Palët kuq e zi të flamurit i rrihte era e fortë. Para tyre dukej sikur shqiponja nderte krahët, merrte fluturim. Dhe, në atë copë të shkëlqyeshme në ngjyrë të kuqe, partizanët e partizanet lexonin emrin e brigadës së tyre. Partizani syshkruar me flokë kaçurrel e ngre lart mbi rreshtat flamurin e kuq. Ja zbukuron supet djaloshit Flamur Sabriu, një shami mëndafshi, që ishte përgatitur nga gratë e Përmetit për partizanët e brigadës së re. Ishte qëndisur në këto shami, me gërma të kuqe parulla luftarake e partisë:

«VDEKJE FASHIZMIT,
LIRI POPULLIT»

6

Ai që do të marrë një ide të qartë të planit që kishite komanda gjermane në ditët e operacionit të dimrit në këtë zonë, s'ka si ta përfytyrojë ndryshe këtë plan veçse duke shtruar mbi tryezë hartën, dhe të ndjekë kështu lëvizjen e shigjetave për të lexuar emërtimin e regjimenteve, divizioneve dhe forcave mercenare që vepruan në këtë operacion në mënyrë që të përfytyrojë kolonat e motorizuara që lëvizin nëpër rrugët automobilistike, të veshtrorë në çdo rrugë malore dhe lugina, ngjitjet e batalioneve dhe të regjimenteve SS, në çdo kalim lumi e shteg që zbret nga malet dhe ushtarët që mbyllin këto kalime.

Që në ndeshjet e para u vu re këmbëngulja e gjermanëve për t'i shkelur zonat e çliruara nga partizanët dhe qëndresa e palës tjetër për ta kthyer në fortesë çdo gur e stan. Bëhej ato ditë një kacafytje e vërtetë, se-

cila palë kërkonte ta shqyente tjetrën, ta gjunjëzonte, ta hidhte në tokë dhe ta zhdukte.

Kohën e zhvillimit të operacionit e zgjodhën sulmuesit që të ishte në favorin e tyre. Duhet të pohojmë që veprimet e regjimenteve të ushtrisë së gjeneralit Gajb, që në fillim të operacionit ishin nga më të shkathtat, veprime të tërbuara, me më tepër vrull se sa kishte dashur gjenerali Gajb.

Kur e lexon hartën me shigjeta të këtij operacioni të ngjan me një lak mbytës nga ato që me urdhër të Gajbit u ngritën në sheshet dhe në vendet e pazareve të qyteteve të Shqipërisë. Këtë lak, si vargonjtë e hekurt që mbajnë të mbyllur në kafaz kafshën më trime të botës, luanin, ashtu do të mbanin të mbyllura e të izoluara në male forcat partizane, për të hedhur pastaj mbi to goditjet e forcave operuese. Në këto veprime forcat operuese do të kishin arritur me shumë suksese, në qoftë se nuk do të kishin marrë goditje si ajo e Tendës së Qypit. Pavarësisht nga këto goditje, gjenerali Gajb veproi me mençuri dhe në kohën e duhur kur dha urdhër që forcat e divizionit të Janinës të ndiqnin rrjedhën e dy lumenjve, ujrat e të cilëve e kanë zanafillin në afërsi të këtij qyteti, dhe të vazhdonin sulmet gjersa të takoheshin në Tepelenë, në vendin ku bashkohet lumi Vjosa dhe Drinosi. Në malet midis dy lumenjve ai kërkonte të tërhiqte dhe të mbyllte një pjesë të madhe të forcave partizane. Në vazhdimin e këtyre sulmeve kërkonte gjithashtu të arrinte qëllimin që nuk e kishte arritur në sulmet e mëparshme.

Por nën goditjet partizane plani i veprimeve të forcave të tij ndryshonte, ajo që ishte parashikuar të arrihej me një ditë luftimesh zgjaste dy ditë të tjera. Aty ku çanin forcat e tij hynin pykë në thellësi dhe lëshonin degë anash, shkelnin vendin, terrorizonin dhe digjnin fshatrat.

Në hartën e këtij operacioni ndryshuan hera-herës vijat e luftimeve. Të dy palët vazhdimisht ndërronin vend, zakonisht partizanët zmbropseshin, ndërsa gjer-

manët dyndeshin edhe më thellë në zonat e çliruara duke përhapur kudo frymën e vdekjes. Ndodhte edhe e kundërta, sulmonin partizanët, godisnin si rrufe dhe zhdukeshin si era. Ndodhte që forcat gjermane binin në prita të partizanëve, këto ishin të shpeshta dhe të ndjeshme, por gjenerali Gajb i mbyllte këto shushurima në shtabin e tij vetëm me një fjalë: «Këto janë hollësira për komandant kompanie dhe batalioni, jo për oficer shtabi». Shtabi i operacionit nuk ishte asnjëherë në gjëndje të përcaktonte saktësisht forcën e furtunës në të gjitha vendet ku bëheshin goditje dhe disa herë një lajm alarmues nuk dilte asgjë, në të kundërtën një lajm i vërtetë, një disfatë i raportohet gjeneralit si diçka e lehtë. Kjo bëri që gjenerali Gajb të zgjidhte si vendvrotimi të betejës një autobлиндë të verdhë dhe të re, me të cilën ai lëvizte nga njëra luginë në tjetrën. Dhe operacioni vazhdonte, goditjet shtoheshin, kolonat me ushtarë lëviznin. Në kuadrin e këtij plani kolonat me ushtarë hitlerianë vërshuan luginës së Vjosës.

7

Kur brigada partizane u rreshtua në bregun e Vjosës, në malin e Papingut u dëgjua jehona e tri pushkëve dhe e një bombe, që u zbraz nga rojet. Krismat shpuan qiellin e zyrtë dhe jehuan grykë më grykë. Sinjali erdhi gjer në Përmet, se sinjali «tri pushkë e një bombë» s'mbetej kurrë midis rrugës, atë fshati ja përcillte fshatit dhe mali malit.

Mbi majat e malit Paping u dëgjua grahma e motorit të një aeroplani zbulues, që erdhi gjer mbi Përmet.

— Hë de, ja spiunët, e dërguan lajmin te gjermani:

— Mos luani nga vendi!

Asnjë fjalë. Vetëm aeroplani uturinte. Një ushtar italian i ekonomatës mori vrapin.

— Ulu në vend, pipino, ku shkon! — thirri Refat Arapi.

Aeroplani shkoi më tutje, nga malet.

— S'pa gjë, jo!
 Shtabi i brigadës diskuton:
 — Koha nuk pret, duhet të vendosim — u thotë
 shokëve Marengleni.
 Brigada vrapon. Populli vrapon. Në luginën anës
 lumit dëgjohej:
 — Brigada partizane u nis në luftë!
 — Populli shkoi në luftë!
 Po ku do të zinte pozicionet brigada? Ku do të
 zhvillohej lufta?
 — Po lumi?.. Kalohet Vjosa?
 Mbi pasarelë vrapojnë njerëz.
 Brigada vrapon. Populli vrapon.
 — Ku shkojnë?
 — T'u zënë pritë ushtarëve të gjeneralit Fon Gajb.
 — Në lumë e në det, aty shkojnë — tha një zë në
 turmë.
 — Ej, ti atje, pusho, mos hap panik!
 Ai nuk pushoi.
 — Pusho, he, t'u bëftë një xhëng në gjuhë! — shfryu
 gjithë inat Refat Arapi.
 Vjosa buçet... Ajo duket më e egërsuar, më e frik-
 shme! Mbi urën me tela, përkunden njerëz... Ecin duke
 u mbajtur anash. Me të vënë këmbët në bregun tjetër
 të lumit, vrapojnë të zënë shokët, të shkojnë në pozi-
 cione, të godasin armikun.
 — Më shpejt, o burra, më shpejt, — thirri Maren-
 gleni.
 Partizanët vrapojnë, bëhen erë... Shkojnë të zënë
 vendet, për t'i dhënë armikut goditje.

Komandant Goliku, që u nis me kompanitë e para,
 u caktoi atyre pozicionet dhe, pasi kërkoi të vinin ko-
 mandantët e komisarët e tyre, u ngjit në një lartësi të
 mbuluar nga malet. Atje shikohej gjithë rruga automo-
 bilistike gjër në Këlcyrë. Gjermanët sapo kishin thyer

forcat partizane në Kriçok, qenë vënë në kolonë dhe shpejtonin në drejtim të Përmetit. Në fillim Goliku u mundua që t'i numëronte një e nga një maqinat, por, si e pa që ju ngatërrua numri, i tha korrierit të tij të merrej me këtë punë. Pastaj u foli komandantëve të kompanive, që ishin mbledhur aty, të afroheshin, dhe, duke treguar me dorë andej nga vinte autokolona, u tha:

— E shikoni gjermanin? Ecën si i tërbuar dhe në varg maqinat njëra pas tjetrës. U kujtohet në Cepo ¹⁾, kështu erdhën edhe atëhere, me maqina të murme si këto dhe me autoblanda e tankse në krye dhe në fund. Kur vihen kështu në varg, s'dinë lku shkojnë, i fundit ndjek të parin, si puna e deles janë këta, dhe, në buzë e në shkëmb i pari, në buzë e në shkëmb i fundit — kjo është e gjitha! — I vështroi në sy, pastaj hodhi dorën në zverk si për të kujtuar fjalën që do t'u thoshte. — C'desha të them? Hë, desha t'ju them që duhet ta shtrëngoni zavën, të mbaheni de, atë të bëni, se kemi shokët, more djem, shokët më trima, që janë të plagosur, të na i zënë dhe të na i shkojnë në thikë, atë duan! Po do t'u marrin të keqen, prandaj, sapo të hyjnë të gjithë në pritë, sapo të dëgjoni ato viranet që vumë në xhade, gati! Bum, minat e bamp, ne. Njëherësh të bëhet zjarri, t'u përcëllojmë zhapën e barkut, atë t'u bëjmë kodoshëve! Apo jo, Halil?

Komandanti i kompanisë. Halil Imeri, që e kishte vendosur kompaninë më afër xhadesë nga të tjerët lëvizin kokën, shenjë që tregoi se ai që në një mendje me Golikun.

— Halil, o Halil, kujdes kësaj radhe, more! Shtrëngoje zavën, more!

Të tjerët dëgjonin fjalët që këmbente komandanti i asaj kompanie me komandant Golikun...

«E, pra si ju thashë, po, ju thashë që, pasi të bien autobлиндat e gjermanit në minat, që u vendosën në xha-

1) Vend në afërsi të Gjirokastrës.

de, do fillojnë të qëllojnë topat e brigadës, kështu u morëm vesh me Marenglenin dhe Voglin, ndërsa ju do të heshtni, s'kini punë ju, dëgjuat! Jua them këtë se mos ndonjë rrëmbëhet dhe fillon pushka, kjo s'do t'ju falet, prandaj vështroni këtu ku jam unë, do të dal majë bregut dhe do të qëlloj tri herë radhazi me pushkë, ama, sapo të zbraz të tretën herë pushkën, bjeruni dreqërve me ç'të mundeni.» U mendua pak, hodhi dhe një herë sytë nga Këlcyra. Kolona ngadalë, por gjithnjë e më shpejt po afrohej. «Dëgjuat ç'ju thashë, kur të zbraz së treti herë pushkën, t'u bini qenve të qenit, bjeruni ama ashtu si e dini vetë vençe, që t'i njohin djemtë e Shqipërisë, por me mend harxhoni fishekët, se mos zini gërr e gërr dhe, po mbetëm pa fishekë, do na ngjitet tedesku pas dhe s'kemi më ku të futemi. Kaq, s'kam ç't'ju them tjetër! Ikni tani, por me kujdes që të mos dukeni, vjedhurazi, të shkoni gjer në pozicionet dhe u thoni partizanëve as gëk dhe as mëk, gjersa të jepet shenja, të heshtni si dheu. Kur të japim shenjën, e dini vetë pastaj.»

Komandantët e komisarët shkuan nëpër kompani dhe u thanë partizanëve fjalët që tha Goliku.

Në rrugën e automobilit, anës Vjosës, aty afër, ku vështronin tytat e armëve dhe sytë e partizanëve, në Kosinë, kalonin maqina dhe njerëz. Partizanët i kishin zënë pozicionet në veri të rrugës, nga ku lugina sundohej krejtësisht. Zhurma e automjeteve erdhi më e fortë në pozicione. Asnjë partizan nuk lëvizte nga pozicioni. Duart, në çaste si këto, me zor largohen nga arma e sytë nga shenjestrat.

Dikush thërret:

— Mos luani nga vendet!

— Hë, more, ju atje, ç'po qëndroni ashtu majë bregut? Uluni, zini pozicion! — thoshte xha Refati. Nuk e njohën, ai që lëvizi ishte komisar i brigadës, Marengleni, që shkonte te partizanët e topit.

Sa shikoi pozicionin e topit komisar i brigadës, Marengleni, u tha:

- E, shokë, gati?...
- Gati, shoku komisar.
- Ta shohim, e njoh edhe unë topin. — Ulet, kontrollon gradimet, pastaj u drejtohet partizanëve:
- Goricën keni shënuar?
- Po.
- Mirë, shumë mirë!
- Ulet përsëri pranë topit, vështron në tejkqyrëse.
- Më duket se bashkë njihemi, në mos gaboj.
- Po! — ja ktheu komandanti i topit.
- Keni kohë në artileri?
- Që atë ditë që zbrazëm topat në Qafën e Gjash-tës.
- Ishe atëhere?
- Si jo, aty e zbrazta për herë të parë topin. Në fillim e kisha vështirë, por...
- Mësohesh. Çdo punë në fillim të duket e rëndë. Më ngjan se numërorët i ke të përgatitur.
- Tym do ta bëjmë dhe kësaj radhe, o shoku Marenglen, si atë ditë në Gjashtë.
- Pastaj Marengleni u largua, kaloi nga njëri pozicion në tjetrin dhe u ndal te Çerçiz Fejzua, që ishte ulur në afërsi të xhadesë.
- Hë, patriot, gati e ke mitralozin?
- ...
- Ki kujdes te kthesa e rrugës. Me kursim përdori fishekët, se do të kemi punë të gjatë me ta.
- U ngrit për të shkuar në pozicione të tjera. Çerçizi e shoqëroi me sy gjersa ai kaloi bregun, pastaj lëvizti pak nga vendi, ndërroi pozicion.
- Gojë më gojë në pozicionet e brigadës kalonte vetëm një fjalë.
- Gati! Gati!
- E përmendi edhe Çerçiz Fejzua fjalën «gati» dhe u përgatit më mirë, vendosi qytën e mitralozit në sup dhe mori shenjë...

Armiku u shfaq para pritës partizane në fshatin Kosinë.

— T'u biem! T'u biem! — thanë te topi.

— T'u biem! — thanë të gjithë.

— Jo, duhet të afrohen, prisni! — urdhëroi komi-sari i brigadës.

Përpara një autobлиндë, mandej një tanks... Ecën përpara kompania tankiste, pastaj qëndron në vend gjersa e arrijnë ushtarët.

«Po kjo? Këta duket sikur po shkojnë në Përmet me bandë e zurnara. I gënjen mendja.»

— T'u biem — thanë prapë te topi.

— Jo! — kundërshtuan të tjerët.

— Jo?

— Pritni, akoma nuk duhet.

— Deri kur do të presim?

— Të futen më parë në mina... Kështu ka urdhëruar Marengleni.

— Mina?..

— Po, është minuar rruga.

Partizani tundi kokën, i erdhi mirë që në rrugë genë vënë mina.

Kaloi autoblinda e parë në urë.

— Nuk plasën, nuk plasën minat!.. — thanë shumë zëra.

Autoblinda shkoi edhe pesëdhjetë metra të tjera më afër qytetit, më afër urës, të cilën partizanët duhej ta mbronin me çdo kusht derisa të zbriste nga Zagoria dhe të kalonin Vjosën forcat që vinin andej.

...Një buçitje; tymi në formë këpurdhe ngrihet lart.

Oshëtin rëndë një copë herë Dhëmbeli e Papingu. Partizanët, kudo që ishin, në Dhëmbel dhe në pozicione, i mbërthyen sytë në atë vend, ku u ngrit si këpurdhë tymi i zi. Pastaj përsëri shpërthime të tjera në xhade. Tymu u ngrit po në atë lartësi, oshëtimat të njëjta. Tan-

kset e maqinat frenuan në vend. Ushtarët me helmëta vështronin përpara, ndjenin frikë, por as që u shkonte ndër mend që nga afër i kishin vënë në shënjestra pushkë e mitraloza.

— Ç'presim akoma? Zjarr!

Zëra:

— Në shenjë, në shenjë!

— Shënoni autobлиндën tjetër, mbushni topin! —
thirri komandanti.

— Gati!

Autoblinda tjetër tërhiqet, kalon mbi urë.

— Zjarr!

— Topi oshëtiu... Autoblinda u godit, nxori tym.

— Zjarr!

Fërsëri tym...

Kolona armike përçahet. Partizanëve të plagosur dhe popullit, që zbriste nga Dhëmbeli, u dhanë urdhër:

— Më shpejt!..

Pas krismave të armëve, nën kodrat e fshatit, në rrugë, disa automjete nxirrnin tym. Ushtarët, që u vranë, ende s'kishin mundur t'i hiqnin, ndërsa ata që u shpëtuan plumbave, u strukën në anë të Vjosës bashkë me komandantin e batalionit të tyre, majorin Diter Grebner.

Goditja e pritës në befasi e struku batalionin e Diter Grebnerit buzë valëve të Vjosës. Kjo goditje ishte reja që paralajmëronte goditje edhe më të forta dhe e turbulloi vështrimin e kthjelltë të komandantit të batalionit, por nuk i vari buzët dhe as i rrudhi vetullat, sepse ai kishte besim në vetëvete dhe në ushtarët e batalionit të tij.

Filloi përsëri sulmin.

— Po vijnë, shoku Marenglen — tha komandanti i batalionit.

— ...

— Ku shkoi Vetëtima? — pyeti Marengleni për komisarin e batalionit.

— Drejt shkëmbit, andej nga rruga.

— Shumë mirë.

Gumëzhima e maqinave të hekurta po afrohej. Marengleni dhe komandanti i batalionit vështronin armiqtë.

— Zjarr mbi nazistët! — thirri komandanti i batalionit.

Edhe Marengleni qëlloi mbi armiqtë.

— Sulm, para, djem, përpara! — thirri Marengleni, dhe bashkë me komisarin e batalionit, Vetëtimën, u hodh në sulm.

Predha topi, plumba ngado. Marengleni dhe Vetëtima, komisari i brigadës dhe i batalionit, zbresin nga mali drejt rrugës. Zëri i komandantit buçet afër armiqve. Automatiku i Vetëtimës vjell zjarr parreshtur. Ai vrapon drejt armikut, kapërcen një ledh are, del në qoshe të një ndërtese dhe qëllon. Autoblinda e parë i afrohet. Vetëtima ngre dorën të hedhë bombën, por goditet në dorë. Gjaku i ndizet, sytë i lëshojnë flakë.

— Tërhiqu!

— Nuk tërhiqem! — Sulmon përpara në një hap me partizanët e batalionit.

— Tërhiqu! — urdhëron prerë Marengleni dhe shtie mbi armiqtë.

Majori Diter Grebner struket përsëri në anë të Vjosës.

Zhurmojnë prapa tij valët e egra të lumit. Përpara, në errësirën e natës, shquhen flakët e pushkëve. Majori nazist kërkoi të bisedonte në radio dhe, ndërsa ushtari radist mundahej të hynte në lidhje me komandantin e regjimentit Diter Grebner u struk me gjithë forcat e tij në anë të lumit. Kërkonte ndihmë.

Të tjera maqina të hekurta afrohen...

Natë...

Çdo gjë në fushë e në mal ka ngrirë. Era fryn parreshtur dhe rrëmben nga kreshtat e maleve dëborë.

Humbasin gjurmët, humbet rruga... Po kolona partizane me të plagosur, që ngjitet malit të Dhëmbelit, ecën.

— Doktor, keq e kemi! Të ftohtët e janarit hyn edhe në bririn e kaut.

Doktor Medini ecën, nuk i përgjegjet.

— Doktor, të ndalemi këtu, kam dhembje.

— Jo, edhe pak.

— Po ku shkojmë kështu, doktor, ku?

— Në male.

— Aha, mirë, mirë!

I plagosuri qetësohet, pushon. Doktor Medini i vë dorën mbi ballë. «I plagosuri paska temperaturë». Pas-taj shkon pranë një partizani tjetër të plagosur.

Pas kolonës, në Zagori, gjëmon mitralozi e topi. Fshatrat digjen. Kudo hyjnë kësaj ane ushtarët gjermanë. Praparojet partizane luftojnë. Gjermanët pikasin rrugën nga largohen të plagosurit dhe të sëmurët e spitalit të Zagorisë dhe i ndjekin prapa.

— Vendi është akull. Era e Dhëmbelit të pret.

Një i plagosur pyet:

— Po tërhiqemi?

— ...

— Ku do të shkojmë?

— Më lart, po vijnë gjermanët.

— Si s'na u ndanë, zagarët!

Retë trazohen në qiell. Në fytyrën e të plagosurve përplasen copat e dëborës, u mpihen duart e këmbët, edhe trupi u mpihet...

Drita e një elektriку të dorës ndriçon në errësi. Çelin një shteg me lopata. Një përgun me dëborë kalon vargu i të plagosurve. Kalon edhe ai, njeriu që ka në trup shtatë plumba. Në krah atë e mbajnë katër veta. Të katërve u fundosen këmbët në dëborë. Të gjithë janë të lodhur e të mpirë. Ecin edhe dëgjojnë. Sa herë që shoku i tyre rënkon, ndalen, mundohen të shkelin lehtë mbi tokë, i flasin mjekut, mandej përsëri vazhdojnë rrugën.

Nata e dimrit është e gjatë. Spitali partizan gjatë asaj nate udhëtoi pa asnjë pushim. Të gjithë ecnin.

Po afronte mëngjezi, por ende ishte errësirë e madhe.

— Ylli i mëngjezit është ai?

— Jo, moj Bukuri, është akoma larg dita.

Bukurisë i mbylleshin sytë nga lodhja. Asaj i duhej të luftonte jo vetëm me borën e furtunën, por edhe me gjumin. Nga kreu i kolonës erdhi fjala:

— Shpejt, më shpejt, shokë!

Ngjitën të përpjetën e fundit, dolën të gjithë në Qafën e Dhëmbelit. Të priste fytyrën era e ftohtë. Posh-të, në luginën e Vjosës, ishte ende errësirë. Shiheshin shirita dritash që lëviznin; ato vinin nga dy drejtime nga Janina dhe Berati e i afroreshin Përmetit.

— Gjermanët! — tha doktori. Kur i pa aq afër urës së Përmetit forcat e armikut, doktori ndjeu kraharorin t'i bëhej akull; ju duk sikur atje vërshoi, si nga një derë e hapur, thëllimi therës i Nemërçkës. Ndjeu atë çast dhembjen e të gjitha plagëve të partizanëve të plagosur. I ndjente ato tani ndryshe nga herët e tjera.

— Gjermanët! — murmuriti përsëri, rrudhi ballin ... heshti.

— Po hedhin sinjale pizevengët, doktor?

— Ç'të jenë këto? — pyeti doktori.

— Ç'janë? Ushtritë lidhen me këto drita më mirë se me telefona e radio.

— Gjendja është e vështirë, — tha doktori — veç s'kuptoj pse zhurma e luftës është fashitur. Mos është tërhequr brigada partizane nga lugina e Vjosës? Ky mendim, që disa herë i kishte pushtuar mendjen, e hodhi në një dëshpërim, që e vunë re edhe partizanët, që u ndodhën atje. «Pse kjo heshtje varri, ç'të jetë kjo» i tha doktori një infermieri. Por atë çast, fare papritur, një breshëri armësh u dëgjua në këmbët e Dhëmbelit, poshtë, afër brigjeve të Vjosës. Erdhi gjer sipër në majat e malit gjëmimi i thellë i armëve, kaloi nga njëra pllajë në tjetrën, ja përcolli shkëmbi-shkëmbit.

Më në fund, edhe partizanin ezmer me flokë të zes dhe shtatin si lis e ngjitën në Qafën e Dhëmbelit.

— Uleni! — u tha doktori.

Ata u ulën.

Partizani i plagosur rënkoi. Doktori i shkoi afër, i zuri pulsën... Partizani ngriti qepallat, duke lëvizur pak fytyrën e verdhë. Doktori vështroi sytë e djaloshit që i ishin fundosur në zgavra.

«Si dy sy të vdekuri» murmuriti doktori. I plagosuri tha:

— Ti je, doktor?

— Si dukesh, o trim! A ke të ftohtë, Dardan?

Doktori nuk e pyeti për plagët; e dinte që ato i dhembnin.

Përsëri i plagosuri mbylli sytë. Doktori i bëri një gjilpërë me kamfor. I plagosuri e ndjeu veten më mirë. Ai e vështronte doktorin në sy sikur donte t'i thoshte: «Mos u shqetëso, doktor, unë do të rroj»!

Dhe kaloi në Qafën e Dhëmbelit barela e fundit, partizani i fundit. Pra mbeti rruga e çelur në dëborë, rruga e skuqur me pika gjaku, që rridhnin nga plagët dhe këmbët e plasaritura të partizanëve, të cilët mbainin në krahë shokët e plagosur.

Ata që të katër e harruan lodhjen. Shoku i tyre, Dardani, më në fund kishte folur. Përsëri doktori mendohet: «Kush është më hero, partizani i plagosur, apo shokët e tij që e ngjitnin dhe e zbresin në shpinë këtyre maleve të larta të mbuluara nga bora e akulli? Miqësia e tyre më ngjan me shkrepimat e natës së shëndreut: Sa më e zyrtë të jetë nata, aq më shumë ndriçojnë ato.

Komandant Meleqi, që u nis të mbronte rrjedhën e sipërme të Vjosës, duke shfrytëzuar një linjë telefonike, që kalonte asaj ane, flet në telefon me komisararin e brigadës. Njofton:

— Te ura e Devojkës¹⁾ dolën ushtarët armiq.

— Sa janë?

— Një regjiment.

— Të divizionit të Janinës?

— ...

— E ndreqën urën? (Urën partizanët e kishin hedhur në erë).

— Jo.

— Forconi vrojtimin dhe merrni masa, kaloni në anën tjetër të Vjosës; të zihet dhe të mbahet Mali i Bardhë. Duhet me çdo kusht të qëndroni, mbasi ende vazhdon kalimi i të plagosurve dhe i njerëzve në urën e Përmetit. Mbjajtja e pozicioneve në Mal të Bardhë ka rëndësi të dorës së parë. Me çdo kusht duhet të qëndroni! Ua shpjegoni partizanëve mirë detyrën. Kini kujdes! Më kuptoni?..

Nga pjerrësitë e Papingut u ulën dy aeroplanë gjermanë, zbritën drejt tokës, si t'u qenë këputur krahët. Manoli, që kishte venë në shqehëzën e shënjestrës së mitralozit ushtarët nazistë, nuk mundi të ngrinte kokën që t'i shikonte. Zhurma u largua.

— Kaluan edhe këta si të tjerët... Duket që brigadën tonë kërkojnë — i tha shoku Manolit.

— Gjithnjë janë të shtangur nga sytë njerëzit e ballonave, e kam provuar unë... Po qëndrova në vend, të marrin për dru e për shkëmb dhe s'të ngasin. E hanë sapunin për djathë ballonat.

U dëgjuan disa herë me radhë të kollitnin mitralozat e aeroplanave, gjëmuan dhe tri bomba njëra pas tjetrës.

— Mitraluan në qytet!

Manoli u ngrys në fytyrë, i shkoi mendja te nëna, te motra, te xha Golja dhe njerëzit, që kishin mbetur ende atje.

— Ja, qëllojnë urën, atë qëllojnë. Duan ta prishin që të mbeten forcat e Zagorisë dhe spitali, të rrethuar.

1) Urë në rrugën Konicë-Përmet.

Mbi urën e Vjosës ende kalonin të plagosurit.

Të gjithë partizanët e partizanet, edhe ata që ishin vendosur në Mal të Bardhë, edhe të tjerë, që zunë pozicione në Kosinë, vështruan nga Përmeti tymin që u ngrit nga bombat e hedhura prej aeroplanave. Mos vallë atë që nuk e bënin dot batalionet e armikut në vijën e sulmit po e bënte një bombë aeroplani.

Manoli s'mundi të hiqte syrin nga shenjestra. Drejt tij vinte me armë në duar një skuadër me ushtarë gjermanë.

Buçiti boria.

Në të njëjtën kohë u zbrazen të gjitha pushkët e batalionit, të gjithë mitralozat.

Ushtarët gjermanë, ata që nuk kishin marrë ende plumba në trup, u tërhoqën prapa, u fshehën pas një mulliri. Pastaj u bë qetësi. Nauni nuk i binte më borisë, pushkë nuk zbrazeshin më. Edhe Manoli e ndërroi krëhërin e mitralozit. Dikush thirri. Manoli e njohu atë zë dhe i tha shokut:

— Ka ardhur Marengleni, komisari i brigadës.

— ... E mora me mend që ai do të ishte këtu.

— Nga?

— E di unë; po ngriti pritën Marengleni, di ai si e bën. Ja, si këtë që po sheh. Dru që hëngrën gjermanët... as që u shkonte në mendje se ne ishim këtu, në Mal të Bardhë, apo jo?...

Partizani i buzëqeshi Manolit.

U dëgjua përsëri zëri i Marenglenit.

— Kini kujdes, krahu i djathtë, pregatituni!

Atë çast Manoli e mbërtheu sërish vështrimin atje, ku bashkohet lumi Lëngarica me Vjosën, disa hapa poshtë urës. Në zallin e bardhë dilnin nga lumi peshq të trullosur dhe rrëmbeheshin sërish nga përplasja e valëve... Manoli, kur ishte i vogël, gjithnjë vinte nga qyteti gjer këtu me pesë-gjashtë çapkënë dhe mbushte trastat me peshq.

— Ç'peshk që mbeti atje!

— Ku?

— Nuk e shikon si lëvrin ujët? Po shteroi edhe cazë Lëngarica, mbetën në zall...

U dëgjuan të lehurat e thata të një mortaje. Në pozicionin e Manolit ato erdhën si një krismë e venitur revolveri. Pastaj filluan të shpërthenin predhat.

Nazistët kërkonin me çdo kusht që të merrnin Malin e Bardhë, dhe, fap, i mbërthyen bajonetat te grykat e pushkëve. Sulmin e filluan me një thirrje të çjerrë në gjuhën e tyre.

— Zjarr, shokë partizanë, zjarr! — thirri Marengleni dhe pushkët u bënë më të dendura. Nëpër gurët e bardhë u ngrit tym. Radhët e armikut u lëkundën.

Qëlloi edhe i biri Gole Përmetarit, Manoli, me mitralozin e tij. I ra dhe më shumë borisë Nauni, komandoi me zë të lartë komisari i brigadës:

— Bjeruni fashistëve, shokë!

Nga mali i Dhëmbelit ende zbrisnin njerëz dhe në urë vazhdonin të kalonin të plagosur...

11

Erdhën në bregun e Vjosës edhe tre partizanë dhe partizanja Bukuri, që mbartnin në shpinë barelën me Dardanin.

Më shumë e ndjenin dhembjen e plagës njerëzit kur tundeshin e përkundeshin mbi urën me tela. Po i vinte radha të kalonte mbi urë barelës me djaloshin zeshkan. Fytyra, si gjithnjë, i mbeti Dardanit ashtu, e bronxtë. Atë e rrihnin rrezet e diellit, por Dardani nuk i ngrinte qepallat; ishte i dërmuar nga plagët, nga lodhja.

Komisari i brigadës, Marengleni, kthehej nga Mali i Bardhë në Shtabin e Brigadës për të biseduar me Voglin dhe Golikun. Rruga e nxori në afërsi të urës ku kalonin të plagosurit, u kthye dhe qëndroi disa minuta në bregun e lumit duke vështruar njerëzit, që kalonin në urë.

Një nga partizanët e komandës së vendit u ankua:
— Do rregull kalimi i urës, shoku komisar.

Marengleni nuk foli. Ai e konsideronte të përfunduar këtë çështje. Ishin të plagosurit e fundit, që po kalonin Vjosën.

Marengleni u hodh në anën tjetër dhe arriti vigun e fundit.

— E? Si duket? — u tha i shqetësuar komisar mbartësve të të plagosurit. Ata u ngritën, nderuan me grusht dhe nuk folën, por nga vështrimet e syve të tyre dukej sikur i thoshin:

«Rëndë, shumë rëndë është, shoku komisar!» Komisarit ju pasqyrua në fytyrë hija e dhembjes që ndjente për të. Ditën që u plagos, kishte qenë bashkë me të, në vijën e parë të luftës. Ja dinte edhe vendet e plagëve, ja dinte forcën e guximin, deshte t'i fliste, por u përmbajt e përsëri pyeti:

— Është përmendur rrugës?

I njëjti vështrim nga ata që e mbartnin.

— Jo?

«Megjithatë Dardani do të rrojë» tha me vete. Pastaj ngriti zërin:

— Po doktori? Ku është doktori?

Një partizan u afrua, nderoi me grusht.

— Ju jeni **doktori?**..

12

Kolona me njerëz, që zbriti nga Zagoria dhe që shkante nga Përmeti në Frashër, lë një vazhdë në dëborë; kudo shiheshin gjurma. Partizanë me barela në krah, të sëmurë, pleq e fëmijë ngjiteshin drejt maleve të Frashërit; dalin përsëri në borë. Formohet në mal, mbi dëborën e bardhë, një vijë e zezë e lëvizshme. Dhe atje godet përsëri topi. Në dëborë mbeten shenja të zeza. Spitali po tërhiqej...

— Ku shkojmë, doktor? — pyesin të plagosurit.

—

— Zonë e lirë është andej?

— Malet janë të larta — tha doktori.

Këndeј s'kanë fund malet. Gjenerali gjerman Fon Gajb i kishte shënuar në hartë këto male dhe u kishte dhënë drejtim divizioneve të tij që t'i shkelnin një nga një. Në shumë vende doli alpinisti gjerman, zbrazti mitralozin, por mbeti në male, bashkë me armën. I ngriu arma, i ngriu edhe zemra.

— Mbeti zonë e lirë ajo anë?

— ...

— O burra, andej!

Kolona lëvizte e ngjiteј malit. . .

Mbi urën prej teli po kalonte barela e fundit me Dardanin e plagosur. Qenë vonuar në anën tjetër të lumit, gjersa doktori i kishte mjekuar Dardanit plagët. Bukurisë ju bë sikur i iku lodhja nga shtati, sapo tha doktori se Dardani kishte shpresë të shëroheј. Të katër e ngritën në krahë dhe u nisën. Ishte barela e fundit që kalonte Vjosën. Ura, si gjithnjë, lëkundej. Ishte e vështirë të ecje mbi të e të ruaje ekuilibrin. Në çdo lëvizje ura dridheј dhe Dardanit i lëndoheshin plagët.

Në qiell u dukën nga ana e Frashërit dy njolla të zeza. Vargu i gjatë me njerëz dhe me partizanë të plagosur, që arrinte nga bregu i lumit gjer në bredhat e Hotovës, u ul në tokë. . .

Aeroplanat bombarduan disa herë gjatë ditës.

Bukuria dhe mbartësit e të plagosurit ishin midis urës, ndërsa njëri pas tjetrit aeroplanat po uleshin mbi Vjosë. Zbritën gjithë tromarë drejt mbi urë.

Bukuria dhe të tjerët qëndruan një çast. Dëgjuan nga afër uturimën e motorit të aeroplanit ndjekës gjerman. Bukuria lëvizi supin dhe u mundua të shikonte andej. Dalloi krahët e hollë ngjyrë hiri të aeroplanit, që, duke ulëritur, u vërsul mbi urë e mitraloi. Në urë mbetën shenjat e plumbave. . .

Shqetësim në kolonë. Zëra:

— Mos luani nga vendet!

Mbartësit e të plagosurve shpejtonin të dilnin nga

ura. Një tjetër «Stukas» erdhi mbi ta... Në urë përsëri mbetën shenja të tjera plumbash. Njëri nga mbartësit e të plagosurve u gjunjëzua. I plagosuri rënkoi.

— Rrëshqite? — i tha Bukuria shokut që kishte në

krah.

Kujdes!

— ...

Poshtë buçisnin valët e harbuara të Vjosës.

Ai nguli gjurin e djathtë, mblodhi forcat, u ngrit në këmbë. Vazhdoi të ecte... I merreshin këmbët, çalonte.

— U plagose? — pyeti përsëri partizanja.

— Jo! — u përgjegj ai.

— Po ty të merren këmbët!

— Jo — kundërshtoi përsëri partizani. — Gjë e lehtë. Dhe vë dorën në kofshën e djathtë që e shtrëngon fort.

U ngjitën edhe më lart, ndoqën po atë rrugë, ku kishin kaluar të tjerët. Dolën te një bregore, pastaj u ngjitën në fshatin Bodar. Atje u ndalën. Pushuan një çast në këmbë.

Dëgjuan afër krismat e luftës. Në Kosinë, në bregoret e tjera anës rrugës, ende luftohej me ashpërsi me forcat armike, që vinin nga Berati e Gjirokastra, ndërsa në Mal të Bardhë, luftohej me ato që vinin nga Janina.

Erdhi urdhëri:

— Të tërhiqen më shpejt shokët e plagosur!

— Dolëm nga rrethimi — tha partizanja.

Dardani ngriti një çast qepallat. Fjala e gëzoi...

— Deri në mbrëmje duhet të arrijmë në Malin me Bredha — i tha Bukuria shokut në krah.

Ai nuk u përgjegj.

— Pse hesht, u lodhe? Edhe ky mal është i pjerrët.

— Bukuria e pa që shoku i saj ishte zbehur në fytyrë, ndaj përsëri i tha:

— Je plagosur?

— Jo.

— Nisemi, duhet të ecim më shpejt.

U nisën. I plagosuri heshtte. Partizani që mbante në shpinë, përsëri u gjunjësua, s'pati më fuqi të ngrihej. Shokët panë që i rridhte gjak.

— U plagose?

— ...

Doktori i lidhi plagën. Ai përsëri u ngrit, mori barelën në krah, ju ngjit malit.

Doktor Medinit sërish i shkoi në mend:

«Kush është më hero, ai që ka shtatë plagë në trup, apo këta që e mbajnë në shpinë?»

KAPITULLI I DYTË

*Armiku na shikon si halë në sy,
ne si plumb e shpojme në zemër.*

1

Goliku ndiqte me vëmendje të madhe kalimin e spitalit partizan, ndaj u gëzua shumë kur Marengleni e njoftoi me një letër se të gjitha forcat që ishin në anën tjetër të Vjosës kishin kaluar lumin. Njoftoi për këtë lajm forcat që qëndronin në afërsi të rrugës dhe urdhëroi që të mbaheshin pozicionet deri në mbrëmje. Kjo ishte e domosdoshme se ditën e kishin të vështirë të lëviznin dhe ajo që ishte më kryesore, ndalja e armikut në vend, i jep-te kohë spitalit partizan dhe popullit të fshatrave anës rrugës të tërhiqeshin më në thellësi të maleve.

Refat Arapi, që kishte qenë në takim me komandantin e kompanisë, Halil Imerin, sa erdhi në skuadër, u tha shokëve:

— Djema, shokët i shpëtuam nga rreziku, por, derisa armiku qëndron akoma si kukudh para nesh, prapë do të kemi telashe. Armiku na shikon si halë në sy, ne si plumb e shpojme në zemër.

Nazistët zunë të drejtoheshin përsëri në formacion luftimi në bregoret nën fshatin Kosinë. Filluan luftimet.

— Më thirr Çerçiz Fejzon — i thotë korrierit komandanti i kompanisë partizane.

Disa minuta më vonë, duke u zvarrisur, Çerçizi u hoq disa hapa prapa. Si kaloi ca shkurre, ndoqi një përrua të vogël, pastaj u ngjit lart e doi te bregu në fund të fshatit Kosinë, ku disa shtëpi e plevica kishin marrë zjarr. Si u zvarris dhe ca barkaz, ju paraqit Halilit, komandantit të kompanisë.

Qëndruan disa minuta afër njëri-tjetrit. Komandanti i kompanisë, Halili, fliste, Çerçizi dëgjonte e rrallë e kthente vështrimin nga ai. Halil Imeri kishte tipare burrërore, fytyrën ja lezetonin një palë sy të shkathët korb të zinj. Ishte i pashëm, shikonte ëmbël dhe rreptë. Kur bisedonte për çështje serioze si ato që po bisedonte atë çast me Çerçizin, shprehjen e fortë të syve të tij e theksonin akoma më tepër vetullat e përqëndruara midis ballit. Edhe kur kishte çështje tepër të rëndësishme, Halili buzëqeshte dhe buzëqeshja e hijeshonte aq shumë, sa që veç doje ta shikoje.

— Babaxhan e kemi komandantin e kompanisë — u kishte thënë shokëve Çerçiz Fejzua, sapo kishte mësuar ditën që ishte formuar brigada se komandant në kompaninë e tyre qe caktuar Halili.

Halili vishej bukur, mbante të varur në gjoks një gajtan të bardhë, me çorape e jelekë leshi lara-lara, opingat e llastikta i puthiteshin për këmbësh, xhaketa ja tregonte trupin më të mbushur, qilatat e prera për merak dhe kapelja partizane prej leshi të bardhë me yllin e kuq midis gjithë asaj veshjeje të thjeshtë kishin bukurinë dhe elegancën e tyre. Çerçizi vështronte jo aq tiparet e veshjen, sa shpirtin e njerëzve. Dhe Halil Imeri i qe dukur njeri i pastër nga shpirti, si qelibari, komunist i vërtetë. Por u dëshpërua shumë, kur Halili i tha:

— Do të zësh shtegun mbi atë shkëmb, Çerçiz. Ja aty do të dalësh! — Çerçiz Fejzua puliti njërin sy dhe turfulloi:

— Ç'thua?

Çerçizi u largua dhe i erdhi keq që, në kohën kur të tjerët do të luftonin, ai të ngrihej nga pozicioni për

të shkuar gjetkë, në një vend ku do të qëndronte ndoshta duarkryq.

Andej nga shkoi Çerçizi, po vinte një kompani me ushtarë gjermanë, të cilëve u printe komandanti i batalionit nazisti Diter Grebner, që kishte marrë urdhër të kapte Gurin e Kosinës dhe t'u dilte në shpinë forcave të batalionit partizan. Kishte kaluar dreka, kur filluan luftimet. Lugina e Vjosës përsëri jehoi nga krismat.

— Sot do t'ua bëjmë më zi nga dje, kanë për të parë — tha me vete Çerçizi dhe i jepte të drejtë Halil Imerit. «I merr me mend para kohe komandanti ynë se ç'duan të bëjnë nazistët» i tha shokut që kishte në krah, por ai, duke mos e kuptuar se ku e kishte fjalën Çerçizi, heshti.

Një tanks po ngjitej drejt tyre dhe doli te Guri i Kosinës. Aty u ndal... Partizanët vështruan njëri-tjetrin. Në luftë vështrime të tilla këmbehen rrallë. Tanksi qëlloi në fillim me mitraloz, mandej edhe me top. Zbrazi vetëm tri predha topi dhe përsëri lëvizi nga vendi.

Ushtarët erdhën edhe më afër. Kalonin nëpër një kanal, që dredhonte fushës. Nazisti Diter Grebner që bëre një me tokën. Ecte me kujdes, mbante të varur në gjoks automatikun, në dorë parabelin. Mbas tij nëpër hendek shkëlqenin helmata të tjera. Tanksi ecte anës kanalit. Të gjithë shkonin drejt shkëmbit, atje ku qëndronte në pozicion Çerçiz Fejzua. Partizanët këmbenin fjalë:

— Ç'qenka kjo bina hekuri si një përbindsh i gjallë!

— Edhe lubia e hekurt i ka frikë gërxfhet tona... Le të afrohet, pa e ka për të parë... Do ta qajë gjermanka gjermanin.

Tanksi ngjitej duke uturirë. Ndalej një hap e qëllonte. Sa herë që qëllonte nga shpina e hekurt e maqinës, topi dridhej sikur teshtinte dhe lëshonte flakë e tym nga gryka. Oshëtima shkante e përplasej me forcë në shkëmb.

Predhat godisnin në të njëjtën kohë edhe shkëmbin, edhe tanksin. Tanksi as që donte t'ja dinte nga plumbat

e mitralozit të Çerçizit, ndërsa shkëmbit i mbeteshin vrima si plagë nga goditjet.

Tanksi po afrohej gjithnjë e më tepër. Partizanët e dëgjonin më fort zhurmën e tij. Çerçizi i pa topit grykën e lartë e kërcënuese. Për një çast nuk qëlloi as tanksi, as mitralieri. Pastaj, në shkëmbin e Kosinës diçka fishkëlleu, dha vetëtimë, gjëmoi, goditi, shpoi në shkëmb. Çerçizit ju zbe fytyra, i buçitën veshët. Pastaj ndjeu dhembje. Në shkëmb binin predha të tjera.

Çerçizi me sy të hakërryer vështronte maqinën prej hekuri që vinte drejt shkëmbit, vështronte helmetat që vinin nëpër kanal. Murmuriti me zë: «Më lanë veshët!» Dhe kjo i dukej më shumë se të plagosej, më e frikshme nga predhat e topit që godisnin shkëmbin. Bëri të ngrihej më këmbë, por një tjetër e zuri nga palltua dhe e uli në pozicion.

Çerçizi ktheu kokën. Ishte një nga shokët e tij. E para herë që Çerçizi nuk e dëgjonte zërin e tij. U mundua të ngrinte zërin. Prapë nuk dëgjonte. Përsëriste të njëjtën fjalë:

«Veshët, shokë, më lanë veshët!»

Tanksi i doli ballas e mu afër.

Njëri nga partizanët hodhi para tij dy granada. Çerçizi i dalloj nga tymi, sepse veshi nuk ja kapte mirë zhurmën. Tanksi ndërroi rrugë, eci anës bregores, nën fshat. Përsëri qëlloi...

U përleshën atje afër disa partizanë me ushtarët e kompanisë armike që vinin përroit bashkë me tanksin. Tanksi i madh, i rëndë e kërcënues, vazhdonte të shtinte me top. Partizanët hidhnin bomba.

— Mbi të, vëllezër — foli Flamur Sabriu, duke dalë nga pozicioni për të hedhur bomba. Tanksin e mbuloi tymi. Por ai prapë lëvizì dhe qëlloi me top. Flamuri mori një plagë të rëndë. Dy partizanë të tjerë u vranë dhe një fshatar u plagos në fyt nga copat e predhës.

— Tërhiqu — e urdhëruan fshatarin. Ai largohej nga pozicionet me këmbët e tij. Disa shtëpi të tjera morën flakë. Dëgjoheshin klithma fëmijësh.

— Të zbrazet fshati — urdhëroi Goliku.

Kompania me ushtarë gjermanë, që erdhi gjer te tanksi, mbeti në vend. Më kot mundohej nazisti Diter Grebner të hidhej përsëri në sulm.

Oshëtima e luftës kalonte shpat më shpat e grykë më grykë. Krisma në Kosinë... Krisma në Mal të Bardhë, krisma në tokë... Krisma edhe në qiell. Krismat e armëve pushtuan gjithë luginën e Vjosës. Vetëm jehona krismash përplaseshin në mal e në shkëmb.

Skuadra e Refat Arapit ishte vendosur në anën e majtë të shkëmbit të Kosinës.

— Duhej tani mitralozi i Dardanit. Po mitralozi i Dardanit disa javë më parë kishte dalë jashtë përdorimit dhe vetë Dardani qe plagosur aq rëndë, sa që Refat Arapi ja kishte hequr shpresën. Të qe Dardani me mitraloz, ndryshe do ta ndjente veten Refat Arapi, por, as Dardani dhe as Bukuria nuk qenë më në skuadër. Tani e kuptonte Refat Arapi se krismat e mitralozit të Dardanit dhe zëri i këtij qenë derdhur në shpirtin e tij dhe po e ndjente që s'ishte i qetë pa ata. Megjithatë duhej të mësohej edhe pa to. U foli shokëve të skuadrës:

— Gati!

Vocua e kishte luftën e parë me gjermanët këtë. U pre në fytyrë. Edhe kur të tjerët e nisën luftimin ai ende s'po e zbrazte armën.

— Qëlllo, ç'pret!

— ...?

Refat Arapi qeshi me të madhe. Vocua u prek në sedër. Pastaj e mblodhi veten dhe filloi të qëllonte kundër armikut. Shihte që binte ndonjë ushtar armik në tokë dhe gëzohej. Pandehte se rrëzoheshin të gjithë të vdekur në tokë. Sa e shikonte armikun që shembej në tokë, krekohet:

— Unë e vrava, unë! — thoshte me vete dhe kthen-te kokën, se mos kishte qëlluar tjetër njeri. Kur... ç'të shihte, pranë tij qëndronte me pushkë në sy dhe qëllonte Refat Arapi.

— Xha Refat, unë e vrava atë, apo jo? — e pyeti. Refat Arapi, që s'e hoqi syrin nga shenjestra, i tha: — Po, bir i xhaxhait, ti, Voco, e vrave, por mos lëviz nga vendi. — Po a mbahej Vocua? Ai kishte provuar luftën dhe kishte ç'të tregonte nga kjo luftë. Kishte provuar luftën dhe kishte vrarë fashistin e parë... Gëzohej. «Hej», thoshte «tashti jam luftëtar i brigadës partizane»! Befas ndërroi pamjen dhe e preu fjalën.

Në pozicione erdhi lajmi:

— Gjermanë të tjerë po vijnë që nga Këlcyra.

— More, gjithë Gjermania s'ka ardhur akoma? — tha Refat Arapi dhe, si rregulloi pozicionin për qitje, filloi të qërtonte veten për atë mendim, që kishte pasur për Halil Imerin.

— Pregatiten për qëndresë, dërguan për fishekë e bomba...

2

Kolona me njerëz të plagosur nga çasti në çast ngjitej më lart malit.

Dardani ndjente çapet e shokëve që e mbanin në shpinë, frymëmarrjen e Bukurisë dhe krismat e armëve. Me mendje, ai shkoi një çast në vijën e parë të luftës, atje ku brigada partizane luftonte edhe për Dardanin e shokët e tij të plagosur.

Bukuria u ndal. Kishte dëgjuar murmuritjen e Dardanit. I hodhi një vështrim. Qepallat e tij ishin mbyllyr. Pastaj, si ndërroi supin, u nis.

Spitali partizan ngjitej më lart. E tërë kolona me njerëz e ndiqte në gjurmë.

Komisari i brigadës, Marengleni, kishte dalë mbi gurët e Zleushës në Qafën e Hajdinit¹⁾ dhe vështronte me dylbi kolonën më të plagosur dhe vijën ku bëheshin luftimet.

1) Vend ku u luftua në ditët e Operacionit të dimrit.

Komisarit i vinin lajme nga anë të ndryshme. Shpesh ato ishin alarmuese, por ai qëndronte i qetë atje në shkëmbinjtë e Zleushës. Dikush i doli përpara dhe i tregoi një nënë me një fëmijë të vdekur.

— Ja vranë në duar, i farmakosën zemrën, shoku komisar!

Gruaja nuk foli, i kishte ikur zëri, i qenë shteruar lotët. Ecte me fëmijën e vdekur në duar dhe me dhe-
mbjen e thellë në zemër.

... S'kishte mundësi ta varroste. Ende malit me foshnjën në duar, pa ditur se ku shkonte. Dhembja ja kishte mpirë mendimet.

Korrieri vuri re se si fytyra e zbehur e Marenglenit u ndez, mollëzat e faqeve ju skuqën, sytë i shkrepëtinë, nga goja ju derdhën fjalë, që gruaja e ata që ishin atje s'i kishin dëgjuar herë tjetër. Gruaja hodhi sytë mbi fytyrën e fëmijës së vdekur. Nga gjoksi ju ngrit dhe i doli një psherëtimë e dhimbshme. «T'u çaftë ajo zemër, gjerman, e t'u bëftë copa, ja si ky dru» mendoi, dhe në sytë e tharë të nënës buluan përsëri lot...

— Gjer kur kështu? Mjaft nuk mundemi të rrimë në vend! — foli i dëshpëruar njëri nga të plagosurit.

Këto fjalë ai ja drejtoi komisarit të brigadës, i cili kishte disa minuta që përfshinte me sy sektorin ku ende luftonin patizanët e brigadës dhe rrugën ku tërhiqeshin njerëzit drejt malit.

Në atë vend, sapo dilnin ata që mbanin të plagosurit, ndaleshin për të rimarrë forcë që të vazhdonin rrugën, që shkonte drejt nga Përroi i Bubullimave në fshatin Kosovë.

Të plagosurit dergjeshin shtrirë mbi barela. Ata qenë të lidhur me fasho të bardha dhe të zbetë në fytyrë. Kur doktor Medini dha urdhër që të niseshin, shtrënguan buzët e ngritën vetullat. Po fillonte përsëri troshitja për ta. Dardanit, që kishte plagë më të rënda se të tjerët i qe mpirë trupi nga ato lëkundje. Po mbushte një natë e një ditë që po kolovitej mbi barelë.

— Kujdes! — foli një nga ata që mbartnin të pla-

gosurit. Dardani e njohu, ishte Bukuria. Ai, si nëpër mjegull kishte përfytyruar Bukurinë, ngaqë nuk mund t'i ngrinte qepallat. Ajo që një vajzë e çiltër, e pastër në shpirt, e bukur. Të gjithë shokët e skuadrës e thërrisnin atë «motër». Po Dardani megjithëse e donte shumë, nuk kishte mundur t'i fliste me atë emër. Zenra nuk u bënte udhë fjalëve.

Marengleni ngjiti rrugën përpjetë malit bashkë me kolonën; ai dëgjonte fjalë nga më të ndryshmet. Për partizanët, për brigadën të gjithë flisnin mirë, vlerësonin heroizmin partizan, por lodhja i kishte drobitur. Ushqimi u mungonte. Njerëzit ishin të uritur, edhe kafshët gjithashtu. Si të shëndoshët, si të plagosurit, të gjithë qenë të mardhur e të nxirë në fytyrë. Dukeshin si qenje pa jetë. Marengleni u ndal te një pllajë e zhveshur, prej së cilës shikoheshin edhe forcat e brigadës, edhe të armikut.

Atë kohë nisi të frynte një erë e furishme. Përsëri filloi dëbora. Njerëzit e kolonës thuajse i rrëmbeu era, aq shumë frynte Papingu.¹⁾

Te lisi i madh, atje ku rruga malore thyhej dhe shkonte faqeve të malit, drejt nga fshatrat Kosovë e Hotovë, ata panë të qëndronte një burrë shtatvogël, një partizan me armë në dorë, i veshur me një xhakëtë bezhë dhe me rripa të kryqëzuar. Ai qëndronte atje në vend, si të ishte gozhduar, qëndronte me nofulla e grushte të shtrënguara dhe drejtonte njerëzit. Ata që kalonin andej, e shikonin njeriun me maliher dhe vetulla të ulura, nën të cilat xixëllonin dy sy të mëdhenj e të bukur. Shpesh dëgjohej t'i thërrisnin:

— Shoku komisar, shoku Marenglen!

Kështu e thërrisnin, jo vetëm ata të brigadës, por edhe kolona me njerëz që ngjitej nga Përmeti në malet e Frashërit dhe të Kosovës. Edhe ai i njihte të gjithë. Të gjithëve u drejtohej në emër e u jepte kurajë.

Korrieri e dinte që mushkëritë e komisarit të brigadës qenë brejtur nga tuberkulozi, i afrohej, donte t'i

1) Mali më i lartë në luginën e rrjedhës së Vjosës.

fliste. «Ktheji shpinën erës, shoku komisar, ruaju!». Po nuk guxoi e murmuriti me vete:

— Sa erë e hidhur, ç'qenka kështu kjo era e Papi-ngut! Po filloi të fryjë, edhe lisat i shkul nga vendi.

3

Në mbrëmje brigada u tërhoq duke u larguar nga rruga e automobilit për të zënë pozicione të reja.

— Këto pozicione duhet t'i mbrojmë me çdo kusht! — u thotë partizanëve komisari i brigadës.

— Do t'i mbrojmë, shoku komisar! — Nën degët e lisave të lashtë këmbehen mendime.

— Ku është «Shkëndija» — pyeti komisari. Emrin e vërtetë «Shkëndija» e kishte Flamur.

— U vra! — Me zor e nxori fjalën ai që foli.

Marengleni u pikëllua për Flamurin, por nuk e bëri veten.

— Si trim u vra, o shoku Marenglen!

Komisari i brigadës heshti. Ai e dinte ç'dhembje ndjente Refat Arapi kur një nga shokët mbetej në luftë. Flamuri ishte dëshmori i parë i brigadës.

Disa minuta më vonë komisarit i erdhi një letër nga Goliku, e cila i bënte të ditur që edhe të tjerë partizanë e partizane ishin vrrarë si trimat në betejë...

Siç bënte gjithnjë, edhe kësaj radhe u ul mbi një nga gurët e malit vuri pushkën mbi gjunjë e mbi çantë, filloi të shkruante. Sa letra e sa urdhëra kishte shkruar Marengleni në këto kushte gjatë dy vjetëve në malet e Jugut? Edhe tani ai shkruante... Ishte lista e parë e celulave të partisë, ishin emrat e komunistëve, që milonin në radhët e brigadës. Firmoste komisari i brigadës, dërgonte listën në adresë të Komitetit Qendror të Partisë, njoftonte shokun Enver Hoxha.

— Pushojmë sonte këtu! — i tha korrieri. Ai interesohej për shëndetin e komisarit.

— Jo, do të shkojmë!

— Do të shkojmë! — Partizani u zbe. Ai e dinte që

kështu i rrezikohej jeta komisarit, por nuk guxonte ta kundërshtonte.

U nisën...

Ditët e fundit të janarit Marengleni i kaloi me punë të vazhdueshme. Puna e madhe për formimin e brigadës dhe dhembja e plagës në mushkëri e kishin lodhur, si e thonë, edhe në bebet e syve. Kjo sëmundje mund të shërohej vetëm po të kishte çlodhje, qetësi, ushqime e mjekime. Por ai e dinte që lodhjet do të qenë gjithnjë e më të mëdha, prandaj mendohej t'i bënte ballë sëmundjes, t'u bënte ballë të gjithave. Dhe ai, që e parashikonte rrezikun serioz të sëmundjes së rëndë që i grinte mushkëritë, në çdo kohë gjente forca që në buzë t'i mbetej gazi, në gojë fjala e mirë, në zemër urrejtja e thellë për armiqtë dhe dashuria pakufi për popullin.

U nis Marengleni malit. Ecte bashkë me të edhe korrieri partizan.

4

Në jug të Vjosës vargmalin e mbuluan retë. Era e lindjes frynte edhe më e vrullshme. Dyqind e tetëdhjetë e dy partizanë e partizane, të plagosur ngjiteshin në drejtim të Frashërit.

Kolona me partizanë, që kishin plagë më të lehta, ngjitej drejt rrugës për nga Frashëri. Andej shkonin edhe dhjetëra e qindra të tjerë, ndërsa të plagosurit rëndë, i kaluan në rrugë tjetër. Ndoqën rrugën e tërthortë, që të nxjerr në fshatrat Kosovë e Borockë. Këndej rruga ishte edhe më e vështirë, dëbora edhe më e madhe, pylli edhe më i dendur. Doktor Medini ecte në krye. Partizanët që i mbartnin në shpinë të plagosurit, e kishin shumë të vështirë, sepse çanin rrugën e pahapur.

— Pushim! — u foli doktori.

Njëherësh u hoqën nga supi barelat. Me kujdes e ulën edhe barelën me Dardanin.

Sytë e partizanëve vështrojnë andej nga mali, nga shkëmbi i Kamnecit. Kudo një natyrë e ashpër, e cila të

verbonte me bukurinë e saj të rrallë. Bora e re i kishte dhënë pyllit një pamje fantastike. Çdo gjë kishte emigruar nga ky vend: barinj të me tufat e tyre, shpezët, kafshët e egra, veç ariu sillej këtej e linte gjurmë.

— Atje, vëllezër, atje duhet t'i çojmë! Edhe zogu e ka vështirë të arrijë në atë vend, këtë unë e kuptoj, por vetëm atje mund të jenë të sigurtë. Në anën e majtë të grykës, në shkëmb, është një guvë. Thonë që është e mirë, e ngrohtë — u tha doktori.

— Ka ndonjë shteg që të çon atje? — pyeti doktori udhërrëfyesin.

— Po... — Djaloshi tregoi drurët e hedhur nga njëri shkëmb në tjetrin.

— Na udhëhiq, vogëlush!

Dëshira për t'i larguar shokët nga rreziku i shtynte drejt çdo sakrifice. Bukuria me vështirësi mbahej në shkëmb dhe më me vështirësi mbante në sup barelën. Era e ftohtë në këtë grykë frynte papushim. Edhe fytyrën e Dardanit e rrihte thëllimi:

— Dardan, shoku Dardan!

Zërin e Bukurisë e rrëmbente era.

«A do të shpëtojmë?» Sa herë ja kishte bërë vetes pyetjen, kishte shtangur.

Një e nga një barelat u fshehën në errësirë. Qetësi dhe vetëmi e plotë. Në shpellë nuk dëgjohej asnjë kris-më arme, asnjë zhurmë. Asgjë nuk i shqetësonte tani të plagosurit. Gjithandej heshtje. Heshtje e plotë si edhe masivi gjigant e i ngjeshur i gurit që e mbyll në çdo anë zgavrën e errët. Bukuria e uli Dardanin me kujdes. Dardanit e ndjente kokën të rëndë, aq sa e kishte vështirë t'i ngrinte qepallat.

Asnjëherë nuk i qe dukur trupi aq i huaj, aq i rëndë, aq i tepërt. Dëgjoi zërin e Bukurisë dhe lëvizti buzët, po s'mundi të thoshte asnjë fjalë, ngaqë zëri, pa arritur te qiellza, ju shua.

— Ëh!

Rënkimi i të plagosurit erdhi në veshin e Bukurisë si nga fundi i dheut. Bukuria nuk mundi ta dallonte i

kujt ishte ai rënkim, i Dardanit apo i ndonjë shoku tjetër të plagosur, ndaj u ul pranë tij.

— Ëh... ëh...

Ajo i vuri dorën mbi ballë. Digjte balli i Dardanit, që vazhdonte të rënkonte. Bukuria i foli:

— Durim, Dardan!

I plagosuri shtrëngoi fytyrën dhe çakërriti sytë në errësirë, u mundua të lëvizte trupin, po s'mundi.

Dikush ndezi zjarrin, që ndriçoi edhe qoshet më të errëta të shpellës.

«Sa shpellë e çuditshme!» mendoi Bukuria. Ishte diçka e rrallë ajo që shikonte. Këto forma gurësh si kristal ishin çuditërisht të bukura. Ishte vend i ngrohtë, por të plagosurit i bezdisnin disa pikëza uji që heraherës binin mbi ta. Këto pika uji prishnin heshtjen e rëndë të shpellës.

U ndez edhe më i madh zjarri. Gjuha e kuqe e flakës ndriçonte guvat e shpellës dhe fytyrat e trishtuara të njerëzve. Dardani u përmend. Dëgjoi zëra.

— Ku jam! — Kaq mundi të thoshte dhe sërish qepallat e tij u ulën.

Bukuria, shoqja e skuadrës, që atë kohë ishte ulur mbi një gur dhe po pastronte armën, i shkoi pranë. Dardani, pa u kuptuar, e vështronte përmes qepallave. Pas-taj ai i mbylli sytë dhe humbi në gjumë...

Bukuria u ngrit. Në hyrje të shpellës qëndronte në përgjim një grykë mitralozi. Aty e prisnin Bukurinë shokët e tjerë dhe doktor Medini. Ata do të ktheheshin në brigadë, ndërsa doktori do të qëndronte në Malin me Bredha. Brigada kishte nevojë për ata.

5

Ishte bërë natë kur erdhi në Malin me Bredha komisar i brigadës, Marengleni, dhe njerëzit qenë përhapur sa nga kreu në fund të pyllit.

— Ku janë shokët e këshillit? — pyeti ai. — Më tregoni ndonjë shok nga të komandës së vendit.

Korrierët kalonin zjarr më zjarr e u flisnin me emër. Te një bredh i madh, ku qëndroi Marengleni, u mblo-
dhën edhe disa njerëz të tjerë. Të gjithë ishin me armë. Mbi vetullat, Marenglenit, i ishte formuar një shtresë nga flokët e borës që binte. Ai pyeti nëse kishin ardhur të gjithë dhe foli:

— Më në fund rrezikun e madh e kaluam, por armiku s'ka për të hequr dorë nga planet e tij. U mësuaam me gjermanët. Ata janë kokëfortë në atë që vendosin.

— Edhe ata kokë kanë, shoku Marenglen, s'kanë mbi qafë kungull, de!

— Duhet të organizohemi, të nxjerrim ata që mund të dalin për të zënë shtigjet. — Nuk ishte koha për biseda të gjata. Marengleni foli shkurt e qartë:

— Nesër, me siguri, armiku do të na sulmojë. Bisedoni për këtë me njerëzit, i përgatitni shpirtërisht, i organizoni me sa të mundni, i armatosni, u jepni armë e fishekë.

— Do të vuajmë disa ditë, — u tha Marengleni — por situata nuk do të qëndrojë gjithnjë kështu. Forcat e ushtrisë sonë partizane kudo japin goditje. Zona e Oparit, Devolli, Skrapari dhe Kolonja u çliruan përsëri nga forcat tona.

Lajmi ngjalli gëzim te njerëzit, forcoi edhe më shumë besimin në fitoren kundër armikut. Marengleni e vuri re këtë dhe vazhdoi: — Dhembjen e goditjeve të ushtrisë sonë armiku ka filluar ta ndjejë thellë. Detyra jonë është që, së bashku me gjithë brigadën, të bashkojmë forcën e grushtit tonë me grushtin e fuqishëm e dërmues të ushtrisë sonë partizane, me grushtin e gjithë popullit tonë dhe të godasim!

Të gjithë sa ishin atje, u çelën në fytyrë e u gjallëruan. Marengleni duhej të nisej për udhë, mori me vete edhe korrierin.

— Mirë u pafshim, shokë! — u tha ai dhe filloi të largohej. Duke ecur, u kollit. Dhe kur kollitej, ai zbehej

në fytyrë dhe e anonte trupin andej nga i dhembte më shumë plaga.

Udhëtuan mbi gjysmë ore në pyll dhe ja ku doli në një vend të hapur. Edhe atje kishte njerëz. Në Malin me Bredha, natën të thante thëllimi i mprehtë, që të futej gjer në palcë. Megjithatë, disa partizanë, të kapi-tur nga lodhja, i kishte zënë gjumi pranë zjarreve te venitura. Flinin dhe nuk ndjenin që po bëheshin kallkan, si bora, mbi të cilën qenë shtrirë. Marengleni kalonte nën degët e një bredhi, shkonte nga njëri grumbull i njerëzve te tjetri. Mundohej të mos shkelte mbi kapo-tat e atyre që flinin, kalonte midis zjarreve të shuara. Ai u drejtua atje ku një lis i madh digjej me degë e trung.

— He, he!... Largohuni ju atje, largohuni, se ju shkoi lëkura për dhjamin e murros! — fliste një nga pllaja tjetër e luginës. Flakadani i kuq u drodh, krisi e nxori shkëndija.

— Largohuni, largohuni!

Flakadani i kuq u anua në fillim. Dikush pa që atje ende flinte një partizan.

— Çohu, ti, atje, hashash ke pirë? Çohu, gjumash!

— Shkuan dy veta dhe e ngritën nga palltua. Flakadani, si një fantazmë e kuqe, ra shul në pllajë pikërisht atje ku flinte partizani. Atje u mblodhën njerëzit si mblidhet bleta e re në një degë.

— Oj, ku paskan qenë gjithë këta?

Korrieri çapitej, këmbët i fundoseshin gjer në kof-shë. Edhe Marengleni në fillim u shqetësua. Duke zbri-tur me rrëmbim, ai pa afër tij një partizan të veçuar, i cili ngrohej në flakën e zjarrit. Kapela italiane i qe ulur partizanit në gropë të qafës sytë i zgurdullonte e fytyrën e fshihte hera-herës mbas pëllëmbëve të duarve. Po ngrohej. E njohu.

Ishte një nga partizanët e topave të brigadës.

— Duhet të dërgojmë për predha — i tha korrierit.
— Thuhet se në Frashër gjenden disa kasa me predha të këtij lloji. Më gjej komandantin e topave — i tha ko-rrierit. Pastaj i foli partizanit:

— Si je, o trim?

— ...

6

Marengleni dhe korrieri natën vonë u larguan nga Mali me Bredha me besimin e plotë se ditën e nesërme sulmet e nazistëve do të thyheshin. Sapo u nis, një prozhektor që nga Përmeti ndriçoi pllajën e malit, i hodhi dritat gjer në bredhat e Hotovës. Ata qëndruan. Për një çast pa malet që e hoqën sharpën e zezë dhe u ndriçuan. Pastaj errësira u bë edhe më e fortë. Kjo Marenglenit dhe korrierit partizan ua vështirësoi ecjen. Fill pas shuarjes së dritës u pa një flakë, pastaj fishkëlloi mbi ta predha, që kaloi malin dhe plasi larg, në një shkëmb. Edhe dy herë u pa në anë të Vjosës flaka dhe erdhi përsëri në mal predha e oshëtima e topit... Pastaj heshtje... Ata të dy ecnin, zbrisnin më poshtë, mbaheshin nga degët, fundoseshin përsëri, ngriheshin dhe përsëri fundoseshin, donin me çdo kusht të ishin në shtabin e brigadës. Detyra të tjera me rëndësi duhej të zgjidhte gjatë natës komisar i brigadës, Marengleni.

Ecnin me nxitim...

— Ku shkoni? — u foli një zë kercënues.

— Kush është atje? — foli korrieri dhe i doli përpara Marenglenit, duke i kthyer sigurecën pushkës.

— Parullën! — tha tjetri dhe krëk-krëk ja bëri llozi i pushkës. Pasi u shkëmbyen parullat, roja, që e njohu zërin e komisarit, tha:

— Aha, ju jeni, shoku Marenglen? — Ishte një nga të plagosurit, kishte radhën e rojes. Kjo gatishmëri e njerëzve që kishin plagë në trup i dha Marenglenit më tepër forcë për të përballuar sëmundjen. U nis...

Më tej vendi ishte edhe më i thyer. Errësira më e madhe. Ecnin me kujdes, duke kapërcyer dushqe e dëllenja, duke u fundosur në borë. E kishin më të vështirë se në ngjitje, herë-herë fundoseshin gjer në kofshë e herë edhe gjer mbi brez. Ishte errësirë në pyll. Ndriço-

nin rrugën duke ndezur një elektrik dore. Marengleni ndjente se po e linin fuqitë. Donte të merrte një sy gjumë. Por ai e dinte që s'duhej të flinte as edhe një minutë. Ai me Voglin dhe Golikun duhej të mendonin për atë që duhej bërë të nesërmen.

Ecën më shpejt...

Sado që ishin larguar nga bredhat e Hotovës, dëgjoheshin gjer atje biseda, klithma dhe këngë. Dhe këngët jehonin jo vetëm rreth një zjarri. Gumëzhinte pylli si koshere bletësh. Pastaj pas pak edhe zjarret ranë, edhe njerëzit heshtën. Po një grup s'e kishte ndërprerë ende këngën. Dikush ju drejtua atyre me zë të lartë:

— Hej, ju aty, kë martoni? Pushoni këngën!

Sërish u bë qetësi. Nata duket gjithmonë më e errët në pyll. Pylli u bë më i mistershëm. Komisarë ecte drejt fshatit, shkonte në shtabin e brigadës.

7

Ishte mesi i natës kur Marengleni po i afrohej shtabit të brigadës. Për të arritur deri atje, kishte kaluar përrenj, pyje e rrëpira, gropa të mbushura me ujë dhe borë. Filloi t'i rëndonte kraharori dhe të ndjente dhe mbje, ndaj u kthye në njërin anë dhe nga gjoksi i doli një kollë e lehtë dhe e thatë. Për pak sa s'ju zu fryma. Megjithatë vazhdoi të ecte. Voglin dhe Golikun i gjeti në një plevicë. Ishin duke punuar.

— Hë, more Muço, ç'u bërë — u ngrit nga vendi Goliku dhe e përqafoi Marenglenin.

— Ku humbe? Po eja, ulu e ngrohu... Do të kemi punë me tedeskët nesër.

Edhe Vogli u përshëndet me shokun e tij. Pastaj u ulën rreth zjarrit e biseduan gjatë. Si edhe Marengleni, Vogli e Goliku kishin shkuar kompani më kompani, kishin biseduar me partizanët e partizanet, kishin luftuar në një pozicion me ta. Brigada, gjatë natës, po pregatitej për ditën e nesërme. Përsëri do të niste shtërngata.

Në shtabin e brigadës hynin dhe dilnin korrierë, komandantë e komisarë. Brigada gdhiej në pozicione. Ushtarët gjermanë, gjithashtu, në pozicione. Dy shtabe e vështruan atë natë hartën e maleve të Frashërit dhe shënuan në hartat e tyre atë që do të bëhej të nesërmen.

Shtabi i armikut u vuri si detyrë ushtarëve, të cilët erdhën nga Janina dhe Berati dhe që u bashkuan në Përmet që, të nesërmen, pasi të goditeshin pozicionet me artileri, të hidheshin në sulm. Detyra e ditës për armikun: «Të merreshin të gjitha lartësitë në veri të Përmetit, të kalohej në malin e Frashërit dhe të Hotovës, pas-taj të vazhdohej mësymja më në veri, duke ndjekur rrjedhën e lumit Osum».

Brigada partizane gjatë natës do të grumbullonte forca dhe do të godiste në një pikë, do të godiste atje ku armiku të mos ishte më në gjendje të ngrinte kokën. Këtë detyrë u vuri shtabi i brigadës forcave që u grumbulluan në Malin me Bredha. Por atje kishin ardhur edhe njerëz të tjerë nga fshatrat. Vogli, duke punuar një kohë të gjatë në Qarkorin e Partisë, shumë nga ata i njihje e, kur bisedonte, u fliste në emër, u caktonte detyrat që do të kryenin. Dhe për ditën e nesërme po pregatitej populli e partizanët.

Këto probleme diskutoheshin në shtabin e brigadës.

— Këtu duhet të sulmojmë — thoshte Marengieni dhe hiqte një vijë të kuqe në hartën e tij.

Goliku vështronte në hartë. Ai vërtet që s'dinte ta lexonte mirë hartën e nuk kuptonte ato vija rrushku-luese, por e njihje vendin me pëllëmbë, sepse kishte shkëlur çdo gërxh e shteg. Goliku u spjegoi se si do të vepronin. Në ato takime të shkurtëra me komandantët dhe komisarët, Goliku desh të fliste më me hollësi; donte t'u spjegonte shumë gjëra, por edhe me aq sa tha, ju duk se kishte thënë ato që duheshin.

— Është fodull gjermani, dëgjoni xhaxhanë juve. Ai, do medoemos të dalë e tija, po s'i del se. Ka thënë se do të jem në filan ditë në këtë vënd dhe pëlçet, dëng ja bën zemra, po nuk arriti atje. Ka thënë se do të sulmojë

këtej, andej i bie, murin me kokë ta rrëzojë dhe e godet. Po ama dëgjoni dhe vëreni në mend këtë fjalë që po ju them: Fati i çdo aksioni ushtarak varet nga ata që qëndrojnë në vijën e parë të luftës dhe bërtasin: «Bo, bo, na dolën nga krahët!» apo, që s'e përfillin frikën dhe thërrasin: «Përpara, mbi ta, t'i kapim me dorë!» dhe vini re — s'të qëndron tjetri t'i shkosh afër; i hedh thëmbërat e këmbës te supi edhe më trimi. Prandaj të parën e të fundit dua t'ju them:

— Guxim, guxim djema!

Sikur ato fjalë të kishin hedhur rrënjë në shpirtin e tij, i përsëriti disa herë. Pyetjen që i bëri një komandant kompanie për të vetëvepruar, Goliku e priti me habi, u rrëmbye dhe tha një fjalë që më vonë i vinte turp ta kujtonte. Pastaj shtoi:

— Më mirë të gabojmë duke vepruar se sa duke u ruajtur se mos bëjmë gabime, por inisiativa e secilit duhet të jetë në interes të veprimeve luftarake të brigadës dhe jo ta dëmtojë atë.

Marengleni, megjithëse kishte folur gjatë në atë takim duke marrë shkas nga pyetja që u bë e plotësoi një mendim që i erdhi aty për aty.

— Kujdes, shokë, praktika do të na mësojë se si duhet të luftojmë. Janë shabllonistë oficerët gjermanë. — Disa nga ata që ishin atje nuk e kuptuan, ndaj ai spjegoi:

— Në ushtri kjo fjalë përdoret kur kryen veprime luftarake të njëllotja, pa shfaqur inisiativë dhe krijimtari, duke u përmbajtur qorrazi atyre që ke planifikuar, pa marrë parasysh kushtet reale të luftimit. Kjo është një dobësi e madhe e tyre.

Për luftimin u diskutua në çdo kompani partizane, në çdo celulë partie. Shokët e shtabit të brigadës zbritën përsëri në kompani, në vijën e parë. Në pozicione shkoi edhe Marengleni, u takua me luftëtarët e një kompanie. I gjeti disa tek flinin nëpër pozicione. Ata kishin ditë pa ngrënë dhe për qetësimin e trupit në ato kushte, gjumi, ishte i vetmi ilaç. Korrieri ndihej i lodhur, shumë i lo-

dhur. Gjithë vëmendjen e kishte përqëndruar te komi-sari, ndaj i dha vetes guxim duke menduar.

«Po Marengleni nuk lodhet? Ai është i sëmurë. Pla-ga në mushkëri i peshon si një gur. Ajo plagë e mundon, i than shëndetin, e dobëson përditë e më shumë. Por ai gjen forca ta mposhtë dhembjen, të qëndrojë e të luftojë, se brigada do mendje dhe mundim që të pregatitet për sulm».

8

Mëngjez. Në Malin me Bredha bënte ftohtë. Era e rrihte këtë vend nga të katër anët. Bredhat me trup të hedhur e të drejtë lëkundeshin e me degët e tyre krih-nin erën e malit. Në këtë mal ku u grumbulluan njerëzit e kolonës, që erdhi nga Zagoria, shkuan edhe topat. Par-tizanët i mbërthyen dhe i vunë topat në pozicion pranë njëri-tjetrit. Kur u gdhi e mbi majën e malit ra dielli, mbi grykën e një topi disa gra po ndenin teshat e fëmi-jëve për t'i tharë.

—Tutje, moj motër, s'të arrijnë ato shkurre? Ja, hidh një hap më tutje!

Gratë shkuan më tej.

Një ka i madh afrohet te gryka e topit, merr erë, pastaj zë e kruhet.

— Oha, dreq, ç't'u kujtua, oha, Menxur!

— Arap e ka emrin, o shok, jo Menxur!

— Djall e pastë, ç'më duhet! Merre, ore, kaun se për pak na përmbysi topin.

I zoti ja lëshoi shkopin e thantë e kau u largua më tej. Po lopë e qe dilnin ngado. Pranë kalit që zakonisht mbartte topin vinte dhe lopa të hante dorën e fundit të kashtës.

— Po kjo pikë e zezë! Ç'po ndodh kështu? Kafsha s'e mban dot topin pa ngrënë.

— Çfarë thua?

— Si çfarë? E shikon? Ku është parë që, midis

pushkëve të kulmosura të qëndrojnë djepet e fëmijëve ku, më thuaj, ku?!

A di të më thuash se ku jemi ne e ku janë ata? S'di... Atëhere, ç'dërdëllis, kur nuk e di. Më mirë hesht!

Një «Stukas» kaloi mbi ta duke uturirë. Sapo dëgjoji zhurmën, dikush tha:

— S'e paska zënë gjumi sorrën e Hitlerit.

Një bombë që lëshoi aeroplani ra larg, por pylli oshë-tiu gjatë, e njerëzit u përndanë ashtu siç përndahehet tufa e shpendëve të egër kur mbi të hedh një gur. Topat dhe partizanët mbetën në vendet ku ishin.

— Si duket, do të bëhen përsëri luftime sot.

— Me siguri.

Mbas atij gjëmimi në male e në luginë sundoi hesh-tja. Aeroplani u largua drejt kufirit grek.

— E theu qafën.

— Ku dreqin ulet, në Janinë?!

— ...

Poshtë në bregun e Vjosës ushtarët e gjeneralit Fon Gajb i zbuluan grykat e topave, i graduan shenjestrat dhe vunë në to predhat...

9

Dëborë s'kishte pushuar gjatë gjithë natës dhe të nesërmen kudo sundonte vetëm ngjyra e saj e bardhë. Rrugët, pemët, shkëmbinjtë, qyteti-gërmadhë, fshatrat e anës së rrugës që sapo ishin djegur, bile edhe disa tankse, autobllinda e maqina, të gjitha i mbulonte çarçafi i bardhë i dëborës.

Më kot vështronin oficerët gjerman me dylbi, më kot kërkonin artilierët të zbulonin vendet ku do të për-qëndronin zjarrin. Kudo bardhësi... Dëborë kishte fshirë çdo gjë. Po në atë bardhësi po të vështroje nga afër, do të dalloje jo vetëm grykat e armëve që përgjonin, por edhe sytë e ndritshëm të partizanëve. Në pozicionet e para të çelura në dëborë, krahas të tjerëve qenë edhe

partizanët e skuadrës së Refat Arapit ishte edhe Bukuria, që sapo kishte ardhur në skuadrën e saj. Secili kishte zgjedhur një vend që të vështronte pushka afër dhe larg.

Në ato çaste një autobлиндë lëvizte nga Këlcyra në drejtim të Përmetit. Kur kaloi ajo në afërsi të Këlcyrës, u dëgjua buçitja e baterive të artilerisë. Autoblinda u ndal. Andej zbriti një oficer gjerman, flokëverdhe, i veshur me uniformë ngjyrë hiri. Pas tij të tjerë zbritën nga disa maqina të tjera. Edhe ato u ndalën dhe rreth oficerit të gjatë me fytyrë të hequr e me një kryq të Fyhrerit në gjoks u grumbulluan edhe të tjerë. Topat sërish buçitën. Komandanti i korparmatës, gjenerali Fon Gajb, vuri dylbinë, vështroi përpara, në thellësi, ku dilnin mbi kodrat e tjera gurët e Zleushës. Atje u ngrit tym.

— Goditjet tona asnjëherë nuk duhet të pushojnë. Re-partet tona gjithnjë duhet të jenë në sulm. — Erdhi në qejf. Topat e tij i çonin predhat në shenjë.

— Nisemi! — urdhëroi gjenerali.

Gumëzhinë motorët...

Kur doli te rrapet e Pacomithit, gjenerali Gajb përsëri u ndal. Ishte problem shqetësues për gjeneralin Gajb ky sektor lufte. Ato ditë gjenerali Gajb ende nga njëri qytet në tjetrin. Ishte bërë nervoz. Plani i operacionit nuk po i ecte. Kur po kalonte rrugës, i shkuan sytë padashur te disa bunkerë të ndërtuar nga fashistët italianë. Gjenerali Gajb, pasi shau nëpër dhëmbë, tha: «Ata mendojnë se duke u strukur në fortino, do t'u shpëtonin goditjeve të njerëzve të këtij vendi. Sa njerëz pa mend paskan qenë! Ne, sapo hymë në këtë vend, e përbuzëm taktikën që ndoqën forcat italiane dhe u bazuam në taktikën tonë ushtarake. Megjithatë, sado që trupat tona e kanë shtuar shpirtin sulmues, prapëseprapë forcat e tyre shtohen, brigadat mbijnë njëra pas tjetrës».

Ndjeu pasiguri gjenerali Gajb, po s'e bëri veten. — Marsh! — i tha shoferit dhe maqina e derdhur në çelik, në uzinat e Ruhrit, autoblinda e verdhë me dy kryqe të thyera dhe automjetet e tjera, që shoqëronin gjeneralin thatim, morën drejtimin e Përmetit.

Në Përmet ai u informua për luftimet. Dy koma-

ndantë regjimentesh u munduan të justifikonin vonesën që u bë shkak që çarku, i ngritur nga shtabi i tij për rrethimin e forcave dhe të spitalit partizan në Zagori, shkrepri bosh. Nga lëvizjet që bënte, ata e kuptonin që gjenerali ishte shumë i shqetësuar. Ai nuk fliste, por komandantët e regjimenteve e dinin që vonesa e takimit të tyre u dha mundësi forcave partizane të dilnin nga rrethimi.

— Turp, turp! — shpërtheu gjenerali. — U ndeshët vetëm me forca të një brigade që sapo u formua dhe mbetët në vend.

— ...

— Ajo duhej të ishte shpartalluar që në ndeshjen e parë.

Komandantët e regjimenteve dhe oficerët, që e shokëronin, morën drejtqëndrim, heshtën...

Ndërsa tek ura e Përmetit bëheshin këto biseda, në drejtim të Malit me Bredha godiste artileria, afroheshin forcat e dy regjimenteve. Komandantët i treguan gjeneralit planin e veprimit. Ai përputhej me planin e përgjithshëm të operacionit. Kjo sikur e zbuti pak gjeneralin, i cili filloi të kundronte kryqet e thyera dhe yjet. Sa shumë kishin qëndruar në këto male yjet! Ai do të donte që çdo yll të shuhej, por në vend që të veniteshin, ata shndrisnin e -shtoheshin gjithnjë e më shumë. Një yll i ri që edhe brigada, që ishte formuar, një yll që, sipas gjeneralit Fon Gajb, duhej të që shuar me çdo kusht nën goditjen e armëve gjermane. Po ai nuk u shua, qëndronte, luftonte. Gjenerali shtrëngoi grushtet...

Fon Gajb nuk i besoi akuzat që drejtonte komandanti i regjimentit në adresë të majorit Diter Grebner dhe i hodhi komandantit të batalionit që sapo erdhi atje, një vështrim hetues. Nazisti Diter s'mundi t'i qëndronte atij vështrimi, ndaj si me frikë sytë e tij rrëshqitën nga gjenerali. Vështrimi i gjeneralit ishte i ftohtë.

Gjenerali Gajb fliste shkurt sepse i përmbahej parimit që mendimet më të larta gjenden në fjalët e shkurtëra. Ishte një nga gjeneralët më të shkathët, po në të

njëjtën kohë, edhe më pedanti. Ai, duke ditur se plani i operacionit që kishte përgatitur vetë ishte i përkryer, nuk lejoi t'i bëheshin ndryshime sipas kushteve ku zhvilloheshin luftimet. Megjithëse e dinte mirë që njeriun që nuk është në gjendje të ecë në rrugë të sheshtë kot e shtrëngon që t'i ngjitet malit, prapë urdhëroi që batalioni i Diter Grebnerit të dilte në vijën e parë, të sulmonte malin ku dora e gjeneralit si një stekë e gjatë drejtoi veshtrimet e oficerave. Nazisti Diter Grebner ngriti dorën, nderoi dhe syt i mbetën të ngulur mbi malin e Tremishtit. Gjenerali e vuri re gatishmërinë e majorit, ishte i bindur që ai dhe ushtarët e tij do të dilnin atje.

Ndoshta gjenerali Gajb do të kishte mbetur të sodiste përleshjen, por radisti i dha një fonogram. Dy njoftime: njëri i jepte lajm për kabinën e Mesaplikut, tjetri për Kurveleshin. Atë e shqetësuan këto lajme, po s'e bëri veten. U vuri detyra komandantëve të regjimenteve, kërkoi që batalioni i nazistit Diter Grebner të dilte përsëri në vijën e parë, dhe u largua drejt Gjirokastrës. Gjatë gjithë rrugës ai mendonte vetëm për lajmet që mori, vështronte malet dhe ndjente se ishte i pafuqishëm të vinte në jetë atë që kishte planifikuar, atë që i qe dhënë detyrë.

— Më shpejt! — urdhëroi gjenerali Gajb.

Autoblinda ecte me rrëmbim anës Vjosës.

— Më shpejt! — foli prerë gjenerali.

Ai nuk ishte i sigurt nga pritrat partizane. Donte të arrinte patjetër në mbrëmje në qytetin e Jugut, të fliste me komandën eprore, të njoftonte situatën e krijuar. Ecte dhe gjithnjë mbante në gojë fjalët: Kurvelesh dhe Mesaplik...

Disa metra më lart, rrëzë një shkëmbi të lartë me ngjyra të errëta, që në sfondin e bardhë të borës dukej edhe më i errët, u mblodhen kokë më kokë njëmbëdhjetë

partizanë dhe një partizane. Midis tyre ishte edhe zëvendëskomisari i brigadës, Vogli.

Ai qëndronte këmbëkryq me automatikun të shtrirë mbi këmbët dhe kuvendonte me komandantin e kompanisë.

Vogli i hodhi një vështrim të ëmbël Halil Imerit, ai e donte me gjithë zemër, sepse atë shpirt të pastër që kërkonte te partizani, e kishte gjetur te Halili. Ai i pëlqente nga çdo pikëpamje: nga karakteri i tij i gjallë, nga ndershmëria, nga mendimet e tij që i shfaqte haptas, nga sytë e zes e të flaktë, me ala qerpikë të gjatë, nga flokët korb, të derdhur dhe nga një palë mustaqe të mëdha që ja lezctonin edhe më shumë tiparet burrërore të fytyrës dhe mbi të gjitha nga gjakftohtësia dhe guximi, që kishte treguar në luftimet te Guri i Kosinës.

Refat Arapi e kishte herën e parë që merrte pjesë në mbledhje të celulës dhe, vinte si i drojtur. Ishte diçka e rëndësishme ajo që po ndodhte, pranohej në parti në vijën e parë të luftës dhe duhej të fliste, të thoshte diçka, të bënte autokritikë, sidomos për atë ngjarjen që ishte bërë shkak të plagosej Dardani; fundja edhe atë gjermanin do të ishte mirë të mos e kishte vrarë, derisa ishte dorëzuar. Po a duhej pikërisht tani?

— Çasti arriti — tha Vogli. — Brigada jonë do të hidhet në sulm, do t'i japë goditje, sa më shumë goditje armikut!

— Hë, pra, kur do të sulmojmë? — tha Refati she një që tregonte prapambetjen e tij në luftime.

— Nga çasti në çast pritet sinjali. Po partizanët ç'thonë, si do ta presin këtë?

— Ç'thonë partizanët? — u hodh Refati. — Sulm, mjaft në pozicione, nuk e ka njeri në qejf mbrojtjen! Të hidhemi në sulm, t'i godasim!

Dhe të dymbëdhjetë komunistët u shpërndanë për në pozicione. Edhe zëvendëskomisari i brigadës, Vogli, zuri vend pranë një partizani e u përshëndet me të. Këndeje vendi shikohej si në pëllëmbë të dorës. Vogli e vuri re atë tejpërtej, nëpër tërë gjatësinë e tij. U ndie lëvizja

e shuleve. Partizanët shtynë në gojën e pushkëve fishekun e parë, u përgatitën. Mandej Vogli shkoi më tej, në një kompani tjetër, në një celulë tjetër partie.

Përgatitej sulmi...

11

— M'u mpinë duar e këmbë, kërcunj m'u bënë, s'i ndej më si të miat. Asgjë s'qenka më e gjatë se nata mbi borë.

— Durim, o xha Refat!

— Durim? Në daç mos duro! S'e kam atje llafin, por të ngrirët, o vëlla. është më i keq se plaga e plumbit.

— Djali, ku është djali! — u kujtua Refati. — Voco, o Voco! — foli.

— Ç'është ajo borie andej — qërtuan nga bregu tjetër.

Refat Arapi heshti dhe u tërhoq pas, këmbadoraz, derisa u largua nga pozicioni dhe, kur kaloi nga ana tjetër e kodrës, thirri:

— Voco, o Vocooo!

Ndërsa priste përgjegje, dëgjonte po zërin e tij, që përroi i thellë e përsëriste radhaz: Voco, o Vocooo!

— Dhe kjo m'u desh — tha i mërzhitur me vete Refat Arapi. Ishin çaste me rëndësi dhe duhej të ruhej morali partizan. U ngjit deri te lisat e mëdhenj, shikoi te zjarri ku qëndronin disa partizanë dhe, kur nuk pa gjë, mendoi të kthehej në skuadër. Nuk ishte koha të endej larg shokëve, po vinin gjermanët, do fillonte lufta. Refati dyshoi se mos djali kishte shkuar në fshat. «Të than ky i ftohtë, s'duroi dot, fare i vogël ishte». Ju kujtua se Vocua ishte nga këto anë, ndaj u dha këmbëve, por, sapo doli nga pylli në anë të lisave të mëdhenj, te kthesa e rrugës, jo shumë larg nga pozicioni i skuadrës dhe nga fshati dëgjoi dënesat e një fëmije. Shkoi andej. U habit që gjeti pranë një gur varri Vocon, që belbëzonte me sytë e mbushur me lot.

— Ç'ke, biri im, folë!

— Nëna, xha Refat, nëna!

Tjetri nuk e pyeti si kishte ndodhur ngjarja. Po Refati mësoi se Vocos, shtatë muaj më parë, aeroplani italian i kishte vrarë nënën. Refat Arapin e piku në zemër ngashërimi i vogëlushit. Ecte dhe thoshte:

— Shumë borxhe kanë për të na dhënë ushtritë e huaja. Për të gjitha do t'u kërkojmë hesap një për një.

Sërish u dëgjuan edhe më afër krismat e predhave të topave. Refat Arapi qëndroi një çast në këmbë, si u mendua, i foli Vocos:

— Eja pas meje, kujdes, mos u ço në këmbë, më kupton Voco?

Nga shtabi i brigadës erdhi urdhëri:

— Lërinin të afrohen!

Urdhëri, si te përhapej nëpër linjën telefonike, kaloi gojë më gojë, nga njëri skaj i brigadës në tjetrin, duke përshtuar në një kohë shumë të shkurtër të gjitha lartësitë, ku ndodhej brigada.

Gjermanët ngjiteshin grykave, ishin ende larg nga pozicioni i tyre. Ndaj ata bisedonin:

— Na trego një herë atë ditën e parë që re në luftë, Çerçiz, atë na trego!

— Ohu, iku ajo kohë, o xha Refat!

— Folë, folë! — ju lutën edhe dy shokë të tjerë që ishin atje afër.

— Po ky hall i madh, gjetën kohën! I shikoni te deskët që po vijnë?

— Folë, tregona! — i tha prapë Refati. — Ka nevojë njeriu të këmbejë fjalë me shokun, gjersa të fillojë dyfeku.

— Pastaj?

— Pastaj fjalos me dyfekun njëlloj si edhe me shokun.

Të tjerët u bënë gati të dëgjonin.

Çerçizi si me përtesë nisi të fliste:

«Ishim në Cepo, luftonim me italianët. Atëhere nuk më ishte vrarë ende vëllai, Demua, nuk më ishin vrarë edhe njerëzit e tjerë të shtëpisë, nuk kisha mbetur' qyq

i vetëm si sot. Atë ditë që vajta unë në çetë, na sulmuan fashistët italianë. Hyra dhe unë në luftë, ama pa gjë në dorë. Kur u thyen fashistët, rrugës gjeta nja tri bomba, që u kishin rënë pipinove. I mora. Po ç'e do, s'dija t'i zbrazja. E pruri puna që të isha fare afër me disa ushtarë italianë. Njëri nga shokët e mi më foli:

— Hidhi bombat, Çerçiz, hidhi bombat!

Zbatova urdhërin. Hodha të parën e prita të pëlciste, por hiç! Ah! — thashë — si s'plasi! — Hodha të dytën dhe ra mu afër ushtarëve fashistë. Ushtarët klithën, por edhe ajo nuk plasi. Më mbeti edhe një bombë në dorë. E shikova me kujdes. I fola sikur të ishte njeri:

«Ç'patët që s'plasët? Ku e keni marifetin? Ç'duhet t'ju bëj?» Në bombë që një heqës, një copë llastiku, e cila sikur donte të më thoshte: «Kapmë këtu dhe hiqmë fort». Ashtu bëra. E tërhoqa me forcë dhe me një forcë edhe më të madhe i dhashë krahut dhe e hodha tutje. Ajo ra pak larg nga ushtarët, po shpërtheu. Ata u ngritën e ja mbathën vrapit. Njëri e la fuçilen¹⁾ në vend. Unë e mora dhe e ndoqa nga pas. Vrapova sa pata fuqi, se doja t'i zija rob, po s'munda. Megjithkëtë u bëra me pushkë dhe kjo më gëzoi shumë.

— Mandej si u bë?

— Kaq, mbaroi, s'ka më ç'të tregoj tjetër.

— Pushkën, ku e ke pushkën?

— E ka marrë Bukuria. Ja dhashë kur mora këtë «sharsin». S'më ndahej shpirti nga ajo pushkë, por ky babloku është edhe më i mirë.

12

Komisari i brigadës, Marengleni, qëndronte në vrojtim me sytë e mendjen të ngulur mbi forcat armike, që ngjiteshin nga Përmeti në drejtim të malit të Gostnishtit. Të gjithë partizanët rrinin në heshtje e pa lëvizur. Ato

1) Pushkën.

çaste nuk dëgjohej gjë veç frymëmarrjes së luftëtarëve të brigadës, të cilët ishin në pritje të armikut, që po afrohej gjithnjë e më tepër.

Krugët, lartësitë dhe luginat përcillnin drejt pozicioneve të brigadës si një kope ujqsh të uritur me sy të skuqur, ushtarë nazistë. Dukej sikur mali shtrëngonte fort nofullat shkëmbore, përgatitej t'i bënte ballë furtunës. Shpatet e këtij mali kishin disa minuta që përcillnin oshëtimin automatësh që lëviznin në xhade dhe krisma artilerie. Marengleni vështronte me dyllbi lëvizjet, ecejaket e automjeteve dhe grykat e topave që luhatin tym e flakë nga gryka. Ndodheshin atje afër në pozicione disa kompani partizanësh që do të merrnin pjesë në sulm, kishin ardhur komandantët e zëvendëskomandantët, komisarët e zëvendëskomisarët e kompanive. Komisari i brigadës, që vështronte me dyllbi vërshimin e armikut drejt pozicioneve të brigadës, foli:

— Pa mblidhuni, shokë, mblidhuni dhe shikoni?

Ata erdhën grumbull rreth Marenglenit. Komisari shtriu krahun andej. Hodhën vështrimin nga tregoi ai.

— Ja, me ata duhet të masim forcat. Si thoni, do të dalim faqebardhë dhe kësaj radhe?

Drejt grykave nga vinte armiku u derdh vështrimi i ziarrtë i tyre. Ishte çasti kur armiqtë kishin marrë formacion luftimi dhe, posa u afruan, qëlluan me ç'kishin: me pushkë e automatikë, me mitraloza e mortaja. Fishkëllën në drejtim të partizanëve mijëra predha plumbi dhe predha mortaje e topi.

Marengleni i shikoi në sy. Edhe ata e vështruan komisararin.

— Shkoni — urdhëroi Marengleni — dhe kujdes, sapo të jepet sinjali, sulmoni. Drejtimin e sulmit e keni të qartë?

Pjesa tjetër e brigadës, që ishte në pozicione, priste të vinin më afër armiqtë. Ishte në këto pozicione edhe Çerçiz Fejzua. Ai u foli shokëve:

— Përgatituni!

Shokët e vështruan në sy. Ai qe bërë flakë i kuq në

fytyrë. I shndritnin sytë. Sa fillonte sulmi, ai s'dëgjonte më krismë arme, ecte përpara. Po vështrimet qërtuese të shokëve dhe të Refat Arapit e mbajtën në vend. Sa e shikoje partizanin me rroba shajaku, me baluke të rëna mbi ballë, me pamje hijerëndë, me vetulla të ulura mbi sy, mbi dy sy therës që shkrepëtinin, kuptoje që fytyra e tij s'shprenhte gjë tjetër veç urrejtjes. Ishte i pesti nga familja Fejzo. Kishte dhe katër pjesëtarë të tjerë, po i qenë vrarë që të gjithë në luftë. Ai ishte i fundit dhe vazhdonte luftën. Me nofulla të shtrënguara fort vështronte me bisht të syrit armiqtë dhe bënte gati armën për t'u hakmarrë për ata të katër. Veprimet e tij disa herë i kishin kritikuar. Çerçizi pranonte se dëshpërimi e hidhte drejt flakës e plumbave, por shokët sërish i flisnin për ekspozimin para armikut, për mospërmbajten e vetes si të meta që ai medoemos duhej t'i zhdukte.

— Gjaku nuk merret duke vrarë një apo dy ushtarë më tepër, ne nuk luftojmë vetëm për t'u hakmarrë për vuajtjet tona personale, por për ta gjunjëzuar këtë kuçedër, që u është hedhur në shpinë popujve, për ta varrosur nazizmin — i tha Refat Arapi. Çerçizi uli kokën si i zënë në faj dhe shokët vunë re që fjala e kishte vrarë në zëmër.

Por, kur binte në luftë, Çerçizi i harronte këto, prandaj edhe atë çast tha me vete:

«Do të hakmerrem për ta, po, do të hakmerrem për vëllanë, për babën, për nënën, për mbesën, për të gjithë do të hakmerrem». Sa herë kishte përpara armiqtë, edhe pse mundohej t'i harronte, i kujtoheshin të afërmit e rënë në betejë. **Lëvizi një çast nga vendi**, ndërroi edhe pozicionin e mitralozit dhe mori shenjë. Pa në shqekëzën e shenjestrës një ushtar armik, që qëndronte pas një peme.

— Hej, hajdut i ndyrë, ku shkon, more bastard?

— Me kë flet, Çerçiz?

— Ja, me atë, o xha Refat, e shikon?

Ushtari i shkurtër dukej si ndonjë brumbull i gjel-

bër, që zvarritej nga partizani. Refati e pa (brumbulli kishte sy, veshë dhe pushkë) dhe foli:

— Bjeri, ç'po e lë akoma? — Kështu e kishte zakon Refati, i shkrephte dhe e bënte, pastaj, kur kritikohesh, kafshonte me dhëmbë buzën e sipërme, pendohej.

— Le të vijë më afër!

Ushtari lëvizi duke u hedhur përpara me kërcime. Të tre partizanët e panë, të tre e shënuan në trup.

13

Marengleni lëshonte drejt qiellit fushqeta të kuqe. Tinguj dhe krisma. . . Brigada u hodh në sulm. Disa flitnin me zë të lartë:

— Ja ç'është brigada, grusht është!

— Topuz quaje, moj shoqja Bukuri.

Armiku kësaj radhe po goditej në një kohë dhe në një vend nga e tërë brigada.

— Kjo është goditje! Ja ç'bën forca e bashkuar në brigadë. Të tilla goditje mund të japin vetëm brigadat, vetëm ato.

Kompania e Bukurisë zuri qafën dhe u ngjit mbi gurët e mprehtë të Zleushës. Andej ajo vështronte më mirë vendin ku ishin gjermanët. Një kompani me ushtarë gjermanë rrokulliset nëpër përroin e madh. Qëllojnë kundër tyre të gjithë partizanët, qëllon edhe Bukuria. Kjo kënaqet kur shikon të mbetet në bokërimë i shtrirë, me duar e këmbë të hapura ushtari nazist.

— Hë, u godit. Na dhe një tjetër!. . — Përsëri trupin e gjermanit e përshkon plumbi.

— Ç'bën ashtu, Bukuri? — i flet xha Refati, — Me kursim plumbat, moj! Mos pandeh se sot do të marrë fund lufta? Duhet kujdes në harxhimin e fishekut.

— Nuk m'u durua, o xha Refat.

— Si? Pse, ku jemi këtu? Je në luftë dhe, në luftë, durimi i duhet partizanit, po aq sa edhe trimëria. Të vura re që rrëmbehesh. Kurseje plumbin. Po e mbajte

me të parën armikun, mirë se mirë, s'e mbajte, vuri një shenjë në trup, ta ketë kujtim, pa gjë s'ka lezet ta lëshosh. Kështu, bijë e xhaxhait? — i tha Refati dhe vrapoi.

— Uh, ky! Kush flet pa le, këshillon të tjerët ndërsa vetë bën si t'i shkrepet. Ta kishte dëgjuar Refati atë fjalë, do të qe zemëruar dhe kur i varte buzët, mbetej i zymtë gjithë ditën, por s'e dëgjoji, më mirë që nuk e dëgjoji — pohoi Bukuria dhe vrapoi.

Kur po sulmonte grykës, Bukurisë i doli përpara një ushtar armik. Fill e vetme midis shkurreve të pyllit provoi të rrëqethurat më të çuditshme në jetën e saj dhe s'pati kohë të mendohej e të fliste. Ngriti pushkën dhe, duke ndjerë në të njëjtën kohë një forcë të re, që ishte më e madhe se frika, drejtoi armën e qëlloi kaq afër, saqë thujse ja mbështeti në gjoks tytën e armës kundërshtarit, i cili u mundua të ikte, po s'arriti të hidhte disa hapa dhe u shemb përdhe. Ajo mbeti një çast si e hutuar, pastaj foli:

— Këtej, shokë, këtej, xha Refat, përpara!

Në xhade gumëzhimë motorësh, grahamë topash... Po të soditje atë kohë, do të dalloje vendet ku sulmonin partizanët. Megjithëse në shumë vende i lakuar, rreshti partizan dukej, si një vijë e gjatë, si një brez i vetëm. Hija që hidhte mali kësaj ane shënonte edhe ku firin, përtej të cilit ishin gjermanët. Andej vendi mbetej i zymtë, i ftohtë...

— Hë, e provuat si luftohet me partizanët! — Ulsyrin e shënon Refat Arapi. Çdo krismë të pushkës e shqëron me një fjalë.

— U mundën, o burra, mbi ta! Afër pa që vraponte një djalosh i ri, një pionier. Ishte Vocua. Me kokërdhokët e syve të këcyer jashtë, rrëmbeu pushkën e një ushtari të vrarë, e hodhi krahëqafë dhe thirri:

«Përpara, kompania jonë!»

— Ej, Voco, prit! Ç'më futesh ashtu si i verbër, kontrollo vendin! — i foli Çerçizi. Djaloshi u ndal një çast. Diku afër tij qëlloi një automatik.

— Ulu në tokë, se të vranë! — klithi Refat Arapi.

Djaloshi s'u kthye; të tjerët ndoqën shembullin e tij. Përsëri i folën, po djaloshi nuk e dëgjoi zërin e tyre. Ai zbriti andej nga u dëgjua krisma e armës dhe, duke vrapuar, thërriste vazhdimisht:

«Përpara, kompania jonë!»

14

Të gjitha mortajat dhe topat i kthyen grykat mbi malin e Tremishtit. Pastaj, asaj ane, në krah të brigadës u dukën ushtarët e batalionit të nazistit Diter Grebner.

— Ata duan të godasin edhe andej nga krahët, të zënë malet, të rrethojnë një pjesë të brigadës.

Disa kompani partizane, atje, në malin e Tremishtit, zunë pozicione dhe u ndalën.

Goliku u kishte thënë:

«T'i presim këtu! Le të na afrohen. Këtu, në këtë mal do të matemi me ta dhe do të shohim sa u vlen lëkura». Dhe qëndruan.

Në lartësi çdo gjë heshti. Nuk dëgjohej asnjë fjalë. Goliku mundohej të zbulonte ç'plane kishte armiku. Po shkonte drejtë pesëdhjetave Goliku dhe gjithnjë kaçak maleve të Labërisë kishte qenë. Nëpër luftëra, me pushkë në dorë që nga trembëdhjeta, komandant çete në njëzetën, në luftën e Vlorës, kaçak i malit deri në ditët e luftës së re. Më shumë jetoi në shkëmb se në shtëpi, ndaj, kur shikoje fytyrën e tij, të ngjante me një copë nga shkëmbinjtë e maleve. Nuk fliste, shtrëngonte nofullat e dala dhe grushtet. I shtrëngonte fort. E shikonte që armiku ishte më i shumtë në numër dhe më i armatosur. Si të bënte? Të urdhëronte tërheqjen! Bah, kjo ishte e pamundur, do të ishte turp e rrezik i madh për forcat e tjera të brigadës që vazhdonin luftën drejt xhadesë. Si ju hakërryen sytë atë kohë! Bluante në mendje plane luftimi nga më të ndryshmet. Thithi me afsh duhanin. Fytyra ju bë më e vrazhdë. Ky lloj sulmi i hesh-

tur i armikut, që në të parë dukej qesharak, e kishte kredhur në dyshime. Vetë ai do të qe hedhur para pa ngurrim, por e shikonte që rrugëzgjdhja peshonte për gjithë shokët, që prisnin urdhërat e tij. Ç'duhej të bënte?!

Goliku, me revolen, me kollanin e fishekëve e me një sërë bombash rreth mesit, u ngrit nga pozicioni dhe, ashtu me vetulla të ngrysura, i ra poshtë e përpjetë vendit. Deshte të murmuriste me vete, por zëri e tradhëtoi, i doli i lartë:

— Po qëlloni, or qena bir qenash, qëlloni, more!.. dhe shtrëngoi më fort nofullat. Në të tilla raste çdo komandant do të ndodhej ngushtë. Duhej gjykuar shpejt, drejt dhe duhej vendosur.

Në këto telashe ishte Goliku, kur nga pozicioni i parë erdhi tek ai zëvendëskomisari i brigadës. Sikur u lehtësua kur i tha:

— Si do bëjmë, o shoku Vogli?

Fjalën e partisë gjer në veshin e Golikut, në shkëmbinjtë e maleve, ku endej vite me radhë, ja kishte çuar atij Vogli. Goliku njihej me Voglin shumë kohë përpara se Shqipëria të okupohej nga fashistët. Kaçaku Jaho Goliku qe mësuar të mos u zinte besë fjalëve, ndaj nuk u vu lehtë në brazdë, po i pëlqyen mendimet e partisë, ndaj njeriu i sertë i shkëmbit u zbut dhe, duke qenë afër njerëzve të partisë, u bë e qartë se kë dhe ku duhej të godisnin plumbat e armës së tij. Kur u bind se cila ishte rruga e luftës çlirimtare, kaçaku Golik u dha me ç'kishte për revolucionin dhe tani qëndronte në krye të një brigade që e krijoi dhe e drejtonte Partia Komuniste.

Pranë, në një llogore me të qëndronte Vogli. Kur e kishte pranë zëvendëskomisarin, atij i vinte mirë, i dukej sikur edhe më mirë do të shkonin punët dhe më lehtë do të mposhtej armiku, ndaj u gëzua që erdhi afër tij do të mposhtej armiku, ndaj u gëzua që erdhi afër tij atë kohë, në pozicion, Vogli. Dëgjoji nga ana e nazistëve një zë të lartë, por në gjuhë të huaj. Diter Grebner kishte dhënë komandën dhe ushtarët, në majat e pushkëve, mbërthyen bajonetat. Ende s'qe dëgjuar në bregoren e Tremishtit ndonjë armë. Sundonte vetëm heshtja. Pikë-

risht tani ajo ishte më tronditëse se plumbi e bomba. Duke sikur heshtja ishte vetë vdekja.

— Ku shkojnë kështu?

— Duan të godasin në krahë forcat e brigadës. Dhe po të arrihej kjo, sulmi i brigadës partizane dështonte, dëmet do të ishin të mëdha. Edhe ai sulm, që bënë në kodrën përtej, atë qëllim kishte.

— I thyet?

— ...

— Nga tanët u vra ndonjë?

Vogli heshti. Lajmi që do t'i jepte, ishte tronditës. Tjetri e kuptoi se kishte ndodhur diçka me rëndësi.

Nën vetullat e **vrenjtura**, **nën sytë** e errësuar, fshiheshin mendimet e tij mbi ndeshjen që do të fillonte dhe sytë e tij lëshuan zjarr drejt zjarrit; ju duk sikur e gjeti atë që bluante në **tru**, e **gjeti çelësin e fitores**, ndaj thirri:

— Para, partizanë! — dhe u hodh i pari, së bashku me Voglin.

Ishte lodhur e mpirë në vend partizanët, por fjala për t'u ngritur në sulm sikur ua përtëriu fuqitë e i hodhi përpara.

— Përpara! Përpara!

Majori Diter Grebner u thërret ushtarëve, i kërcënon... Ndërsa Vogli e Goliku me partizanët zbresin në drejtim të Përmetit.

Ishte shuplaka e dytë që merrte në fytyrë majori Diter Grebner. Ai u tërhoq në drejtim të xhadesë. Lugina e Vjosës buçiste nga zërat:

— T'i ndjekim! T'i ndjekim!

Dhe batalionet e brigadës sulmonin në shumë drejtime.

Gjithë populli u vërsul mbi ta. Sulmoi edhe mjeshtri Gole Përmetari. Krismat mbi pozicione nisën të dendësohen. «Populli i gjithë po vërsulet» i tha Vogli komandantit. Goliku heshti. Duke parë këta njerëz me shollë llastiku të mbërthyer me tela, apo me opinga lope, që me një dyfek në krah vraponin të zinin pozicionin në vijat e para, pati një përshtypje edhe më të fortë nga ato

që kishte dëgjuar për njerëzit e prapavijës. Deshte t'i thoshte Voglit se vetëm në raste të tilla shfaqet modestia e popullit, forca e tij, por heshti. Sikur ja pikasi Vogli mendimet, ndaj ndërhyri:

— Duhet t'i kemi kujdes, do të kenë nevojë për municion.

— Po, — tha Goliku — atje duhet të dërgojmë dikë — dhe njoftoi intendencën e brigadës.

15

Majori Diter Grebner kishte mbetur me praparojet. «Më mirë pulë e pranë zjarrit, se sa trim e në llogore», dyshoi për të parën herë majori.

Por tani praparojet mundoheshin të ngadalësonin ndjekjen e partizanëve, që t'u jepnin kohë forcave të tërhiqeshin. Dëgjohej zëri i fuqishëm i Marenglenit:

— Sulm! Sulm!

Majori Diter ngriti dylbinë dhe dalloi atë që foli. E njohu, ishte po ai partizani me mustaqe me xhakëtë bezhë që këmbyen me të flakë për flakë armët në Kosinë dhe që plumbi i pushkës së tij i kishte prerë xhakëtë te supi.

Dëgjohet më afër nazistit Diter zëri dhe krisma e armës së Marenglenit.

Në shpinë të armiqve hidhet plaku Gole nga njëri ledh në tjetrin, zbraz «austriaken», vështron përpara dhe sérish e mbush armën. Atij i bëhej sikur në ato qindra zëra e krisma ishte dhe zëri i të birit, sikur dëgjonte krismën e armës së Manolit. «Di ta përdorë dyfekun ai, krismën e armës së Manolit. «Të lumtë, Ma-e di që s'më turpëron» thoshte me vete. «Të lumtë, Manol, të lumtë, o bir!» Pastaj: «Po sikur të m'i ndodhë gjë djalit? Bah, larg qoftë!...» «Austriakja» përsëri kërcet në duart e Gole Përmetarit.

Sulmon brigada...

Sulmon biri i Gole Përmetarit.

Një mitralier nazist ja bën tym me plumba të birit të Goles, që u vu në ndjekje të tij. Të gjithë u ulën në

tokë. Edhe Golja zuri ledhin dhe u bë gati të zbrazte «austriaken», sado që andej u drejtuan shumë gryka pushkësh. Mitralozi i armikut shtinte.

— E ka zgjedhur vendin; as dreqi nuk afrohet atje.

Prapë këmbehen armët. Manoli ka marrë pushkën e shokut, rrëshqet përpara, i afrohet mitralozit. Gole Përmetari vështron, mundohet të dëgjojë krismën e armës. Po as krisma dhe as zëri i Manolit të tij s'po dëgjo-heshin më dhe Gole Përmetari u bë sy e veshë. Megjithatë ai s'qe në gjendje të dallonte krismën e armës. I buçisnin veshët, i rrihnin fort tëmthat. Mitralozi armik qëllonte. Golja, si gradoi shenjëstrën, u bë gati të shtinte. Pa mu afër pozicionit të mitralierit gjerman të birin që zvarritej; shkonte drejt mitralierit. Ushtari fashist sikur ja ndjeu erën, ndaj hodhi një bombë. Ajo shpërtheu disa metra larg partizanit.

— Ki kujdes, Manol, ki kujdes! — i folën shokët.

Edhe dy hapa të tjerë Manoli ju afrua më pranë ushtarit gjerman.

Gole Përmetari murmuriti me vete.

«Kujdes, Manol, ki kujdes, bir! Ç'e pruri këtu egër-sirën që nga ana e anës!» I dridhej më shumë zemra nga buzët.

Një çast ai grup partizanësh që ishte atje mbeti në vend. Nuk mund të përparonte. Marengleni pyeti:

— Cili është ai partizan që shkon drejt mitralozit.

— Manoli.

— Djali i Gole Përmetarit?

— ...

Dy granada hodhi Manoli, dy kërpuurda tymi u ngritën atje. Pastaj Manoli u hodh dhe mori mitralozin. Gole Përmetarit gati sa s'i shpëtuan lotët kur i biri i tij shtiu me atë mitraloz që ja hoqi nga duart ushtarit të kolonës armike që tërhiqej. Goditi Manoli me plumba edhe maqinën e hekurit në fund të kolonës, me të cilën largohej nga lugina e Përmetit, i mundur, majori nazist Diter Grebner. Marengleni përsëri dha urdhër për t'u ngritur në sulm. U dëgjuan qindra zëra:

— Përpara!

KAPITULLI I TRETË

*«Për këto ëndrra të së ardhmes
i mbajmë në sup armët».*

1

Një diell i ngrohtë derdhte i qeshur rrezet e arta mbi qilimin e bardhë, që kishte mbuluar gjithshka. Një pamje të rrallë verbuese mori tërë luginë. Edhe Vjosa, si një shirit i argjendtë, zgjatej luginës. Rridhte atje dëbora, ujët e maleve. Nuk dëgjoheshin më afër në këtë luginë krisma armësh. Fytyrat e njerëzve ishin të çelura e të gëzuara. Mbas zmbropsjes së armikut jehoi përsëri anës Vjosës kënga. Në një lëndinë, jo shumë larg nga bregu i lumit, një partizan i bie kitarës. Dëgjohej tingujt e ëmbël dhe diku larg krisma të armëve. Reparte të tjera partizane godasin ushtarët e gjeneralit Gajb.

Në bregun e lumit ka një gjallëri të papërmbajtur, një vërshim këngësh.

— I thyem, i thyem dhe kësaj radhe — dëgjoheshin zëra.

Partizanit me kitarë i gufonte zemra; ulur mbi një gur ai godet telat me majat e gishtave dhe tingujt melodiozë ngrihen të fuqishëm. Bukuria dhe Çerçizi së bashku me disa partizanë të tjerë këndojnë. Dalëngadalë zërat, që shkrihen në marshin e ri të brigadës së porsaformuar, bëhen më të fuqishëm, më të sigurt, më harmoniozë dhe kënga derdhet anës Vjosës, në luginën e ftohtë:

*Dhe me hov sulet përpara,
Në sulm, në sulm Brigad' e...*

Njerëzit i ka rrëmbyer kënga, gëzimi, shpesh shpërthejnë në brohoritje:

Rrofshin brigadat partizane!

Thirrjet e fuqishme i rrëmbeu mali dhe guvat e grykat oshëtinë: «Rrofshin brigadat partizane!»

Kitaristi, i përpirë në jonet e gëzueshme të marshit luftarak, hedh gishtat nëpër tela, e tingujt shpërthejnë nga gjokset...

Pak më tutje një partizan dhe Refati po kuvendonin me njëri-tjetrin:

— Ç'm'i ka ata sy të zes, ky Çerçizi!

— Pse trupin? Bredh shullëri, fidan të drejtë...

— Kur erdhi partizan, vinte ca i drojtur, ndërsa tani këndon me zë bilbili.

— Më pëlqejnë këngët e trimërisë, që ndjekin njëra-tjetrën, derdhen e shkrihen së bashku, duke sajuar një rapsodi të pambaruar.

— Këngët e popullit, biri im, janë si përrenjtë malorë, që herë me pak ujë e herë duke shkumëzuar derdhen përjetësisht në një burim, që s'thahet kurrë; ashtu janë ato.

Refat Arapi, me pushkë të hedhur në krah e me çibukun të ndezur, shkoi të gjente Halil Imerin.

— Të erdhi mitralozi, xha Refat. Tani edhe skuadra juaj do të ketë përsëri mitraloz — i tha Halili.

Refat Arapit s'ju durua:

— Ç'markë është?

— Mitraloz «sharës».

— ...

— Bashkë me mitralozin po vjen dhe mitralieri.

Refati u vrenjt, e tha:

— Kam djem për mitraloz, vetëm armën kërkoj unë, shoku komandant. Ma prishën mitralozin gjermanët, ma vranë edhe shokun — psherëtiu:

«Dardan, Dardan».

— Nuk ka vdekur, pse flet kështu, më thanë që është më mirë.

— Zor i mban trupi aq plagë, o shoku Halil. Pastaj, o u dashka mitralozi në luftë, s'ka skuadër pa mitraloz. Po si nuk shtiva dot në dorë një tjetër! Më vjen të pëlças. Gjithë ato armë zumë, edhe mortaja edhe mitralozë të rëndë u zumë, po një mitraloz për veten tonë s'na ra në dorë.

— ...

Dhe Refat Arapi u kthye në skuadër bashkë me mitralierin e ri.

— E, djema, ja edhe mitralozi na erdhi.

— ...

— Armë e mirë është. Ç'kompani e kapi? — tha Bukuria.

— Ky trimi, që është këtu, e shikoni?

Manolit i erdhi turp e u skuq në fytyrë. Refat Arapi i përkëdheli shpatullat dhe e goditi lehtë me pëllëmbën e dorës.

— Njihuni!

Partizanët, një e nga një, rrokin duart.

— Bashkë me ngjan se jemi parë.

— ...

— Ke qenë në luftën e Mezhgoranit?

— Po.

— Po në luftën e Libohovës?

— Po.

— Atje jemi parë. Ulu, bir i xhaxhait, ulu. Kjo është skuadra jonë. Ja, më i madh në moshë jam unë. Hamall kam qenë tërë jetën. Më i vogli është Vocua. Shejtan është! E ka marrë partizan komisari i brigadës, Muçua. Tretur është djali. Nënë ja vrau balloni i Italisë. E kanë munduar. Ja ka tharë jetën ujët e balta. Në fillim mezi na ndiqte, tani ka filluar të luftojë mirë dhe shkrimin po ja mëson kjo shoqja Bukuri e quajnë. Nga qyteti është. Është rritur me halle. — Dhe me radhë e njohu me të gjithë. Pastaj u tha partizanëve:

— E dini kush është ky shoku?

— ...
— Djali i mjeshtrit, djali i Gole Përmetarit, Manoli. T'i çojmë fjalë Gole që ta dijë se Manoli është këtu në një skuadër me ne. Mirë do t'i vijë...

2

Nëpër gërmadhat e qytetit gjarpëronte një rrugë me drëdha të shpeshta. Kësaj rruge shkante komisari i brigadës, Marengleni, që po kthehej nga batalionet. Ai po sillte në shtab mendimet e partizanëve, të komandan-tëve e zëvendëskomandantëve, të komisarëve e zëvendës-komisarëve. Kishte shumë për të thënë. Të gjithë kishin kërkuar të hidheshin në goditje të tjera. Kishte edhe asish që u shprehën se pas lodhjes së madhe, duhej të pusho-nin të merrnin forca e mandej të sulmonin, por zërat humbën në zërin e vetëm të përbashkët të brigadës: «Të godasim!» Goditjet e njëpasnjëshme Marenglenit i duke-shin të domosdoshme, se ndryshe do të kishte rrezik të ktheheshin në një repart ushtarak të plogët, të humbis-nin shpirtin sulmues të brigadës.

«Të godasim! Po ku?» Ky ishte një mendim, që e shqetësonte Marenglenin. Pra, duhej t'i bëhej një vlerë-sim i ri situatës, duhej me çdo kusht të merrej lidhje me shokët e qarkorit të partisë, me brigadat e tjera. Në shumë drejtime u nisën korrierët.

Komisari ishte zhytur në mendime kur, pranë tij, u rrëzua me zhurmë faqja e një ndërtese të djegur. Ai u ndal dhe hodhi sytë në ato mure ku dikur ngrihej një shtëpi e vjetër. Kujtime të paharueshme e lidhnin me atë shtëpi. Një vit më parë, si i deleguar i qarkorit të partisë në atë shtëpi kishte mbledhur celulën e partisë dhe kishte formuar këshillin e parë të rrethit. Disa ditë qëndroi atëhere në këtë shtëpi. Edhe atëhere silleshin rrugicave të qytetit patrulla ushtarake, milicë. Por ce-lula e partisë jetonte. Ishte shkëndija, që dha flakë në këtë luginë. Mundohej të kujtonte shokët e parë. Ato ditë ata kishin qenë pak, por çdo ditë shtoheshin. Tani

mbushnin radhët e çetave partizane. Një pjesë e tyre ishte rreshtuar në brigadë.

Veprimet luftarake në Shqipërinë e Jugut po arrinin në fazën e tyre më kritike. Operacioni në zonën e Mesaplikut, Kurveleshit e Kardhiqit vazhdonte. Në situatën e re, detyra të tjera i dilnin edhe brigadës së re partizane. Ajo u ngjiti përsëri në male, u vu në kërkim të armikut.

Nga këto male Marengleni shikon me dylbi male të tjera, lugina dhe rrugë automobili. Armiku është kudo; nga çdo anë lëvizin batalionet e regjimentet e tij. Kudo tym dhe gërmadha. Dëshpërimin, që ndjen çdo partizan, e provon dhe Marengleni. Edhe Refat Arapit, po ta shikoje me vëmendje, do t'i dalloje dëshpërimin në fytyrë. Shpesh, duke zbritur nga malet, thoshte:

— Pritna, gjerman, për të gjitha do të na japësh hesap!

Nga goditjet e njëpasnjëshme, që merrte armiku, filluan të çliroheshin disa fshatra.

Kalojnë partizanët e kompanisë së Halil Imerit me shpejtësi nga njëri fshat në tjetrin. Skuadra e Refat Arapit, duke ndjekur armikun, kishte arritur në skajin më të largët të krahinës.

Ata qëndruan në një fshat që nuk ishte prekur nga zjarri i luftës. U futën në rrugicat midis shtëpive, trokitën në një portë. Asnjë përgjegje. Kushedi përse?.. Trokitën njëherësh në dy porta të tjera. Nga një haur doli një djalë i vogël, që u largua i frikësuar.

— Qëndro aty, o vogëlush, qëndro!

Djaloshi u bë erë, ja mbathi me të katra e thirri i trembur:

— Ballistët, ballistët!

— Jemi partizanë, djalo — i foli Refati.

Djaloshi mbajti këmbët e donte të dëgjonte në ishte e vërtetë ajo fjalë.

— Qëndro, more vogëlush! Partizanë jemi! Mos u tremb, o trim!

Vogëlushi u kthye.

— Vdekje fashizmit, vogëlush! — e përshëndeti Manoli.

— Partizanë, partizanë! — u kthye djali e foli me zë edhe më të lartë: — Hape, xha Kola, hape! Janë partizanë!

Ato ditë kishte edhe ballistë, që endeshin në krahinë.

U hap një portë dhe pesë partizanë dhe Bukuria hynë brenda. Në këtë shtëpi ata gjetën një partizan të plagosur. Të plagosurin e gjetën të shtrirë, pa ndjenja. Manoli ja zgjidhi plagën dhe, pasi ja mjekoi, ja lidhi përsëri, po në fytyrën e tij u vu re një dëshpërim i madh. Me sa dukej, gjendja e të plagosurit ishte shumë e rëndë. Fytyrat e njerëzve, që i qëndronin pranë, u bënë edhe më të zymta.

Heshtje...

— Si të duket, o i biri i Goles?

Manoli uli qepallat e nuk foli.

— Si e ka emrin, moj motër? — ju drejtua Refati. Gruaja që e kishte hequr nga pozicioni partizanin mblodhi supet. Ajo tani mendonte vetëm për atë. Donte ta shpëtonte.

Partizani i plagosur kishte lidhur në qafë një shami të kuqe. Vallë në ç'batalion, grup apo brigadë bënte pjesë ai djalë i ri?

Kërkuan sërish nëpër xhepat e xhakëtës së tij mos mësonin emrin, mos kishte të paktën ndonjë shënim të vogël, që t'u ndihmonte të dinin diçka për të, për vendlindjen e tij.

— Kërkoni, djem, kërkoni! — u thoshte shokëve Refat Arapi.

Nuk lanë xhep pa shikuar, zbrazën edhe çantën, por aty gjetën vetëm fishekë dhe bomba.

Pyetën në fshat. Të gjithë fshatarët thanë se në atë vend qe luftuar. Partizanët ishin pak e armiqtë shumë.

— Ama, luftë bënë! Trima ishin, qëndruan gjithë ditën, por i hëngrën nga krahët... Ata dreqërit e Ballit, ata ua treguan rrugën. Njëri mbeti në vend, ja, aty te

kodra. Kishte mitraloz. Trim djalë ishte. Ç'e do, e goditën rëndë. Nuk ngriti dot më krye. I shkreti djalë!

... Disa orë më vonë, përposh nën fshat, te bregu i vogël i mbuluar me lisa, u çel një varr. Atje, në pozicionin ku luftoi, po varrosej partizani i panobjhur. Halil Imeri i rreshtoi shokët përpara varrit të partizanit dhe u foli të gjithëve sa ishin atje.

Refat Arapi u drodh:

— Kurrë s'më ka bërë vaki të varros një njeri, të cilit nuk ja di emrin! — u tha shokëve.

Kjo gjë i preku të gjithë. Pranë pozicionit, ku shndriste ylli i kuq në kapën partizane, u ngrit foli dhe Çerçizi. Ai tha:

— Ëndrrra jonë, o vëllezër, për të jetuar të lirë, për të jetuar në një botë të re, ngjitet bashkë me ne në matjat e maleve. Për këtë ëndërr të së ardhmes i mbajmë armët në sup. Për këtë ëndërr ra, si mijëra të tjerë, ky ushtar i lirisë, shoku ynë! Lufta po na çel shtigjet drejt jetës, drejt dritës! Të ecim në këtë rrugë, të ecim me guxim...

Pastaj Halil Imeri me gëzhojat e mitralozit, që kishte mbetur në atë pozicion, shkroi mbi varrin e tij gërmat: «V.F.L.P.» Bukuria e pa dhe nxori nga çanta një copë të kuqe. Mbi varr u ndeh flamuri. Partizanët shkrepën pushkët dhe kënduan një këngë për dëshmorët.

Nënës i lëvizi diçka midis ballit, Bukuria rrahu fort qerpikët e syve. Një pikë loti e nxehtë u rrokullis nëpër faqen e Vocos dhe ra mbi tytën e ngrohtë të pushkës; Refat Arapit ju mblodh dhembja në fyt e në zemër kurse Çerçizi, që ishte pushtuar nga emocioni, këndonte dhe zbraste breshëri mitralozi.

3

Mbasdite brigada u grumbullua në një lëndinë në mal. Grupi teatral, që sapo ishte formuar, jepte shfaqjen e parë. Partizanë e partizane të ulur këmbëkryq mbi borën e bardhë, me armë të mbështetura te supi i djathtë,

me tyta lart, bisedonin për ngjarje të ndryshme. Rreth tyre male të larta, borë...

Nemërçka si gjithnjë sillte furtunën.

Refat Arapi, që vështronte andej, u thoshte shokëve:

— Keni provuar ndonjëherë furtunë si ajo?

— ...

— Keni dëgjuar si i mbyt rryma e erës njerëzit e kafshët, që ndodhen në qendër të saj?

— Jo, xha Refat.

— Pyesni xhaxhanë. Edhe frymën ta ndal, edhe lëkurën ta rrëmben, ndaj tremben njerëzit nga ajo rrymë ajri, që ngrihet në verë në fushë dhe në dimër maleve. Ja ashtu si ajo, si shtylla që ngrihet drejt përpjetë...

Do ta kishte vazhduar ende bisedën, po të mos delte në skenën e vogël, të improvizuar me disa fletë çadre, një partizan. Refati vuri dorën te veshi për të dëgjuar më mirë. Ai e njihte atë zë. «Uh, qenka Bukuria jonë! Hajde, ç'vajzë që është! Pushoni, ju, dëgjoni! Po Dardani, si do të jetë?» Mendja i punonte edhe te Dardani, edhe te skena.

Bukuria jepte programin me zë të lartë. Refati vinte dorën në vesh për të dëgjuar më mirë.

Pastaj në skenë doli njëri nga aktorët, që përshëndeti e pastaj u hodh, u përdrodh e thirri me të madhe: «qesh e ngjesh».

Të gjithë ja plasën gazit, pëshpëritën vesh më vesh: «Kushedi sa qyfyre do të dëgjojmë!»

Dhe shfaqja filloi me pjesën: «Nga fjalori i dallkavkëve dhe i kriminelëve».

Vuajtje: fjalë e re, e shpikur nga kuqalashët dhe nga harbutët. Ne jo vetëm s'e kemi provuar në vendin tonë, po as e kemi dëgjuar ndonjëherë. Unë kuptim mirë nuk ja di, as që kam qejf t'ja di. (Marrë nga fjalori i Shefqet bej Vërlacit).

— Nga do ta dish ti, o lum miku, e di ky babaxhani ç'i ka hequr shpina prej samarit. Më vriste bile më shumë se kalin. Kallo më qe bërë kurrizi. Po për ju, o shushunja, i ruajmë plumbat, mos kujtoni se mund të na shpëtoni.

Një nga partizanët e prek me bërryl e i thotë ngadalë:

— Jemi në shfaqje, xha Refat.

— Po veç ai, që ka dalë atje, më ngjan në fytyrë si ata.

Në skenë del një aktor tjetër. Biseda ndërpritet nga zëri i fortë:

Popull: (turçe «*pis millet*») quhet ai që është këmbëzbathur, lapurak, gojështurur, ndyravec, ai që nuk nderon «*oxhakun*» dhe «*fisnikun*», që nuk përkul kurrizin dhe nuk bën temena. Këta barbarë guxojnë t'i flasin edhe beut me «*ti*». Bile kanë përfolur, maskarenjtë, edhe për mikun tim të dashur e të shtrenjtë, Dalmacon, që i marrçin të keqen njëmijë herë.

— Nga fjalori i kujt janë marrë këto radhë — pyet aktori që nga skena.

Xha Refati u ngrit nga vendi. Të gjithë kthyen sytë nga xha Refati që po përgjegjej:

— Të Ali bej Këlcyrës, më duken. Atij i ngjake, topall je edhe ti, si ai, barkosh, si ai. Po, ai i tëri!

Përsëri gaz, fjalë, shaka.

Prapë del në skenë një aktor tjetër.

Karakter: kjo forcë shpirtërore e atij që punon për popull e atdhe, në fjalorin e tij shpjegohet:

«Atdhe nuk është vendi ku ke lerë, po vendi, ku rron mirë. Atij që të mbush kuletën, atij duhet t'i shërbesh. Prandaj në shtëpi duhet të kesh flamurët e të gjitha shteteve dhe t'u shërbesh, të nxjerrësh në ballkon atë flamur që ta dojë puna, interesi dhe leverdia.

Paret e shteteve nuk shteren kurrë më sa shteron deti. Kush nuk pi ujët e këtij deti të pafund, është derr. Për njeriun me karakter vetëm dy fjalë duhet të figurojnë në fjalorin e tij: «*Peqe*» dhe fjala që ka mbetur nga dovleti: «*Çok jasha, padishah*» që nuk duhet harruar kurrë.

— E dini cili është ky?

— Spiunët! — thanë disa.

— Ballistët! — ja pritën të tjerët.

Dhe prapë u shfaqën në skenë të tjerë. Ballistët, që enden me pula të varura në tytat e pushkëve, nazistë gjermanë, që kapen robër, por nuk duan të thonë «kaput Hitler».

Na kënaqën. Ku u ka vajtur mendja! Po qenka vajtëzë me mend Bukuria jonë. Hë, ajo i mëson, për kokën time, ajo!

— Paskësja qenë i humbur i dynjasë. Si, ore, ditka edhe i biri i Gole Përmetarit të lozë thiatro? Këtë nuk e dija! Por ai djali i Fejzajve të Golemit, nga mësoi ai?

Partizanët çlodhen, gëzojnë, mësojnë, këndojnë... Ndërsa në shtabin e brigadës Marengleni, Vogli dhe Golliku bisedojnë për detyrën e re luftarake, që i është ngarkuar brigadës nga Shtabi i Përgjithshëm, për kohën dhe vendin ku duhet të japë goditje brigada!

— T'i sulmojmë! T'i godasim armiqtë kudo që të struken, kjo është detyra e brigadës sonë — u thoshte Marengleni. Partizanët vunë re që fytyra e komisarit ndriti, sytë ju çelën, ju bënë më të bukur sapo zuri në gojë sulmin.

— Gati jemi, gati! — jehonin malet nga zërat. Dhe brigada natën u vu përsëri në marshim.

4

Komandanti i kompanisë partizane që ishte në pararojë, Halili fliste e caktonte detyra. Era e malit fishkëllente. Komandant Halili, kur dyshonte se mos këputej vargu i partizanëve, e ngrinte zërin edhe më lart, kthente kokën e bërtiste: «O burra edhe ca!» Suferina ja bënte zërin si sokëllimë. Partizanët filluan t'i ngjiteshin majës së malit. Ecnin duke u përkulur përpara. U ngjante sikur do t'i rrëmbente era.

Njëri nga partizanët e pararojës rrëzohet dhe ulet një çast.

— Ngrehu, ti, aty, se do të mbetesh i ngrirë në vend, në qoftë se nuk lëviz.

— E di Refati atë, po s'mundem, shoku Halil, nuk mundem!

Ulet, do të mbledhë forca.

— U lodhët, xha Refat? — Komandanti i afrohet.

— E shoh, Halil, që u plaka me të vërtetë. Sa hedh dy hapa dhe më priten këmbët. Ku, si kam qenë në djallëri! Të lodhesha unë? Kurrë!

Ai me një stërforcim të muskujve ngrihet, futet në rresht e murmurit:

— Është shumë e përpjetë. Një kohë më dukeshin një, si rruga e malit dhe e fushës. Tani, eh, po më lënë të shkretat — dhe u ra me pëllëmbë të duarve gjunjëve.

Filloi të binte shi i përzier me borë. Mustaqet dhe vetullat kaleshe të Refat Arapit vunë një shtrat të hollë bore. Partizanët e kompanisë që dukeshin si diçka e bardhë, e lëvizshme, fundoseshin me gjithë armë. Bukuria rrëshqiste disa metra më poshtë duke u zhytur në borë.

— Ki kujdes, moj bijë e xhaxhait, ki kujdes! Ndër krahun, kapu pas pushkës, hop!

Ata dalluan diçka përpara dhe Refati foli me zë të ulët:

— Pa fjalë!

Lëvizën ngadalë.

— Aty ka roje: dy qenkan. Ishin dy njerëz me duar e këmbë të mpira. Shiu nuk u kishte lënë vend pa i lagur.

— Me kujdes, të mendojmë si do të veprojmë.

— T'i godasim!

— Jo, krisma s'na duhet, presim, pastaj shohim e bëjmë.

Rojet erdhën dhe nja dy herë rreth, duke vështuar hera-herës rrugën që zbriste nga mali. Ato qëndruan një çast, pò Refat Arapi kot dyshoi, sepse rojet nuk kishin parë asgjë. Dhe ato, pasi kishin shkundur gllënjikën e fundit të rakisë, që kishin marrë me vete, filluan të shanin shokët e ndërrimit, që ishin vonuar. Pastaj të dy i mbështetën pushkët dhe i vunë krahët një guri që të mbroheshin nga era...

— Hë, eja këtu, Manol! I shikon?..

— Po, xha Refat!

Partizanët, duke u zvarrisur, u morën pushkët rojeve.

— Erdhën qerozët! Ah! Qerozë, a qerozë! — tha ballisti, që mblodhi këmbët nën sharkun për të mos ja lagur shiu. Ai vazhdoi të shante, duke kujtuar se ata që erdhën ishin shokët e tyre, që do të bënin ndërrimin.

— Çohu dhe lëre muhabetin! — i tha Bukuria rojes.

Refati qëndronte i gatshëm për t'ju hedhur sipër ballistëve.

— Ej, ç'na e punove, o pjellë e dreqit — shau përsëri ballisti. — O çoparka e djallit, tani kërkon edhe të na frikësosh! Ma bën atë zërin si të ndonjë çupke, si ato të partizaneve! Tallu, o edepsëz, tallu, o pizeveng, se na e punuat mirë sonte. Ja, dhe Isufin e ka zënë gjumi, s'lëviz fare tutkuni. Është shtrirë dhe fle si i vdekur. Gërhet sikur do t'i dalë shpirti. Ka pirë shumë budallai dhe s'e mban rakinë.

— E ç'më mbuloresh ashtu? Çohu! — i thirri Refati.

— Po sikur të vijnë partizanët?

— U plaka unë në këto vende — ja priti menjëherë ballisti. — Sonte, o miku im, s'kalon dot prakun e derës, e jo të kalosh qafën e Çajupit.

— Çohu, rebel, mos bluaj kot së koti! — i foli Bukuria dhe e goditi me qytën e pushkës. Ballisti u çua, ngriti duart lart. Duke u dredhur i tëri, thirri i tmerruar:

— Perëndi, ç'më gjeti!

Në fshat kishte mercenarë dhe ushtarë gjermanë.

— Zini vendet! — urdhëroi Halili.

Partizanët e kompanisë zunë vendet dhe u lëvizën sigurecat armëve.

Zjarr me granata, zjarr! — u dëgjua zëri i Halilit.

Gryka dha jehonin e zërit, shpellat e gërxhet e përsëritën disa herë me radhë: zjarr me granata, zjarr! Shungulloi nga gjëmimet gryka. Sulmonte drejt rrugës kompania partizane, sulmonin batalioni dhe brigada!

— Sulm në Stegopul!

— Sulm në Erind!

— Sulm në Saraqinishtë e në Suhë... kudo sulm...

Krismat e pushkëve partizane u dëgjuan në qytetin e lashtë dhe popullit të Gjirokastrës i ngrohej zemra. Atje, në ato rreshta partizanësh, në male, qyteti kishte bijtë dhe bijat e tij. Sapo krisi lufta, qyteti vështroi flakët e pushkëve, që derdheshin nga malet. Binin ato pushkë në kohën kur në qytet larot e Ballit dhe prefekti çirreshin duke thënë që gjenerali gjerman Fon Gajb i kishte zënë një e nga një partizanët e brigadës së re, siç i zë poha peshqit e lumit, duke i futur në rrjetën e madhe, në rrjetën e çeliktë, ndaj dhe kalaja qe mbushur.

— Gënjeni! — thoshin në qytet.

— Shikoni, ja, i shikoni? — dhe hapeshin dyert e rënda të kalasë së qytetit, nxirrej që andej i lidhur me hekura në këmbë e në duar një partizan a një partizane, që e merrte në shenjë pushka, i hidhej në qafë litari i trikëmbëshit, i cili i ngjante qytetit si një gjarpër i madh, që ditë e natë, si përbindsh, shullohet në mes të sheshit pranë përmendores së Çeços.

Popullit i dhembte në zemër, por krenohej, sepse ata s'e ulnin kokën kur i godisnin me plumba, por thërrisnin:

— Poshtë okupatorët! Rroftë liria!

Krismat e armëve të brigadës ndiheshin edhe më afër.

— I dëgjoni? — thoshin qytetarët.

Ballistët lehnin:

— Janë verbuar nga bora, ngordhën; duan të hanë, duan bukë, bukë! Keni për të parë ç'do t'u bëjnë gjermanët!

Disa ditë më parë nëpër qytet ishte shpërndarë një trakt, që njoftonte formimin e brigadës së re partizane. Ishte gëzim për qytetin, sepse shtohej edhe një brigadë partizane. Si kudo në Shqipëri edhe në qytetin e gurtë njerëzit thanë:

— Rrofshin brigadat partizane!

Një javë më vonë fletushkat e ballistëve lajmëruan

se brigada e re partizane ishte asgjësuar në luginën e Përmetit. Prefekti vuri tellallët që të përhapnin lajmin rrugicë më rrugicë.

— Nuk është e vërtetë! Gënjejnë!

Meqë lufta po ndihej gjithnjë e më afër qytetit, populli mendonte:

— Ndoshta është brigada e Marenglenit, patjetër që ajo do të jetë! Asnjëherë s'kishin qenë kaq të dendura të shtënat e armëve partizane në afërsi të qytetit.

Rrugëve të qytetit vraponin atë ditë ushtarë gjermanë e ballistë. Të gjithë shkonin në Lunxheri, andej nga qëllonin armët.

— I mbërtheu dambllaja ballistët.

Populli priste me ankth. Nëpër mure ngjiteshin trakte kundër okupatorit.

U dërguan forca të tjera armike: toga e kompani me ushtarë vraponin drejt bregut të lumit, kalonin të parët mbi urën e lashtë, shkonin për në Lunxheri, i delnin përpara brigadës.

Ballistët e xhandarët, që endeshin nëpër qytet me pushkë, shqyenin sytë. Çdo krismë u jepte një dridhje në zemër.

— Hë, ku do të futeni tani, ku? — u thoshin me kurajë qytetarët. Traktet, shtoheshin nëpër rrugët e qytetit.

Ishte ende mëngjez. Një diell i ngrohtë porsa kishte derdhur rrezet e para, kur sulmi partizan drejt kalasë së shën Triadhës, drejt qytetit, bëhej edhe më i vrullshëm. Partizanët ngjitnin një e nga një lartësitë. Çerçiz Fejzua me një grup partizanësh u kishte vajtur shumë afër gjermanëve. Nazistët ishin në pozicione dominuese, në vende nga mitralozët e tyre godisnin çdo skutë.

— Eh, shoku Çerçiz, si do të bëjmë?

— Sulm, shokë, përpara mbi ta!

Dhe ngrihet i pari Çerçiz Fejzua me mitraloz në dorë; sulmon nga ana tjetër Bukuria, që sakaq zbraz armën, Refati me maliherin dhe Vocua me patickën e tij. Pastaj Çerçiz Fejzua kalon nga ai vend në një tjetër, e

hedh bomba. Partizanët e morën dhe një pozicion e u shtynë më përpara.

Një mitraloz hap zjarr kundër partizanëve... Disa shokë mbeten të plagosur. Toka u lag me gjakun e luftëtarëve. Për një çats vargu partizan mbeti në vend. Kjo dha shkas të këmbenin biseda në qytet:

— Ku i lë gjermani t'i vijne qytetit te hundët. Tym do ta bëjnë.

— Pusho, o i shitur!

Prefekti, si ta kishte pickuar blea në vesh, ktheu kokën me rrëmbim. Në fytyrat e qytetarëve shikonte urrejtje. Nuk guxonte t'i shikonte drejt në sy. Hodhi disa çape më tej. Numëronte çapet e tij, bisedonte me vetëveten, dëgjonte krismat e luftës e shqetësohej.

Brigada partizane u ngrit përsëri në sulm. Dhe mitralozi prapë i qëllonte. Kësaj radhe vargu partizan u ndal.

Prefektit ju bë qejfi. Nderi dorën që njerëzit të shikonin në atë vend. Nuk ishte larg nga qyteti dhe shiheshin veprimet luftarake të dy palëve.

Çerçiz Fejzua rrëshqiste përpara e i afrohej mitralozit gjerman. Ushtari gjerman qëllonte drejt Çerçizit.

— U vra! — tha Bukuria.

— U vra! — tha dhe Refati.

— Kush u vra? Jo, s'ka plumb, që e mposht atë sorkadhe. O burra, në sulm! thirri Halil Imeri — dhe kalaja e shën Triadhës edhe qyteti e Mali i Gjërë ushtuan nga krismat e armëve partizane.

Buçiste boria e Naunit:

— Ta-ta-ti! Ta-ta-ti!

Përsëri qëlloi mitralozi. Në radhët partizane u derdhën breshëri plumbash. Vargu partizan bie në tokë. Përsëri të tjerë partizanë me plagë në trup.

— Gjarpëri — tha Çerçizi dhe i shkoi më afër, u hodh mbi të, u përlesh. Mitralozi gjerman heshti.

Partizanët serish u ngritën në sulm...

Disa partizanë thanë:

— Të kalohet në anën tjetër të lumit! Të godasim në qytet!

Të tjerët shprehën dyshim: — Nuk kalohet lumi në ditë si e sotmja.

Megjithatë disa nga ata që ishin në vijat e para të sulmit, të rrëmbyer nga dëshira për ta parë qytetin të çliruar, ju drejtuan urës së vjetër, por mbi urë, që nga kodrat e shtëpitë e para të qytetit vërshuan në një kohë qindra plumba. Dhe pati asish, si kompania e Halil Imerrit, që, nëpër plumba, u hodhën drejt urës. Në rrugë, te këmba e urës, lëvizi rrëmbimthi një maqinë e hekurt, që hapi zjarr me mitraloz.

— Autoblinda, autoblinda!

Sulmuesit ranë në tokë. Zunë pozicion dhe ju përgjegjën zjarrit me zjarr.

Ishte mesi i ditës. Lumi kishte dalë tejpertej dhe rridhte turbullt. Buronte i bardhë nga shkëmbi, në fund të malit, një lumë tjetër. Shirat, bora dhe stuhitë kishin dyndur fushën me ujë. Kudo ujë, baltë dhe krisma armësh. Nga njëra anë e bregut armiqtë, nga tjetra, partizanët. Kudo flakë pushkësh. Po të ishte ditë tjetër, jo dimër, sulmi partizan do të shkonte drejt qendrës së qytetit dhe do të luftohej shtëpi më shtëpi, rrugë më rrugë.

Kur erdhën në bregun e lumit, edhe Refat Arapit, që ishte betuar se do t'i dilte lumit tejdanë me not, i ikën fjalët. Ai zuri pozicion në anën e majtë të këmbës së urës dhe filloi të qëllonte e të këmbente ndonjë fjalë me Manolin. Refati nuk e kishte zakon të ankohej nga vuajtjet, ndaj u pendua që i tha Manolit: «Eh, biri im. Edhe hekur të isha, do të ndryshkesha. Po njeriu nuk është si hekuri që ndryshket, nuk është si guri, që çahet. Dëgjo mua hamallin, ti, është më i fortë se këto njeriu, për ideal, më i fortë!»

Ndërkohë nga shtabi i brigadës erdhi urdhëri:

«Të largohen forcat nga bregu i lumit!

Këtë urdhër në vijën e parë të luftës, te këmba e urës së lashtë e çoi Halili.

— Gjer këtu, nuk duhet të shkojmë më tej, — tha ai.

— Pse, shoku Halil, ç'do të na gjejë po të hedhim edhe pesë çape më tej?

— E kuptoj, por... — Halil Imeri, shtrëngoi fort nofullat. Shpirtërisht ai qe me të tjerët, donte që kompania e tij të hynte në qytet, por...

— Urdhër, xha Refat, duhet të tërhiqemi.

— Kush i jep këto urdhëra, shoku komandant, Halili?

— Shtabi i brigadës.

— Po shtabi i brigadës s'i kuptoi ndjenjat e partizanëve? Po zemra e partizanit ç'kërkon? Pyet për këtë shtabi ynë, apo jo?

Refat Arapi u ngrit si me përtim nga pozicioni dhe me përtesë lëvizën dhe partizanët e tjerë. Por i erdhi mirë dhe u gjallërua sapo mësoi që njëra nga skuadrat, që do të mbetej në shën Triadhë, ishte skuadra e tij. Prapë afër qytetit do të ishte.

7

Refat Arapi, tani që kishte zbritur nga mali në fushë, nga bora në tokën e zezë, që avullonte nën rrezet e diellit, ndjente ndryshimin e madh të klimës së maleve me atë të vendeve të ulëta. Ai u mbështet në murin e kësh-tjellës dhe po sodiste vendin përreth, pastaj nguli vësh-trimin më tej, te rrapi i Mashkullorës.

— He, dynja! Si kalojnë kaq shpejt vitet, si ujët. Ishit ju atëhere, moj Bukuri? — i foli partizanes, që qëndronte në krah të tij. Bukuria, pa ditur ku e kishte fjalën Refati, mblodhi supet. Refati e ngriti zërin.

— E moj, ishte atëhere në Mashkullorë?

— Kur?

— Atëhere kur u bë festa e luftës së Çeços te Rrapi i Mashkullorës?

— Po, xha Refat!

— Të kujtohet ç'fjalë mbajti atë ditë Muçua?

— Për Marenglenin e ke fjalën?

— Si e ulën kokën ata të hyqymetit. E humbën fare kur brohoriste rinia: «Poshtë fashizmi!» Ç'u bënë ashtu të bardhë si bakëri i kallaisur, dreqërit!

— ...

— Pa lëre më, kur Muçua nxori nga gjiri i tij flamurin e kuq. Të kujtohet?

Bukuria tundi kryet. Ajo i kishte qëndisur vetë fjalët në atë copë të kuqe e të shndritshme.

— Ata që erdhën nga hyqymeti, ja e bënë veshin, bigë — vazhdoi xha Refati. — Prisinin ku do ta nxirrte fjalë Muçua. I mbante zemra djalit. Bamb, ua plasi: «... Brezi ynë ka një përgjegjësi të rëndë, ka një barrë të madhe, ka shumë për të bërë: jemi skllëvër dhe duhet të bëhemi të lirë; duhet të këpusim zinxhirët e robërisë, që na i kanë hedhur armiqtë e jashtëm e të brendshëm.»

E, moj bijë, të kujtohet si i varën buzët njerëzit e hyqymetit? Sidomos prefekti Tahir Kolgjini e humbi fare pusullën. Pa le kur Muçua shpalosi flamurin e kuq dhe e ngriti lart që të lexoheshin mirë fjalët: «*Në malet e Shqipërisë valon gjaku i shqiptarëve*». Ishte fillimi atëhere e sapo kishin nisur punët e luftës.

E pe ç'bënë ata, si i shtrembëruan buzët! Ç'njerëz të pëgërë paskëshin qenë! Ata lajmëruan që të vinin autoblindat e karabinierët, por Muçua ngjiti Malin e Gjerë. Të kujtohet si na përshëndeti me grusht? Ç'na tha vallë? S'e mbaj mend më.

— ...

— E, po, vërtet, ashtu tha: «Ju pres në male» dhe nderoi me grusht.

— Dhe ne erdhëm, ja ku jemi, xha Refat.

— Ndërsa prefekti, sa u kthye në qytet, dërgoi në çdo postë xhandarmerie fotografinë e Muços dhe shpalljen që, kush e vriste atë, do të merrte qindra napolonë, ja vuri pas koshadhën, por Muçua s'mbeti vetëm, u bë me shumë shokë të tjerë dhe nisi luftën.

— Kurse prefekti u zhgarkua nga detyra.

— Ishte mirë atëhere nga shëndeti Muçua. Tani është ligur. E ke vënë re si kollitet? E mori atë të shkretë sëmundje atje, ja tek ajo... — Drejtoi sytë nga qyteti, nga kalaja e lashtë.

Andej lëviznin maqina me ushtarë, dukeshin bunkerë, prej ku përgjonin tyta mitralozash.

8

Ushtarët armiq erdhën në befasi dhe u hapën nga njëra anë e bregut të shën Triadhës në tjetrën. Luftëtarët e dy skuadrave partizane, që ishin atje, u desh të lëviznin për të zënë vend larg nga njëri-tjetrit. U ngrit nga pozicioni edhe Vocua, që bëri më majtas dhe zuri vend te një goricë, qëllloi me pushkë andej bregut nga vinin ushtarët armiq. Këta e panë partizanin e vogël, kur i dha krahun trugut të goricës dhe qëlluan me të gjitha armët në drejtim të tij. Plumbat i binin pranë posi ai breshëri kokërrmadh, që e rreh tokën me tërbim dhe këputnin nga trugu i goricës bujashkat.

Ushtarët fashistë dolën në varg dhe pastaj u shpërndanë. Dy prej tyre i shkuan Vocos drejt e në pozicion. Ishte e para herë që Vocua fillikat ndodhej i vetëm ballë për ballë me dy armiq. Ai u foli shokëve:

— Xha Refat, po vijnë kënde, po vijnë!

Zëri i doli ndryshe nga herët e tjera, ai s'kishte folur. I kishte ndodhur ashtu si ditën e parë kur ra në luftë dhe mbushte e zbraste pushkën pa e shkrepur. Kur një partizan e kishte parë si i binin fishekët një nga një në pozicion, e kishte qërtuar:

— Pse, ore, me sy mbyllur qëllon?

Kishte qenë balli i tretë që zbraste dhe asnjëherë nuk vuri re të mbetej ndonjë «thes në shesh» përpara tij, sikur plumbat e pushkës t'i shkriheshin në ajër, sapo linin tytën.

— Çudi! — tha me vete. — Mos më mbërtheu edhe sot frika si atëhere? Jo! — Shënoi dhe e tërhoqi me forcë

këmbëzën e shkrepjes. Nga tyta e pushkës së tij doli flakë.

Ushtarë dëgjuan këtë krismë dhe i zbrazën në një vend automatikët. Vocua ulte kryet e qëllonte. E pa se armiqtë po i vinin më afër. Mendoi një herë sikur të ndërronte pozicionin e të largohej më prapa, po si ta linte pozicionin, që i kishin besuar? Ç'do t'i thoshin shokët? Ndërroi mend, mori guxim dhe thirri, kësaj radhe me zë më të lartë:

— Po vijnë, xha Refat, po vijnë, Bukuri!

Zërin e dëgjoi edhe Refati dhe ju përgjegj:

— Bjeru, Voco! Guxim, biri im, guxim!

Dhe Vocua dëgjoi krismën e pushkës së tij dëgjoi edhe maliherin e xha Refatit dhe pa si ra në tokë njëri nga fashistët. Vocua shtiu me patickë.

— Shëno. Voco! Mos shtjerë në tym, shëno, biri im! Vocua shënoi, qëlloi. Ushtari gjerman u përpëlit në vend, si pula kur i pret kokën.

— E vrava. e vrava, xha Refat — klithi Vocua.

— Ruaju, i ra pranë plumbi dhe ndërroi vendin i biri i drejt, ja si drejton këndeje automatikun. Ruaju Voco!

Sikur të mos kishte ulur kokën, disa nga plumbat, që zunë në trugun e goricës, do kishin përshkuar trupin e vogëlushit. Kundër dy fashistëve, që ende qëndronin afër pozicioneve të partizanëve, goditën edhe armë të tjera. Armiqtë u larguan me vrap. Vocua tani syrin nuk e mbyllte dhe shënonte drejt në trup të fashistëve. Xha Refati i vajti afër. Armiku të tërhiqej. Vocua shtinte më dendur.

— Prit, o Voco, gradoje more djalë, shenjestrën e pushkës. e shikon që u larguan? — Refat Arapi u hodh më tej, zuri një vend më të mirë.

Pionieri kësaj radhe u skuq nga turpi.

— Po, ka të drejtë xha Refati që më kritikon, se unë ende nuk kam mësuar të luftoj si duhet. — Dhe sytë i shndritën si xham, ju lotuan...

KAPITULLI I KATERTE

I

*Shqipëria do të bëhet ashtu si e donin ata...
Shqipëri me diell, Shqipëri për fukaranë, që
ta gëzojë jetën nën dritën e yllit të kuq.*

1

Shtëpia e nënë Argjirosë qe në fund të fshatit. Ishte një shtëpi dykatëshe, me avlli guri dhe me një portë të madhe. Atje kalonte sokaku, që çonte midis fshatit, te rrapi ku bëheshin mbledhjet. Shtëpia qe mbuluar me plloça guri, oborri i shtruar me kalldrëm, dyert e dritareve të lyera me bojë. Në këtë shtëpi të Qestoratit, që ndodhej në krahun e djathtë të rrugs, bujtën xha Refati, Manoli, Bukuria dhe Vocua. Këtu banonte vetëm nënë Argjiroja, djali i së cilës kishte dalë partizan.

— U, korba! Jeni të lagur, keni të ftohtë?

Me këto fjalë i priti Argjiroja partizanët. Pastaj ndezi një goxha zjarr, që të kënaqte.

— Ngrohuni, teruni! Ju kalbi shiu e bora e këtij djallo dimri! — dhe u largua të përgatiste diçka për të ngrënë.

Pas pak u kthye dhe shtroi sofrën.

— Hani, bijt' e mi! Qenkeni lodhur shumë, ju marrtë të keqen hasmi!

— Jemi lodhur sa s'bëhet, moj motër — ju përgjegj Refati, që qëndronte këmbëkryq në krye të vatrës me pushkën të vënë shul mbi të dy gjunjët, me revolen gjash-tëshe me mulli e me zemberek të ngrehur, varur në bel.

— Nga të kemi, o shok? — e pyeti nënë Argjiroja.

— Nga Tepelena jam, po në Gjirokastër rroj.

— Ke njerëz në shtëpi? Me hallet e jetës si bëjnë?

— Ç'më pyet, moj motër? Njeri pa halle nuk ka në këtë botë. Po hallet e të varfërve s'kanë fund. Më sa qëndron në jetë fëmija pa i lidhur kërthizën, aq qëndron gëzimi në shtëpitë tona. Jeta jonë lëkundet në këtë botë, siç lëkundet një ashkël në ujët e detit. Atë e marrin dall-gët e halleve dhe e përpijnë. Një tufë me fëmijë rrita, moj motër. Ku i kemi? Dy m'i rrëmbyen ethet një fruthi, dy më të vegjëlit, shyqyr, mbetën gjallë. Kanë ikur edhe ata maleve me pushkë, kërkojnë jetën, duan t'i shpëtojnë varrit. Ai i vogli kaq është, sa ky malukati — tha e tregoi Vocon me dorë.

Nënë Argjiroja druhej të pyeste të tjerët. «Njëlloj, një hall kemi të gjithë. Erdhën dhe këta dushmanë nga ana e botës dhe tani vendin e rrëmbeu zjarri. Ç'është kështu!» Këto i tha me mend, nënë Argjiroja, pastaj u ngrit e vuri një sahan tjetër në sofër.

— Urdhëroni, hani, o vëllezër, me ç'na ndodhet.

— Mos u shqetëso, duar kemi, edhe uri kemi, do të hamë posi! — Dhe Refati nderi dorën gjithë asht e theu bukën e ngrohtë...

Kundrejt Refatit, nga ana tjetër, ishte një djalë i ri e i gjatë me mustaqe korb të zeza, me flokë e vetulla të zeza. E zonja e shtëpisë çuditej pse atë djalosh, që ende s'kishte mbushur njëzet vjetët, të gjithë e thërrisnin me një emër tjetër.

«Mirë këta, po ky pse e thërret me këtë emër? «Baba» i thotë ajo vajza e re, «baba» i thotë edhe ky burrë i thinjur. Ç'të jetë?» mendonte plaka. Donte të kishte tjetër emër ai djalë i ri, ndaj e pyeti:

Emrin tënd e ke, o bir, apo ta kanë ngjitur?

Partizanët ja dhanë gazit. Edhe Manoli qeshi. Plaka për një çast u hutua, pastaj tha:

— Edhe djalit tim i kanë ngjitur në çetë një emër tjetër. S'më vjen hiç mirë t'i ndërrojnë emrin. A ndërrohet emri për së gjalli? Kanë ardhur në shtëpinë time Çakalli, Breshëri, Piperi, Skifteri... Ehu, e di unë e varfëra si i kanë emrat! Pse kështu? Mbani, ore, emrat tuaj!...

Partizanët sërish vunë buzën në gaz. Edhe Manolit, të cilin e thërrisnin «Baba», s'ju mbajt gazi.

Në çdo shtëpi të popullit për partizanin kishte zjarr, kuvend dhe bukë e kripë në sofër. Kjo ishte nata e parë pas atyre dy javëve, që flinin në shtëpi, që ngroheshin në zjarr.

— E di si më duket?

— E, si të duket, o xha Refat?

— Sikur do të shkrihem nga zjarri.

— Kur e kemi rojen?

— Në mëngjez.

— Ej, Voco, ku e ke fletoren e shkrimit?

— Lëre sonte, Bukuri, është lagur.

— Pak duhet, gjithnjë nga pak.

Nënë Argjiroja vështronte se si djaloshi partizan kishte gdhendur në një dërrasë druri disa shkronja.

— Lexo! — urdhëroi Bukuria.

Vocua filloi. Nënë Argjiroja buzëqeshi.

— I mëson shkrim. E kemi mësuese të skuadrës. Edhe mua ajo më mësoi. S'dija të vija firmën, ndërsa tani unë shkruaj letër e i lexoj vetë ato të atyre malumëve, që kam në brigada të tjera. S'ka si shkolla, moj motër!.. Po ti a di shkrim?

— Jo.

— Kështu na lanë të pasurit e bejlerët, të verbër na lanë që ta kishin më lehtë të na rripnin. Po tani po ndërrojnë kohët. Eh, moj motra Argjiro, të dëgjosh komisarin e brigadës sonë, Muçon, si flet për ditët që do të gëzojmë!

— Ashtu është, o vëlla, lum kush të rrojë që ta gëzojë lirinë.

— Dhe ti, moj Argjiro, do të mësosh të shkruash.

E zonja e shtëpisë shprehu mosbesim.

— Ashtu thosha edhe unë, por komisari ynë i çetës atëhere m'u vu prapa, ku të linte Muçua? Ma priti një ditë i inatosur: «Dëgjo, Refat Arapi» më tha. Me kohë dhe me durim gjethi i manit kthehet në mëndafsh e jo më njeriu të mos mësojë shkronjat». Unë s'pata nga t'ja mbaja, vërtet që m'u duk më i rëndë lapsi nga pushka, por u shtrova në brazdë dhe gjene mirë, mësova!

Refati filloi të kollitej fort nga duhani që thithte.

— Preje duhanin, xha Refat!

Si u qetësua, ai u mbështet te buxhaku e sytë ja mbrëtheu Vocos, të cilit i avullonin rrobat. Sa herë e shihte mirë, gëzohej, e donte sa edhe djalin e tij të vogël e përgjerohej për të.

— Zbërthehu, bir! Hiqe kollanin e fishekëve; ma jep mua pallton të ta ter, se s'dihet ku shkojmë nesër.

— ...

— Hiqi këpucët, bir!

— Jo, moj motër, është partizan.

— Por...

— E sikur të ndodhë gjë? Ka lezet për partizanin të lërë këpucët në vend? — Vocua u mbështet dhe, pasi vuri kokën në jatak, e zuri gjumi. Nënë Argjiroja e mbuloi me një levenxë të re leshi.

— Mund të flemë, Xha Refat — tha Manoli.

— Po.

Nëna qëndronte, zgjuar. Zjarri bubulak ngrohtë dhomën e ndriçonte fytyrat e partizanëve; ndriçonte edhe fytyrën e Manolit. Ai kishte mbështetur kokën në jastek e linte, ndërsa nëna e vështronte.

«Sa djalë i mirë!» mendonte nëna. «Po pse ja kanë vënë atë emër? Pse e thërrasin «baba»? Diçka do të ketë, ndonjë histori. Thonë se këta emrat e partizanëve kanë një kuptim. Edhe Vangjelit tim i kanë vënë gjithatë emër (mendohet cazë) «rrufe», i thoshte komisar i çetës. «Rrufe» e thërresin të gjithë. Këtë emër ja kishin ngjitur në çetë. Pse e thërresnin me këtë emër, as sot e kësaj dite

unë s'e di. Po i thuhet njeriut «rrufe», i thuhet djalit «baba»?... «Flaka bubulake ndriçonte fytyrat e partizanëve, ndriçonte edhe fytyrën e re të Manolit.

2

Atë natë veç nënës Argjiro dhe dikush nga mysafirët qëndronte zgjuar. Ishte Bukuria. Megjithëse që munduar të largonte mendjen disa herë, gjatë këtyre ditëve përfytyrimet e saj genë ndaluar përsëri po në atë ngjarje. I dukej sikur e jetonte sërish ngjarjen e asaj dite kur në një bazë sekrete, në qytetin e saj të lindjes, takoi një partizan që kishte hyrë ilegal në qytet dhe solli në Qarkorin e Partisë një letër nga Marengleni. Partizani e kishte nderuar me grusht dhe e kishte përshëndetur me zë: «Vdekje e fashizmit!» Bukuria i pati buzëqeshur, pastaj ata të dy qëndruan përballë njëri-tjetrit. Kishte një vëshrim të çuditshëm ai partizan. Veshja me ato armë të rënda ja hijeshonte më tepër trupin, ja zbukuronte tiparet e fytyrës, ja freskonte pamjen burrërore. Të dy qëndruan disa minuta me vështrim të mbërthyer të njëri-tjetri. Partizani mbante një pseudonim dhe vetëm më vonë Bukuria mësoi që emri i vërtetë i tij ishte Dardan.

Takimi i parë dhe njohja me Dardanin i kishin mbetur në kujtesë si një gjë e bukur. Gjurmët e turbullimit i mbetën vazhde.

Gjithashtu më vonë i kujtohej çasti kur ai i dha një çantë ushtarake të mbushur me komunikata e gazeta «Zëri i Popullit», i kujtohej se si që munduar ta ndihmonte vajzën për ta vendosur çantën në sup, duke rregulluar rripat që i rrinin ngushtë. Dhe aty në atë shtëpi të fshatit Qestorat, ku batalioni partizan i saj u strehua të kalonte atë natë dimri, Bukuria ëndërron. Nëna Argjiro çohet dhe hedh një krah dru në vatër. Zjarri bubulak ndriçon dhomën, ngroh partizanët. Bukuria ndjen vapë, i vjen ta heqë kapotën ushtarake, por përton; gjithnjë qëndron me të njëjtat përfytyrime. Refati nisi të gërhinte.

Kjo nuk ja ndërpreu mendimet Bukurisë. «Ja se si po e porosiste partizani që të ruante postën sekrete, postën e partisë. Dhe ajo e dëgjonte me vëmendje, i buzëqeshte. Pastaj ajo i kishte dhënë të mbështjella në një letër një palë çorape leshi. «Këto janë për ty». Partizani e kishte falënderuar. «Asgjë» i qe përgjegjur — Bukuria. Ajo parafytyronte të gjitha ngjarjet e mëpasme: vuajtjen që hoqën rrugës, qafën e malit, aeroplanin gjerman që i miralonte, pyetjen e Marenglenit për Dardanin dhe shpellën ku mbeti ai, shpellën e heshtur dhe të gurtë. E kishte gëzuar vetëm lajmi që i kishte thënë një ditë më parë doktor Medini se Dardani ishte jashtë çdo rreziku, se plagët kishin filluar t'i përmirësoheshin. «Duhet t'i shkruajmë një letër, mendon; sapo të çohet xha Refati do t'i them, duhet patjetër t'i shkruajmë». Pastaj: «apo mos bëj gabim...?» Edhe kësaj radhe i ndrydhi ndjenjat, se Refat Arapi shkas donte do të shpërthente me fjalë nga më të rëndomtë: «gili-gili s'lejoj unë në skuadrën time. Përsë keni dalë maleve, të luftojmë okupatorin apo...» Këtë përgjegje priste nga Refat Arapi dhe Bukuria edhe kësaj radhe nuk guxoi të propozonte për t'i shkruar letër Dardanit.

3

Natën, kur shtëpitë e fshatit qenë ngarkuar me borën e re, një njeri zbriti shkallët e gurta të shtëpisë së nënë Argjiros. Ishte muzg, por silueta e njeriut me pushkë dallohej ngaqë vendi qe zbardhur nga bora. Ecte dhe linte gjurmët nëpër rrugicat ku shtëpitë dukeshin si të ngjitura me njëra-tjetrën. Në këto shtëpi pushonte kompania e Halil Imerit. Një kompani tjetër i kishte asaj nate rojet, por Halili i dinte të papriturat, që ndodhin në luftë, ndaj në fund të asaj rrugice kishte dhënë urdhër të shtohet dhe një roje. Njeriu, që doji nga shtëpia e nënës Argjirosë, u drejtua për në vendin e rojes. I biri i Gole Përmetarit u vu në përgjim. Në kohën që

Manoli mori shërbimin e rojes, retë u ulën nga mali i Lunxherisë dhe zunë në fillim kodrat rreth fshatit, mandej mbuluan gjithshka. Kudo errësirë. Manoli mundohet të vëzhgonte. Manoli vështronte malet e larta mbi fshat, që ndrisnin nga bardhësia. Por më shumë ai vëzhgonte nga qyteti, sepse hera-herës armiqtë shtinin me mitraloz e lëshonin në qiell fushqeta të kuqe. Edhe në kalanë e shën Triadhës vendin ku kishte qëndruar gjatë asaj dite Halil Imeri me dy skuadra partizane e kishin zënë gjermanët. Një herë retë u larguan dhe Manoli dalloi vargmalet e bardha dhe luginën.

— Tremben, edhe atje ku janë, kanë frikë — thoshte Manoli dhe me pushkën gati endej në rrugë. Përgjonte. Ai pa se në rrugën që vjen nga Janina, po lëvrinin me zhurmë maqina. Armikut po i vinin në ndihmë forca të reja.

Sado që rojet partizane qëndronin në përgjim, errëra e natës e fshehu lëvizjen e kolonës së nënkolonelit Kurt, prej tetëqind vetash që në dy drejtime ju afrua fshatit Qestorat. Nënkoloneli gjerman çdo gjë e kishte shënuar në hartë. E kishte mbyllur fshatin me një rreth të kuq, pastaj si heshta futeshin në atë rreth të kuq shigjetat blu. Dhe shigjetat ishin të shpeshta. Mandej që vendosur mbi batalionin partizan shenja naziste, që ngjante si një kryq i madh i vendosur në një varrezë të përbashkët. Ky «varr» do të që një ndëshkim shembullor që forcat e gjeneralit Gajb do t'i jepnin brigadës partizane.

Po harta ra në duart e partizanëve, që mësuan edhe emrin e nënkolonelit Kurt, i cili shrejtonte këtë sulm. Kjo ndodhi të nesërmen e asaj nate, kur partizanët pushonin, ndërsa nënkoloneli Kurt me ushtarët e tij, po afrohej si një bishë e egër. Shumë gjëra priste të kryeshin ato ditë brigjeve të Vjosës gjenerali Gajb. Atë që nuk mundi ta bënte në Përmet, ai mendonte ta bënte kësaj nate. Nënkoloneli Kurt ishte mjeshtër i luftës partizane. Reparti i tij ishte një repart special, që kishte plotësuar detyra të veçanta. Kur binin në luftë, s'mba-

heshin më ushtarët e nënkolonelit Kurt, çanin me bajonetë, turreshin me automatik, godisnin me thikë.

Sado që rojet partizane, ndër to edhe Manoli, mudo-heshin të vëzhgonin lëvizjet e armikut, ata nuk shikuan asgjë.

Ushtarët e nazistit Kurt ecnin me kujdes. Nuk dëgjohej asnjë zhurmë. S'kishte asnjë dritë.

Komandanti i kolonës gjermane, nënkoloneli Kurt, dinte sa partizanë ishin në atë fshat. Lajmin e kishte çuar në qytet një spiun, që rrinte tani bashkë me nënkolonelin Kurt. Nënkolonelit Kurt i dukej sikur e kishte në dorë batalionin partizan, sikur asnjë prej partizanëve, që pushonin, s'do të dilte nga rrethimi, ndaj në kolonë kërkonte disiplinë, heshtje... Ushtarët i zbatonin urdhërat e tij me rreptësi.

4

Në kohën kur nata po shkëmbehej me ditën, ushtarët zbulues të **veshur me rroba të bardha**, rrëshqisnin në borë.

Roja partizane vështronte rrugën në kodrën e vogël, e bënte veshin bigë, përgjonte. Asnjë zhurmë... Ushtarët e nënkolonelit Kurt, krejt me të bardha, ishin afruar në disa drejtime dhe në vendet e ngritura kishin vënë mitraloza në përgjim. Një skuadër me ushtarë, që mbanin në duar automatikë e në dhëmbë thika, ju afruan shumë afër rojes partizane.

Ishte butësirë. Çdo gjë ishte stepur nga bora. Në fshat batalioni flinte, kurse roja partizane rrinte në përgjim. Vocos i doli gjumi, u ngrit e u afrua te zjarri dhe filloi të vajiste armën.

— Të doli gjumi, bir i nënës? — i foli nënë Argjiroja. — Pse nuk e hoqe atë rrip me fishekë? Si nuk u lirove ca, more bir? Në shtëpi jeni, s'jeni në mal — Vocua buzëqeshi dhe vazhdonte të pastronte armën.

Atje ku bënte roje Manoli, kishin ardhur zbuluesit armiq dhe i qenë afruar që ta kapnin të gjallë. Po pse, binte i gjallë në duart e armikut Manoli? U dëgjua një

krismë e nbytur. Po krismat e armëve në dëborë herë dëgjohen, herë s'dëgjohen, ndaj Manoli në hyrje të fshatit hodhi dy bomba.

— Alarm!

— Përpara! — urdhëroi nënkoloneli Kurt dhe ushtarët zunë edhe disa lartësi të tjera afër fshatit.

Partizanët rrëmbyen armët e dolën në borë. Edhe Vocua rrëmbeu armën dhe u largua nga shtëpia. Para se të ikte, ai u përshëndet me nënën.

— Mirë u pafshim, o nëna jonë!

— Mbarë ju vafhtë dyfeku, o bijtë e mi!... Dhe nëna Argjiro mbylli kanatat dhe i vuri llozin derës.

* * *

— Gjermanët! Ja ku janë! — thërret befas një partizan.

— Po... Ua shoh kaskat e hekurta. Kanë zënë pozicione. Është një radhë e gjatë, një vijë me helmeta. Nodohen afër! Qentë!

— Na kanë rrethuar!... Për besë na kanë rrethuar!

— Ç'na vështrojnë ashtu, pse nuk qëllojnë?

— Duan të dorëzohemi.

— Kush. Ne të dorëzohemi!

Nëpër rugicat e fshehta vraponin partizanë e partizane, që shkonin në qendër të fshatit, ajte ku nuk mund të depërtonin shenjestrat e ushtarëve me uniformë bojë hiri.

Ushtarët e nënkolonelit Kurt zunë çdo gur e shteg rreth fshatit, por ata nuk guxonin të sulmonin gjersa të mos shpërndahej errësira e natës, megjithëse ishin gati, me gishtin në zemberek. Dukej sikur vdekja i kishte shtrirë krahët e saj mbi batalionin partizan, që mudohej të grumbullohej.

Duhej gjakftohtësi e madhe, zotësi për t'ju përshtatur situatës dhe aftësi për të marrë një vendim të drejtë. Këto nuk i mungonin komandantit të batalionit partizan, Sadikut.

Kishin mbetur yjet e fundit të mëngjezit, më të bukurit. Nënkoloneli Kurt lëshoi mbi fshat shenjat vezulluese të sulmit. Yjtë humbën një çast nën ato drita që mbetën si fishezkare mbi kokat e partizanëve. U dëgjua një zë i huaj në atë vend. Pastaj armët e ushtarëve kositën e dhanë dridhje edhe në zemrat e më guximtarëve. Edhe komandanti i batalionit partizan, Sadiku, u hutua në sekondat e para, aq e fortë ishte goditja. Kjo zgjati vetëm një çast.

— Sulm, mbi ta — thirri Sadik Buzua dhe u hodh si një sorkadhe drejt bregut, arriti te lisi. Rrinte në këmbë afër pemës dhe u fliste shokëve, u përcaktonte detyra, u jepte me zë kurajë dhe qëllonte me maliher. Një breshëri mitralozi i lëshoi komandantit një degë mbi sup. Gjithë inat Sadiku goditi degën e lisit dhe shtati e flokët ju bënë të bardha. Plumbat e mitralozave këputën edhe degë të tjera, por s'mundën ta prisnin forcën e komandantit të batalionit, që u hodh përpara duke u thirrur të tjerëve: — Të zëmë shkëmbin! Foli dhe iku në ball të sulmit. Përleshja filloi të bëhej e tillë që, doje s'doje, do të futeshe në valle.

Sapo u ngjiti te qafa, andej nga shikohej fshati ku ishte vendosur batalioni tjetër, Sadiku zbrazti disa herë me radhë pushkën dhe xixa e plumbit kaloi mbi fshatin Saraqinishtë dhe u shua kur arriti në hyrjen e grykës së Selckës. Ata pesë plumba si kometa xixëlluese ishin pesë shenja alarmi, pesë thirrje që i bënë shoku shokut kur e shikon veten në rrezik dhe në batalionin tjetër në Saraqinishtë u dha alarmi.

Sadik Buzua nuk arriti të shikonte si vraponin andej partizanët e atij batalioni, por e mori me mend që ata i panë ata plumba me zjarr që do të thoshin pesë herë me radhë:

Ndihmë!

Këtë thirrje e nxjerr nga goja çdo njeri vetëm në çastet më kritike të jetës dhe një çast si ky Sadikut nuk i kishte ndodhur herë tjetër në jetë. Urdhëroi të vazhonte sulmi; qëndronte në këmbë, nuk u trëmbej plu-

mbave. Ende pa arritur te lisi i madh mbi kodër nga plumbat dhe vazhdonte të qëndronte në këmbë. I bëhej se, po të gjunjëzohej ai, do të gjunjëzohej edhe batalioni. Po zërat dhe krismat e shokëve ja ngrohën gjoksin me besimin që edhe në këtë përlëshje batalioni do të dilte fitimtar. Atëhere, si çdo trup që goditet njëherësh nga shumë plumba, edhe ai ra te lisi në kodër, ra për të lëshuar në këtë vend rrënjë të përjetshme.

Rënkonte vendi nga gjëmimi i topave të rëndë, nga krismat e armëve të ushtarëve të nënkolonelit Kurt. U çelnë gropa, që ngjanin si varre... Sytë e nënkolonelit Kurt shkëlqenin nga besimi për fitoren.

— Tani i kam në dorë. Ja, këtu në grusht i kam. — Njofto me radio komandën eprore — i tha ndërlihdësit nënkoloneli Kurt. Fonogrami që njoftonte për suksesin kaloi nga njëri shtab në tjetrin, gjersa e mori njoftimin edhe gjenerali Gajb.

Mbi kokat e partizanëve u vërtit në qiell një aeroplan armik, ndërsa në tokë prapë zëra. Përsëri thirrje për t'u dorëzuar.

5

Partizanët e rrethuar luftonin. Luftimi bëhej afër, një luftim për jetë a vdekje.

— S'kanë ku të shkojnë, në dorë i kam, në grusht i kam! — gëzohej nënkoloneli Kurt.

Ai e shtrëngoi edhe më shumë rrethimin. Në hartën e tij u shënua me ngjyra edhe më të theksuara kryqi i thyer. Megjithëse batalioni partizan qëndronte, ai mendonte se kjo ishte një përpëlitje pa shpresë. Prandaj urdhëroi të shtoheshin forcat rrethuese.

Mbi një shkëmb u ngjit një partizan. Si doli gjer atje, as që e dinte njeri, por, si thoshin vendësit, ai që ngjitur atje ku s'qe parë ndonjëherë të shkelte këmba e njeriut. Që andej ai zbrazi mitralozin.

— Mitralozi i Manolit! — thanë të rrethuarit. S'lin-

te vend pa godiur ai mitraloz. Kishte fushëqitje në çdo drejtim.

Nënkoloneli Kurt, si oficer me eksperiencë në luftë, e kuptoi rezikshmërinë e atij mitralozi dhe dha urdhër të goditej vendi ku qe vendosur.

Dy gjëra i tërhoqën më shumë vëmendjen nazistit Kurt: mitralozi, që ishte ngjitur në atë shkëmb dhe batalioni partizan, që vinte nga Saraqinishta në formacion luftimi për të ndihmuar të rrethuarit. Disa herë kërkoi të goditeshin ato forca me top, por as topi s'qe në gjendje t'i ndalte, pa le që t'i kthente prapa.

— Zjarr! Zjarr! — çirrej nënkoloneli Kurt.

Të rrethuarit sulmonin. Ata kërkonin të dilnin nga rrethimi. Shokët e tjerë nga Saraqinishta po afroreshin për ndihmë.

Nënkoloneli Kurt mblodhi forca të reja në atë drejtim dhe ndërtoi një barrikadë me grykë pushkësh.

Me siguri përlëshja në kodrën Kike¹⁾ do të bëhej edhe më e ashpër!

6

Rrethim!

Vetëm ai që ka provuar ç'është rrethimi dhe si luftohet në rrethim, mund të flasë për të.

Sa gjendje e nderë krijohet në çaste rrethimi!

Në kohën kur luftimet bëheshin më të ashpra arritën me shpejtësi në ndihmë të forcave të rrethuara partizanë, të cilët u hodhën menjëherë në sulm. I goditën në shpinë gjermanët. Të rrethuarit dëgjuan zërin e borisë së Naunit e thirrjet e shokëve. Dallonin edhe krismën e mitralozit «sharës» të Çerçiz Fejzos. E dëgjuan që larg, e pastaj më afër.

— Çerçizi, Çerçizi! — thërrisnin e gëzoheshin të rrethuarit.

1) Një nga vendet ku u zhvilluan luftime të ashpra me gjermanët më 8 shkurt 1944.

Çerçizi hodhi midis armiqve dy bomba, pastaj zuri vend dhe qëlloi me mitraloz. Disa gjermanë mbetën të shtrirë përgjithnjë.

— Të lumtë, Çerçiz, të lumtë, o shok!

Dhe binin në kodrën Kikel) breshër plumbash e bombash mbi kokat e gjermanëve.

Njëra nga partizanet e rrethuara rrëmbehet e do të ngrihet.

— Ku shkon, Bukuri?

— Në sulm!

— Prit se gjermani të godet me plumba e jo me bis-kota — e ndaloi atë shoku, që kishte në krah.

Përsëri u dëgjua zëri i Çerçiz Fejzos, po tani edhe më afër. Disa çape më poshtë nga ai, një partizan kishte një copë herë që mundohej ta godiste me thikë ushtarin gjerman, me të cilin po përleshej.

Çerçiz Fejzua, sa erdhi atje, thirri:

— Mbahu, mbahu, shok.

Mirëpo ushtari gjerman e vuri poshtë partizanin. — Ah, shok, vëlla! — thërret. Ngrihet Çerçizi nga vendi e i shkon në ndihmë. Në këtë cast atij ju duk sikur e goditën me një gur të rëndë. Ju morën mendtë dhe sytë ju errën. Për një çast pa si në mjegull helmata gjermane dhe kryqe, pushkë e mitraloza, tym predhash dhe siluetën e maleve. I erdhën ndër mend për një cast njerëzit e shtëpisë, që kishin rënë një e nga një në ballin e luftës. Çerçizit i qante e i therte zemra sa herë mendonte për ta. Rreth tij ju duk sikur u gjendën partizanë e partizane. Ishin të gjithë. Dhe Çerçizi ngriti kokën lart e tha: «Kam, shumë kam. Një brigadë partizane kam. . . një Shqipëri të tërë kam. Shqipëri të lirë deshën njerëzit e mi? Ajo do të bëhet ashtu si e donin ata: Shqipëri me diell, Shqipëri për fukaranë, që të gëzojnë jetën në dritën e yllit të kuq.»

Këto përfytyrime i kaluan para syve me shpejtësinë e vetëtimës. Pastaj ai u platit e ra si një lis i prerë dhe një mjegull e dendur i verboi pamjen.

Mitralozi i Çerçizit nuk u dëgjua më. Secili që ndiq-

te me vëmendje krismën e atij mitralozi, zërin e atij luftëtari, filloi të tronditej. Çerçiz Fejzua e ndjente kujdesin e të tjerëve, dhe në batalion, brigadë, me shokët dhe shoqet, që ishin për të gjëja më e shtrenjtë, i dukej vetja si në shtëpinë e tij. Por shokët e rrethuar ishin në rrezik të madh. Ç'duhej të bënte? U hodh midis armiqve, i goditi me plumba e bomba. Për të shpëtuar shokët e rrethuar, nuk kishte armik që ta ndalte, nuk kishte plumb, që ta rrëzonte. Ndaj sulej si fajkua mbi armiqtë. Por edhe ajo goditje, ngaqë i shkau këmba, ishte e rëndë. Në fillim qëndroi, mandej ra, ndejti disa minuta i shtrirë, pastaj përsëri ju kthjellua mendja, u ngrit dhe prapë deshte të hidhej në sulm. . .

7

Nënkoloneli Kurt ishte duke qëndruar në një lartësi, nga e cila vështronte fshatin dhe rrugën që vinte nga Saraqinishta, po sillte ndër mend përleshjen e asaj dite, kur nuk mund të zinte asnjë partizan, bile asnjë pushkë: u rrëqeth. Shumë ushtarë i qenë vrarë dhe tani sulmi i partizanëve i vinte forcat e tij në rrezik. Nga çasti në çast mund të rrethohej, mund të vritej edhe vetë. U ngrit edhe nga ai vend, ecte dhe mendohej, pastaj si doli te disa gurë të zez, te kodra me dëllinja, u ndal. Këndej e shikonte më mirë vendin ku ishin rrethuar partizanët. Aty binin breshëri predhash dhe vendi ku ndodheshin partizanët e rrethuar përcaktohej edhe nga gjurmët e shpërthimeve të predhave, të cilat kishin zhubrosur e nxirë kudo dëborën. Ai vështroi partizanët me dylbi në ato vende ku qëllonin radhazi topat dhe mortajat. Ata njerëz dukeshin si të mbërthyer në vend. Dalloi edhe kufomat e shtrira pa jetë. Sapo heshtën topat, pushuan edhe armët në vijën e parë. Si dukej të dy palëve u duhej kohë të shikonin vendin, të merrnin vetën që pas-taj të përplaseshin më me forcë. Kurti i kuptonte të gjitha këto, por ai nuk do të kishte vepruar me aq rrëmbim, në qoftë se nuk do të kërcënoheshin forcat e tij që të

goditeshin rëndë nga krahët. Kjo e detyroi që njërin nga batalionet që komandonte, ta urdhëronte me telefon që të sulmonte përsëri forcat e rrethuara. Sulmi u bë pas disa minutave. Ishte një sulm dhe një mbrojtje e dëshpëruar. Të dy palët ju afruan njëra-tjetrës aq sa këmbyen bombat dhe në disa raste u përleshën fytyfytas. Në sulm ushtarët e nënkolonelit Kurt u treguan të shkathët, të vendosur për të shpartalluar batalionin partizan, që kishte mbetur i rrethuar midis dy lartësive në gropën ku i godiste plumbi nga çdo anë. Po batalioni partizan edhe kësaj radhe nuk u dha; kjo kuptohej nga krismat, që si në fillim vazhdonin të paprera dhe se pozicionet partizane mbetën aty ku ishin, vetëm të vrarët qenë shtuar. Kësaj radhe dëmet kishin qenë më shumë për gjermanët. Kjo e detyroi nënkolonelin që të jepte urdhërin: «Topat dhe mortajat të qëllojnë përsëri mbi partizanët e rrethuar».

Dukej sikur s'do të kishte mbetur frymë e gjallë atje, por në dylbinë e tij shiheshin përsëri njerëz, që lëviznin, zinin pozicion, merrnin shenjë dhe shtinin. Dheu i ngjeshur nga predhat nxirrte avull nga rrezet e diellit, që sapo ranë në tokë. Atje, nënkoloneli Kurt dëshironte të kishte vetëm vdekje, por dylbitë i afronin ato qenje të gjalla e të çuditshme, që luftonin për të mbrojtur jetën.

— Zjarr, zjarr! — thirri.

Dhe përsëri e rëmihën vendin kryq e tërthor copat e predhave; rrethi u zgjerua më tepër dhe u bë edhe më i zi. U goditën forcat e tij nga krahët, sulmuan të rrethuarit dhe zunë disa kodra të tjera zotëruese. Dalloi nënkoloneli Kurt mes krismash zërin e një partizani, që thirri e u ngrit në sulm. Ecte në ballë, sulmonte dhe punonte dyfekun, ishte komandanti i kompanisë, Halil Imeri, që u jepte zemër shokëve të hidheshin në sulm. Nënkoloneli Kurt u zgërdhesh kur pa Halilin, që e goditën plumbat dhe ra; po vrulli i sulmit partizan nuk u ndal. Në këtë bregore pesë minuta larg nga fshati u tha fjala e fundit për këtë luftim. Aty, te lisi madh, qe shtri-

rë me fytyrë në borë kapiteni gjerman që komandonte një kompani ushtarësh, përballë, në anën tjetër të lisit kishte mbetur komandanti i batalionit partizan. Rridhte në borë gjaku i trupave të ushtarëve, disa metra më tej kullonte gjak nga trupa partizanësh. Kodra u mbulua me kufoma, siç qe mbuluar me shkurre kodra tjetër fqinje.

Përleshja zgjati edhe disa orë. Asnjëra nga palët nuk hiqte dorë nga kodra Kike. Shihet një partizan dhe një uniformë e murme shtrirë në dëborë që po hahen me duar. Në krah të tij ishte Manja. E kishin marrë disa plumba dhe në buzë i kishte mbetur gazi, ndërsa flokët era ja kishte hedhur në ballë. Rexhepi dhe Hamzai i mbështetën pushkët mbi dy kufoma ushtarësh dhe qëllonin. Bektashi, që çau në ballë të shokëve me bomba, sapo u godit dhe pushka i mbeti e mbushur, me fishekun në gojëz.

Te qafa e vogël degët e goricës dridheshin nga një fishkëllimë rrëqethëse. Ç'të ishte ajo? Mos ishte fishkëllima e erës në hone e gryka? Jo, aty kryqëzoheshin nga dy anët e kodrave plumbat e ushtarëve të nënkolonelit Kurt.

Sejdiu u godit dhe shokët i folën:

— Ulu, Sejdi, dëgjon si fishkëllon plumbi, ulu! — Sejdi Minga dëgjonte edhe zërin e shokut edhe fishkëllimën e plumbave, por nuk ulej. Dikur në një mbledhje ai kishte thënë: «po ju trembëm plumbit, e humbëm luftën!» Të humbiste lufta? Bah, kjo do të ishte më shumë se të humbiste varri i gjithë shokëve e shoqeve që ranë në luftë. «Po, më shumë» — tha atë kohë Sejdiu dhe nuk u ul, nuk ju tremb fishkëllimave të plumbave.

Plumbat binin e vrisnin, por sulmuesit sa më shumë pakësoheshin, aq më me vrull sulmonin.

Ndërkohë Çerçiz Fejzua, që kishte filluar të përmëndej, u çua dhe me mitraloz filloi të godiste nga e majta ushtarët e nënkolonelit Kurt. Një tjetër mitralier qëllon-

te nga e djathta, ishte Manoli. Mitralierët e njihnin njëri-tjetrin në breshërinë e zjarrit. Dinin të fjalosheshin në përmjet krismave. Kuptonin ç'duhej të bënte njëri e ç'duhej të bënte tjetri. Dinin kur të harxhonin fishekë dhe kur jo.

— Mbi ta, vëllezër, mbi ta! — thërriste Bukuria dhe u jepte zemër e guxim luftëtarëve të kompanisë. U përhap lajmi i vrasjes së komandantit të batalionit dhe i bëntë partizanëve dhe komandantit të kompanisë tyre, Halilit. Ç'gjëmë! Me këtë tronditje në zemër Çerçizi vra-poi drejt armikut, e uli armën në tokë dhe e zbrazi dy herë radhazi.

«Duhet të ecim përpara, të ndërrojmë pozicion» këto i thoshte Manolit me ato krisma Çerçizi.

Gjermanët filluan të tërhiqeshin. Do të kishin dalë nga rrethimi nazistët, po të ishin më të ngadalshëm dhe po ta kishin ruajtur veten e tyre nga copat e predhave dhe mortajave, ata dy mitralierët partizanë. Po ata as u trembën dhe as u goditën. Nuk thuhet kot fjala se, ai që fshihet nga frika e plumbit, vdes më parë se trimi që sulmon me guxim. Mitralierët zbritën poshtë fshatit, zunë vend përballë njëri-tjetrit dhe u përgatitën që të ishin gati për të bërë kryqëzimin e zjarrit të armëve. Atë që bëjnë dy njerëz kur ndihmojnë njëri-tjetrin, nuk mund ta bëjnë dymbëdhjetë kur duan t'ja lënë të keqen shoqi-shoqit. Çerçizi dhe Manoli nuk ishin të tillë, ndaj graduan shenjestrën, morën shenjë dhe hapën zjarr.

Nënkoloneli Kurt mbeti i gozhduar në vend. Asnjë nga njerëzit e tij nuk guxonte të çante nëpër atë grykë. Përsëri u dha urdhëri dhe përsëri shpërthyen predha në të dy pozicionet e mitralierëve.

Ushtarët e nënkolonelit Kurt vinin grykës në varg.

Shumë nga ata qenë të detyruar t'i mbanin për kra-
hësh shokët e tyre, disa i hiqnin në shpinë për të mos i
lënë në duar të partizanëve. Për të vdekurit dhe armët,
që mbeteshin në fushën e luftimit, nuk interesohej
njeri. Formacioni luftarak i batalionit, që filloi të tër-
hiqej, qe shturur, gjithshka qe përzier dhe në pështje-
llim të plotë, ushtarët, sikur t'i tërhiqte një forcë e çu-
ditshme vraponin drejt qytetit. Ç'të qe vallë kjo forcë?

— Frika... Frika — mendonte i dëshpëruar nën-
koloneli Kurt. Apo nuk ishte frika ajo që i hodhi bata-
lionet e tij në amulli. Ndoshta!

I pëlqente që nga ushtarët e tij të plagosur nuk dë-
gjonte rënkime. A nuk ishte kjo një shenjë që tregonte
moralin e lartë të ushtarit gjerman? I neveriteshin nën-
kolonelit Kurt ushtarët, që, sapo plumbi i thyen diku
kockën, nisin të kuisnin si zagari kur e godet me shkop.
Kjo e mallëngjeu nënkolonelin Kurt dhe ja ndezi më
teper urrejtjen ndaj partizanëve.

— T'i vihet zjarri fshatit! — urdhëroi i zemëruar.
Pas pak nga shtëpitë e fshatit u ngrit deri në qiell tymi
e flaka.

Nënë Argjiroja në fillim mbeti e hutuar. Shtëpia
e saj pa njerëz i qe dukur e frikshme. Doli në dritare e
u mundua të shikonte partizanët.

Mbi fshat dëgjoheshin krisma armësh dhe zëra.

— Luftojnë, trimat e nënës, luftojnë!

Rrugës kryesore të fshatit kalonin dy ushtarë. Ishin
të preparojës, po ata që nënë Argjiroja i pa kur i vunë
zjarrin shtëpisë së fqinjës. Kur ushtarët erdhën te porta
e saj, ajo ngeli shtang nga habia. «Oh, ç'pikëllim! Duan
t'i vënë zjarrin edhe shtëpisë sime» mendoi ajo. Ishin të
dy në një trup, të dy me sy të zgurdulluar. Si ujçër i du-
keshin nënë Argjirosë. «S'kanë zemër, por gur kanë në
gjoks këta njerëz» tha nënë Argjiroja dhe nxori një
pushkë të fshehur në synduk. U bë gati të qëllonte.

— S'i lë të më djegin shtëpinë, do t'u bie — tha dhe
ja drejtoi tytën e patickës ushtarit, që i binte portës me
qytën e pushkës. Në këtë çast ndërroi mendim. Nuk kish-

te shtënë ndonjëherë me pushkë, s'kishte pasur guxim të therte një pulë, jo më të godiste njeri. U zbe... Tani ajo s'dinte të dallonte më ku ishin partizanët e ku ishin gjermanët. Edhe gjësimet i vinin turbull.

«Do të më djegin, do të më vrasin!» mendonte.

Njëri nga ushtarët ngjiti shkallët me vrap.

«Do të më vrasin, do të më djegin!»

Me pushkë në dorë nënë Argjiroja shkoi drejt derës. Ju bë sikur dëgjoi afër zëra partizanësh.

«Mos erdhën, ndoshta... Ah, jo, jo! Ai goditi më fort derën e dhomës. Nënë Argjiroja drejtoi drejt pushkën nga dera. Përsëri e largoi e përsëri e drejtoi pushkën për nga dera, i bëhej sikur e shikonte fytyrën e shtrembëruar e të shfityruar të ushtarit, që godiste me qytën e pushkës derën. Ushtari që një qenje e gjallë, pa shpirt, një diçka e padenjë për ta quajtur njeri. Mori zemër dhe më në fund qëllloi. Ajo nuk pa si ushtari vuri dorën në bark dhe u hoq anës murit, po dëgjoi që diçka e rëndë u rrokullis nga shkallët e gurta. Nënë Argjiroja doli në dritare dhe pa Bukurinë e Vocon, që vinin drejt shtëpisë së saj.

— Kujdes, moj thëllëzë e nënës, ki kujdes!

— Nënë Argjiro, nënë Argjiro! — foli Vocua.

Papritur u dëgjua një breshëri automatiku. Qëllonte që nga porta ushtari tjetër nazist. Plumbat ranë te këmbët e partizanëve, të cilët u hodhën dhe zunë vend në dy porta të tjera.

«A, qeni do të më vrasë djalin, do të më godasë me plumb atë thëllëzë. Hë, po të lashë unë gjallë...» Mundohet të vërë në pushkë fishekun tjetër, po ishte e pamundur. Ajo nuk e dinte si nxirrej gëzhoja, që që bymyer. Tani as goditja me pëllëmbë s'e lëvizte shulin e pushkës.

«U prish, e flamosura, u prish» psherëtiu nënë Argjiroja. «Si të bëj?» Doli nga dritarja tjetër që t'i thosh-te Vocos e Bukurisë të vinin nga ajo anë për t'i dalë fashistit në krah. «Nga ai vend do t'ja përtypim trutë këtë lugati». Atë kohë u dhanë nga ana tjetër xha Refati

me të tjerë. Ushtari nazist, si i pa, u tërhoq e desh të ikte, po rrugën ja prenë plumbat e partizanëve. Bukuria e Vocua erdhën te porta.

— Kujdes! Kujdes!

— Nënë Argjiro, nënë Argjiro!

— E, ç'pati ky i flamosur dyfek, si nuk i luan më llozi, ç'pati i flamosuri! — Kur po mundohej të rregullointe armën, pa se ushtari nazist erdhi një herë rreth avllisë e pastaj u fut në furrikun e pulave, ndërsa Bukuria u dha te porta.

— Ki kujdes, ki kujdes!

— Atje e keni, është struktur në...

Dy armë u drejtuan andej.

Nazisti ngriti duart. Nënë Argjiroja çeli derën, nisi të zbriste shkallët. Kur pa ushtarin të shtrirë, u hoq prapa dy-tri hapa.

— Po ky, ç'pati ky — tha Bukuria. Pastaj vështruan nënën me pushkë, e përshëndetën, kapërcyen murin, kaluan bahçen dhe fluturuan poshtë luginës. Nëna vështroi Refat Arapin, që vraponte, shtinte me pushkë dhe thërriste:

— Përpara... Kuadra, përpara! — Në kohën që rrëmbehej, ai s'e shqiptonte dot gërmën «s».

Refati zbriti me poshtë dhe zuri vend te një shkëmb dhe me sy e vesh të hakërryer vështronte vendin dhe mundohej të dëgjonte zërat e shokëve të skuadrës së tij dhe krismat e armëve të tyre. Sado që e kishte afër, nuk mundi ta dëgjonte krismen e armës, që e përmbysi shul në ujë e në baltë një ushtar. Nga dokumentat që ju gjetën këtij ushtari të vrarë u mësua se ky ushtar përfaqësonte divizionin e Janinës në garat sportive të zhvilluara një vit më parë në Athinë në divizionet e gruparmatës «E», të gjeneralit Loher. Dhe këtë njeri të rritur tej masës e përmbysi në tokë partizani i vogël Voco.

Refati u hoq anash dhe zuri vend pas një guri, prej të cilit shikonte më mirë vendin nga tërhiqeshin armiqtë. Priste, sa të dilte ndonjë ushtar nga shkurret e pyllit të dendur dhe «bam» do të bënte dyfeku i xha Refatit. Be-

fas ai u prish nga fytyra, ju bë sikur midis pyllit nga dilnin herë-herë ushtarë nazistë, dëgjoi zërin e Vocos. Qëndroi disa çaste pa shtënë. Ishte e vërtetë që veshi i tij kapi zërin e Vocos. Po ato shkarpa, si lëviznin aq shumë, ç'të jetë ai që çau nëpër ato shkurre? Dalloi atje një kapele ushtari me shenjë të SS-it në të dhe e ktheu andej grykën e pushkës, por kapelja humbi një çast dhe i doli mu afër. Ju bë sikur e dëgjoi përsëri zërin e Vocos, bile më afër dhe shkoi në drejtim të shkurreve, që lëvizën.

— Përpara, kompania jonë! — thirri po ai zë.

Kurrë Refati s'ja kishte ndjerë frikën krishtës së pushkës se sa atë çast. Aq u drodh, saqë s'po i kujtohej në e zbrazi pushkën apo jo dhe priste që djali nga çasti në çast të binte në tokë.

— Kush je, ti, atje, more, kush? — thirri Refati.

— Jam unë, xha Refat! Jam unë, Vocua.

— Qëndro atje, Voco, hiqe, more djall me brirë, atë kapele ushtari, hiqe shpejt! Hë, c'e paske rrasur ashtu gjer në vesh, për pak të rrëmbeu, o i zi, plumbi për gjerman, hiqe të them, hiqe shpejt! — Refati ju hakërrye.

— Ç'më ndizesh flakë si rrëshira e pishës.

Vocua i zemëruar e hoqi kapelen e ushtarit të gjatë nga koka.

— Dëgjo — i foli gjithë inat Refati. — Po nuk të fola unë, mos lëviz nga ai vend, ki kujdes dhe qëllo po pe ndonjë murrash, që të lëvizë nëpër përrua — dhe vetë u ngrit të sulmonte.

9

Kodra Kike, në hyrje të Qestoratit, qe dëshmi e gjallë e betejës, që u bë disa çaste më parë. Në këtë vend dukeshin shenjat e luftës dhe të vrarë nga të dy palët. Kësaj ane kaloi Çerçiz Fejzua dhe, si zbriti me rrëmbim shpatin e vogël, zuri pozicion të shpella Gosëm, afër një burimi ujëakull. Kundrejt tij në shkëmbinjtë e Shpellës së Bardhë doli Manoli. Këtu përrenjtë që zbresin nga maja Marrata e malit të Lunxherisë, dynden në një

luginë të vetme, hyrjen e së cilës e shënojnë dy shpellat e bardha ku ngrehën mitralozat Çerçizi dhe Manoli. Kjo luginë, që zbrit në drejtim të kalasë së shën Triadhës edhe qytetit, është një luginë e gjatë, me dredha e pjerësi të mëdha. Çerçiz Fejzua dhe Manoli e kundruan me kujdes vendin dhe u morën vesh që, kur të ngriheshin nga ai pozicion, të shkonin drejt lartësive, që e ngushtonin më shumë luginën, andej njëqind metra larg njëri-tjetrit do të kryqëzonin përsëri zjarrin e mitralozave, do t'u prisnin rrugën e tërheqjes ushtarëve të nënkolonelit Kurt, do t'u thërrisnin, në qoftë se nuk ndaloheshin, do t'i godisnin përsëri me plumba. Dhe vrapuan. Nënkoloneli Kurt e vuri re dhe shtrëngoi grushtat, foli në radio.

Një shpërthim... Edhe një tjetër! Në kodrën ku doli Çerçizi.

— Ulu, Çerçiz, ulu!

Çerçizi u struk midis gurëve. Predhat e mortajës fishkëllenin në qiell si gjarpërinj e binin në vendin ku zbrazej mitralozi. Edhe nga ana tjetër, atje ku zuri vend Manoli, e goditte vendin një top.

Nënkoloneli Kurt kërkonte të hapte shtegun.

Çerçizi desh të shikonte, prandaj u mbështet në pëllëmbë të duarve dhe i dha gjoksit përpara. Po nuk mundi të rrinte gjatë, sepse pranë veshit i fishkëlleu një plumb, një tjetër i preu në dy vende bustinën. Shoku i tij e tërhoqi dhe e uli poshtë.

Edhe më shumë shtoheshin mbi pozicionin e mitralierit partizan predhat e topit dhe të pushkëve.

Çerçizi dhe Manoli panë se nga gryka e thellë poshtë fshatit po tërhiqeshin ushtarët armiq dhe filluan të kryqëzonin aty zjarrin e mitralozave.

Nënkoloneli Kurt i zbehur në fytyrë, me zë të dridhur vazhdonte të jepte urdhëra.

Nazistët ngriheshin e vraponin, donin të largoheshin që të dilnin nga rreziku, që i kërcënonte. Posa ngriheshin, breshëri mitralozash, pushkësh e automatikësh zbrazeshin mbi ta.

Sulmonin batalionet, sulmonte brigada...

— Hë, ja, kështu duhet! — thoshte Refat Arapi. Ai zbriste me pushkë në dorë faqes së një kodre të Trano-shistës, zbrazte malisherin në këmbë dhe i thërriste skuadrës:

— Mbi ta, djema, mbi ta!

Ushtarët gjermanë po mblidheshin të gjithë shuk në përrua. Po tërhiqej i mundur nënkoloneli Kurt. Ngërdheshej nazisti Kurt, e topat e tij përsëri merrnin she-një, por... Ushtarët e nënkolonelit Kurt ishin futur në mes të dy zjarreve. Në luginë binin të vrarë e të plagosur shumë ushtarë.

Kompania e Çerçizit i mori armikut lartësinë në të djathtë të fshatit. Njëra nga skuadrat, që vepronte në krahun e majtë, rrëshqiti në bokërimë dhe ra në gropën ku bashkohen të dy luginat. Atje u bashkuan me Çerçiz-in dhe disa partizanë të tjerë.

Duke parë këto forca, nazisti Kurt dha urdhër që atje të përqëndrohej zjarri i ushtarëve. Tre gjermanë u ngjiten në kodrën e vogël dhe hapën zjarr me mitraloz. Disa nga partizanët zbritën poshtë, ndërsa të tjerët vrapuan te muret e rrëzuara të një hauri. Nga goditjet e plumbave ciflat e bloqeve dhe të gurëve ngriheshin për-pjetë mbi kokat e partizanëve.

— Na theri pizevengu — i tha Çerçizit një partizan i shëndoshë, vetullhollë, me ca sy të mëdhenj të zes dhe pastaj vendosi armën mbi një gur shtufi që të qëllonte kundër mitralozit armik.

— U plagosa, Çerçiz! — thirri befas partizani i shëndoshë e vetullhollë dhe shtrëngoi fort plagën, që e kishte marrë në dorën e djathtë.

— A qëllon dot me tjetrën? — i tha Çerçizi.

— Po, po, qëlloj — u përgjegj dhe mbështeti automatikun në mur e i dha një breshëri tjetër. Gjaku filloi t'i rridhte më shumë, ndërsa në fytyrë i ra një çehër e verdhë.

Dielli që ngritur mbi Malin e Gjerë, Qyteti i Gjirrokastërës kishte marrë një pamje edhe më të bukur. Toka nxirrte avull. Përtej, në fund të malit, nga një burim i vetëm gjarpëronte fushës një lumë. Ishte një ditë e bukur. Mirëpo njerëzit nuk kishin kohë të sodisnin këto bukuri. Secili atë ditë vështronte shenjestrën, tytën dhe flakën që nxirrte arma.

— Tërhiquni! — i thanë urdhër me radio nënkolonelit Kurt.

Nga të tërhiqeshin?

Kur i pa ashtu armiqtë, në pikë të vrapit, Refat Arapi ngriti zërin:

— Prisni, tani do të lozim cingëlthi me ju; dale, ore!

Me vrap ja kishte mbathur edhe nënkoloneli Kurt. Ndoshta kësaj radhe do të kishte shpëtuar, po Çerçiz Fejzua u bë erë e doli i pari për t'i zënë pritë.

— Nuk na u nda ai mitralier — murmuriti.

Disa nga ushtarët e tij u vranë, pjesa tjetër mbetën në vend nga ky zjarr i papritur dhe nënkoloneli Kurt u shtri barkas për të qëlluar, pastaj ai u ngrit e u bë gati të hidhte granadën, por mbeti i hutuar. Çerçizi, posa e pa, shtrëngoi fort buzën e poshtme me dhëmbë dhe flegrat e hundës ju zbehën e i lëvizën. Qëlloi. Nënkolonel Kurtit ju bë një pullë e zezë midis vetullave atje ku shënoi Çerçizi. Mbeti aty i shtrirë në vend sa gjatë-gjerë hitleriani i gjatë dhe i thatë, fytyrëhequr, me dy sy të bardhë e me flokë të verdhë. Një nga partizanët i hoqi automatikun, i hoqi hartën me shigjeta dhe revolverin. Nënkolonel Kurti e ndjeu që dikush ishte afër tij... Belbëzoi. Gishtat e duarve i nguli në baltë, mundahej të shuante dhembjen e plagëve.

-- O burra, shokë, t'i ndjekim!

Dhe Çerçizi u ngrit nga pozicioni e shkronjë së parë. Ishte i gëzuar, i shndritnin sytë dhe balli, i gufonte zemra. Përsëri qëllon me mitraloz e thërret:

— Përpara!

Batare pushkësh e mitralozash. Bombat buçasin në afërsi të qytetit dhe bëhen një me tingujt e borive, me jehonën e zërave:

— Para, brigadë partizane!

Në sulm, me radhë të ngjeshura partizanët e brigadës kalojnë nga njëri vend në tjetrin. Afër Çerçiz Fejzoz, në një hap me të, ecën një partizane. Befas dhe nga afër u dëgjua krisma. Armiku qëllon. Diçka i ndodhi Çerçizit, që ndali vrapin dhe u përkul e ra përdhe, si zog i goditur në fluturim e sipër. Ishte goditur nga dy plumba. Ndjeu një dhembje therëse në gjoks. Vuri dorën në plagën e porsahapur dhe ajo ju njom e ju skuq nga gjaku. Edhe ashtu ai gjeti forca sa të drejtonte armën nga armiqët. . . U mbajt gjersa mitralozi i tij i zbrazti të gjitha plumbat. Sërish e mbushi mitralozin e u mundua të merrte shenjë. Dikush i afrohet.

— Vëlla, të paska marrë plumbi! Të rrjedh shumë gjak! . . Prit të ta mjekoj.

Çerçizi e vështroi në sy.

Nuk e njihte. Ajo ishte një nga partizanet e çetave, që ishin inkuadruar në brigadën e re. Shërbente si sanitare.

— Motër. . . Motër. . .

Partizanja sanitare e shkathët dhe me një shprehje serioziteti në fytyrën e saj të vogël e rrëmbeu, i zërbëu dhe i vuri diçka në gjoks për t'i ndaluar gjakun.

— Motër. . . oh, motër!

Nga afër u dëgjua një krismë automatiku.

Djaloshi mundi të shikonte duart e motrës partizane, që u ulën pa forcë. Një buzëqeshje e ëmbël i kaloi

vajzës në buzë, si për t'i kërkuar falje që s'kishte mundur t'ja lidhte dot plagën.

Malet rreth qytetit të lashtë gjëmonin. Grykat përsëritën jehonën e krismave. Plumbat e armikut vërshonin rreth e rrotull. Çerçizi pyeti:

— Motër, më thua j si quhesh?

— Anife.

— Po buzëqesh? A nuk e sheh që plaga jote rrjedh gjak? Të plagosën? Ah, qentë!

Partizanja e vështroi, sytë i shndritën. Diçka pëshpëriti, diçka si «diell... diell» dhe ra...

«Plagët s'e mposhtin partizanin. Dridhu, armik! Anifesë do t'i merret haku!» Dhe mbi gërmimet e betejës, mbi kërkëllimet e pushkëve, ballë për ballë me armikun, në portat e qytetit të gurtë, u ngrit nga gjaku, në këmbë, një trup i shpuar nga plumbat. U dëgjua krisma e mitralozit. Brigada tha:

— Mitralozi i Çerçizit!

Bukuria, që e pa nga afër ngjarjen, ndjeu sikur t'i thyhej diçka brenda, në shpirt dhe u zbe? Ishte trimi i fundit nga dera e Fejzajve që vritej në luftë.

Pastaj ajo rrëmbeu mitralozin dhe hapi zjarr kundër nazistëve.

— Është Çerçiz Fejzua — thoshte brigada.

Mitralozi derdhte zjarr papushim mbi armiqtë. Brigada sulmonte, partizanë e partizane thoshin:

— Të lumtë. Çerçiz të lumtë!

U përhap lajmi për vrasjen e Çerçizit. Ky lajm ka-loi me rrëmbim nga njëra kompani në tjetrën.

— E, ç'shokë na rrëmbeu plumbi! Lulen e vajzave e të djemve të vendit!

— Qëllonte mitralozi i Çerçizit.

— Kush e punon atë mitraloz, kush?

— Bukuria!

Refat Arapit ju bë zemra mal dhe, sa herë dëgjonte krismën e mitralozit, murmuriste:

«Nuk janë vajzat e gratë tona si ato hanëmet e bejlerëve, që nuk i sheh as dielli dhe as hëna...»

...Në brigadë, sa herë flitej, atë ditë, për Çerçiz Fejzon, përmendej edhe emri i Anifesë, emri i partizanes së vogël, që kalonte përmes plumbave nga njëri pozicion në tjetrin që të mjekonte shokët, emri i vajzës gjashtëmbëdhjetëvjeçare, që shkëlqeu si kometë, i vajzës që qëndroi në brigadën partizane vetëm dymbëdhjetë ditë dhe u vra duke mjekuar shokun.

Ngjarjen e vogëlueshes e mësuan të gjithë. Edhe këngën e Anifesë e këndonin të gjithë:

*Me gëzim shkove në çetë
Ti, o shoqja Anife,
Ju ngjite malit përtpjetë,
Trimëshë e maleve,
Thëllëz e burimeve
Motr' e partizanëve...*

PJESA E DYTË

KAPITULLI I PESTE

*Në hartë qenë shënuar shumë shigjeta
me kryqe të thyera dhe shumë yje.*

1

Ka raste që edhe për komandantët e shkathët në veprime, që janë të zotë të orientohen në çdo kohë e situatë, vjen një kohë kur mendja e tyre fillon të mos punojë aq mirë. Disa gjeneralë, duke u plakur, zvogëlohen në vend që të rriten. Ndoshta kjo ndodh për faktin që ata qëndrojnë gjithmonë larg nga ushtari. Po gjenerali Gajb ende nuk ishte plakur, ai nuk u ngjante gjeneralëve hutaqë e të plakur me të cilët tallen oficerët e pritej te frynte dhe në kohë merрте masat e duhura. Po kësaj radhe provoi që s'dinte të përcaktonte si herët e tjera fundin e përleshjes. Do të fitonte, apo do të humbiste? Ja çekani që godiste përherë në kokën e komandantit të operacionit. Për herë të parë në ato ditë luftimesh ai provoi që i mungonte aftësia për të përcaktuar mundësinë e fitores. Në sy të vartësve hiqej se parashikonte shpartallimin e plotë të forcave partizane.

Disa ditë pas përleshjes në Lunxheri, erdhi që nga Janina në Gjirokastër. Nga dritarja e ndërtesës katërkatëshe, ku qe vendosur komanda e garnizonit, ai sodiste malet edhe qytetin e gurtë me shtëpitë e ngritura mbi

njëra-tjetrën. Kishte shëtitur nëpër shumë shtete, por një qytet të tillë prej guri s'ja kishin zënë sytë gjatë, ndaj e sodiste gjithë kureshtje. Pastaj u largua nga dritarja dhe ja hodhi sytë hartës së vendosur në një tryezë. U suall një herë rreth, e bashkë me të lëvizën edhe disa oficerë shtabi, që mbeteshin si të ngrirë, sa herë i vështronte gjenerali. Në hartë, me laps me ngjyra të ndryshme, qenë shënuar shigjeta me kryqe dhe me yje. Sa shumë shigjeta me kryqe dhe me yje... Ai mendoi:

«Këtë duhej ta kisha mbytur, se e kisha brenda rrjetës». Nuk thuhet kot që dhelpra tretet duke mejtuar pulën që nuk e shtiu dot në dorë. Bri atij ylli të kuq shënohej emri i brigadës së re partizane. Nga kjo brigadë ai njihnte një njeri, edhe atij nuk ja dinte emrin e vërtetë, por pseudonimin. Marenglen e quanin.

«Pse e thërresin me këtë emër?» Kërkoj t'i sillnin dosjen. Dosja e Marenglenit ishte çelur nga xhandërmëria e Zogut, kishte vazhduar edhe në kohën e okupacionit nga fashistët italianë. Mëkëmbësi Jakomoni kishte lëshuar edhe një dekret që e dënonte me vdekje. Gjenerali ju shpjegua gjithshka kishte dosja, por ai më tepër vëmendje u kushtonte fotografive. Nëpërmjet tyre ai vështronte fytyrën e njërit prej kundërshtarëve të tij. Kishte fotografi nga më të ndryshmet, që nga koha kur ishte nxënës e shëgert dhe gjer në ditët e luftës. Pas çdo fotografie jepeshin shpjegime. Edhe ato i lexoi gjenerali Gajb, sado që fotografitë flisnin vetë. Kuptohej kur e kishte lidhur xhandarmeria e vendit dhe kur korofillakët e shtetit fqinj; dalloheshin hekurat e burgut dhe stanet në male, ku komunisti fliste me lebërit. Po më me kureshtje ai shikonte fotografitë e viteve të luftës. Në nëntor të vitit dyzet e dy që fiksuar një fotografi në ballkonin e nënprefekturës së Kurveleshit, ku Marengleni, pasi kishte drejtuar sulmin dhe kishte çarmatosur forcat fashiste, i fliste popullit. Në një fotografi tjetër ai e pa fytyrën e komunistit bashkë me prefektin dhe me autoritetet e tjera të vendit. Gjenerali u bë kureshtar të dinte. Fotografia që fiksuar në një fshat të thellë të

Labërisë. Marengleni ishte maskuar si mësues fshati.

— Administratë e kalbur, — tha gjenerali — çfarë prefekti...

— Nuk isha unë — ndërhyri prefekti.

Gjenerali përmes fotografive mundahej të psikologjiste kundërshtarin. Oficerët e tjerë qëndronin në këmbë.

— Do të na nxjerrë telashe ky njeri — tha gjenerali.

I përqëndruar në leximin e dosjes, herë pas here thithte fort një cigare të gjatë.

— Pse e thërresin me këtë emër? — pyeti befaz gjenerali.

— Të gjithë partizanët mbajnë pseudonime — ju përgjegj prefekti, i cili, sapo kishte dëgjuar ardhjen e gjeneralit, kishte rendur ta priste.

Gjenerali kërkoi të dinte domethënjen e atij pseudonimi. Prefekti ja zbërtheu dhe ja shpjegoi.

Edhe pse dy nga ata emra, që përbënin pseudonimin ishin gjermanë, gjenerali pështyu.

«Më vjen ndoht kur kujtoj që janë gjermanë» tha me vete.

Prefekti s'vonoi të jepte përgjegje, meqë e dinte mirë gjermanishten.

Gjenerali heshti... Diçka mendonte. I mbërtheu sytë mbi fotografinë e Marenglenit, e cila qe ngjitur në dosje dhe mundahej të lexonte mendimin e këtij njeriu. Po qe e pamundur, ndaj zbërtheu inicialet e emrave, i shkroi dhe lexoi: *Marks*, *Engels* dhe *Lenin*. Ashtu nervoz siç ishte, hoqi mbi ato dy vija të forta me laps blu, hoqi edhe një tjetër më me forcë, saqë ju gërvish faqja e blikut. Prefekti, që gjer atëhere kishte heshtur, ndërhyri:

— Nga ju gjermanët mbiu së pari fare e komunist. Vetëm ju mund ta shkulni këtë dreq, që mbiu... Është murtajë kjo, zoti gjeneral, e më zi se murtaja.

Gjenerali nuk fliste, por të gjithë sa ishin atje kuptuan se e kishte mbërthyer dëshpërimi. Sado që në vargmalet, që shtrihen nga brigjet e detit Jon gjer në

portat e qytetit e në afërsi të Vlorës forcat e tij ende vepronin, ai e konsideroi veten të mundur dhe nisi të mendonte për mbrojtjen. Mund të përsëritej, sipas tij, e njëjta e papritur, që kishte ndodhur në zonën e Korçës, ku në pak ditë forcat partizane i kishin çliruar zonat e shkelura nga forcat e tij dhe kërcënonin garnizonet në afërsi të qyteteve. Me këto mendime në kokë u veçua nga të tjerët dhe, duke ecur me hapa të shkurtër, u mbështet mbi parmakun e dritares dhe po vështronte përsëri andej nga malet. Mundohej të dallonte kufirin e luftimeve.

Kudo ushtarët e tij, në vijat e para të përleshjes dhe në thellësi, goditeshin me plumba. Malet, grykat e gërxhet, shtëpitë, rrugicat e qyteteve e të fshatrave u kishin drejtuar atyre grykat e armëve, u derdhnin plumb. Këto mendonte dhe prandaj ishte i dëshpëruar, saqë, kur i hoqi sytë nga malet, fytyra i mori pamje tjetër.

— Duhet të nisemi — tha papritur.

Adjutanti i tij rrahu fort thembrat e çizmave dhe nderi dorën për t'i dhënë gjeneralit kapelen ushtarake të rënduar me shirita të pruar.

Maqina e hekurt lëvizi me zhurmë në sheshin kryesor të qytetit, pastaj u ndal te dera e ndërtesës. Ai hipi në autobлиндë dhe u nis.

Motori i autobлиндës uturinte me forcë. Gjenerali vështronte herë qytetin dhe herë malet dhe thoshte me vete:

«Ku shkoi brigada e re partizane? Në cilin drejtim duhet t'i dërgoj forcat? Ku duhet ta kërkoj?»

2

Brigada e re partizane goditi në Lunxheri si rrufe dhe u zhduk po aq shpejt duke u ngjitur nëpër male. Shtabet e reparteve partizane ndiqnin me kujdes veprimin e regjimenteve të gjeneralit Fon Gajb. Megjithëse pozitat e partizanëve ishin përmirësuar, duke çliruar për

së dyti disa zona, përsëri rrugët dhe qytetet i mbante armiku dhe forca të tjera të tij sulmonin. Operacioni vazhdonte.

Në shtabin e brigadës partizane vinin lajme nga organizatat e partisë të qytetit dhe nga simpatizuesit e luftës. Zbuluesit partizanë dhe populli gjurmonin lëvizjet e armikut dhe njoftonin mbi përqëndrimet e tyre. Për të gjitha këto dha shpjegim në mbledhjen e kuadrove të brigadës, me fjalë të thjeshta e të kuptueshme, Goliku. Si gjithnjë, Goliku vetë nuk foli gjatë, por u la radhë të tjerëve. Komandantët e komisarët e kompanive e të batalioneve rrinin ulur, shumica e tyre këmbëkryq, me armën në prehër, ndiqnin me vëmendje çdo fjalë e lëvizje të Golikut, e mbanin ndonjë shënim në fletore.

Foli edhe Marengleni. Si gjithnjë, ai u ndal mbi situatën, foli edhe për detyrat, që kishte kryer brigada; pastaj edhe ai parashitroi mendimet e tij. Për ato ditë, kur ende vazhdonte operacioni, ato qenë mendime të guximshme, por Marengleni i paraqiste ato me zjarr dhe bindje të thellë; fytyra e tij ishte e skuqur, vetullat i lëviznin papushim, shkonte me brigadën në rrugë të gjata, vështronte larg, përpara, ku ajo do të jepte të tjera goditje. Të tjerët dëgjonin në heshtje, duke ndjekur me vërejtje jo vetëm fjalën e Marenglenit, por edhe drejtimin që merrte maja e mprehtë e lapsit të tij dhe ndalesat, që bënte në hartë për të treguar vendin ku do të bëhej goditja.

E morën fjalën shumë komandantë e komisarë. Ata folën shkurt, siç ishte zakon të flitej në luftë, por të gjithë jepnin mendime, që dëgjoheshin me interes të veçantë nga shtabi i brigadës dhe nga pjesëmarrësit në mbledhje. Gjithë ajo mbledhje s'qe veçse një kuvend, një mendim i përbashkët i të gjithëve: duke e përbuzur vdekjen, ata betoheshin të ishin në ballë të kompanive e të batalioneve që komandonin, të frymëzonin me shembullin e tyre gjithë luftëtarët e brigadës. Ishte ky një zotim që morën ata para partisë dhe Shtabit të Përgjithshëm,

që, krahas formacioneve të tjera partizane, brigada e tyre t'i jepte armikut gjithnjë e më shumë goditje.

Në fund foli zëvendëskomisari i brigadës, Vogli. Të gjithë e dëgjonin me vëmendje. Thua jse të gjithë e njihnin Voglin. Duke qenë në qarkorin e partisë, ai shpeshherë kishte marrë pjesë në mbledhje të celulave e të çetave partizane. Vogli i njihte thua jse një për një me emër dhe kjo e ndihmonte që ai të komunikonte më shpejt me ta. Dinte si t'i drejtohej njërit e tjetrit.

— Armiku na hodhi litarin në grykë dhe kërkonte të na mbyste. Ne, e shqyem këtë lak dhe, për këtë lak dhe, për këtë celulat e partisë kanë një meritë të veçantë — tha Vogli dhe vazhdoi fjalën:

Tani, çdo goditje që japim është një grusht për armikun dhe, njëkohësisht, një shkollë e madhe, ku mësojmë të gjithë. Urtësia, guximi dhe frymëzimi janë tiparet e partizanit. Jeta në luftë ka bindur cilindo partizan e partizane se, të luftosh kundër batalioneve e regjimenteve të gjeneralit Gajb, është njësoj si të vraposh drejt rrezikut. Por, në qoftë se vetëm për një çast harron të luftosh kundër këtyre forcave operuese, atëhere do të vijë çasti që të të rrëmbejë në thonjtë e saj vdekja. Kështu shtrohet problemi në këto kushte. — Duke folur për rolin që duhej të luanin celulat e partisë, zëvendëskomisari i brigadës vështronte shënimet e mbajtura në fletore. Në dy javë të jetës së brigadës, qenë mbledhur shumë episode për komunistët dhe partizanët që ishin vrarë në ballët të luftës. Për vetëmohimin e tyre në luftë u mbajt një minutë heshtje. Para syve të të gjithë pjesëmarrësve në mbledhje dilnin një e nga një shokët e tyre të rënë.

— Do t'ua marrim hakën — thanë të gjithë me një zë, duke shtrënguar fort armët dhe duke mundur dëshpërimin, që ndjenin për shokët e rënë.

— Ashtu si zemra, që ngroh trupin, edhe celulat e partisë ngrohin e gjallërojnë jetën e brigadës. Prandaj të mbështetim gjithë punën tonë në forcën e tyre, se, po e bëmë këtë, çdo detyrë që do t'i ngarkojnë brigadës partia

dhe Shtabi i Përgjithshëm, do të plotësohet — u tha shokëve Vogli.

U shpërndanë dhe biseduan me partizanët për detyrën e re. Nga malet, brigada do të nisej në mbrëmje.

U ndanë forcat në dy drejtime. Në njërin drejtim bashkë me forcat shkuan Vogli dhe Goliku, në tjetrin Marengleni.

Dy kolona partizane.

Dy goditje!

Brigada përsëri u vu në marshim. . .

3

Veprimet e reparteve të gjeneralit Gajb gjatë ditëve të operacionit bënë që forcat reaksionare të gjallëroeshin. Ato ditë beu i Këlcyrës, Aliu, dërgoi në zonën e Mallakastrës, në Tepelenë, Gllavë dhe Dëshnicë letra për beun e Margëllëcit, Margushin, për dervishin Harjulla, që shërbente në teqenë e Gllavës dhe që ishte vënë në krye të një formacioni mercenarësh, për Axhem Belulin, një nga krerët e mercenarëve. Të tre këta në ditët e Operacionit të Dimrit i nxorën forcat e tyre gjer në luginën e sipërme të Vjosës, në afërsi të Përmetit, por nuk guxuan të hynin në luftë me forcat e brigadës partizane. Pas goditjes në Lunxhëri mercenarët Axhem Beluli, dervishi Harjulla, dhe beu Margush filluan ta ndjenin erën e goditjeve të brigadës partizane. Ata, duke biseduar me njëri-tjetrin, hynë në lidhje me majorin Dieter Grebner dhe në bashkëpunim me forcat e tij ndërtuan në të dy anët e Vjosës pikëmbështetje të rrethuara me mina e tela, forcuan kështjellën në Tepelenë dhe Margëllëç, mbyllën rrugët, qafat e maleve; gjithë shtigjet u mbyllën. Lundrat ruheshin nga roje dhe hyrja e dalja në zonën e tyre qe mbyllur. Nazistët dhe mercenarët me zonat e çliruara nga partizanët bisedonin vetëm me gjuhën e pushtës.

Në popull bëhej propagandë e madhe, përhapeshin

gazeta që i nxirrnin partizanët si egërsira, botoheshin trakte që shanin brigadën partizane dhe komisarën e saj, Marenglenin, si njeri fanatik, komunist të rrezikshëm dhe të shitur, ndërsa Golikun e quanin një kaçak mali, që gjithë jetën ndejti nën hijen e dyfekut dhe s'beri kurrë prokopi.

Ajo që prisnin armiqtë, goditja nga ana e brigadës partizane, po afrohej...

Marengleni me një pjesë të brigadës u nis për të vepruar në një zonë, që ende mbahej nga armiqtë, kolona tjetër e drejtuar nga Vogli e Goliku zbriti nga mali në luginë, pastaj në mbremje përsëri ju ngjit malit. Do të kalonte shpatin e Trebeshinës, do të udhëtonte larg fshatrave e rrugëve.

Me kolonën, që marshonte, ishte edhe skuadra e Refat Arapit. Ai ecte në gjurmë të shokëve, pas shokëve të shtabit.

— Nga këmbët e di që s'ndjen lodhje, po sytë si i ke, o xha Refat?

— Vërtet, më pengon një çikë syri, o shoku Vogli. Besoj që edhe ju të rinjtë nuk e keni aq lehtë të shikoni në një natë të zezë si kjo.

Kaluan një copë rrugë së bashku. Zëvendëskomisari i brigadës e pyeste Refatin. Ky hazër xhevap. Tregonte se si ishte ndarë me një gjerman e si kishte zënë një ballist për zverku në Lunxheri. Tregonte bukur Refati. Të tjerët, ndonëse i kishin dëgjuar shpesh ato që thoshte, prapë kënaqeshin kur i dëgjonin. Ato i dinte kompania, i dinte batalioni e qarkullonin edhe në batalionet e tjera të brigadës.

— Ku shkojmë, shoku Vogli?

— Nuk e di?

— Jo.

— Ku ta merr mendja se shkojmë, o xha Refat?

— Në luftë, ku tjetër. Dasmat janë prerë tani sa të përzëmë këta qafëthyerit. Kam qeif t'i përpjekim një herë armët edhe me ata.

— Me cilët?

— Po mjaft u kacafytëm këto ditë me gjermanët, e u dhamë dajak që ç'ke me të. Tani duhet edhe atyre t'ua ndukim bishtin. U është rritur hunda. Thonë që janë tërbuar. Duan raki e mish nga cilido. Edhe më i ligu i tyre është krekosur. Axhem Belulit i pret palla në të katër anët. Duhet medoemos t'u biem, t'u ulen de, të shkretën, një çikë veshët. Apo jo, shoku Vogli?

Kur fliste Refati, të tjerët e ndërprisnin fjalën dhe dëgjonin.

— Po ku i gjen aq shpejt fjalët, që i rrjedhin si ujët nga burimi. I lumtë, o vëlla! Unë s'i bëj dot dy fjalë bashkë, si të isha gagaç — thotë një nga partizanët. Refati s'e la të vazhdonte gjatë atë që foli.

— Ku i gjej fjalët? More, po e kam parë diellin shumë më herët se ju... Pastaj ç'bëra unë në skelat? Fjalë mësova, thasë në shpinë ngrita. Ç'të bëja tjetër?...

— ...
Kaluan pllajën e malit, ranë në Këçok. Kudo borë... Te qafa, aty ku kryqëzohen rrugët, të rrëmbente era. Frynte, bora ngrihej duman. Ajo i godiste partizanët në fytyrë dhe ngrinte në qafën e palltos dhe në flokët e tyre. Kolona çapitej ngadalë.

Kur zbritën në qafën e Këçokut, te kryqëzimi i rrugëve, partizanët i shtynte era drejt përroit të madh, tutje nga Gllava, por Vogli dhe Goliku, që rrinin në kryqëzimin e rrugës, flisnin me zë të lartë:

— Majtas, shokë, majtas!

Dhe shkuan andej, u ngjitën përsëri në drejtim të malit dhe lëvizën nga fshati Ramicaj. E tërë brigada ishte në lëvizje.

Partizanët shkelnin në gjurmë të njëri-tjetrit, ngjiteshin në male, shkonin në drejtim të armikut...

Kishte zbardhur dita, kur disa nga partizanët e skuadrës së Refat Arapit dolën jashtë fshatit dhe qëndruan

në përgjim atje ku dredhonte rruga. Të mbledhur kokë më kokë, bisedonin. Si gjithmonë, Refati tregonte ndonjë ngjarje. Njëri nga shokët e pyeti:

— Ku jeni njohur me shokun Vogli?

— Këtu u njoha, në brigadë. Më thirri ditën e dytë të luftës e më pyeti. Si dukej, i kishin folur për mua.

Në fillim flisja më pak unë dhe më shumë ai që më bënte pyetje. Dhashë të mbahesha dhe nuk u mbajta dot, atëhere fillova të tregoja. E nisa që nga fillimi, nga dita që e zunë Shqipërinë italianët. Më kujtohen ato ditë si pasuria e Shqipërisë zbriste nga mali në qytet, mbushej skela dhe unë hamalli dengat e mëdhenj me mall i hidhja në shpinë dhe me gjunjë që më dridheshin nga pësia i afrohesha vaporit italian. Një çengel me dhëmbë të nprehtë si dhëmbë ujku më ngulej në shpinë dhe iku malli, iku balta flori e Shqipërisë, e gërryente i huaji pak e nga pak, deti thithte mallin tonë. Unë, sa herë çengeli më rrëmbente mallin, ngrija shpinën, pa mallin shpina ime ndihej më e lodhur, ndaj i zemëruar i thosha vaporit të Duçes:

— Do të të ngecë në fyt pasuria jonë, ke për të parë.

— Dhe e shikoja vaporin e huaj, që largohej duke lëshuar një uturimë të egër.

Fola për shumë halle të jetës dhe kuptova që Vogli i dëgjonte me vëmendje.

Ai më pyeti gjithashtu për çetën, në të cilën kisha luftuar.

— Unë i tregova se në fillim luftova me ato të Tepelenës, pastaj mbeta në një nga çetat e Gjirokastrës. Dola partizan me të dy djemtë. I vogli kaq është, ja, sa ky trimi i xhaxhait, që shikon atje — e i tregova Vocon, që ishte shtrirë midis barit. E kuptova që donte ta dinte punën time me soj e sorollop dhe ja tregova. Pas disa ditësh, më thirrën në mbledhje. Vajta e u ula këmbëkryq, me dyfekun në prehër.

— Celula vendosi t'ju pranojë anëtar partie, xha Refat — më tha Vogli. — Atje e kuptova pse më bëheshin ato pyetje. M'u drodh zemra nga gëzimi. Si të mos

gëzohesha? Kjo që dita më e lumtur për mua. U bëra komunist. Ajo ngjarja që më ndodhi ditën që u plagos Dardani dhe sidomos vrasja e ushtarit gjerman që zëmë rob, nuk u la në harresë. Një natë pa gjumë më mbajti Muçua gjer e pranova gabimin.

— Refat Arapin e thërrasin në shtab të brigadës — foli një zë.

— Po kjo, ç'të jetë kjo? — u tha shokëve. e la në mes fjalën dhe u largua.

Shtëpitë e lagjes ku që vendosur shtabi i brigadës ndodheshin prapa një kodre. Kur po ngjitej andej, dëgjoheshin këngë. Refat Arapi i kishte qejf ata që dinin të këndonin, ndaj filloi të dëgjonte me vëmendje këngën e re, që kishte dalë atë ditë.

— Kush po ja merr kështu!? — dhe vinte dorën te veshi.

— Bukuria është, ja njoh zërin, ajo është. — Dhe fjalët i vinin atje. I këndonin luftës që kishte bërë brigada në fshatin Qestorat të Lunxherisë. Kur këndonte Bukuria, ja dalloje fjalën që nga larg, se ajo kishte një zë të kthjellët e të bukur, që veç ta dëgjoje. Refati thithte duhan dhe përfytyronte luftën në Lunxheri. . . Partizanët këndonin:

*Në Qestorat mu në breg
Bajonetë me bajonetë. . .*

Mirë ja kanë gjetur fjalët kësaj kënge. Ashtu që vërtet lufta e Lunxherisë.

Kënga buçiste:

*«O lufta në Lunxheri
Do shkruhesh në histori.
Çerçiz Fejzo Golemi*

— Eh, more Çerçiz! — murmuriti Refat Arapi. — Djalë e për kokë të djalit ishe.

Pasi hodhi sytë andej nga malet përmbi Tepelenë, ku

ishte vendlindja e Çerçizit u ngrys në fytyrë; midis ballit ju ngrit një damar. I kërcente ai damar gjithnjë kur ishte i shqetësuar. Tutje jehonte kënga për Çerçiz Fejzon:

*«Çerçiz, partizan i rrallë,
Yll në zemër, yll në ballë»*

Refat Arapi po shkonte në shtabin e brigadës dhe thoshte me vete:

— Hë de, më të lumtë ajo gojë! Bukur ja thua këngës! Si thëllëzë ligjëron, si ajo thëllëza e malit, që nuk e pret kurrë këngën. Po ku i gjen këto fjalë! Si të gdhendura në gurët e malit do të mbeten. Do t'i kujtojë Shqipëria vajzat e djemtë që ranë në luftë.

Më tej, radhazi partizanë e partizane çohen nga vendi. Kënga ndërpritet.

— Çfarë ka ndodhur?

Përsëri zhurmë, gëzim...

— Hë, moj, nisja këngës, ç'ke me ata?

Bukuria u bë gati ta fillonte. Dikush thërriti.

— Erdhi Dardani!

— Dardani! Dardani! Erdhi Dardani!

Dardan Veliu, mbasi qëndroi disa javë në shtrat, që ngritur pa u përmirësuar mirë.

Shkuan ta takonin.

U qafuan me Dardanin.

Bukuria ndërroi në fytyrë. Mbeti një çast në vend. Pastaj edhe ajo shkoi andej. Ecte me emocionet e ditëve kur kishte kaluar qafën e Dhëmbelit me Dardanin e plagosur. I foli:

— Dardan! Vdekje fashizmit, shoku Dardan!

U vështruan sy ndër sy. Ata, Dardani në spital e Bukuria në vijat e para të luftës, gjithmonë kishin kujtuar njëri-tjetrin.

— More, sa qenka ligur Dardani!

— Shtatë plagë; e di ç'do të thotë të të marrin në trup shtatë plumba? Edhe mirë u bëri ballë. Trup i fortë, ndryshe!...

Ndërhyri Refati:

— Pa dale, Dardan, ma trego një çikë plagën.

— ...

— Dy plumba kishe në këtë këmbë? Po, vërtet, kështu ishte, më kujtohet, kockën sikur s'ta preku në njërën këmbë. Të shkuara e të harruara, o bir. Ngule këmbën, ec!..

Dardani bëri dy-tri çape.

— Mish e kockë, bir i xhaxhait, të këputën nga trupi plumbat, të kanë lënë pak topall... hiçgjë, djalë je... — E rrëmbeu midis duarve, e puthi. — S'ka ç'na bën plumbi gjerman neve, jo! U shërove Dardan, u shërove, o divi i xhaxhait.

— Po, xha Refat, po, ç'hoqa, vetëm unë e di.

Refat Arapin fjala e goditi me forcë plumbi, u zbe në fytyrë. I kujtohet që nga rrëmbimi i tij kishte vënë në rrezik gjithë skuadrën. Sërish sytë e tij shkuan te plagët e plumbave, ato tani ngjanin si një sipërfaqe e zvogëluar në hartë, ishin mbyllur.

Bukuria e ndjente veten krejt ndryshe nga ditët e tjera. Disa herë ajo i hodhi vështrime të zjarrta Dardanit, nëpërmjet qerpikëve të saj të gjatë, hera-herës e vështronte sheshit. Kurrë në jetën e saj nuk kishte vështruar ndonjë djalë në mënyrë të tillë. Ndjeu se zemra po i rrihte fort. Kujtonte rrugën që kishin bërë në ballin e dimrit. Supi i saj i vrarë e i shembur nga druri i barelës, bora, doktori, spitali partizan, aeroplani gjerman dhe Dardani, të gjithë i shfaqeshin në kujtesë. Për qëndresën e Dardanit flisnin me admirim të gjithë. Ju kujtua çasti kur ajo ishte ndarë në Malin me Bredha me Dardanin. I kishte thënë:

— Mirë u pafshim, Dardan! — Një valë e nxehtë ndjenjash i kishte përflakur zemrën vajzërore.

Dashuria që tregonin partizanët dhe fjalët e zjarrta që kishte thënë Vogli, e ngashëryen Dardanin.

— Eja, Dardan, mjaft të kemi pritur! — i tha Refat Arapi dhe e zuri nga krahu. Pastaj: — Po, si, ore, harrova, më lanë mendtë. Prit, Dardan, prit. Më kanë kër-

kuar në shtab të brigadës — dhe shkoi vrap te ndërtesa, ku qe vendosur shtabi i brigadës, në lagjen e kreut të fshatit Maricaj.

5

Në shtab, Refat Arapi i dhanë detyrën.

— Do të nisemi — u tha ai shokëve të skuadrës.

— Ku?

— Në Tepelenë. Do t'i godasim një herë që të mos e ngrenë më kokën.

— ...

— Atyre do t'u duket sikur do të ketë gjuajtur crufeja në të kthjellët.

— As që u shkon në mend që do t'i godasim në Tepelenë. I kanë nxjerrë rojet një ditë larg nga kalaja. Pregatitu, ti, Manol!

Partizanët lexojnë. Mësojnë për goditjet, që japin partizanët e tjerë në Devoll, në Korçë e Kolonjë, në Pezë e kudo. Ndjekin me një interesim të veçantë sidomos luftimet në jugë të Vjosës. Përmenden në komunikata goditjet në Mesaplik e Kurvelesh, në Kardhiq e Himarë; u bëhet thirrje forcave partizane të japin të tjera goditje.

Refat Arapi, i mbështetur mbi grykën e dyfekut, pasi rikujtoi ato që dëgjoi në shtab, u foli shokëve:

— Mirë ua kanë ngritur çarkun edhe kësaj radhe. I pjell mendja Voglit, e njoh unë atë. E di si më ngjan ky plan? Tamam si një litar, që i hidhet në qafë mushkës kriçe. ashtu më ngjan. Ja, ashtu duhet, të mbash fort litarin në duar dhe mori fund. Që do sillet vërdallë e hazdisur kriçja, kjo s'do mend. Por laku është lak, dhe aq më tepër kur të shtrëngon në grykë!

— Janë shumë ballistë në Tepelenë, o xha Refat?

— Shumë thua? Si fara e dreqit. Kanë mbushur Tepelenën, aq sa s'i nxe kasabaja. Thonë një batalion... dy... ndoshta...

— Dre, brigadë duan të bëjnë?

— Ku gjejnë burra, u vënë në sup një pushkë dhe hajt, i futin në rresht. Pa di tjetri të luftojë a s'di, kush e pyet. Edhe kur ndonjë guxon të pyesë pse ja kanë dhënë në dorë pushkën, krerët e tyre i bien shkurt: «Lufto- i thonë «Lufto për Gjermaninë e madhe. Vdiq Musolini. s'ka gjë, kemi Hitlerin. Lufto që Shqipëria të shpëtojë nga harbutët». Ai që merr pushkën, mbledh supet. Po ku të lë Axhem Beluli? «Nisu» i thotë, dhe një shqelm në vithet, e tjetri hyn në rresht, bën tutje pa ditur shumë herë se ku shkon.

— Mercenarë — tha njëri.

— Dreqër — ja priti Refati. — Si mall s'janë gjë. si numër këto ditët e operacionit gjithnjë shtohen.

— Shqiptarë janë dhe ata, lëndë e nxjerrë nga një lis jemi, xha Refat!

— Ata shqiptarë?! — ju egërsuan sytë — Ata shqiptarë?! Ik, ore, tutje, budalla!

— Është mur pa llaç ai muri i tyre. — ndërhyri një i tretë.

— Hë, të lumtë goja, mirë e the, ashtu është. Muri i thatë shpejt ngrihet e shpejt rrëzohet. Të ka zënë syri të rrëzohet ndonjë mur pa llaç? Jo! Pyet xhaxhanë të të tregojë. Rrëzohet me krye e themel, bie në tokë. Kështu është edhe puna e këtyre «derrave» të Ballit; pak t'i trembësh dhe bien nga degët. Kanë frikë nga flaka e pushkës.

— Vec mos harro gjermanët, xha Refat.

— Edhe ata s'janë më të parët. E panë ç'do të thotë luftë në malet tona. Shqipëri është kjo. ore babam, po s'ja ka bërë lëkurën çdo krali.

— Dikush po vjen andej nga ana e armikut — lajmëroi roja. Refat Arapi i ngriti vetullat, siç ngrinte çarkun e dyfekut. Doli të shikonte. Drejt tyre po vinte një burrë me pushkë.

— Mos i bini, le të afrohet.

Njeriu me pushkë po i afrohej gjithnjë e më shumë pritës. Ata i dallonin pushkën, kollanin e fishekëve dhe stemën e ballistit.

— Nga ata qenkan — murmuriti Refat Arapi dhe të tjerëve me zë të ulët u tha:

— Ku dreqin shkon?

Ballisti, kur e pa veten e tij midis grykave të pushkëve, u dorëzua. Dërgohej me një letër. E sillte atë letër nga ana e përtejme e Vjosës. Në atë letër, komandanti i forcave mercenare të Tepelenës, Axhem Beluli, i shkruante komandantit të mercenarëve në Mallakastër, beut Margush:

«Jemi informuar se në Dëshnicë është dukur brigada partizane. Është mirë që të vijnë forcat tuaja në anën e përtejme të Vjosës dhe të lajmërohet që forcat gjermane të vijnë sa më parë për t'i forcuar disa pika kryesore dhe për t'i pasur ato mbështetje...»

— Oj, ç'mision i paska ngarkuar Axhem Beluli! Të dërgojë letra! Po nga vjen, more bandill, nga Tepelena?

— ...

— Të dërguan ata, dhe ti do ta çoje letrën në vend. Qenke këlysh besnik i tyre. — Ballisti u betua, kërkonte të shfaqësohej. Atij i bënë pyetje dhe ai tregonte. Nga të gjitha ç'tha, Refat Arapi nuk shënoi asnjë në fletore, veç i ngajti fjalën:

— Ju paskan thënë që u zhdruk fara e kuqe dhe mbiu juaja, fara e zezë. Pt, edepsëzë! Nuk ka baltë që i mban sipër tradhëtarët. Ju paskan thënë që qindra e mijëra partizanë janë vlarë, se burgjet e kalatë janë mbushur me partizanë, ju paskan porositur që, po t'i shërbeni gjermanit, i keni shërbyer teqesë së zotit. Hëm, dinë si i lozin gurët. Po në letër, e dëgjove si shkruajnë?

Ballisti mblodhi supet.

— Folë, pse s'flet, hë, mo, pse të iku goja? — Dhe Refat Arapi u rrëmbye. — Po ju, more qyrravecë, në ballë i keni sytë, pse ore, të kthyera nga brenda i keni ju bebet e syve?

Ballisti edhe më shumë e ndjente frikën. Dhe nga të ftohtët e frika nisi të dridhej. Kuptohej që Refati atë kohë diçka donte të bënte. I shkrepiti t'ja zbrazte një herë

«belxhikun» ma në zemër, por aty për aty ndërroi mendje, i foli Vocos:

— I ke ato hekurat me vete, bir?

— Po.

— Shtrengojani mirë duart dhe përcilleni... T'i dorëzohet letra shokut Vogli, atij t'i bjerë në dorë.

6

Refat Arapi shkelte në ujë e në baltë, binte në gropa me ujë, s'ruhej nga asgjë, veç vraponte e fliste:

— Me çdo kusht duhet të kapim lundrën! Po nuk e shtimë lundrën në dorë, më mirë të mbytemi.

Kur thoshte Refati këto fjalë, në fshatin Ramicaj, Vogli dhe Goliku kishin mbledhur partizanët e u kishin **njoftuar detyrën.**

— Më mirë t'u biem ne. Pse të presim të na godasin ata? — thanë partizanët.

Vogli lexoi disa nga letrat e krerëve të Ballit. Një partizan tha:

— Këta, me ndihmën e gjermanëve, ndërtojnë rrjetën, ashtu siç e ndërton merimanga. Po dhe merimanga diku qëndron, ashtu dhe këta zemrën e tyre e kanë në kështjellë, në Tepelenë.

— Atje t'i godasim! Atje! — tha me një zë brigada.

Partizanët, sapo kishin mësuar që Refat Arapi ishte ngarkuar me detyrë të kapte lundrën, qenë bindur se lundra do të kapej pa u dëmtuar. «Ehu, «kishin thënë» di njëmijë dhelperi Refat Arapi. Me siguri do ta kemi shtegun të lirë.»

Dinte Refati, por dinin edhe armiqtë.

— Për djallëzi janë të vetmit edhe këta — u thoshte shokëve Refati. — Nga raca jonë i kemi, po ç'e do, u ka marrë djalli mendtë. I shërbejnë beut, agait e gjermanit, sikur t'i kishin babë e nënë. Ç'dreqin është kështu! Pastaj:

— Më shpejt, më shpejt!

I kujtoheshin fjalët e Marenglenit, që thoshte për klasat dhe luftën e klasave, për të varfërit e të pasurit, për nevojën që të përmbyseshin çifligarët, t'u merrej toka e t'u jepej bujqërve, atyreve që e punonin. Mirë kishte folur Marengleni: «Po këta dreqër sos janë të gjithë të pasur. Disa janë pa shollë në këmbë e pa rrecka në trup. Hë, pra, ç't'u thuash këtyre? Disa i njoh, brekë s'kanë dhe ja ku m'u bënë ushtarë të beut. Pika që s'u bie! Pastaj mos ua shkoj tej plumbin e qilenë». Në këto mendime qe Refat Arapi, kur po ngjiteshin nëpër një bokërinë anës lumit. Si dolën përballë, ai e pyeti udhërrëfyesin:

— Ku është lundra?

— Atje, ku duken ata dy rrapat e mëdhenj.

Një dritë e kuqe u afrua drejt nga lundra. Dëgjoheshin fjalë:

— Ballistë janë, shqip flasin. Ku shkojnë?

Refati e dinte që në të gjitha këto anë endeshin ballistë. Bile brigada po kalonte fshehtazi nëpër zona ku qarkullonin roje dhe reparte mercenare.

Drita, fjala dhe zhurma e hapave u erdhën më afër.

— Nuk do të jenë shumë.

— Le të jenë sa të duan! — tha Manoli.

— Ata qenkan vetëm dy!

— Mos vijnë të tjerë prapa?!

Pas pak atje u bë përleshja... Qenë rrokullisur e zhytur në baltë, qenë përpëlitur të dy njerëzit, që mbanin në dorë dritën dhe më në fund ishin mundur.

Në fillim ua shtuposën gojën me rrecka.

— Hë, kështu duhet; u vuvosën. Shkojmë! — u tha shokëve Refati.

Sapo u zu lundra, në të dy anët e saj Refat Arapi vuri roje dhe përgjonte... Priste në bregun e lumit brigadën.

Nga mesi i natës, kur shiu kishte pushuar, në afërsi të lundrës arritën disa kompani partizane.

Nganjëherë vetëtinte dhe në dritën e tyre shfaqej deri larg shtrati i lumit.

— Det është bërë sonte zullumqarja, s'i duket ana.

— U trembe, ti, xha Refat? — e thumboi Manoli.

— Jo, more djalë, pse rrëmbehesh, s'e kam aty llafin.

— ..

— Ç'presim, o shoku komandant? Dëgjo Refatin ti, na zuri dita. Dëgjo, po na zuri dita, e humbëm davanë.

— Urdhëro xha Refat, ç'të bëjmë?

— Dëgjomë ti të paktën, më dëgjo ti, o shoku komandant. Mbushju, ore, mendjen. E kaloj unë lundrën. Për kokën time e kaloj. Ç'të presim sa të gjendet lundërtari?

Lumi, si për inat të Refatit, gjithnjë shtohet, e kishte filluar të dilte nga shtrati e të vërshonte anës rrapave të mëdhenj, të dyndte në ujë fushën e vogël. U mblodhën grumbull partizanë e partizane dhe mbi të tjerët dallohej zëri i trashë i Refatit.

— Pritni de, ngadalë ca — e qetësoi komandanti i kompanisë. — Në të ardhur e sipër është lundërtari. Në mos u gjendte njëri, do të gjendet tjetri. Nuk është vetëm një lundërtar. Njerëzit kanë shkuar ta marrin.

— E, Halil Imeri të ishte gjallë. — Komandanti i ri i kompanisë s'po ja zinte syrin, sikur i zvarriste gjërat dhe Refati këta lloj njerëzish s'i duronte dot, ndaj pshe-rëtiu dhe filloi të mendonte shumë variante se si mund të kalonin Vjosën edhe pa lundërtarë. Dhe be e fjalë tha sa mundi, për të treguar që ai qenkej lundërtari më i mirë në ato krahina dhe ndoshta s'ja gjeje shokun sikur të kërkoje deri në qytetin e jugut.

— Për lundër, mo?! — thoshte Refati. — Ç'të bëj për ndonjë gjë tjetër, pa me atë jam marrë që i vogël e gjersa u bëra kaq sa më shihni. E kam mësuar zanatin e lundërtarit në Misir. Për kokën time, në Misir! Atje

më ka kaluar gjysma e jetës. Kam kaluar me lundra të tjerë lumenj. E ç'është Vjosa përpara tyre? Një rrëke uji.

Njerëzit, që shkuan për të sjellë lundëtarët, po vonoheshin, orët po kalonin. Partizanët u grumbulluan në anën e Vjosës. Ende s'kishte filluar kalimi.

— Do të qe mirë të kishim një togë përtej lumit e të zinin kodrat — tha Vogli, që erdhi atje e po bisedonte me partizanët e asaj kompanie.

— Hë, more shoku komandant, si do t'ja bësh kësaj pune? Pa mendohu?

— Ç'të mendoj?

— Si ç'të mendosh?

Njerëzit kanë shkuar, por...

— Ndonjë tjetër, s'pyetëm një herë se mundet që edhe ndonjë partizan i kompanisë të dijë ta ngasë lundrën.

— Është njëri; thotë që ka qenë lundërtar.

— Kush është ai?

— Refat Arapi.

— Provojeni, po me kujdes. Pak njerëz të jenë në lundër. Dërgoni me ta edhe një mitralier. Mirë është që të dinë not.

Kur e thirrën Refat Arapin te lundra, ai u mburr edhe më tepër.

— Si? A do ta kaloj dot? Sos do ta kaloj në këmbë, me lundër do ta kaloj. Nuk e kam të parën herë që shihem me Vjosën. Kur nuk kishte punë në skela, endesha anëve të saj, në vend të samarit të hamallit, merrja pohën¹⁾. Këndeje e mora reumatizmin. — U largua si veças nga të tjerët, foli:

— Kuadra e dytë të rreshtohet këtu. — Ngaqë nuk e shqiptonte dot germën «s» Refati, partizanët buzëqeshnin sa herë komandonte.

— U pregatit lundra; u rreshtuan njerëzit. Refati qëndronte në ballë të lundrës në këmbë dhe vështronte përpara. Kudo errësirë. Në ballin e lundrës goditnin dallgët. Lëkundej lundra, lëkundej edhe Refati.

1) pohë-a = rrjetë.

- Gati, Refat? — e pyeti komandanti i kompanisë.
- Gati!
- Sa njerëz hipën në lundër?
- E tërë skuadra.
- Jo, vetëm katër do të kaloni kësaj radhe.
- ...
- Cilin mitralier ke marrë?
- Manolin!
- Di not ai?
- Zhaba janë të gjithë, mos kini merak.
- Shumë mirë, ki kujdes!
- More gjermanit si t'ja bëj, pa Vjosën e njoh unë, i njoh dhëmbë e dhëmballë kësaj katraneje.
- Lundra përsëri u zbraz. Refati mori vetëm tre partizanë.

U zgjidh lundra nga trangu i rrapit të madh ku qe lidhur, dhe me rrëmbim u shkëput nga toka. Refati e shtrëngoi fort drurin e gjatë, që në lundrat bën po atë punë që bën timoni në anije. Sa më i shkathët të jetë lundërtari, aq më mirë di ta drejtojë lundrën nëpërmjet asaj ushte të gjatë disa metra. Rrotulla e lundrës rrëshqiti mbi telin, që ishte hedhur kryq mbi lumë. Rryma e shtyu lundrën midis lumit. Dallgët e goditën fort dhe e anuan në krah. Goditja qe tronditëse... Dallgë e ujë mbi lundër Refati zuri me të dy duart telin dhe mbahej fort e vështronte shokët. Ata të tre për pak i rrëmbeu vala.

Refati, midis valëve, bërtiste:

- Bobo, ky qenka më gjerman se ai gjermani tjetër!

KAPITULLI I GJASHTË

*Dil, nënë, të shikosh jashtë,
Si lufton Brigad' e gjashtë;
Dil shiko këta të djallit,
këto kalbësirat e Ballit.*

Populli

1

Natë... Errësirë.

— Të presim, — tha njëri — do të bjerë lumi.

— S'na besohet — ja priti një tjetër. — Pse, ç'është Vjosa, përrua? Ujët nga burimi mëmë bën disa ditë rrugë gjersa vjen këtu.

Të gjithë shfaqnin nga një mendim, vetëm Refat Arapi qëndronte me nofulla të kyçura dhe bluante fjalë me vete: «Eh, ç'na rrëmbeu ashtu ajo e shkretë valë, si lubi na thithi!»

Kolona partizane priste në breg të lumit.

— Sos ishte Trebeshina a Tomorri e nuk e kaluam, mor, edhe mali më i lartë në botë të qe, do të ngjiteshim në të. Po ky? A kalohet deti me not? — tha një partizan.

— Kalohet, shok, kalohet — ja preu bisedën Manoli.

— Kalohet?... — Partizani kërkoi me sy atë që kishte folur, po pa vetëm siluetën e tij, që po largohej.

— Vetëm këtij lumi i trembem. Plumbit jo, ujit po. Që i vogël u jam trembur lumenjve. S'jemi ne si këta të fshatrave anës Vjosës. Ata notojnë në ujë si rosakët, e presin Vjosën kryq e tërthor ndërsa ne dimë të shkelim vetëm gërxhet e malet.

— Shumë mendje shet, djalo, rri, a lumëzi!

Refatin e lëndonte në zemër çdo fjalë; ai shtrëngonte nofullat e grushtet dhe heshtte.

— Hej, ç'qe bërë Vjosa! Megjithatë, Refati u ngjit së dyti fill i vetëm në lundër, e lëshoi atë midis dallgëve dhe arriti në bregun tjetër. Kur doli në anën tjetër të lumit, ndjeu më shumë forcë në trup, po e ktheu lundrën me rrëmbim në anën tjetër, dukej sikur e kishte mposhtur forcën e lumit dhe, pasi u njoh kështu me rrymën e ujit, ai mori guxim dhe herën e dytë e mbushi lundrën me partizanët.

Nata mbeti gjithnjë pus e thellë, po lundra doli shumë herë në breg. Pastaj brigada u vu në marshim, shkante drejt Tepelenës.

2

— Hapuni, djema, zini vendet! — urdhëroi Goliku. Partizanët e brigadës kaluan me rrëmbim urën e lumit të Bënçës dhe u përhapën në formacion luftimi.

Përsëri filloi të binte shi i përzier me borë, frynte erë dhe buçiste lumi. Ishte errësirë. Megjithatë, nga vendi ku dolën Vogli dhe Goliku, shikohej qyteti i vogël, silueta e kështjellës dhe tej Vjosa, e konturet e maleve.

Shtabi i brigadës diskutonte.

— Të ruhemi nga krahët. Kjo të bëhet para se të fillojmë sulmin. Është mirë që ta minojmë rrugën.

— E ke fjalën për gjermanët?

— ...

— Po këtyre, që kemi në krahë dhe në shpinë, si do t'ua bëjmë? Ndodhemi midis tyre. Them i ne që rrethuan Tepelenën, por pse të mos thonë dhe ata që na kanë rrethuar? Kudo kanë forca. Ta mendojmë më mirë

këtë punë. Ndoshta do të qe më mirë të godasim forcat që janë në Bëncë.

— Dëgjo, Golik, — i tha Vogli — po u godit Tepelena, të tjerët, pa arritur lajmi, do t'ja mbathin. Rëndësi të veçantë ka që të godasim sonte pikërisht këtu, në Tepelenë. Po ama të godasim ashtu siç duhet.

— Për atë mos u bëj merak, e di unë se ku e ka havalenë kjo kështjellë.

— Atëhere asgjë tjetër nuk duhet të na shmangë nga goditja e qytetit. Kjo goditje ka rëndësi të veçantë.

— Pastaj? Si i bëhet pastaj? — pyeti Goliku.

— Godasim dhe tërhiqemi. Në qytet e në kala s'kemi pse të mbyllemi. Këmbën e vezirit s'kemi pse ta zëmë! Brigadën e presin detyra të tjera.

Golikut i erdhi për të qeshur, i pëlqyen fjalët gjithë sarkazmë të Voglit e heshti. Bluante në mendje planin. Ndërkaq forcat e brigadës e rrethuan qytetin nga të gjitha anët.

Goliku pyet:

— I vendosën minat në xhade?

— U zu ura e Bëncës?

— Po mitralozat e rëndë u ngjitën te kodra mbi qytet? Po...

Pastaj sodiste kështjellën dhe i kujtohej viti njëzet. Atëhere Goliku ishte djalë i ri, por edhe ai kishte marrë pjesë me trimat e Selam Musait, që patën sulmuar regjimentin italian në Tepelenë. «Ishte behar atëhere» i kishte shpjeguar Voglit rrugës. «Lufta zgjati disa ditë. U premë ujët dhe ngordhën brenda si miu. U dorëzuan, po nuk i prishëm, u hoqëm armët dhe i nisëm nga deti. «Këputni qafën!» u thamë. «Deti ju nxorri, deti t'ju mbështjellë». I falëm.

— Nuk e ka zakon shqiptari të përzihet në mish të pëgërë — na tha Selami i Salarisë dhe... Po, i falëm.

I mbështetur pas një ledhi, Goliku vështronte qytetin dhe kështjellën. Bisedonte ndonjë fjalë me Voglin, thërriste komandantët dhe u caktonte detyra.

Një skuadër mori detyrë të hynte brenda mureve

të kalasë. Komandant i këtij grupi u caktua komunisti Dardan Veliu; mitralier, Manoli. Vogli dhe Goliku e thirrën Dardanin dhe ja sqaruan hollësisht detyrën.

Filloi sulmi.

Nuk u hodhën nga shtabi i brigadës as fishekndriçues. nuk u dhanë sinjale me bori, as pushkë nuk u zbrazën. Kështu dha urdhër Vogli dhe Goliku. Ashtu u bë.

U ngritën në sulm, i shkuan më afër qytetit, më afër kalasë. Pritej vetëm një pushkë të zbrazej nga rojet dhe të fillonin. . . Po rojet e armikut s'po ndiheshin.

3

Në kohën që brigada partizane e kishte rrethuar qytetin, komandantin e mercenarëve, Axhem Belulin, sapo e zuri gjumi. Komandën e tij e kishte në një ndërtesë, brenda mureve të kalasë. Gjatë natës, në atë shtëpi, që bërë muhabet i gjatë. Më shumë e mernte fjalën Axhem Beluli. «Gjenerali gjerman është betuar që do t'ua vërë këmbët të kuqve, në një opingë. . . Po kur luftojnë, sulmojnë? . . . De, mor, de! Dale një çikë, prit ku të çon mushka. Maten me hijen e mëngjezit. I dalin në prita gjermanit. . . Po i dilet përpara ushtarit të Hitlerit?!»

— Qafën do thyejnë, zoti Axhem.

— E thyen qafën që në këtë operacion. U humbi fara. Mirë tha gjenerali gjerman. Burrë me mend në kokë ishte. E dëgjuat se ç'tha?

— Jo! — thanë ata që ishin rreth sofrës.

— U duhet qëndruar me çekan kokës të kuqve — këtë tha.

— Ashtu, ashtu! — ja ushqyen mendimin të tjerët Axhem Belulit.

— Fjalët e njeriut, zoti Axhem. janë masa e mendjes së tij — ndërhyri njëri nga krerët e çetave.

— Hë, ti ishe kur kaloi këtu me autobлиндë gjenerali, e dëgjove vetë.

Tjetri tundi kokën. Vuri dorën në gjoks. . .

— Dha urdhër gjenerali që batalioni i majorit Diter

Grebner të vinte i tëri në Tepelenë. Ka rëndësi ky vend, kjo kala. S'më pëlqen ky majori. I ka dhënë urdhër të jetë këtu dhe ende s'ka arritur. Ka lënë një kompani ushtarësh dhe... — Axhem Beluli i gënjente, se gjoja gjenerali i kishte dhënë urdhër majorit Diter Grebner të përqëndronte forcat e tij kryesisht në drejtim të Mallakastrës, asaj ane që qëndronte edhe beu Margush, komandanti që mbante lidhje me qeverinë kuislinge në Tiranë.

— Kushedi ç'ka ndodhur, nuk shtrohet aq lehtë Mallakastra — i tha njëri nga ballistët.

— Ai koloneli, që u ngjit në regjimentin e tij grykës së Bënçës dhe doli në Kurvelesh, qe për këtu. Atij, pa frikë, mund t'ja besojë kështjellën. Kushedi se ku ndodhen sonte forcat e tij.

— Kur janë ushtarët maleve, edhe ne ndryshe e ndjejmë veten, apo jo, zoti Axhem?

Do të formonin në Tepelenë një batalion tjetër.

Ishin duke pirë raki e duke ngrënë mish të pjekur, kur njëri nga ballistët foli:

— Zoti Axhem, duhet t'i vëmë një emër batalionit.

Axhem Beluli i rrëmben me sy njerëzit rreth sofrës.

— Mirë e ka, posi, të ketë një emër. Pse jo? — u thotë. Ja nisën propozimet:

— «Selam Musai!» ta quajmë.

— Jo, atë emër e kanë të kuqtë.

— «Çerçiz Topulli».

— Edhe atë emër e ka një çetë e tyre.

— «Avni Rustemi».

— Edhe atë e kanë të k... — nuk e mbaroi fjalën. U ndje si i këputur ai që fliste dhe në një çast tha tre-katër emra përnjëherësh: — Hajredin Tremishti, Toto Bolena, Koto Hoxhi... Të tjerët heshtën. Nga fytyra e tyre ai kuptoi që edhe ata emra i kishin po të kuqtë.

— Pse vrisni mendjen? — u hodh një, që ishte pirë e bërë tapë. — E di unë ç'emër do të ketë batalioni ynë. Më tregoni kur do të rreshtohemi.

— Nesër. Edhe tri orë na mbetën. Ç'do bëjmë këto

tri orë? Të flemë, apo të mendojmë për emrin e batalionit?

— Mos u merakosni për emrin — belbëzonte ballisti.

— Hë, more qite nga goja!

— «Ali Pashë» të quhet.

— Të lumtë, o Felek, i ke rënë në kokë. Po vetëm «Pashë» t'i lëmë — tha beu që mbante mbiemrin e një oxhaku të rrënuar në Kardhiq dhe vazhdoi: — Të kujtojmë pashallarët, që zotëruan në këto kështjella anës-Vjosës, që na mbledhin e na mbrojnë nga harbutët e kuq, që mbuluan dynjanë. Po, po! Të pimë për pashallarët, që ngritën këto kështjella nga Gjirokastra gjer në derdhjen e Vjosës në det. Hajde, o trima, — thirri Axhem Beluli — çukitni gotat:

— Të pimë për pashallarët!

— Edhe për bejlerët. Edhe për babë Hitlerin të pimë, — tha një nga krerët e Ballit që, duke shqyer me dorë një shpatull dashi, ju drejtua komandantit:

— Mirë e ka thënë një filozof, o zoti Axhem, fjalën e mençur e thotë ose budallai, ose i marri. — Axhem Belulit i shkoi goja te veshi nga të qeshurit, pastaj rrëmbëu prapë gotën.

— Edhe një herë tjetër! Hajde me fund dhe të biem, se nesër do të kemi punë. Pastaj një këngë e shtruar dhe një iso e zvarur.

Kur Axhem Beluli ra në shtrat dhe një nga «ushtarët» e tij uli dritën e llambës, përjashta, në hyrje të qytetit, partizanët i zunë rojet e tij pa çak e pa bam. I shkuan më afër kështjellës dhe hynë në shtëpitë e para të qytetit. Kudo ata vrapojnë e sulmojnë! Po ky ishte një sulm i heshtur. Asnjë krismë. Kështjella ngjan sikur është në gjumë të thellë. Përpara çdo partizani shfaqen shtëpitë, rrugët e ngushta të qytetit dhe muret e trasha, muret e zeza të kështjellës hijerëndë. I afroreshin më shumë armikut. U mpiheshin nga era faqet e duart. Çdo minutë ata ndodheshin më afër themeleve të kështjellës. Të shqetësuar, pyesnin:

— Kur do të fillojë?

Ishin mësuar me krisma.

Mbas një kohe të gjatë, Dardan Veliu do ta shikonte përsëri vendlindjen e tij. Edhe kur je në luftë, në vendin tënd, sikur e ndjen veten më ndryshe, më të fortë, ndaj Dardani shkonte drejt kështjellës së Tepelenës i bindur se do të plotësonte me sukses detyrën. Në fillim ndoqi një rrugicë, pastaj i ra mes për mes arës. U zvarritën këmbadoraz që të mos zbuloheshin nga armiku. Në këtë arë ai kishte filluar të njihte botën, kishte punuar me kazmë e me bel, pastaj këtu për të parën herë, kur ende qe fëmijë, ishte përkulur në bishtin e parmendës. Kishte thithur vlagën e dheut të saj. Kështu kishte kaluar jeta e Dardanit, gjersa kishte dalë malit... Megjithëse e donte shumë këtë arë, brazdat dhe vlagën e dheut, një vit më parë kishte ikur... Shkoi të luftonte. Dardani rrëshqiste tani në arën e vogël dhe shkonte drejt vendit ku ndodhej shtëpia e tij. Toka kishte mbetur djerrë. Mbi brazdat e tokës së tij shkelte çizmja e të huajit, kalonin armiqtë. Sa shumë i donte brazdat, sa shumë i donte lulet... Që kur ishte i vogël, ai luante e këndonte në këto vende. Ndërsa tani atje shikonte vetëm skelete muresh, që nxinin nga nata si fantazma e të futnin frikën në trup. U ndal dhe e treti vështrimin në ato vende ku lozte në vegjëli. Edhe rrugicat, edhe ndërtesat i dukeshin ndryshe. Edhe jeta i dukej sikur ishte shuar në vendlindjen e tij. Instinktivisht ai rrëshqiti përpara drejt një ndërtese. Ishte shtëpia ku lindi dhe u rrit. Bashkë me të lëvizën edhe të tjerët.

Duke u ruajtur që të mos shikoheshin nga armiqtë, me pushkët në duar gati për zjarr, ata u hodhën gjer te ndërtesa. Atje u ndalën dhe vështruan përsëri vendin ku do të kalonin. Rruga ishte e lirë, por Dardan Veliu, i mbështetur në anën e ledhit, qëndroi disa minuta, siç mbetet i shtangur njeriu, kur mëson një gjëmë, që ka ndodhur. Ai vetëm atë çast po mësonte që shtëpia i qe rrëzuar, plevicat ishin djegur, pemët ishin prerë. Pshëretiu:

— E paskan përmbysur nga themeli. Po njerëzit? Ku do të jenë vallë nëna dhe motrat? — Dhe i hodhi sytë nga malet. Kishte ëndërruar ditën që do të kthehej në shtëpi. Sa do të gëzoheshin motrat! Ato do ta veshtronin në dritën e syrit vëllanë e vetëm. «Nëna... Ah, e shkreta nënë!» murmuriti. Na ka rritur me njëmijë halle. Ku do të jenë tani, ku? Në cilin mal, në cilën shpellë?» Sikur të qe ndryshe, tani nëna do ta mbështillte në gji birin e saj, do t'i përkëdhelte supet me gishtat e plasarisur, do t'i lëmonte plagët e do t'i thoshte:

«Bir, sa m'u rrite! Ruaju, biro, ki kujdes!» Ndërsa Dardani do të qeshte, do ta merrte në duar e do ta rrotullonte. Ajo, buzëplasura nënë, që e kishte rritur me halle e derte, do të gëzohej që djali i ishte rritur, ishte bërë trim azgan e i dëgjuar.

Ato minuta ai ndjeu në gjoks atë mundim, që ndjen njeriu, kur i mungon ajri. Gërmadha... Kudo gërmadha. I dukej sikur jeta kishte vdekur, e kishte vvarë i huajt. I rrihnin fort tamthat e shtrëngonte grushtet. U kujtua që në krahë kishte Bukurinë. Bëri t'i thoshte një fjalë, po heshti...

«Sido që të bëjnë, nuk e vrasin dot jetën nazistët» mendoi Dardani. I kujtohej dita kur në atë shtëpi, gjash-tëmbëdhjetë djem të qytetit në vitin dyzet e dy, i kishte mbledhur Marengleni, që kishte hyrë ilegalisht në qytet dhe kishin biseduar për luftën, një ditë e një natë. Në fund ata qenë betuar. Ishte betuar dhe Dardani: «Do të luftoj deri në pikën e fundit të gjakut që Shqipëria të çlirohet nga të huajt, që populli të heqë qafe zgjedhën e beut e të zengjinit» kishte thënë.

Nëna e kishte dëgjuar të birin e ishte zbehur në fytyrë. Jashtë shtëpisë endeshin milicë e ushtarë fashistë italian, por Dardan Veliu e ngriti zërin dhe tha: «Më marrshin në zemër plumbat e këtyre armëve, në qoftë se do të tradhëtoj fjalët, që them!...»

«Po nëna, ku mund të jetë nëna e motrat?» mendonte.

Sulmi i heshtur drejt qytetit vazhdonte. Errësira e natës e fshihte të gjitha veprimet e brigadës partizane.

— U zunë në lagjen Dragot të qytetit gjashtëdhjetë robër, që u dorëzuan pa çak e pa bamb.

— Ju thashë, — tha Refat Arapi — si mall s'janë gjë, si numër. . .

— Po të tjerët? Ku do të jenë krerët e tyre? Ç'pozicion mbrojnë nazistët gjermanë?

— Po ti, more Meko Elmazi, ç'dreq të bëri me këta?

— Mua. . .

— Si, ç'më thua, more, në shtëpinë tuaj edhe fëmijët janë me partinë, kurse ti na qenke bërë me dreqin. Hë, për atë yll sabahu, je për të shkuar në plumb.

— Më muarën me forcë, xha Refat.

— Të ikje!

E uli kokën sikur ta kishin goditur me diçka të rëndë.

— Sa ditë ke këtu?

— Tri ditë!

— Ç'është ky? — pyeti Goliku?

— Vëllai i një partizani, bir i një shtëpie, që edhe meçujtë i ka me ne. Dhe ku? . . .

Mekua donte të shpjegonte se si e ku kishte ndodhur, se ai s'qe i tillë, por. . . Golikut aty për aty i lindi një mendim.

— Mund të na ndihmosh? — ndërhyri Goliku.

— Jam gati për çdo gjë.

— I jepni pushkën dhe gjerdanin. Vëri bombat në mes!

— Ashtu, gati!

— Ku do të shkoj?

— Në krye të kësaj skuadre, të shkosh para tyre t'u japësh parullën rojeve, t'u thuash se ke një lajm me rëndësi për zotin Axhem dhe për oficerin gjerman. Pas-taj, kur të kalohet porta, na mëson puna. Dakord?

— . . .

— Ja, këta do të vijnë me ty.

Dardani dhe Mekua i shtrënguan dorë njëri-tjetrit dhe u nisën. . .

Kaluan në krah të një shtëpie të lartë e të rrethuar me avlli, që ndodhej në anën e sipërmë të qytetit, mbi xhade.

— Është shtëpia e Axhem beut — thotë Mekua.

— Me gjermanët është beu?

— Në shtëpinë e tij ka ushtarë. Ai vetë është në krye të atyre të kështjellës.

— Të kalojmë anash — i tha Dardani.

Shtabi dërgoi forca të tjera për ta rrethuar shtëpinë. Ishte e vetmja shtëpi, jashtë kalasë, që ishte e padjegur nga zjarri. Në afërsi të rrapit, pranë kalasë, dëgjoheshin çapet e partizanëve, po ende nuk po u dallohej fytyra e veshja, se ishte akoma muguëtirë.

— Ndal! Ndal! — folën rojet në hyrje të kalasë.

— Ç'do! — i foli Mekua. — Jemi nga tanët.

— Parullën!

— Pse flet aq fort? — ndërhyri Dardani.

— Parullën të them!

— Pse flet me zë të lartë? Për kë e do parullën, për vete, apo që ta dëgjojnë dhe të kuqtë?! Pusho, ore!

— Parullën! — klithi përsëri roja.

— «Meli» — i tha Mekua. Dardani nuk fliste.

— Afrohu! — Roja u zbut dhe e uli armën.

Mekua e partizanët u afruan më pranë.

— Kundërparullën.

— ...

— Kundërparullën! — tha Mekua.

— Melhemi! — u përgjegjën rojet. Pastaj u dëgjua zhurma e lëvizjes së skuadrës partizane që kaloi nën qemeret e portës së kështjellës.

Refati po vështronte me vëmendje nga larg skuadrën partizane, që po hynte në kala qetësisht. — I mba zemra Dardanit, uh, të isha unë flakë, do ta ndizja që te porta.

Si e shtinë dhe këtë objekt të rëndësishëm në dorë, sulmuesit u drejtuan nga dy hyrje të tjera. Këto, dhe vetëm këto hyrje hapnin shteg drejt kështjellës. Duke ndërtuar disa porta, kështjella në të vërtetë kishte fituar

stoli, por kishte humbur forcën. Në një vend zotërues midis kështjellës doli si nga thellësia e tokës Dardan Veliu me shokët e tij dhe ngriti mitralozin. Në atë vend ai e ndjeu veten zot të kështjellës.

U ngrit që jashtë mureve në sulm Refat Arapi. Por, si nuk gjeti qëndresë përpara, pyeti habitshëm:

— I kemi brenda, apo mos na gënjeu ai qeni, që zumë rob?

Pa e mbaruar fjalën Refat Arapi, plasi pushka. Në fillim u këmbyen disa pushkë, pastaj zëra e pushkë qoshe më qoshe të qytetit. Kudo në muret e kalasë flakë pushke e mitralozi. Sytë e Refat Arapit u mbërthyen në hyrjen kryesore. Andej, një ballist, që ende mbante teshat e milicit të Duçes, vraponte nga porta... Dollaku i këmbës së djathtë i hiqej zvarrë. Ai zbrazti armën e u ndal. Me një gjest nervozizmi e shkuli dollakun, e vërtiti tej pas murit të kështjellës dhe, si rimbushi armën, u hodh drejt hyrjes së saj. Kërkonte të zinte hyrjen. Po në atë rrugë ai dhe shokët e tij, të gëzuar, kur kishin parë t'u ngjiteshin maleve batalione e regjimente me ushtarë nazistë, në kohën që kishte kaluar në Tepelenë gjenerali Gajb, kishin kënduar me mburrje:

«T'u biem të kuqe!

T'i djegim komunistët!

T'i vrasim komunistët!»

— Hë! — qeshte Goliku, që duke parë mercenarin, thoshte: «Ama të rënë që u bëtë? Dale, ore dale» dhe flakë i nxirrte gryka e armës, u sul drejt kalasë. Edhe Vogli ndodhej aty, midis partizanëve. Gjithmonë në kohë pushimi ose kur brigada ishte në marshim, Vogli gjente kënaqësi të veçantë të bisedonte me ndonjë partizan të thjeshtë, ngandonjëherë për orë me radhë. Nuk rreshtte së hetuari në thellësi mendjen e bashkëfolësit dhe, kur bindej, s'ngurronte aspak që të rekomandonte aty për aty futjen në parti të një luftëtari trim e besnik. Por këtu, në vijat e para të luftës, zëvendëskomisari i brigadës

dukej një njeri krejt tjetër. Ai i shprehte mendimet e tij në mënyrë fare lakonike, duke e shikuar bashkëfolësin drejt në sy nga afër dhe pa bërë asnjë gjest. Njerëzit hidheshin në sulm, shkonin përpara midis plumbave e predhave; këtë lloj gjuhe e kuptonin më mirë. Dëgjohej thirrja: «Para, partizanë!» Vogli e njohu zërin e Refatit dhe shkoi dhe ai drejt mureve të kështjellës, duke qëlluar me automatik. Në kala hidheshin bombat e dorës, me-reshin një e nga një pozicionet e armikut.

Këmbeheshin brenda mureve të kështjellës plumba dhe bomba. Zëri i Golikut gjëmonte. Disa nga ballistët, që ishin në pozicion e njohën dhe qëlluan mbi të, por komandant Goliku zuri vend dhe s'kishin ç'ti bënin plumbat e tyre.

— Të njohën, xha Jaho — i tha Goliku zëvendës-komisari i brigadës.

Plumbat godisnin vazhdimisht ledhin ku kishin zënë pozicion Vogli dhe Goliku, pastaj, si nuk u përgjegj asnjë armë nga ai pozicion, ballistët i prenë të shtënat. Fill pas kësaj, në dritaret e shtëpisë qenë përgatitur për zjarr shumë pushkë, kishin marrë shenjë dhe pastaj njëri nga mercenarët kishte folur me zë të lartë:

— Dil sheshit të luftojmë si burrat, o kaçaku Golik, ç'më je tulatur si mi, ngreu, apo s'ta...

Komandant Goliku nuk e mbajti dot veten, si ju shkapërcyen sytë, i dha trupit të ngrihej, deshte të dilte e të këmbenin flakët e pushkëve me njëri-tjetrin me atë që foli, por Vogli e uli nga palltua.

— Nuk duhet, — tha Vogli — ata ta njohin mirë karakterin dhe ndaj të provokojnë.

— Të poshtërit... — Goliku s'trëngonte grushtat, vështronte rreth. Përsëri tha po atë fjalë: «Të poshtërit!» Heshtje...

— Dil, more pusht i maleve, nxirre kokën — thirri përsëri mercenari.

Përgjegjen ja dha automatiku i Voglit.

— S'ta mban, o komunist, dil! Dil në mejdan!

Golikut i dhembte koka, i kërcyen damarët në ballë,

që hidhnin, se mos nga muret i merrte në shenjë pushka; më në fund arritën në hyrjen e kështjellës. Në këtë vend Vocos ju dukën muret më hijerënda.

— Këtu qëndrojmë, Voco!

— ...

— Ki kujdes, hapi sytë, bir i xhaxhait!

Partizani i vogël vështronte. Kishin arritur në portën, që dilte nga ana e lumit. Sapo dolën aty, mjegulla e hollë, që vinte grykës, fshehu anën e kështjellës dhe u pengonte pamjen. Mjegulla bëhej përherë e më e dendur, më e ngjeshur, më e errët. Nëpërmjet kësaj shtrese të dendur, që dilte nga avujt e lumit, Vocos i dukej kalaja si një përbindsh me njëqind sy. Porta, kullat e rojeve, frengjitë e pushkëve, muret e drejta, të trasha, të ftohta e të zeza, çdo gjë përreth qe ndërtuar në atë mënyrë që njeriut, që i afrohej kështjellës, t'i shtinte në trup vetëm frikën. Refat Arapi qëndroi në çast dhe dëgjonte, mundohet që nëpërmjet krismave e flakëve të armëve të dallonte ku qenë forcat e brigadës. Dhe, ai dinte të orientohet nga këto krisma si ata barinj të motshëm, që vrojtonin motin gjatë verës për të përcaktuar se në cilin muaj të dimrit do të bënte më ftohtë.

— Shkojmë pak më përpara? — i tha pionierit.

Lëvizën të dy me kujdes. Po sikur në atë kullë, në ato porta, të ishte ndonjë mitraloz armik?

Kur u ngjiten në vendet e rojeve, në portën që dilte nga kështjella në Vjosë, ata të dy u ndalën. Brigada kishte hyrë në kështjellë. Luftimet bëheshin në lagjen brenda kështjellës.

Refati, sapo u mbështet te muri, te kolibja e rojes në hyrje të kështjellës, ndjeu të ftohtët e gurit. Ishte koha kur brenda mureve u bënë më të dendura krismat. Kundrejt tij zuri vend Vocua. Në përgjim e sipër xha Refati filloi të mendonte e të qortonte vetëveten: «Kokëkrisur isha dhe i tillë mbeta. Ku i ke shokët e skuadrës, or qyq? Si ikën kështu si plumb i shurdhër, ku shkon? Kanë të drejtë që më kritikojnë, por huqet mbeten huqe për njerëzit dhe qenka shumë zor t'i flakësh tutje. Po

kjo pikë e zezë, mbaro një luftim e Refat Arapi duhet të bëjë autokritikë dhe pse? Hë de, këtë kush ma thotë.» Ju bë sikur dëgjoi zërat e shokëve e shoqeve: «Edhe komisarit të brigadës i është dashur të punojë me ju, ke nevojë, Refat Arapi, të njohësh më mirë atë që duhet të bësh, mos harro se fakti që sulmon në vijën e parë nuk të shkarkon nga detyra si komandant skuadre». Pastaj nisi të thoshte për shokët e tij: «Pse nuk më morën pas, pse të mos shikonin që unë ndoqa anën e jashtme të mureve të kështjellës, por shkuan andej?» Këto fjalët e fundit i dëgjoi edhe Vocua.

— Dil, more bir, shiko një herë mos janë duke ardhur.

Vocua shkoi deri në dalje të kështjellës dhe u kthye përsëri në vendin ku ishte pa folur. Refati e mori me mend që djaloshi s'kishte parë njeri, ndaj rrudhi ballin dhe psherëtiu. Ai tha sërish: «Huqet është zor t'i flakësh tutje, shumë zor!»

Vocua ktheu kokën që të shikonte ndër sy Refatin dhe desh t'i thoshte: «Pse të rrimë kot në këtë vend? Të ecim më përpara». U drojt e nuk i tha gjë, se pandehte se Refati ishte bërë xhind që edhe kësaj radhe kishte bërë po të njëjtin gabim dhe nuk do ta dëgjonte. Dhe ja, veshi i Vocos atë çast kapi një zhurmë.

— Dëgjoj zhurmë, xha Refat!

U panë siluetat e tre njerëzve, u dëgjuan zëra. Refati e hoqi pas djaloshin dhe e fshehën trupin në hijen e murit. Hijet që iknin të trembura nga flakët e pushkëve u afruan.

— Po këta ç'do jenë?

Hijet e zeza erdhën më afër. Vocua bëri gati armën.

Ato hije nuk guxonin tani të dilnin nga porta e madhe, mbi të cilën ishte shkruar viti i ngritjes së kësaj kështjelle. Përrjashta mureve përgjonte pushka partizane. Për ku drejtoheshin pra, ata tre njerëz, që ecnin me aq nxitim?

Në kështjellë ka dalje sekrete. Këtë e dinte njëri nga ata. Dalja më e largët arrinte deri në buzën e lumit.

Ajo niste aty në portën e madhe nga kështjella, që priste dhe përcillte që nga lashtësia mysafirë të shquar.

Njëra pas tjetrës të trija ato hije mbërritën deri në një kënd të crrët të kështjellës.

— Dre, — tha Refat Arapi — u qenka bërë ujët e trashë më i hollë se të hollët! Ku gremisen kështu?! Refati dhe Vocua thirrën të dy njëherësh me zë të lartë:

— Ndal!

— Ndal! — jehuan muret e kështjellës.

Hijet e zeza kapërcyen në gardh dhe u zhdukën prapa një ndërtese.

— Na ikën, o Voco! — tha Refati dhe të dy u ngri-tën nga vendi.

Atë kohë gjëmuan disa bomba, që u hodhën brenda në kështjellë nga partizanët.

Refati e Vocua i ndoqën prapa hijet e zeza. Ishin dy gjermanë dhe një ballist, që iknin në pikë të vrapit.

Hijet e zeza hynë në një haur të gjatë si stallë. Partizanët zunë derën dhe po përgjonin. Ende ishte errësirë. Koha po rëndohej më shumë nga retë, errësira shtohej edhe më shumë.

— Voco!

— Urdhëro!

— Unë po sillem një herë rrotull këtij hauri, mos ka ndonjë dalje tjetër dhe na ikin. Ti rri këtu. Mos ki frikë, hë, bir i xhaxhait?

— Unë? Hiç mos u bëj merak. Tani edhe më të fortit prej tyre kam borxh t'ja numëroj në ballë, vetëm më thuaj ç'të bëj.

Refat Arapit ju bë qejfi. I pëlqeu vrulli, guximi dhe besimi i djaloshit.

— Ki kujdes, Voco! — i tha. — Ki kujdes se mos të dalin, ki kujdes, bir! — i tha me zë të ulët dhe u largua, ju soll rreth strehës e ledheve, duke u përkujdesur se mos dëgjonte fjalë e zhurmë. Më në fund u bind që ata ishin atje. Po pse heshtnin dhe nuk u përgjigjeshin thirrjeve të tij për t'u dorëzuar?

— Bam! — krisi paticka e Vocos. Diçka e zezë u

gjunjëzua dhe ra përpara partizanit, në oborr.

— Vrave ndonjë? — i foli nga larg Refati dhe mallëkoi veten që ishte larguar. Gati sa s'e këputi gjuhën së kafshuari nga marazi. Po ai që goditi Vocua u çua dhe vazhdoi të largohet edhe disa çapa më tej. Aty mbeti.

Hijet e zeza dolën nga dritarja në kopshtin e shtëpisë, vrapuan. Kujtuan se kishin shpëtuar, por Vocua i përgjonte dhe shtiu. Refati foli:

— Në rregull, Voco, shumë në rregull! — Tjetri, një ushtarak gjerman, ngriti duart dhe u dorëzua. Ballisti bëri të ikte, por, sa hodhi duart në mur, Refati i foli:

— Ndal aty, se të mbështeta për muri!

Refati ju afrua dhe i solli një herë rrotull grykën e armës, sikur donte të kërkonte zemrën e mercenarit, pastaj bëri disa çape përpara.

— Aman — ju lut mercenari.

— Uh, kush na qenka, Axhem Beluli, oj, oj! Po si të ranë kaq shpejt pendët, mor kokoshi Belu? Si u kaptandise kështu, o bej?

— Mos më prishni! — dridhej mercenari.

— Ikë, dreq!... S'e ndyj dorën me ty, ik gremisu! Gjyqi partizan do të të gjykojë. Plumbi të pret...

7

Kujt i ka rënë rasti të vizitojë kështjellën e Tepele-nës, mund të jetë çuditur, kur ka vënë re brenda saj një kështjellë tjetër të tipit bizantin, një kështjellë me të njëjtën formë si kalaja e madhe. Ajo është mijëvjeçare, por ende e padëmtuar. Në krah të kësaj kështjelle të vogël e të lashtë ishte një shtëpi e madhe dykatëshe ku qe vendosur shtabi i Axhem Belulit. Sapo krisi pushka, ata dolën andej, por mitralozët e rëndë, të vendosur në kodrën mbi qytet, i goditën rrugët me plumba. Të dy skuadrat partizane, që ishin brenda mureve të kështjellës, e përqëndruan zjarrin në atë vend. Në radhët e armikut filloi çoroditja.

Axhem Beluli dhe komandanti gjerman kishin men-

duar që luftimet do të zhvilloheshin në qytet ose rreth tij. Në fund, ato mund të bëheshin në afërsi të kështjellës. E, në fund fare, ata kishin menduar të mbaheshin në kështjellën e vogël brenda kështjellës së madhe. Atje do të luftonin gjersa t'u vinin në ndihmë tankset e auto-blindat e gjeneralit Gajb. Por goditjet, që u dhanë njëherësh e kudo në befasi, i detyruan të largoheshin, të braktisnin luftën. Mitralozat, që kishin vendosur aty në kështjellë, hapnin zjarr, prisnin të vinte atje Axhem Beluli dhe kapiteni gjerman, po ata kishin rënë rob. Një nga ata mitralozat u nxori telashe partizanëve.

— Hidhni atje disa predha mortaje! — dha urdhër Goliku.

Krisma... Tym... Predhat binin rreth, asnjë nuk binte në pozicion. Mitralozat godiste gjermadhat e qytetit, godiste në çdo vend.

— Sulm mbi ta, shokë! — Dardani u drejtua nga kështjella. U ngritën dhe të tjerët. Manoli i mbështeti me zjarr. Predhat e mortajës binin rreth kështjellës. Shpërthyen bombat e dorës. Pastaj u bë qetësi. Mbi murat e kështjellës, midis tymit Dardan Veliu, dhe partizanët e tjerë thërrisnin me zë të lartë.

— Fituam! Fituam!

8

Ajo ditë dimri i gjeti forcat e brigadës së re jo më në male, po në rrugën ku kalonin autoblanda e tankse, në njërin nga qytetet e Jugut, në Tepelenë.

Shumë regjimente me ushtarë gjermanë të gjeneralit Fon Gajb ende ndodheshin në male. Ishin në ndjekje, kërkonin andej brigadën partizane.

«Le të ngjiten maleve ushtarët gjermanë, le t'i kërkojë partizanët në male gjenerali nazist Fon Gajb. Ata gjenden kudo: në male, në fusha, në qytete. Brigada jonë partizane është e pamposhtur!» u tha shokëve Goliku.

Në kështjellën e lashtë qendrat e zjarrit ranë një e nga një. Kapen robër... Në çdo shtëpi duken flamuj të bardhë e dëgjohen zëra:

«Mos na prishni, jemi dorëzuar!»

Në qytet, te shtëpia e beut, ushtarët gjermanë s'po dorëzoheshin. Atje luftohej ende.

— Me bomba, qëlloni me bomba — dha urdhër Vogli dhe Goliku. Dhe shtëpia e beut mori flakë.

— Po në kala nuk paska nazistë gjermanë?

— Kanë ikur maleve; këtu kanë lënë këta miqtë, moj shoqja Bukuri; kanë lënë edhe nga të tyret. E dëgjon ç'bëhet në sarajin e beut? Edhe në kalanë e vogël qenë gjermanë, po Dardani i shkuli që andej me bomba.

— Si shumë u besuan ballistëve!

Ajo fliste dhe nuk po e vinte re ushtarin gjerman të goditur nga plumbat, shtrirë midis rrugës.

Një krismë automatiku. Bukuria ktheu kokën të shikonte. Partizani, që kishte shtënë, foli:

— Të vrau, moj, dhe për pak të vrau qelbaniku.

Ushtarit gjerman i ra revolveri nga dora. Plumbi i partizanit kishte goditur në shenjë.

Më tutje, nga dritarja e njërës nga shtëpitë, që ishin brenda mureve të kalasë, u zbraz një mitraloz tjetër gjerman. Dy partizanë u plagosën. Do ta kishin pasur pisk me këtë mitraloz, por plumbat që hodhi aty Dardan Veliu, e bënë mitralierin të heshte. Bukurisë i vinte mirë që trimat si Dardani ishin të rrallë, por edhe shqetësohej. Kaluan në rrugë dhe të tjerë robër. Midis tyre çapitej çalë-çalë edhe ndonjë ushtar gjerman i plagosur nga të batalionit të nazistit Diter Grebner.

— U ranë pendët dreqërve, mjaft u frynë si gjela deti...

Robërit shikonin me bisht të syrit. Ushtarët gjermanë shkonin andej nga qendra e Tepelenës, midis pazarit, ku grumbulloheshin robërit dhe rritej pirlu me armë.

Ishin pushkët e fundit, që binin në qytet. Edhe Vogli e Goliku po caktonin detyrat e fundit.

Nuk dëgjoheshin më atë kohë në qytet krisma lufte. Rrugët ishin mbushur me njerëz. Gëzoheshin që ishin çliaruar, përqafonin partizanët dhe këndonin:

*«Dil nëno, të shikosh jashtë
Si lufton Brigad' e gjashtë;
Dil shiko këta të djallit,
këto kalbësira të Ballit.»*

Në këtë kohë midis qytetit intendentit numëronte armët dhe shënonte në fletore.

— Prit, shoku intendent, ke edhe të tjera. Në pircun e armëve hidhen armë të tjera, në duart e kryetarëve të çetave balliste kishte zinxhirë. Axhem Beluli me sytë në dhe dridhej. Refat Arapi me zë të lartë thërriste:

— Në gjyq t'i kalojmë, në gjyqin tonë partizan!

KAPITULLI I SHTATË

«Del nga tyrbja e bardhë tyta e zezë e mitralozit. Ajo tytë nxjerr tym e flakë, godet shokët e mi...»

1

Lugina e ngrirë e Vjosës nën rrezet e ngrohta të diellit, dalëngadalë filloi të zbutej e të shkrinte. Mbi tokën e qullët zunë të rridhnin rreke uji. Dheu shkëlqente e avullonte. Pranverë!

Në një lëndinë, kundrejt malit të Trebeshinës në Këlcyrë, qenë mbledhur në kuvend mbi njëmijë burra.

Komisari i brigadës, Marengleni, u fliste. Të gjithë dëgjonin me vëmendje fjalën e tij. Kur fliste Marengleni, gjithmonë njerëzit që ishin pranë tij heshtnin, habiteshin me kthjelltësinë e fjalës së komisarit dhe vështronin sytë e tij të bukur, fytyrën e tij të gjallë, flokët e zes e të butë, mustaqet që e lezetonin dhe e burrëronin më shumë fytyrën e tij. Komisarit vazhdoi:

— Armiqtë, gjermanë e ballistë, kësaj here shpresonin të na gjunjëzonin. Erdhën me bujë të madhe, por ikën me bisht ndër shalë. Ne i goditëm, kudo i goditëm ashpër. Dhe tani gjithkund, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, kundërmësyemja e pranverës ka filluar. Ajo zhvillohet me sukses. Brigadat dhe batalionet partizanë, kudo, nga Jugu në Veri të atdheut, janë hedhur në sulm.

— Rroftë ushtria partizane!

— Rroftëëë! — jehoi zëri i burrave në pllajat e Trebeshinës. Marengleni fliste, ndërta djaloshi Zhul Fushbardhasi, që e vështronte me kujdes, i dukej se diku e kishte parë atë burrë.

Një burrë i moshuar u ngrit, u mbështet mbi shkop dhe foli: — E di, komisar, e di që ato fjalë që na thatë, ja, këtu në zemër m'u ngjitën. Fjalë si këto të kësaj partie nuk janë dëgjuar ndonjëherë. Janë fjalë të nxjerra nga plagët këto!

— Po si të mos zgjohemi ne, nipërit e atyre që kanë ngritur ato saraje sipër, mbi atë shkëmb? — Njerëzit hodhën sytë andej. — Ato saraje në shkëmb janë ngritur dhjetë, njëzet herë më të larta se kalibet tona. Edhe për Trebeshinën, edhe për fushën është lungë ai saraj, një lungë që than edhe erën e barit e të lules së malit, që thith djersën dhe gjakun e njerëzve, dhe ne, o bir, thaheshim e bëheshim kështu si ky gjoksi im, më i thatë se një kaptell samari — dhe goditi me grusht gjoksin.

Marengleni kapej shpesh pas fjalëve të njerëzve dhe bisedonte me ta për të shprehur mendimet e tij. Kjo e bënte më të gjallë bisedën e tij dhe më të kuptueshme, ndaj, pa mbaruar, fshatari i thotë atij:

— Ndaj partia kërkon që të zgjohemi, ne, bijtë e munduar të këtij dheu të vuajtur, kërkon të ndiheni të gjallë e të ngremë krye. Mjaft duruam! Durimi i shumtë e kalb njeriun, i than zemrën! Tani beut i kemi përmbysur vetëm sarajet. Mbi ato mure të zeza këndon kukuvajka, por fara e ligë s'është zhdukur, pushka dhe vetëm pushka partizane do ta shfarosë.

— Rrofsh, o komisar! Na thuaj ç'të bëjmë. Të vijnë partizanë? Po, kjo është lufta jonë, është partia jonë. Të gjithë jemi gati! — tha ai që foli.

— Gatii! — gumëzhitën zërat e njerëzve.

Pastaj heshtje. Kush do të ngrihej pas atyre burrave që kishin folur? Duke vështruar njerëzit, Marenglenin e tërhoqi fytyra e një djaloshi, që ishte më i riu në atë mbledhje. Sytë e komisarit i ngjanin djaloshit si dy bu-

rimet e kthjellëta, që dalin nga Dhëmbeli në grykën e Këlcyrës dhe që ruajnë gjithnjë pastërtinë, sado e turbulltë që të rrjedhë Vjosa. Djaloshi e ndjeu vështrimin ngulmues dhe ju duk sikur e përpinë ata sy. Fjalët, që sapo dëgjoji, i ndezën në zemër një dëshirë të flaktë që të hidhej menjëherë në sulm, prandaj thirri:

— Më shkruaj mua, shoko! — dhe tha emrin e mbiemrin.

Një e nga një të gjithë ata që mbanin pushkë regjistruan emrat. Kushdo që regjistrohej zinte vend në rresht. Në fillim atje doli djaloshi i ri Zhul Fushbardhasi, pastaj shumë të tjerë, dhjetë, pesëdhjetë, njëqind... Dhe lista gjithnjë shtohet.

* * *

Komisari i brigadës, i gëzuar nga ky sukses, u hoq veças e diçka shkroi në blokun e shënimeve. Pastaj korrerët i sollën postën. Ai i çeli me qetësi e interesim letrat. Lexonte dhe fytyra i ndriçohej nga gëzimi.

Shtabi i Përgjithshëm i shkruante shtabit të brigadës: «Përhëndesim në emrin tonë partizanët e partizanet, komandantët e komisarët e brigadës suaj për frymën e lartë të qëndresës, të vetëmohimit, në luftime, për goditjet e njëpasnjëshme, që brigada juaj e re u dha ushtarëve okupatorë dhe tradhëtarëve të Ballit dhe urojmë që brigada juaj të bëhet grusht çeliku për armiqtë dhe tradhëtarët dhe shpresë e madhe... për çlirimin e Shqipërisë!

Marengleni dha urdhër që të mblidhej brigada. «Duhet t'i dijë këto lajme çdo partizan e partizane» mendoi.

Gjer të mblidheshin partizanët, u ul mbi një gëmu-shë. Armën e mbështeti mbi gjunjë, sipas zakonisht dhe nxori urdhërin luftarak që brigada kishte marrë, lexoi:

«Të pastrohet krahina e Mallakastrës nga gjermano-ballistët... Të goditen çerdhet vitale të armikut».

Këtë letër ku caktohej detyra e veçantë, që i ngar-

kohej brigadës nga shoku Enver, Marengleni e kishte lexuar e rilexuar disa herë me radhë. Ai mundahej të deshifronte gjithshka që kërkohej në atë urdhër, të vlerësonte rëndësinë politike dhe ushtarake, që do të kishin këto goditje dhe bluante në mendje vendet se ku duhej të vepronte brigada.

Atë kohë ju paraqit Çeçua (kështu quhej korrieri i Marenglenit) që nderoi me grusht. Marengleni u ngrit nga vendi, u përshëndet me të, i hodhi dorën në sup dhe pastaj të dy u ulën pranë njëri-tjetrit që të bisedonin. Marengleni e pyeti Çeçon në kishte ndonjë vërejtje për detyrën që i qe dhënë për të vepruar si informator, në zonën e zënë nga armiku. Çeçua nuk tha asnjë fjalë. U ngritën. Për një çast vështruan njëri-tjetrin në sy. Edhe partizani edhe komisari i brigadës ndjenin atë që ndjente çdo njeri kur ndahet nga të afërmit e tij, nga shokët.

— Detyra është me përgjegjësi të madhe, — i tha më në fund Marengleni — por shtabi i brigadës ka besim se ti, si anëtar partie, do ta plotësosh me nder. Duhet punuar me shumë kujdes!

Çeçua mori drejtqëndrim, nderoi me grusht dhe u bë gati të nisej.

— Prit! — i tha komisari. — Do të kesh kujdes që të dalësh sapo të dëgjosh që brigada ndodhet në afërsi të kalasë së Margëllëcit. Ne, duhet medoemos të kemi njoftime të sakta mbi armikun. Batalioni i nazistit Diter Grebner thuhet që është vendosur në atë kështjellë, këtë ne duhet ta dimë para se të sulmojmë. Hëpërhë dimë që disa nënreparte i kanë tërhequr nga bregdeti dhe i kanë vendosur në brendësi; kanë mbirë në Mallakastër si këpurdha shumë garnizone të armikut. Kuptohet që ti duhet të na dërgosh sa më shumë lajme, por mos harro që si detyrë mbetet gjithnjë po ajo, të zbulosh gjithshka në Margëllëç e të na njoftosh. Më kupton? Ki kujdes Margush beun, dorë nuk duhet të vësh mbi të. — Këmbyen sërish një vështrim të shkurtër me njëri-tjetrin. Patizani nga Margëllëçi i kishte kuptuar mendimet e komisarit.

Manoli ishte partizani i parë, me të cilin i takoi të bisedonte për një kohë të gjatë partizanit të ri Zhul Fushbardhasi.

— Eja, o partizan, do të kemi rrugë të gjatë! — ju drejtua Manoli. Djaloshit i erdhi mirë se për të parën herë e thirrën me këtë emër. Ai e ndjeu veten pjesë të grushtit partizan, ndaj i ishte mbushur zemra me gëzim.

— Ku do të shkojmë kështu? — e pyeti ai Manolin.

— Në skuadrën tonë je caktuar. Ajo tani po bën roje në qafën e Kiçokut.

Dhe ata të dy ecnin rrugës, që dredhonte fundit të malit të Trebeshinës. Manoli i flet për shokët e skuadrës, Zhuli dëgjon me vëmendje dhe e ndjek në gjurmët. Përfytyron Refatin, sipas përshkrimit të Manolit. Atë e mendonte si partizan të çuditshëm, trim dhe me zemër të madhe.

— Po emrin Zhul Fushbardhasi e ke? — e pyeti Manoli. — Ke njerëz në shtëpi?

— Jo — dhe djaloshi nisi t'i fliste për familjen e tij, që i ishte shuar, ndërsa partizani heshtte duke rrudhur ballin.

Në të ngjitur të Kiçokut, dikush foli:

— Manol, o Manol!

Tjetri dëgjoji me vëmendje. — Është Refat Arapi — i thotë partizanit të ri Manoli.

— Ku është skuadra? — pyeti pastaj me zë të lartë.

— Atje sipër, afër lisave, ka zënë qafën. Andej duhet të jenë ballistët e dervish Hajrullait.

Manoli vuri re që djaloshi Zhul Fushbardhasi ndërroi fytyrë, i shkrepëtinë sytë, ju shpeshtuan rrudhat, i doli në pah një damar i zi. «Diçka do të ketë» mendoi Manoli dhe nuk guxoi ta pyeste. Zhul Fushbardhasi, sa herë përmendte Manoli emrin e dervishit Hajrulla, ndërronte fytyrë e zbehej. Manoli dëgjoji psherëtimën e tij. Atë çast u dha atje Refat Arapi.

— Erdhët, shoku Manol? — Kur po shkarkonin mushkën, ai pa Zhul Fushbardhasin dhe e pyeti:

— Po ky shoku?

— Partizan i ri. Është caktuar në skuadrën tonë.

I dha dorën djaloshit dhe e qafoi, pastaj e pyeti:

— Ç'kemi, o trim?

— Asgjë — u përgjegj djaloshi pak i drojtur që në vend të një kollosit që përfytyronte gjeti një burrë të dobët me shtat mesatar.

Edhe Refat Arapi e kuptoi habinë e djaloshit, ndaj ju drejtua Manolit:

— Uluni e pushoni! Mos dilni pas teqesë, se andej shtien nganjëherë me pushkë ata djajtë...

Moti që i vrenjtur dhe dita e ftohtë. Në sfondin e një qielli të bruztë dukej mali i Trebeshinës i mbuluar me borë. Manoli dhe partizani i ri i kishin vënë shpinën një guri që të mbroheshin nga era, se ishin të djersitur nga rruga. Manoli e solli përsëri muhabetin te dervishi Hajrulla dhe përsëri pa se si djaloshit i shkrepëtinë sytë. Ai rrahu disa herë qerpikët e gjatë dhe sytë ja nguli Manolit.

Ç'ishte ky shqetësim i fshehur?! Ç'lidhje kishte kjo me dervishin Hajrulla?!

3

Zhul Fushbardhasi e pa përsëri komisarin e brigadës. Kësaj here e njohu.

«Po, tha, ai është. Si i flisnin atëhere? Marenglen! Qenka bërë komisar». Dhe ju kujtua çasti kur Marengleni hyri në shtëpinë e tij. Djaloshi e rikujtoi ngjarjen.

Kishte qenë dhjetor. Atë natë, dy njerëz me pushkë, Marengleni dhe një partizan, kalonin udhës. Jashtë binte shi e frynte erë e fortë.

Në derën e shtëpisë së vogël u dëgjua një trokitje e lehtë, pastaj dhe një tjetër. Dikush u kollit, pastaj u çel kanata e një dritareje. I zoti i shtëpisë nxori kokën dhe, pasi i pa me pushkë, pyeti:

— Kush është aty?!

— Partizanë, xhaxho, partizanë jemi.

I zoti i shtëpisë e mbylli dritaren me rrëmbim, ata pritën pak në këmbë.

— Të thashë që në këtë lagje ka njerëz, që janë nën influencën e Ali Beut.

— Është i varfër...

— E, megjithatë është ballist, shoku Marenglen.

Prapë trokitje...

Për një çast heshtje, pastaj përsëri trokitje.

— Ç'doni?

— Të strehohemi sonte. Është dimër i madh, o xhaxho.

— Nuk pranon komunistë kjo shtëpi... Tjetërkujt i ka dhënë fjalën. — Këto i dëgjoji përsëri Marengleni pas trokitjeve të përsëritura.

— Kot prisni!

— Shkojmë, shoku Marenglen?

— Jo.

Shoqëruesi e njihte mirë karakterin e Marenglenit. Po të ngulte këmbë për ndonjë çështje, ai nuk shkulej pa e zgjidhur atë deri në fund.

— Shkojmë! — tha përsëri shoqëruesi.

— Jo.

— ...

Kaloi gati një orë dhe ata prisnin pas portës. Vazhdonte të binte shi dhe të bënte ftohtë. Ata kishin ngritur jakat e palltove dhe pushkët i mbanin me tyta poshtë për të mos u hyrë ujët brenda. Marengleni kollitej herë pas here. Ishte mesi i natës. Bubullimat e rrufetë e përmendën të zotin e shtëpisë, që doli në dritare dhe pa që ata qëndronin atje të lagur në të ftohtë. Njërin prej tyre e ngiste kolla.

— Ju thashë, more njerëz, një herë e jep fjalën burri — dhe erdhi drejt derës i pezmatuar. — Urdhëroni, hyni brenda!

Sa u gëzua Zhuli atë kohë! I ndritën sytë e i gufoi zemra. U ngrit nga teshat dhe ndezi zjarrin.

Ata u shtruan rreth zjarrit e nisën bisedën.

— Si ta thonë emrin, o partizan?

— Shok, më thuaj, Myrteza, se shokë jemi.

— Bah, estakfurulla, komunist unë?

— Pse, ç'të keqe do të keni ju, Myrteza, nga komunizmi?

— Më mirë e mbyll derën fare, i vë prakun e varrit se sa të bëhem komunist.

Zhulit i shkuan të ngjethura në kurriz.

Marengleni i tregoi të vërtetën e madhe Myrtezait. Gjithë atë natë dimri ata nuk fjetën. Më në fund ai i njohu aq shumë mysafirët, saqë u foli hapur.

— Vetëm këtë djalë ke, Myrteza?

— Të vetëm e kam.

— E gruan? .

Kur i kujtoj gruan, Marengleni vuri re që i zoti i shtëpisë ndërroi menjëherë në fytyrë, i shkrepëtinë sytë e mori zjarr. Nuk foli. Marengleni e mori me mend që atë e mundonte një brengë e madhe. Myrtezai heshti. . . Me tjetër njeri nuk e kishte hapur gojën. Po të kishte treguar, ata do ta merrnin vesh që gruan e tij kishte dashur ta çnderonte një nga dervishët e teqesë. Ngatërrresa kishte qenë aq e madhe e ishin folur aq fjalë, saqë gruaja e Myrtezait, nuk i duroi dot fjalët dhe u mbyti në pus. Edhe kjo ishte një mister, si ato që ndodhnin në sarajet e beut të Këlcyrës, ku njerëzit humbisnin pa lënë gjurmë. Pati nga ata që thanë se qe mbytur, por pati dhe asish që dyshonin se e kishte hedhur në pus. Një nga këta ishte edhe i shoqi, Myrtezai. Dervishin Hajrulla e quanin, e kishin transferuar në Berat, por me ndërhyrjen e beut të Këlcyrës e kishin kthyer përsëri. Të gjitha fjalët rënduan mbi gruan, ashtu si dhe mali me gurë, që i hodhën sipër se ishte zakon për gratë, që shtiheshin në dhe me fjalë, të mbulohehin rëndë për gjithë jetën. Ashtu e kishin mbuluar edhe gruan e Myrtezait. Në qoftë se kishte gjë që nuk i pëlqente Myrtezait që të ishte me Ballin, ishte vetëm kjo, që me ata ishte dhe dervish Hajrullai. Bile ai nuk ishte dokudo, por ishte në krye

dhe i dëgjohej fjala. Kur Marengleni ja përmendi emrin dervishit Hajrulla, i zoti i shtëpisë me të birin kryqëzuan vështrimet. Marengleni pikasi që ata sy shprehën urrejtje për dervish Hajrullain, ndaj foli e tha se, megjithëse mbante harkanë e shenjtorit, ai qe një bandit dhe gjakpirës sa edhe beu i Këlcyrës. Po të kishte kërkuar të dinte më tutje për jetën e bujkut të varfër, Marengleni do të kishte mësuar që Myrtezai qe nga një fshat i Labërisë. Ai s'qe as njëzet vjeç, kur, në bazë të kanunit të egër të vendit, qe falur nga plumbi, por me një dënim të rëndë të ndahej për së gjalli nga njerëzit. Kjo për arsye se ai dashurohej me një vajzë. Pastaj kishte ardhur në çiflikun e beut të Këlcyrës, kishte punuar njëzet e pesë vjet hyzmeqar. Më në fund kishte ngritur një shtëpi të vogël dhe ishte martuar. Në çiflik e thërrisnin me emrin e fshatit, Fushbardhas.

Rreth zjarrit fliste Marengleni e herë-herë edhe Myrtezai. Zhuli dëgjonte.

— Shumë i sëmurë qenke, o Fushbardhas.

— Duhet të hash më mirë. Do kujdes sëmundja.

— Çështë nisar, o komunist, nuk e largon dot duke ngrënë. Nga savani dhe guri i varrit s'ka shpëtuar njeri. Çështë nisar, do të bëhet.

Biseda e ngrohtë vazhdonte. Marengleni shpjegonte me këmbëngulje, ndërsa Myrtezai dëgjonte. Ndonëse fjalët e partizanëve përputheshin me jetën e tij dhe u përgjegjeshin dëshirave të ngahershme, prapë kthente. «Tjetërkujt ja kam dhënë fjalën» thoshte me vete.

Duke biseduar me Marenglenin, të zotit të shtëpisë i ngjante e ardhmja si një përrallë, ndaj i tha:

— Dhe ti, o komunist, thua që do vij në ditë të bardha edhe për ne buzëplasurit?! Do t'i dëgjohej fjala edhe Zhulit tim?!!

Komisari dhe partizani, që e shoqëronte, pohonin me kokë.

— Ashtu qoftë, ashtu u bëftë! Po ndjemë, o komunist, që ju lashë në shi e në llohë, më ndje!

Të gjitha këto ndodhën në prani të djaloshit. Ai i thithi ato fjalë. Në mëngjez Marenglenit Myrtezai ju përgjegj kështu:

— Po m'u bë djali për pushkë, ta marrësh me komunistët! Bah, s'ka për të ndodhur kështu! Unë, siç më sheh, me sot me nesër jam, lëngo.

— Do të çlirohet Shqipëria, do të ketë doktorë edhe për të varfërit.

— Mundet, mundet, o komunist.

— Nuk do të kalojë gjatë dhe koha do të të bindë me të vërtetën e saj. Mirë është që dhe ti, o shoku Myrteza, të vish me ne.

— Unë për pushkë! Tani që u bëra kështu si fshesë e vjetër, s'hyj më në punë për asgjë. Miq mbeçim, o komunist! — i dha dorën dhe Marengleni bashkë me shokun e tij u largua. Këto i kujtoheshin tani Zhulit. Po ai korrieri që ishte me të ku do të jetë? Si e kishte emrin ai? Hë, po, Çeço i fliste komisari.

4

Gllavë. Ditë marsi. Në një kodër, komisari i brigadës kishte shtruar hartën mbi disa gurë. Komandantët e komisarët shikojnë në hartë fshatin Bubës, Gllavën, tri lartësitë ngjitur me njëra-tjetrën dhe rrugën e automobilit, më tej dallojnë Rehovën, që ndodhet në shpinë të Gllavës.

Po përgatiteshin për goditjen e parë, që do të jepte brigada në drejtim të Mallakastrës.

Marengleni nxori nga çanta lapsin, e vuri mbi hartën topografike dhe tha:

— I shikoni këto shënime në hartë?

Ata u kërrusën kokë më kokë, vështruan çdo shenjë, por s'arrinin të kuptonin qartë gjithë ato që ishin shënuar atje.

— Këto garnizone të mëdha e të vogla të armikut, që janë përhapur si rrjetë merimange thujase kudo, duke filluar nga Qafa e Kiqokut (në hartë dukeshin njollat e

shënuara me lapsin blu) dhe deri në Fier, duhet të goditen, të shpartallohen.

Ndaj, midis Marenglenit, komandantëve e komisarëve këmbëshin mendime:

Në ato dhjetëra garnizone, të mbira si këpurdat mbas shiut, cili ishte më i rëndësishmi? Majori Diter Grebner dhe mercenari Margush thoshin se, duke vënë kufirin në afërsi të Këçokut, kishin ndërtuar një mur të fortë, që do t'u bënte ballë goditjeve të ushtrisë partizane.

Goditjet, që do të jepeshin, duhej të rrëzonin disa garnizone njëherësh. Ato fillonin me Gllavën, prandaj u diskutua më shumë për fshatin, për teqenë, për tri lartësitë, për dervish Hajrullain dhe për rrugën e automobilit, që kalon andej.

5

Tri lartësitë e Gllavës dhe pozicionet e armikut në Bubës e Rehovë qëndruan më pak nga sa u mendua. Një veturë «Mileçento» që pruri këtej, në ditët e Operacionit të Dimrit, një nga krerët e Ballit, që do të bëhej nën-prefekt në anët e Përmetit, u zu nga partizanët, kur po ikte për në Berat. I zoti mbeti i shtrirë në rrugë. Shkresat e vulat i mori i biri i Gole Përmetarit, Manoli, i cili, duke vulosur me vulën e nënprefekturës një copë letër, u thoshte shokëve të tjerë të skuadrës: «Shkoni, ç'vulë paska...» Pastaj u ngrit e shkoi te vetura. Shokët e tjerë hoqën gomat, i vunë supin dhe e përmbysën maqinën në bokërimë.

— Kjo e pret edhe kryeministrin kukull — tha Dardan Veliu kur po rrokullisej maqina.

Refat Arapit ju bë qejfi mal.

...Luftimet kishin mbaruar. Vetëm një vend mbahej akoma. Atje bëheshin ende luftime. Në teqe, besnikët e saj, të verbuar nga fanatizmi, qëllonin me pushkë e mitraloza. Partizanët, mbas shumë përpjekjeve, më në fund

hynë në «shtëpinë e shenjë të zotit» dhe ua morën armët nga duart dervishëve e muhibëve.

Në Gllavë luftimet morën fund. U ndërpre në krismat e armëve, u grumbulluan forcat dhe po mblihdeshin në një vend robërit.

— U paskan rënë pendët «trimave» të babait të Gllavës.¹⁾

— Ej, Zhul Fushabardhasi, mos i fyej robërit.

— Duan plumbin këta, plumbin në ballë. Ku dreqin i çojnë?

— Në shtab. Thuhet që do t'u bëhet thirrje...

— Çfarë thirrjeje?

— Kush dëshiron të bashkohet me luftën tonë, t'ja kthejë armët beut Margush, që ja dha dhe gjermanit.

— Me këta derra të jetosh në një llogore, me këta që nuk lanë fishek pa zbratur, gjersa i zumë robër? Jo, kjo nuk duhet të bëhet — tha partizani i ri, Zhuli.

Kalojnë atje afër disa robër duarlidhur. I shoqërojnë rojet me pushkë.

— Po këta?

Kryetarët e bandave, Zhul.

— Të fandaksur qenkan si njëri e tjetri.

Befas u dëgjua krisma e një mitralozi. Para partizanëve u ngritën, midis gurëve, tym e cifla.

— Na vranë! Hapuni, zini vendet!

Partizanët e skuadrës së Refat Arapit u përhapën dhe zunë vendet. Zhul Fushbardhasi u mbështet pas një guri. Kthehet me vështrim nga armiku. Përsëri dëgjohe-shin përtej krisma mitralozi.

— Ç'të jetë ky gjarpër që qëllon me mitraloz?

6

— Të dhemb, djalosh?

— Jo — tha Zhuli. — Plagë e lehtë është. Ma lidh të lutem që të mos më shkojë shumë gjak.

1) Eksponent i Ballit Kombëtar.

Bukuria ja fërkoi plagën me alkool e ja lidhi. Zhuli vështronte se si kujdeseshin të gjithë për të. U ngrit nga vendi dhe ju drejtua njërit prej atyre, që u kishin hedhur zinxhirët në duar:

— Kush është ai që qëllon me mitraloz? Folë!

Tjetri u ngrysi në fytyrë e heshti.

— Folë, cili është ai gjarpër, folë!

— Mercenari diç murmuriti.

Pa i mbaruar fjalët mercenari, Zhuli u ngrit nga pozicioni dhe vrapoi nga tyrbja.

— Prit, Zhul!

Sikur të mos kishte fare plagë në trup, ai u hodh andej gur me gur e ledh më ledh e i doli më afër tyrbes së bardhë. Në fillim pa muret e bardha të tyrbes, çatinë e shtruar dhe ngjyrën e gjelbër. Kur kishte qenë në shtëpi, Zhuli besonte që këto vende të «shenjta», qenë shtëpi të ndërtuara në tokë nga vetë zoti. Pra, dhe ai, si gjithë të tjerët, kur shkonte në këto «shtëpi të zotit», përulej, binte në gjunjë e lutej... Edhe dervish Hajrullain, që tani ishte mbyllur në atë tyrbe, e kishte njohur djaloshi. Ai kishte qenë dikur në teqen e Sukës, atje e kishte parë. Thuhej që ishte njeri i shenjtë, një nga dervishët më të mirë të teqes. Po më vonë atij i qe dukur dervishi si ari, të cilin donte ta shqyente vetë.

— Kështu janë të gjithë këta, të gjithë maskarenj janë, o bir! — i kishte thënë i ati Zhul Fushbardhasit.

Po i afrohej tyrbes. Gulçonte nga lodhja, gufonte nga inati. U hodh nga muri i arës e vrapoi. Një breshëri plumbash i ranë pranë dhe ai u shtri rrafsh me tokën.

— U vra, u vra! — thanë shokët.

— Sa i rrëmbyer ky djalë! Ç'është kështu me të? — u thotë shokëve Bukuria.

— Ende nuk është shtruar në luftë — ja priti Dardani.

— ...

— Lufta ka ligjet e saj. Me to nuk mësohesh aq lehtë sa ç'pandehin disa. Kur në gjoks të zien urrejtja, veshët s'dëgjojnë më, thirri sa të duash.

Partizanët kishin mësuar se në tyrbe ndodhej agjenti i fashistëve, komandanti i mercenarëve, dervish Hajrullai.

— Ta kapim të gjallë! Ka llogari të vjetra për të marrë. O burra, andej!

Skuadra partizane e Refat Arapit u nis me vrap.

Tyrbja dërgonte kundër tyre plumba. Nga afër Zhul Fushbardhasi e shikonte grykën e mitralozit, që nxirrte flakë dhe plumbat, që i shkonin një shuplakë mbi krye. Edhe Zhul Fushbardhasi e zbrazi disa herë armën dhe plumbat e saj lanë shenjë në murin e bardhë të tyrbes.

Ai tërë duf kërkonte të hidhej drejt në tyrbën e bardhë e të hakmerrej për të gjitha, edhe për nënën, edhe për babanë, që e shtiu në dhe me atë brengë të madhe, për të gjitha! Ngjarja e shkuar atij ju ndez si zjarr dhe i përvëloi fytyrën... Zvarritej këmbadoraz, i shkonte më afër tyrbes, më afër mitralozit.

Dervish Hajrullai ja ndjeu erën, i dëgjoi më afër hapat... Ndërroi vendin e mitralozit, ja ktheu grykën andej nga kishte dalë partizani. Një çast qetësi... Në dritaren e tyrbes tyta e mitralozit qëndronte në përgjim. Dhe fytyra e dervishit u zbe e një djersë e hollë i mbuloi ballin. Prapa armës, dy sy të mëdhenj vështronin gjithshka... Hajrullai e vuri Zhulin në shenjë dhe priste t'i afrohej...

Një plumb tjetër i mitralozit për pak e mori në shtat Zhulin. U rrëzua e për një çast mbeti në vend si t'i kishte humbur ndjenjat.

— E vrava! — tha dervishi. — E vrava!

Në të vërtetë Zhul Fushbardhasi, i zënë ngushtë, për t'i shpëtuar rrezikut, u shtri me duar e me këmbë të hapura si një i vvarë. Dhe dervish Hajrullai shtiu edhe një herë tjetër me mitraloz, por kësaj radhe kundër skuadrës partizane, që vinte në drejtim të tyrbes dhe pastaj u ngrit nga vendi, u ngjit në dritare e që andej do të hidhej për t'u fshehur në pyll, për t'u bashkuar me ushtarët e majorit Diter Grebner, për të shkuar te beu Margush.

Zhul Fushbardhasi pa fytyrën e dervishit, qafën e tij të trashë, trupin e tij të ngjeshur, çallmën e bardhë me atë rrip ngjyrë bari dhe harkanë në ngjyrën e preshit. E shikonte si nëpër mjegull, se një çast ju err vështrimi nga plaga, që ju lëndua dhe i dhembte. Sa zbriti nga dritarja e tyrbes, dervish Hajrullai ja dha vrapit.

Zhuli e vështroi. Nofulla filloi t'i dridhej, në fytyrë u skuq, e tëmthat i rrahën me forcë. Në veshët ndjente rënkimin e babait: «Zoti vëntë dorë mbi katilin». Zoti? — psherëtiu dhe i vuri pushkës fishekun në gojë, e shtrëngoi fort armën në sup dhe mori shenjë. . Kishte në shqekëzën e armës trupin e majmë të dervish Hajrullait. E shkeli këmbëzën dhe plumbi i parë e rrokullisi për tokë dervishin.

— Të lumtë pushka, e vrave! — i tha Bukuria, që sapo ishte afruar, duke parë dervishin me çallmë të bardhë të rënë përmbys, me kokë të varur në bokërimë.

* * *

Kaloi edhe një ditë...

Brigada pregatitej për goditje të tjera. Bëheshin diskutime në kompani e në celulat e partisë. Në një nga këto mbledhje Marengleni u ngrit dhe foli:

— Zhul, shoku Zhul!

Nga grumbulli i partizanëve u ngrit djaloshi me shtat të drejtë, me flokët e sytë e zes, me një pullë të zezë në faqen e djathtë. Të dy vështronin sy ndër sy njëri-tjetrin. Zhulit ju bë fytyra flakë e kuqe. Marengleni i kishte thënë të fliste për atë që e brente aq shumë e t'ua tregonte të tjerëve. Ai kishte premtuar se do të fliste edhe për atë ngjarje, po s'pati guxim ta tregonte. Një hije varej mbi kokën e Zhulit.

— Tregoje, o Zhul Fushabardhasi, historinë e familjes sate.

Zhuli u zbe si të qe goditur me plumb në zemër.

— Guxim, o trim, folë! Duhet ta dimë të gjithë. Ajo është historia jonë. — Shpërthyen zëra:

— Folë, Zhul, folë!

Ju kujtua i ati, që e mori me vete në varr atë të fshehtë. «Unë i jam betuar atij, duhet të hesht...» mendoi Zhuli.

Përsëri zëra:

— Folë, Zhul, folë!

Dhe Zhul Fushbardhasi tregoi ngjarjen.

Nuk pipëtinte njeri. Të gjithë dëgjonin historinë e dhimbshme të nënës së djaloshit, poshtërsinë e dervishit të teqes së Sukës.

Refat Arapi foli që nga vendi.

— Na i ngriti qimet e kokës përpjetë kjo ngjarje, na u drodh këmisha në trup. Kush është ai dervish, kush?.. Folë, bir!

— Folë, Zhul, folë!

Ndërhyri Marengleni:

— Ai nuk është më. Nëna la prapa djalë e ky ja mori hakun.

— Partia... Partia!... Shoku Marenglen! — tha me zë të dredhur partizani Zhul.

KAPITULLI I TETË

Shikonte në fotografi, midis një familjeje të varfër një fëmijë naiv me sy të mëdhenj e të padjallëzuar, që vështrojnë të habitur. Ishte vetë ai, të cilin partizanet e brigadës e thërrisnin Marenglen.

1

Brigada e Marenglenit qe futur thellë në zonën e Mallakastrës. Populli e quante atë «brigadë të kuqe», ballistët «brigadë dorëzë», kjo sepse kudo që kishte goditur, armiqtë qenë dërmuar.

Shkatërrimi i bandave mercenare në Molisht ishte një sukses i ri për brigadën. Megjithatë Marengleni e mblodhi brigadën e u tha partizanëve:

— Në goditjen që bëmë ne i premë armikut vetëm një nerv, kurse duhet t'i prishim të gjithë sistemin nervor, ta detyrojmë të largohet nga Mallakastra dhe kjo do të ndodhë vetëm atëhere, kur të goditet kalaja e Margëllëcit, në Patos. Këtë ndodheshin vetëm degët, trangu është Margëllëci, prandaj duhet të godasim! Vetëm kur të çlirojmë Patosin, do të kemi zbatuar detyrën, që i ka ngarkuar brigadës sonë shoku Enver.

Brigada dëgjon dhe merr frymë si të ketë një gjoks të vetëm. Të gjithë jetojnë me një mendim: të zbatohet urdhëri i partisë, të merret kalaja, të çlirohet Mallakastra.

— Në Patos, të sulmojmë Margëllëcin! — brohoriste brigada.

Pas mbledhjes partizanët grupe-grupe u shpërndanë dhe lugina u mbush plot gjallëri e jetë. Refat Arapi kërkonte një vend të mirë ku skuadra e tij të kalonte disa orë gjatë natës dhe u tha shokëve të mblidhnin me kohë drutë për zjarrin, që do të ndiznin në mbrëmje. Si dha këto porosi, u ul mbi disa sqine dhe dremiti. Pak më tej, Bukuria nxori nga çanta sanitare, ku mbante ilaçet për të mjekuar shokët që plagoseshin, një blok shënimesh. Kur u përmend, Refati e pa që ajo ende po shkruante në blok.

— Është libri ynë ai, do t'i vijë dita që të lexohet ky libër, prandaj të mundohemi që të jetë e shkruar në të çdo ngjarje e cilitdo partizan, po ama të kujdesemi që secili të shkruajë sa më mirë, sepse një faqe e keqe ndyn gjithë librin. — Kështu kishte thënë Refat Arapi ditën e parë që nisi të shënohej në këtë blok gjithshka, për çdo partizan të skuadrës.

Njëherë ditarin e skuadrës e lexoi komisari i brigadës, Marengleni. I qe dukur një ditari interesant me një vlerë të madhe, sepse në të qenë shkruar ngjarje nga më të ndryshmet dhe pa zbukurime. Refat Arapit në fillim i kishte hyrë në qejf ajo punë, ngaqë emri i tij përmendej shpeshherë dhe kishe ç'të shkruaje për Refat Arapin, që kurrë nuk i fshihej plumbit. Por herë-herë i bëhej t'i thoshte Bukurisë që të mos i shënonte edhe gjërat e papëlqyera.

Ndoshta ajo pikërisht atë ngjarjen e Refat Arapit shkruante në ditarin e skuadrës atë kohë, ndaj ai thoshte me vete: «Nuk bëra mirë, ç'm'u ndez gjaku ashtu, e vrava dreqin, s'bëra mirë, po ja de, nerva kemi dhe ne!» Çështja kishte ndodhur kështu: Një ballist qe dorëzuar dhe Refati, sapo i hoqën pushkën mercenarit, qe hakërryer duke e pyetur për thesin që mbante në krah. Kur i gjetën dhjetëra unaza të vjedhura, disa palë rroba të reja nusërie gjer edhe enë bakri të rrëmbyera nga shtëpitë e popullit, Refati s'qe përmbajtur, po e kishte go-ditur me plumb dhe ballisti kishte rënë shul midis rru-gës. Një pulë të pjekur dhe një shishe me raki, që i gjeti

në trajisë, Refati, sado që ishte i uritur dhe era e rakisë dhe e mishit ja ngacmonin shqisat, nuk e bëri veten, ja vuri te koka mercenarit, për ta shikuar njerëzit që do të kalonin asaj rruge.

Disa orë pas ngjarjes që penduar, por atë që prish plumbi, nuk e ndreq dot mendja.

Ishte shkruar në ditar gjithashtu dita dhe vendi ku Vocua kishte humbur thuprën e pushkës, përmendej emri i Manolit, që, sapo mbaruan luftimet në Tepelenë, nga disa arka me bomba, që u qenë kapur ushtarëve gjermanë, kishte plasur një rën në Vjosë, për të vrarë peshq. Të gjitha këto sipas Refatit s'prishnin ndonjë punë të madhe, në goftë se do të hiqeshin. Ai mendonte:

«Pse të regjistroheshin këto gjëra midis kaq e kaq heroizmave të skuadrës? Pse të shkruhej në letër edhe një proçkë e madhe, dashuria midis Dardanit e Bukurisë, që sikur tani po binte erë.» Kur e kujtonte këtë, Refati mend tërbohej. «Po kjo pikë e zezë, njerëzit më trima do t'i vënë vetes dhe skuadrës njollën më të keqe» mendohej ta largonte këtë të keqe, po s'dinte si t'ja çelte bisedën goftë Dardanit, goftë Bukurisë, ndaj mendonte që ato çështje të mos shkruheshin në letër.

Kaloi atje afër Marengleni, që i foli. Refati u shkëput nga ato mendime, shkoi me komisarin e brigadës dhe me një skuadër partizanësh, me Çeçon nga Patosi, informatorin, që erdhi nga Margëllëci, u ngjit mbi fshatin Lofken, në majë të malit. Komisari i brigadës pyeste djaloshin, që sapo kishte dalë nga Patosi dhe shënonte në hartë çdo pozicion që tregonte Çeçua e çdo vend që kishte zënë armiku. Në fillim Çeços nuk i tërhoqën vëmendjen ato shënime, por, kur pa se çdo gjë që thoshte, komisarit e hidhte në hartë dhe e shihte me dylbi vendin, u bë kureshtar, ndaj i nguli sytë mbi hartën dhe majën e lapsit, po nuk kuptoi asgjë. Dinte të tregonte, vetëm kaq. Komisari vështronte vendin me dylbi dhe i fliste informatorit:

— E pra, Çeço, tregoj shokëve ç'po ngjet asaj ane.

— Janë bërë gjela ballistët, shoku komisar, nuk i

binden më si të verbër Margushit dhe ky, çdo ditë që kalon bëhet me xhind, kërkon të hajë njerëz të gjallë, sidomos, kur goditi brigada në Tepelenë, e kishte humbur; akoma mban një shenjë zije në xhaketë për Axhem Belulin dhe dervishin Hajrulla. Edhe mjekrën e mbajti disa ditë; ndërsa gjermanët, më ndryshe, nuk e japin veten. Bëjnë terror: përditë plaçkisin dhe vrasin.

— Prandaj duhet të sulmojnë sa më parë. Traktet i shpërndave?

— Si jo, edhe brenda në shtëpinë e beut u hodhën disa.

Nga të dhënat që solli Çeçua, dilte se në fshatin Patos, në Margëllëç dhe në kala, qenë vendosur disa qindra ushtarë gjermanë të komanduar nga majori Diter Grebner dhe një batalion mercenarësh i komanduar nga Margushi, beu i Margëllëçit.

Marengleni vlerësonte të dhënat për armikun, llogariste, parashikonte dhe përgatiste aty për aty planin sipas të cilit do të bëhej goditja.

Në Margëllëç armiku kishte forca të shumta e pozicione të forta, por Marengleni e dinte gjithashtu se sukseset në luftime nuk i arrinte sasia e armëve dhe e njerëzve, por forca e shpirti sulmues i tyre, bindjet e tyre politike, prandaj, sa herë mendonte për goditje, ai s'e harronte këtë forcë vendimtare.

Pasi e vështrroi me dashamirësi zbuluesin partizan, i tha:

— Të lumtë, o Çeço, kështu duhet të jenë komunistët!

2

Pa u errur, ata u nisën të zbrisnin përsëri në fshat që të ktheheshin në brigadë.

Marengleni qëndoi pak më këmbë e shënoi diçka në fletore. Ashtu kot, duke shikuar në çantë, i doli përpara një fotografi e hershme, të cilën po e vështronte tërë kureshtje. U mundua të rikujtonte jetën e vet. Shi-

konte midis një familjeje të varfër një fëmijë naiv, me ca sy të mëdhenj e të padjallëzuar, që vështronin të habitur. Ishte vetë ai, të cilin partizanët e brigadës e thërrisnin Marenglen.

E kujtoi me përmallim atë fëmijë dhe mendimet i shkuan në ato vite kur këmbëzbathur bridhte rrugëve të ngushta të fshatit të lindjes.

Ju kujtua pastaj mërgimi, qysh i vogël, nga fshati i tij majë maleve, nga vendi që e donte aq shumë dhe endja si çirak në qytet duke punuar për bukën e gojës. U mundua t'i largonte mendimet, por ato i shfaqeshin përsëri. I kujtohej koha e zisë së bukës, kur endej malësori me thesin e misrit në shpinë, pastaj përpjekjet e jashtëzakonshme për të fituar bursën që të vazhdonte studimet dhe profesori zemërmadh, që i kishte hapur atij dritare për të vështruar jetën. Atje në shkollë, rrëmbëu dije, lexoi libra revolucionare dhe akti që bëri një ditë e vuri atë në listën e zezë të Ministrisë së brendshme. Kishte ndodhur kështu:

Mbreti do të vizitonte shkollën e tyre. Kur ai hyri brenda, të gjithë, profesorë e nxënës, u ngritën për ta përshëndetur naltmadhninë. I kujtohet, ishte ngritur edhe ai. Filloi ora e mësimit, u bënë dy pyetje dhe u përgjigjën dy nxënës, njërin e ngriti naltmadhnia, se ishte biri i një beu, që ai e njihte. Margush e quanin nxënësin (ky Margushi, që tani ishte mbyllur në kështjellën e Margëllëçit bashkë me hitlerianët). Nga përgjegjet që dha, nxënësit e tjerë ulën kokën të turpëruar, sepse Margushi e kishte kërkuar Indinë në Evropë dhe Skandinavinë në Afrikë. Që nga ajo ditë, Margushit, shokët e klasës i ngjitën një nofkë «veshëgjatë» dhe kjo nofkë e ndoqi atë gjer përtej detit në dyert e universitetit. Kur profesori dha disa pyetje nga historia e revolucionit francez, që edhe sot Marengleni mendonte se profesori nuk i kishte dhënë pa qëllim, nga fundi i klasës ngriti dorën një nxënës. Mbreti vështrroi djaloshin; në fillim fytyra e naltmadhnisë qe e qetë, por djaloshi ligjëronte me afsh kun-

dër monarkisë dhe, sa më shumë zgjatej ai, aq më shumë ndërronte çehren e fytyrës naltmadhnia, gjersa kur erdhi çasti që po flitej për dërgimin e Luigjit të gjashtëmbëdhjetë në gijotinë, mustaqet dhe vetullat e mbretit u ngritën çark përpetë si gjemba, sytë ju skuqën dhe, duke goditur me kamxhik regjistrin e klasës, doli jashtë. Mbasdite nxënësin e thirri ministri Musa Juka dhe kërkoi të nënshkruante një deklaratë, që ai qe përgatitur të fliste ashtu përpara mbretit, nga mësuesi i historisë. Djaloshi e kundërshtoi. Ky nxënës ishte, ai vetë, Maren-gljeni dhe jeta e tij pas kësaj ngjarje u bë edhe më e rëndë. Më në fund pas shumë peripecive i mbaroi studimet; ishte koha kur shoku i tij Asim Vokshi nisej për në Spanjë, ndërsa atij s'i eci, kaloi kufirin grek dhe deshte të shkonte në luftë, por borgjezët dhe feudalët kishin një gjuhë të përbashkët kundër komunistëve. Korofilla-kët e dorëzuan te xhandarët dhe ata e mbyllën në kësh-tjella. Pastaj, ai u lirua me kusht që të largohej nga qyteti në fshatin e tij të vogël majë malit, që qëndronte sipër reve. Këtu kaloi vite, çdo ditë do t'i paraqitej postko-mandantit dhe ngjante si ai zogu, të cilin e lidhin me pe, që, sado që merr rrëmbim të fluturojë, prapë e tër-heqin.

Ëndërronte atëhere për një të ardhme të drejtë e të bukur. Ishte koha kur në fytyrën e njerëzve godiste si me shpatë e linte gjurmë skamja, poshtërimi. Kush guxonte të ngrinte krye, dergjej në qeli, shuhej si kandili pa vaj. Sado që mësonte, atij i dukej se më vonë do të zgjoheshin malet, e kur të ngriheshin, edhe retë do t'i përpinin. Po njerëzit i kishin humbur shpresat, u qenë nënshtruar vuajtjeve dhe ngrysnin ditët plot dhembje.

— Eh, — u thoshte shokëve Maren-gljeni — sa kohë do të zgjatë ky gjumë? — Atëhere kishte filluar puna. Duhej ndryshuar ajo që ishte dhe duhej krijuar ajo që s'ishte. Po, që të arrihej kjo, duheshin zgjuar njerëzit, duheshin ringjallur shpresat, duhej krijuar bindja se ata kishin forcë të përmbysnin botën e padrejtë e të ndërtonin një botë të re.

Kur më 8 Nëntor të vitit 1941 lindi në Tiranë partia, Marengleni rrëmbeu armën dhe doli maleve.

Në fillim, endej maleve në çeta të vogla, pastaj udhëhoqi një brigadë. Ai ishte optimist. E shikonte që goditjet, që i jepeshin armikut kudo nga Ushtria nacionalçlirimtare, e çonin Shqipërinë më afër fitores.

Dhe ja tani ndodhej ballë për ballë me Margushin. Ata dikur ishin shokë, të ulur në një bankë mësonin, por pastaj si ujët e një mali që rrjedh nga pllajtat e kundërta dhe derdhet në lumenj të ndryshëm, edhe ata ndoqën drejtime të kundërta dhe nuk kishte si të afroheshin me njëri-tjetrin. Miqësinë shkollore jo vetëm që nuk e trashën më tej, por ajo mbeti edhe shkaku fillestar që ata e panë vëngër njëri-tjetrin. Karakteret e tyre ishin të ndryshme dhe zhvilloheshin po në rrugë të ndryshme. Po të vështroje me vëmendje në sytë e Marenglenit, do të dalloje jo vetëm pasojat e hidhura të varfërisë, por edhe zjarrin e pashuar të një dashurie të vetme që fuqizohet gjithnjë e më shumë, që ngrohej në vatrat e mendimeve të partisë, në rrezet e kuqe të revolucionit. Ndërsa Margushi që situr për diçka tjetër, atij edhe vesi më i keq i dukej virtut, kur i shërbente për të fituar. Këto ndjenja ambicioze e çuan gjer në atë pikë që i biri i beut, Margushi, si dikur milicët, që donin të ishin më fashistë se Musolini, t'ja kalonte edhe beut të Këlcyrës për besimin që kishte në pathyeshmërinë e ushtrisë gjermane. Kjo e bëri Margushin edhe më gjakësor, njeri të egër, që donte të qëndronte në kështjellë deri në pikën e fundit. Për këtë Marengleni nuk kishte asnjë dyshim. Më në fund komisari i brigadës u shkund nga kujtimet dhe nxitoi të arrinte shokët.

Brigadën e gjeti duke u përgatitur për goditjen...

Kur mbaruan përgatitjet, brigada u nda dhe pushonte, komisari i saj gjithashtu pushonte. E ndjente veten shumë të lodhur, ndërsa peshën e plagës në mushkëri

edhe më të rënduar. Po kurrë nuk e mbanin mend partizanët e tij aq në qejf sa atë ditë. I kishte mbetur që nga çastet e përlëshjes gazi në buzë, i ishin rikthyer forca e shëndeti i kohës kur ishte i pasëmurë, shtrëngoi pallton bezhë, ngjeshi më mirë rripin e mesit, i dha pak me majtas dhjetëshes së mbushur me plumba dhe në vendin ku ishte dremiti një çast. Donte të pushonte, por vjen një kohë që truri i stërmunduar ka frikë ta pranojë gjumin, dhe u ul mbi atë trung të butë. I erdhën atë kohë sa e sa mendime. Atij po i kujtohej një ngjarje e kaluar që kishte ndodhur pikërisht këtu, në Mallakastër, në verën e vitit të kaluar nën hijet e ullinjve, afër kështjellës hijerëndë. Ato ditë sapo kishte filluar konflikti i tij me shokun e klasës, Margushin. Në atë kuvendim ku merrnin pjesë edhe shumë fshatarë Marengleni përfaqësonte Frontin nacionaqlirimtar, ndërsa Margushi Ballin Kombëtar. Margushit atë ditë një fytyrë i vinte e një i shkonte. Ai ja dinte këmbënguljen shokut të tij, ndaj që në fillim tha fjalë që errësonin luftën e komunistëve dhe ideologjinë e tyre. Marengleni ja ktheu:

— Ideologjia jonë ka në themel të vërtetën dhe dihet që jeta ngre në pedestal vetëm të vërtetën. — Kështu i kishte thënë Marengleni.

— E vërteta shtrihet në të gjitha drejtimet — u përgjegj Margushi.

— Gënjen! — ja ktheu Marengleni. — E vërteta merr një drejtim me jetën, asaj s'ke ç'i bën, kush shkon kundër saj, bën një gabim fatal.

Margush beu rrudhi buzët, mandej qeshi.

— Juve ju duhet të përhapni errësirën që të mbuloni dritën, ndërsa idetë e revolucionit ju verbojnë.

— Jeni njeri i ekzaltuar, ju mungon ekuilibri — ndërhyri beu dhe aty për aty shtoi: — Gjithmonë keni qenë i tillë.

Marengleni nuk ju përgjegj menjëherë, mendonte fjalët që do të thoshte:

«Jeta... dashuria për jetën. Çdo qenje e gjallë, sado

mikroskopike që të jetë, do që të jetojë, lufton që të jetojë, ndaj jam i lumtur të jem ushtar i popullit.

— Jeta! Eh, — psherëtiu Margushi — sa i ngatërruar është filli i saj.

— Duhet thënë sa e shkëlqyer është drita e saj.

— Jo — kundërshtoi Margushi.

— Shushunjat që thëthijnë gjakun e jetës, populli i di, krimbat që brejnë jetën dhe mbjellin vdekjen, edhe këtë e di populli.

— Cilët janë ata — ndërhyri Margushi.

— Njëri nga ata jeni ju, zoti be Margush, ju dhe shokët tuaj, që thithni gjakun e jetës.

Ata e vështruan ndër sy njëri-tjetrin, heshtën vetëm disa sekonda. Margushi ju kthye:

— Ju nuk e njihni masën e veprimit, ndonëse ju ka ndihmuar natyra që të keni një forcë magjike në të folur për t'i trullosur ata që të dëgjojnë.

Marengleni lëvizzi në duar stilografin, që futi në xhep dhe pohoi:

— Po, zoti bej, kështu jam unë, i paepur, kur e di që përmbush detyrën time si ushtar i popullit, forca e ushtarit vihet në veprim vetëm në betejë.

— Këtu nuk jeni në betejë, këto janë vetëm fjalë dhe dihet se ç'thuhet sot nuk... — beu atë mendim që i erdhi në mend u mundua të mos e thoshte.

— Çoje në fund mendimin. Për ju ashtu është, ndërsa populli është ndryshe. Populli gjithnjë do që t'ja thuash të vërtetën në sy dhe di ai si të gjykojë. — Pastaj, si të mos bënte kuvend me beun Margush, por me fshatarët që ishin shtruar këmbëkryq nën hijen e ullinjve, i tha.

— Të kujtohet kur lexonim në shkollë një libër? S'ka si të të mos kujtohet. Ti më thoshe: «Hiqe, se do të marrësh veten në qafë».

— Po, ashtu është — pohoi Margushi — dhe ato të sollën këtu, të ngjitën në këtë mal, se në libra dihet që pështyn edhe shejtani.

Marengleni qeshi me budallallëkun e Margushit dhe shtoi:

— Unë atëhere nënvizova dhe i shkrojta në blokun tim këto fjalë:

«Doni të kuptoni se ç'domethënë revolucion? Revolucioni përmbys frone, shkel përmbi to dhe vazhdon rrugën e vet duke ngritur në tribunë vegjëlinë?» Të kujtohet? Me siguri që po!

Margushi shtangu.

Kështu e përfytyroi ai kundërshtarin e tij Marenglen në kohën që kishte dërguar kundër tij në fshatin kundrejt kalasë disa skuadra partizane. Nga këto vegjime e larguan Marenglenin vetëm krismat e armëve që u dëgjuan andej...

4

Skuadrat që shkuan në zbulim zunë robër disa xhandarë dhe robërit i kishin sjellë në fshat. Ata qëndronin kokulur, nuk i kishin lidhur.

Marenglenin, kur i vinte rasti të përpiquej me xhandarët, e rrëmbente urrejtja dhe i shante sa mundte. Ndërsa atë kohë që erdhi aty, e mbajti veten dhe i pyeste. Xhandarët qëndronin gatitu, flisnin e mundoheshin të shfajësoheshin, por Marengleni e njihte mirë fytyrën e xhandarit. Radha e pruri që të qëndronte ballas një thantiku me sy larushan, me mustakë të dredhur në formë harku. Vështrimet e tyre u ngërdheshën për të kujtuar një ngjarje të hershme. Ishte viti dyzet e dy kur xhandari i gjatë me sy larushë, vetë i dytë udhëtonte Grykës së Shurit në Kurvelesh dhe kishte takuar në rrugë ilegalin Marenglen. Edhe atëhere sytë e tyre gërvishës kishin vështruar njëri-tjetrin. Marengleni dilte nga gryka, ata hynin për t'u kthyer në postën e tyre.

— Ku shkon, djalosh, — e kishte pyetur xhandari i gjatë me sy larushë, pa e njohur me cilin kishte të bënte.

Marengleni i kishte thënë se ishte kallajxhi dhe punonte në një fshat, aty kishte edhe shokët e tjerë.

Xhandari i gjatë me sy larushë ju afrua te veshi xhandarit tjetër e i tha:

— Mund të jetë ndonjë komunist nga ata të Maren-
glenit, është më mirë ta kontrollojmë.

Xhandarit tjetër kjo ju duk e pabesueshme. Ai
djalosh nga veshja ngjante vërtet me një kallajxhi nga
Përmeti, ja trajsa, ja edhe hekuri e kallaji për të pikuar
enët... Po xhandari i gjatë me sy larushë nuhaste larg,
kontrollonte çdo gjë, ndaj ju drejtua me zë kërcënues:

— Më jepni dokumentin dhe lejen që kini nga nën-
prefekti Margush për ushtrimin e zanatit. — Ishte fillimi
i vitit dyzet e dy, Margushi aso kohe ishte caktuar nën-
prefekt, por nuk e kishte pritur mirë. kërkonte më tepër.

— Dokumentin?... Lejen! «Kallajxhiu» ndryshoi mi-
mikën për të shprehur çudinë.

— Ç'merresh me të, ngasim, se jemi vonë — tha
xhandari tjetër.

Po xhandari i gjatë me sy larushë e dinte që nga
ferra e vogël dilte lepuri i madh dhe nuk e lëshoi veten.
Ai me rreptësi i foli «kallajxhiut»:

— Dokumentat! — Dhe me pushkën gati mori pozën
e gjelit të detit kur fryn pendët.

— Me gjithë dëshirë — i tha «kallajxhiu», vuri do-
rën në xhepin e portofolit dhe fap doli me tytë drejtuar
nga xhandarët dhjetëshja turke. «Kallajxhiu» shënoi me
dorën e majtë, se edhe tek arma si edhe në shkrim për-
dorte këtë dorë.

Xhandarëve u ranë pendët.

— Dorëzoni armët! — u thirri.

Xhandarët i lanë të dy pushkët në tokë.

— Dhe tani përpara, unë jam Marengleni që kër-
koni.

Xhandarët sa nuk u greminës nga frika.

Ecnin nëpër grykë. Udhë u bëhej më e frikshme,
gryka më e errët. Xhandarët ecnin përpara, Marengleni
me dy pushkë në krah dhe me dhjetëshen turke në dorë
vinte pas tyre. U fliste, i kërcënonte. Xhandarët të hutuar
ecnin, rrëzoheshin e ngriheshin përsëri që të shkonin
më afër postës. Në grykën e Lepushkës, aty ku dy male
afrohen aq shumë, sa që ka mbetur një shteg ku mund të

kalojë vetëm një njeri, aty Marengleni i ndali xhandarët, bisedoi me ta duke e mbajtur dorën tek arma.

Xhandarët kërkonin t'u falte jetën.

— Nisuni, shkoni, por hiqni dorë, mjaft i shërbyet fashizmit, nuk kini turp të viheni nën komandën e marshallit italian? Shkoni dhe njoftoni nënprefektin Margush, i thoni që më keni takuar.

Xhandarët thanë njëmijë fjalë të mira, harruan se ç'kishin folur më parë kundër Marenglenit. Ikën me kokën pas.

— A, prisni, ju duhet të shkoni me armë në postë — u foli Marengleni.

Xhandarët i mbërtheu hutimi.

— Po, me vjen keq, ju jeni shqiptarë dhe keni komandant italian; më vjen keq që shqiptari të shkojë te italianii i çarmatosur.

Xhandari i gjatë me sy larushë e mustaqe të dredhura dhe shoku i tij me pushkët në sup, si pula të lagura zbritën në drejtim të postës, duke marrë me vete porosinë e fundit të Marenglenit: «Po ju shumë përsëri në shërbim të fashizmit, do t'u nxjerrim në gjyqin e revolucionit!»

Kjo ngjarje e hershme ju rikujtua Marenglenit.

— Gjithë jetën mbete qen besnik i Margush beut — i tha xhandarit Marengleni. Drejtohet nga roja partizane:

— Të tjerët i lironi, ndërsa ky të lidhet, duhet të kalojë në gjyq.

5

Netve nga qyteti i Patosit në drejtim të kodrave të Myzeqarët e dinin që beu i Margëllëcit, Margushi, s'shuhej deri sa gdhuhej.

Muzeqarët e dinin që beu i Margëllëcit, Margushi, nga frika se mos e sulmonin në befasi, që prej vjetësh kishte bërë zakon të mos i shuante llambat e sarajit të vet për tërë natën. Sarajet trekatëshe e kishin ballin

nga perëndimi, nga fusha, nga deti. Nga ballkoni beu sodiste mëngjezeve, i mbështjellë me një pelerinë kadi-feje, fushën, livadhet, pyllin e bukur dhe gropën poshtë kalasë. Ç'pyll i madh me ullinj qe rritur në atë vend! «Shtorje» e quanin. Atje mbetej zemra e beut.

Në ditët e luftës, në atë shtëpi gjithë natën qëndronte e ndezur llamba, bëheshin biseda e thureshin plane. Komandanti i forcave të Margëllëcit, dhe i gjithë Malla-kastrës, majori Diter Grebner, shpeshherë flinte në këtë shtëpi, që ishte afër kështjellës. Beu dhe komandanti i forcave naziste të përqëndruara në Margëllëç, majori Diter Grebner, qenë lidhur ngushtë. Net të tëra në sara-jet e beut derdhej rakia lumë. Por ky gaz nuk qe jetë-gjatë. Lajmi se në zonën e Mallakastrës ishin parë lë-vizje forcash të brigadës partizane i tronditi. Komandanti i kalasë, në raste si këto, s'qëndronte asnjëherë në shtë-pinë e beut të Margëllëcit. Ai dilte natën dhe shkonte të flinte në bunkerët e kalasë.

Margëllëçi, fshati dhe kalaja, qenë shkrirë në një pikëmbështetje të vetme. Kishin ardhur edhe forca të shumta mercenare. Komandant mbi të gjithë krerët ishte beu Margush.

Thuhej që ditët e fundit ai qe takuar edhe me gje-neralin Fon Gajb. Beu i Këlcyrës kishte ardhur që nga Tirana në Margëllëç për ta përgëzuar. Mbahej për trim Margushi, e kishte gjithnjë me vete trima. Thuhej që dera e tij nuk kishte nxjerrë ndonjëherë mashkull më energjik, më zemërzi. Të gjithë i nënshtroheshin beut të Margëllëcit. Vetëm njëri nga djemtë e fshatit, djali i asaj këmbëzbathurës Lale, Çeçua, i kishte kundërshtuar. Margushi i qe kërcënuar, i kishte dërguar trimat e tij t'i vinin hekurat. Ai, i biri i Lale këmbëzbathurës, qe kthyer, i kishte goditur me plumba dhe kishte fluturuar në male në çetën partizane të Marenglenit. Çeçua i kish-te dërguar fjalë beut. Këtij i vinte për të qeshur kur dëgjonte kërcënimet e tij. Më vonë, pas viteve dyzet e dy e dyzet e tre, beut filloi t'i dukej sikur i biri i Lale këmbëzbathurës, Çeçua, po i afronte gjithnjë e më shu-

më zemrës së tij grykën e pushkës. Ai qe parë në ato anë e ndodhej diku afër. Ai nuk e dinte që zbuluesi i brigadës, djaloshi çamarok, Çeçua, i dërguar nga Marenngleni, kishte disa ditë që flinte në një kasolle afër shtëpisë së tij, përhapte në forcat armike lajme alarmuese dhe kishte filluar të bënte zbulime për forcat dhe armët, që ishin vendosur në kalanë e Margëllëcit.

6

Në fshatin Lofken komisari thirri komunistët, të cilët i porositi të mblihdnin partizanët dhe t'u shpjegonin rëndësinë e sulmit, që do të shpërthente atë natë mbi Patos e Margëllëç.

Një nga këto mbledhje e kryesonte mitralieri i skuadrës së Refat Arapit, Manoli, që sapo ishte bërë komunist atë ditë.

Fytyra e Manolit kishte marrë një ngjyrë të kuqërremtë, çehret i venin e i vinin, skuqeje e zbehej. Pjesa më e madhe e partizanëve qenë më të mëdhenj nga ai në moshë, ndër ta edhe xha Refati. Ç't'u thoshte! Kishte frikë mos dukej sikur para sulmit shiste mend, pastaj i shkante mendja se mos nuk ja vinin veshin, çdo njeri nuk dinte të fliste para partizanëve, sidomos kur ishte xha Refati që të qesëndiste për asgjë.

— Shokë! — filloi plot emociione dhe i turbulluar. — Sontë, siç e keni dëgjuar, brigada jonë do të sulmojë Margëllëçin. Nesër nga armët tona do të çlirohet Mallakastrë. Për Mallakastrën i ka shkruar komisarit të brigadës sonë shoku Enver. Kështu që sulmi mbi Patos do të jetë një ngjarje nga më të rëndësishmet për brigadën tonë.

Kaq tha me zë të lartë Manoli, pastaj heshti dhe vështroi shokët me shqetësim. Të gjithë e dëgjonin me vëmendje, por Manolit sikur i ikte nga mendja ç'duhej të thoshte, ndaj me zë edhe më të lartë tha:

— Kështu shokë! Do të sulmojmë. — Dhe ngriti lart me dorën e majtë mitralozin, ndërsa, dorën tjetër e mblodhi grusht.

Pastaj u ndezën zjarre. Orën kur do të niseshin e dinte vetëm shtabi. Skuadra e Refat Arapit kishte zënë vend në pyllin me shkurre. Këtë vend era e rrihte më pak. Zjarri i madh bubulak bubullonte në mes të pyllit, duke ndriçuar rrethëqark atë vend dhe një ulli të madh, që ishte aty pranë. Sa lehtësohej reja, shfaqej aty-këtu qielli i kaltër. Edhe Bukuria e Dardani ndodheshin pranë atij zjarri. Refat Arapit s'i shpëtoi nga syri kryqëzimi i vështrimeve të tyre, ndaj hera-herës zuri të hidhte ndo një romuz. Bukuria u bë në fytyrë si shegë, flakë e kuqe.

— I duhet hedhur zjarrit ca dru — tha njëri dhe u ngrit e hodhi një krah karthia. Flakët u ngritën më lart.

— Oho! Ky është zjarr! — tha një tjetër dhe afroi shpinën pranë tij.

— Pse shtyn, o, vetëm për ty është zjarri?

— Ç'më lëshohesh kështu si në dyshekun e dhëndërrisë. Mblidhu, ore birçe!

— Kurrizi m'u bë avull, po këndeje barkun e kam akull.

Për t'u shpirë nga të ftohtët dhe nga lagështia e natës, partizanët e skuadrës së Refatit ja nisën «kungullshës» rrotull zjarrit, që s'e linin të shuhej. Kjo lojë, edhe pse luhej çdo mbrëmje kur ndizej zjarri, prapëseprapë zgjonte interes.

— U dogje! — thirri numri katër. Lojën e fitonte, thuajse gjithnjë, Manoli. S'kishte dhënë tjetër herë «dë-nime» si atë natë. Disa i dënoi të këndonin si gjela, disa të pëllitnin si lopë, të tjerë të mjaullisnin si mace, dhe disa të qanin e të qeshnin njëherësh.

— Mjaft de, mjaft! Ç'pëllet ashtu si ai veshëgjati. Vocua u rrëqeth, kur dëgjoi fjalën e Refat Arapit. Të tjerët u mekën në gaz. Edhe Vocua, si picërroi disa herë sytë, ja dha gazit. Vetëm Zhul Fushbardhasi rrinte i heshtur e i menduar. Edhe ai e kishte humbur lojën dhe tani priste dënimin që do t'i jepte Manoli. Ky ju afrova, ja nguli sytë dhe i tha hijerëndë me vetulla të ngrysur:

— Zhul Fushbardhasi, të erdhi radha!

— ...

U kollit pak, u mendua dhe ja gjeti pyetjen:

— Na thua, si e kupton ti, shoku Zhul, fashizmin.

Ishte bërë zakon që njëri nga pjesëtarët e lojës të përsëriste temën e fundit politike, që ishte zhvilluar në kompani.

«Ku drejtin më gjeti mua kjo pyetje!» mendoi Zhuli dhe fytyra i ndërronte, herë i bëhej flakë e kuqe, herë e verdhë dyllë. Djersë të ftohta i mbuluan ballin.

Në kohën që po bëhej gati të ngrinte duart i dëshpëruar, Dardani ja hodhi sytë Zhulit dhe i dha zemër.

Zhuli nisi të fliste me zë të ulët:

— Fashizmin, shokë, e ka pjellë djalli vetë, të pasurit, fabrikantët dhe, kur deshën, e ndërsyen dhe ja hodhën botës sipër që ta shkatërronin.

— Dre!.. Na qenka bërë komisar, a u vraftë! — thirri Refati dhe tundi kokën. Ndërhyrja pa vend ja këputi mendimet Zhulit... Tani s'dinte ç'të thoshte tjetër. Marengleni që ndodhej midis tyre i shkeli syrin Refatit dhe ky heshti. Si duket, edhe vetë e pa se s'bëri mirë që ja preu fjalën.

Zhul Fushbardhasi filloi përsëri të fliste, po kësaj rradhe çapraz... Më në fund, ju duk sikur e rregulloi, kur tha:

— Ushtari fashist është ujë i verbuar dhe i tërbuar. Prandaj qëllon sa të mundësh, se s'ka drejtësi më të lartë se plumbi, që bie mbi të. — Deshte ta krahasonte fytyrën e tij me beun e Këlcyrës, me dervish Hajrullain, me beun Margush. Edhe ata njësoj si bisha i dukeshin, por nuk foli për ta.

Marengleni qëndronte afër zjarrit dhe dëgjonte me vëmendje, i bëhej zemra mal që djaloshi partizan i porsaardhur e njihte armikun, e urrente dhe i kuptonte drejt qëllimet e larta të luftës.

— Ta urresh armikun, kjo është gjithshka, në do që të jesh partizan trim dhe i vendosur — i tha Çeços Marengleni.

Ishin orët e para të natës. Dikush foli:

— Hej, ju atje, të kompanisë së parë! Pushoni, ore çakej!

U bë qetësi. Refati atë kohë hoqi opingën dhe filloi të rrihte me gur një tel që e vriste. Vocua nxori një numër të gazetës «Zëri i Popullit» dhe, në dritën e flakëve të zjarrit, u mundua ta lexonte. Të tjerët u kalonin sipër armëve nga një leckë.

Marengleni u ngjit te lëndina midis ullishtave, bisedoi me Meleqin e Bardhin dhe komandoi me zë të lartë, dha urdhër:

— Brigada të mblidhet!

— Ç'zë që ka ky Muçua ynë! — tha Refat Arapi.

— Një zë i tillë, për besë, edhe malet i lëviz nga vendi! — Dhe u ngrit e bashkë me shokët shkoi drejt lëndinës ku rreshtohet brigada.

Kolona gjarpëruese partizane dredhon dhe zbret në drejtim të Fierit. Pas mbeten malet që i mbajtën në gjiun e tyre luftëtarët. Ata që këndej zbardhëllojnë nga dëbora, duken si valltarë gunëbardhë që e shoqërojnë në sulm brigadën partizane, duket se ecin edhe malet bashkë me të dhe partizanëve u bëhet sikur janë pjesë e këtyre maleve, sikur edhe ata lëvizin bashkë me to.

Toka kudo është e lagët. Brigada partizane ecën. I drejtohet Patosit. Këpucët e partizanëve ngarkohen me baltë, fundosen gjer në qafë. Këmbehen fjalë:

— Ç'palo punë, sikur s'jemi në rrugë, po në kënetë!

— Pse i thonë «topallti»? Është e shëndoshë toka në Mallakastrën e butë. Ç'i pandehe, ato qarrishtet tona?!

Sa e linte fjalën njëri, e fillonte tjetri.

— Asnjë fjalë! — urdhëroi Marengleni që nga kreu i kolonës.

Fjalët u prenë. Partizanët mundoheshin të ecnin lehtë, ngjitur njëri pranë tjetrit. Marengleni, u largua pak nga rruga dhe prapa një ulliri, pa orën.

— Duhet të ishim në vend. Medoemos duhet t'i zëmë pozicionet natën.

Dhe nata s'priste.

Zëra të ulët:

— Shpejt, shokë, më shpejt!

Arritën te qafa Azër, përballë kalasë së Margëllëçit. Përpara, në horizont vërehej një diçka e zezë, ndër-sa, në thellësi, qielli. Ishte duke aguar. Partizanët nuk i dallonin ende mirë konturet e vendit. Të gjithë vësh-tronin kalanë e mundoheshin të shquanin rrugët e shti-gjet që të çonin atje. Ishte vetëm një rrugë, një rrugë me dredha të panumërta. Kujt do t'i binte radha të ka-lonte në të? Marengleni dha urdhër dhe urdhëri kaloi gojë më gojë:

— Gati!

Pritej vetëm sinjali...

7-8

Brigada marshonte atë natë në tri kolona.

Tri kolona. Tri goditje.

Një parullë: Marsi — Mbaroi.

Në drejtime të tjera shkuan Vogli dhe Goliku. Andej, nga ana tjetër e Vjosës buçisnin topat e brigadës parti-zane. Me forcat e brigadës që sulmonin Margëllëcin, ndejti vetëm Marengleni.

Kompanitë partizane ndodheshin kundrejt objektit të sulmit e ishin gati të hidheshin mbi të. Urdhëri ishte dhënë. Detyrat ishin përcaktuar.

Luftimi do të fillonte, do të zhvillohej këtu, në fsha-tin Margëllëç, në kala. Do të bëhej ky luftim sipas planit të përgatitur prej Marenglenit. Ky ishte munduar që t'u sqaronte shokëve të tij çdo gjë. Kishte disa ditë që e kishte bluajtur në mend sulmin mbi Margëllëç. Gjith-një në këto mendime ai kishte dalë fitues mbi armikun. Dhe, i shtrirë në pozicion bashkë me partizanët e briga-dës, mendonte po atë plan. Ai kishte besim te partizanët e partizanet. Pas pak lëvizi dorën e djathtë, nxori armën shenjdhënëse, i vuri fishekun dhe përsëri vrojtoi me kujdes.

Çdo gjë ishte gati!

Marengleni e dinte që edhe kundërshtari kishte bërë planet e tij; kishte dhënë urdhërin që të mbahej me çdo kusht Margëllëçi.

Kush do ta fitonte atë përleshje?

Përpara i dilte një pikëpyetje, një pikëpyetje që shkrihej në trupin e kështjellës së lashtë, në grykat e armëve dhe në guximin e njerëzve. Megjithatë...

— Po — tha me vete — lufta është, para së gjithash, një ndeshje e mendjeve, pastaj e armëve. — Dhe këtë ndeshje me majorin Diter Grebner, Marengleni nuk e kishte të parën. Forcat e brigadës partizane disa herë qenë ndeshur me forcat, që komandonte majori Diter Grebner. Që ditën e parë kur u formua brigada partizane, komisari ja kishte mësuar këtij majori huqet që kur ishte ndeshur me forcat e tij në Kosinë të Përmetit. Atë ditë pak gjëra kishte mësuar Marengleni për majorin Diter Grebner dhe tani Marenglenit do t'i qe shlyer, thuajse fare nga kujtesa, emri i këtij majori nazist, po të mos qe një nga kompanitë e batalionit të tij në Tepelenë. Komandanti i asaj kompanie ishte zënë rob dhe Marengleni kishte dëgjuar shpjegimet e tij. Majori Diter Grebner komandonte edhe nënreparte të tjera, por forcat e tij i kishte përqëndruar në Margëllëç.

Me këtë njeri qe ndeshur me mend në kështjellën e Margëllëçit. Marengleni «sulmonte» e «mbrohej», kështu dhe nazisti Diter Grebner.

«Çdo sakrificë, sido që të jetë», mendoi, «kur vihet në shërbim të shfarosjes të së keqes është e domosdoshme. Ndryshe në mes të njerëzve kurrë s'do të ketë liri e lumtëri, po robëri, varfëri, dhembje e lot».

Dikush foli afër komisarit, në pozicion.
— E shikoni zjarrin e ndezur?

— Shëëët! Shëëët! — ja bëri një i dytë.

— Dëgjova zë — thirri një tjetër.

— Pusho, mbylle gojën!

Marengleni shtrëngonte në dorë pistoletën shenjë-dhënëse.

- Më ngjan sikur na kanë zbuluar, shoku Marenglen.
— Jo, nuk e besoj — tha zëvendëskomisari i batalionit, Bardhi.
— Të nisemi?
— Grupi i sulmit?
— Po.

Bisedoi për detyrën, që i qe besuar komandant Meleqit. Marengleni e njihnte karakterin e rrëmbyer të Meleqit dhe e porositi:

— Ki kujdes... veten duhet ta ruajmë! Të hidhemi drejt rrezikut vetëm atëhere kur duhet, jo në çdo rast, me vend e pa vend. Më kupton, Meleq?

Tjetri e dëgjonte me vëmendje të madhe.

— Ja ku e ke edhe këtë trimin. — Dhe Marengleni i foli Çeços, që erdhi më pranë.

— Ky i di të gjitha pozicionet, shtigjet e rrugët dhe me siguri do t'ju çojë atje, midis bunkerëve të armiqve. Nisu, Meleq, ki kujdes, vëlla, ki kujdes, o... — e mbajti veten, nuk e përmendi fjalën «trim», se trimi fyhet, kur ja përmend trimërinë.

Njëzet partizanë me Meleqin, nëpër errësirën e natës, u drejtuan nga kështjella. Komisari shikoi andej, ata nuk shikoheshin ndaj e hodhi vështrimin në lartësi. Margëllëçi është prerë kryq e tërthor nga llogore. Mbi kala, sipër, midis sheshit, ngrihen si gunga deveje, fortinot. Brenda në fortino janë vendosur mitraloza dhe ushtarë gjermanë. Përballë, andej nga do të sulmonin partizanët, një buzë mbi njëzet metra shtrihej para kalasë dhe mbeteshin vetëm dy anët nga ku mund të ngjiteshe në të. Në këto vende komandanti nazist Diter Grebner me ushtarët e tij kishte përgatitur dy qendra zjarri. Në një-rën prej tyre ai qëndronte edhe vetë. Ishte një kullë e

nëndheshme, e ndërtuar shekuj më parë, kushedi se kur, me tulla të trasha, ndoshta që në kohën kur ishin ngritur themelet e kalasë. Në atë vend ishin struktur ushtarët. E kishin përgatitur vendin si në kazermë: atje flinin, atje kishin nxjerrë nga ana e malit frengji për mitraloza «shars», nga ku shikohej gjithë krahina. Ato vende i vështronte një për një me dylbi komisari i brigadës. Drejt tyre u nis Meleqi.

KAPITULLI I NENTË

S'ka ç'i bën flaka këtij vendi. S'mposhet revolucioni, nuk shterojnë radhët tona. . . Edhe shtëpi të reja do të bëjmë, edhe puse të reja do të çelim, edhe njerëz të rinj do të rritim që të mbushim radhët. Ne nuk do të thahemi, nuk do të zhdukemi kurrë!

1

Beu i Margëllëçit, Margushi, kishte fytyrë vrarëlie, të hequr e nervoze, vinte i gjatë në trup dhe jo me shëndet agai, apo beu. Pantallonat kilotë, çizmet lustrafin, xhaketa e oficerit, gjithshka që mbante veshur i kishte prerë e qepur në Romë dhe, ishin rrobe të bukura ushtarake, që as majori Diter Grebner nuk i kishte. Gradat e kishte bërë rregull të mos i mbante, ngaqë atij si bej dhe njeri që kishte nën komandë një pjesë të madhe forcash në rrjedhën e Vjosës, i dukej e vogël grada kapiten. Thuhej që në përpjekje qëndronte në vijat e para të luftës, por në të vërtetë, sado që ishte komandant i disa batalioneve mercenare, nuk ishte ai që mbahej. Tregohej trim dhe i egër, por, kur ndjente rrezik, bëhej pulë. I qe dredhur zemra, kur i thanë që brigada e Marenglenit po i afrohej Margëllëçit, megjithatë e ruante veten që të mos binte në sy dhe kishte vendosur që të mos tërhiqej i gjallë. Ky vendim e kishte bërë edhe më të egër.

Forcat e beut Margush ishin vendosur në krahun e

majtë të kalasë, te disa shtëpi majë kodrës, nga ana e Roskovecit. Ishin mbi treqind ballistë të mbledhur kokë më kokë, me pushkë e mitraloza në duar që qëndronin natë e ditë në përgjim.

— I kishte mbërthyer frika. Dy nga rojet, që qëndronin te mitralozi, pyesnin njëra-tjetrën:

— Mos na vijë këtu brigada partizane?

— Jo, askush nuk guxon t'i afrohet kësaj kalaje. Ku lë gjermani të preket Patosi? Në mos rrjedhtë, pikon ky i shkretë vend. Gjithnjë duhet benzina e nafta, po në luftë u dashka më shumë. Dëgjo këtu, edhe mbretëria më e madhe s'e bën dot luftën pa naftë.

— Dhe, dëgjo, po erdhën, dorëzohu me dyfekun e parë. Bile është më mirë që të mos e zbrazësh fare. Kam dëgjuar që komunistët të marrin erë në grykë të dyfekut. Po vjen era barut, thonë: «Ka qëlluar plumbin e kallamidhën. Ama s'ke shtirë? Mos u tremb, asgjë s'pëson!

— Si the? — shqeu sytë tjetri. — S'pëson asgjë? Jo, more jo, në luftë digjen bashkë bari i thatë me të njomin. Kam frikë.

— Kam dëgjuar që komunistët zgjedhin.

— Si zgjedhin?

— Nuk i vrasin me radhë... krerët, ata e kanë keq.

— Kush?

— Beu, që është bërë me gjermanët. E pe si që zbehur dje zoti Margush?

— Partizanët s'i kanë për t'i lënë gjermanët t'ja thithin lirisht naftën Patosit. Ndonjë ditë do të dalin këtej. Ç'ditë do të jetë ajo, një dreq e di!

— Në Molisht, në një kohë si kjo sulmuan.

— Jo, binte shi dhe ishte ditë, jo natë.

— Dëgjove, për fat kishte shpëtuar nga plumbi beu Margush.

— Edhe këtu kanë filluar t'i dridhen leqet e këmbëve. E kanë mirë komunistët. As nga një kral i botës s'janë trembur kaq shumë bejlerët. Këta u a bënë tetë me dy, na, ua bënë!

Befas u dëgjua një krismë mitralozi. Plumbat gjurmëlënë të «sharsit» shkuan andej nga partizanët.

— Kundër kujt qëllonjë? — pyesnin të trembur e të habitur rojet.

— Kot qëllonjë, kanë frikë.

— Janë shenjat e para të përmbysjes së një mbretërie. Kështu nisën të bënin edhe ata këmishëzeztë e Duçes. S'lanë armë pa zbrazur e s'vonoi dhe e thyen qafën me gjithë kryetarin e tyre. Edhe beu Margush s'është në vete. Shenjat tregojnë se luftën, o vëlla, do ta fitojnë komunistët.

— Mundet! Veç Patosi do të bjerë i fundit.

Ata bisedonin dhe as dëgjuan që afër tyre kaluan një e nga një Meleqi dhe shokët e tij, të cilët u ngjitën drejt lartësive, drejt bunkerëve.

Krisma e mitralozit e ngriti nga shtrati Margush beun, që u vesh e u ngjesh në armë dhe doli nga pozicionet. Ishte bërë si rregull që para se të gdhihej, «sharsi» gjerman të zbraste disa shirita me fishekë si për të lajmëruar: «Këtu jemi». Këto krisma si gjithnjë e ngritën nga shtrati. Ai, u drejtua nga pozicionet. Kur u afrua te rojet, i vështroi gjithë inat. I kapi nga jaka, u tregoi pozicionin dhe ju kërcënua:

— Zini vendet, qelbësira!

Ndërsa beu shkoi në pozicione të tjera, ata të dy filluan të bisedonin përsëri.

— C'i qenë skuqur sytë ashtu?

— Edhe sytë e tij më ngjajnë si gjëmba që të shpojnë.

— Frika, o byrazer, të bën esëll, e ndjen rrezikun. Përsëri u dëgjua krisma e mitralozit.

— Kot së koti — thanë të dy ballistët dhe u mbështetën në anën e llogores. Pastaj heshtje...

— Komisari i brigadës partizane, Marengleni, që ishte në pozicion nxori nga një këllëf meshini një palë dylbi artilerie dhe me një kadife të butë pastroi xhamin e tyre, pastaj vuri lentat në numrin e syve të tij dhe, si

largoi gjethet me dorë, mbështeti bërrylat dhe vështroi nga kalaja që i erdhi shumë afër. E kaloi shikimin nga njëri skaj i kështjellës në tjetrin. Nga kjo fortesë, ushtarët e nazistit Diter Grebner ishin strukur si grenxat në zgarbull dhe herë pas here dilnin, sulmonin fshatrat dhe, si i digjnin, vrisnin e grabisnin, ktheheshin përsëri në follenë e tyre. Kështjella qëndronte si një ankth i zi në shpirtin e njerëzve.

— Këtë tumor që mbiu midis kësaj krahine duhet ta presim medoemos, ta shkulim nga rrënjët — u tha partizanëve të brigadës Marengleni kur foli për kështjellën e Margëllëcit. Ai nxori nga këllëfi pistoletën, vuri dhe lëshoi një fishek të zjarrtë në drejtim të kështjellës. Një një kohë me atë fishek ndriçues u nderzën në trupin e kështjellës xixa flakësh, ato shikoheshin nga të dy anët dhe me sytë e mendjes kushdo përcaktoi pozicionet që kishin zënë mbrojtësit dhe sulmuesit. Flakët nga të dy palët shuheshin dhe ndizeshin në të njëjtën kohë.

— Fojer! Fojer!!) — thirri nazisti Diter Grebner dhe shtrembëroi fytyrën, u zgërdhesh dhe mustakët e prerë shkurtër për të imituar prijësin e tij, Fyhrer, ju ngritën drejt si gjemba.

Gjethet dhe shkurret rreth kështjellës u grinë nga plumbat. Me forcën e zjarrit të armëve kështjella i mbërtheu në vend sulmuesit. Nazisti Diter Grebner zgërdheshej.

Po të ecnin partizanët më përpara, kështjella do t'i godiste me gjithë forcën e saj, po të hiqeshin pas, ajo përsëri do t'i godiste. Marengleni vuri re se kështjella si një kafshë e egërsuar kishte ngritur krifën dhe gatiti armët e qëndronte në përgjim, e gatshme të villote plumba e predha sapo të afroheshin partizanët.

— Duhet ta shkulim nga vendi përbindshin — thirri Marengleni dhe u hodh në drejtim të kështjellës.

Mijëra xixëllonja plumbash kryqëzoheshin mbi trupin e kështjellës.

1) Zjarr! (gjerm.)

Një shenjës tjetër, si një lule e kuqe, ngrihet mbi lartësinë, mbi kalanë, mbi fortinot. Ishte sinjali, që hidhte përsëri Marengleni.

Vendi ndriçonte. Partizanët, të hapur në formacion luftimi, sulmonin.

Kompanitë partizane dhe çetat vullnetare nga Mallakastra vraponin nëpër shkurret e dendura, nëpër rrëpirat. Grupi i Mallakastrës sulmonte në të majtë të forcave të brigadës.

Në kala mitralozat e armikut qëllonin edhe më dendur.

Vija e sulmit u shkurtua nga pesëqind metra në katërqind...

— Mirë... shumë mirë! — thoshte me vete Marengleni. Pastaj:

— Mortajat të godasin mitralozat në krahun e djathtë!

— ...

Partizanët sulmonin më këmbë. Edhe pesëdhjetë metra i shkuan më afër kalasë. Pastaj në kala u zbrazën të gjitha armët. Fishekë gjurmëlënës goditnin formacionin partizan. Ata nguleshin në tokë ose shuheshin lart në qiell...

Oshëtima e armëve ndihej kudo, në çdo fshat të Mallakastrës. Dhe në Myzeqe e në Fier u dëgjuan ato krisma, u panë ato shenja të kuqe. Kudo dëgjohej:

— U sulmua Margëllëçi!

— Ai që ka kalanë e Margëllëçit në duart e tij, ka celësin e Myzeqesë. Zor ta lëshojnë gjermanët.

Ballistëve, megjithëse qenë me shumicë në kala, nuk ua dëgjonte kush zërin.

Brigada partizane përparonte.

— Përpara! — buçiti përsëri zëri i komisarit të brigadës.

— Përpara, kompania jonë — foli vogëlushi Voco që vraponte rrugicave të fshatit.

— Përpara, — foli zëvendëskomisari i batalionit, Bardhi, dhe doli në ballë të sulmit.

Refat Arapi si një qen i fortë stani, që, sapo e lëshon, sulet në heshtje mbi egërsirën, u afrohej llogoreve të armikut.

Ju afruan edhe më pranë kalasë së Patosit... Dyqind metra përballë pozicioneve fillonte e përpjeta. Partizanët ngjiteshin këmbadoras. Në formacionin luftarak të partizanëve binin predhat e baterisë së mortajave armike, që ishte vendosur në pozicionet prapa kalasë. Qëllonin edhe topat prej njëqind e pesëdhjetë milimetrash. Më parë përhapej oshëtimi e tyre, pastaj fishkëllenin predhat mbi partizanët, në kodrat përçark.

Partizanët u afruan edhe pesëdhjetë metra të tjera. Borizani i brigadës, Nauni, lëshonte sinjalet e i nxitte shokët të shkonin më përpara. Dëgjoheshin zëra:

— Përpara, t'i zëmë me dorë!

Ushtonte boria e Naunit dhe armiqve u bëhej thirrje të dorëzoheshin.

Partizanët kishin përparuar e kishin zënë disa shtëpi, ku më parë qenë ballistët. Erdhi atje edhe Refat Arapi, që gjithmonë mburrej se kishte marrë në Tepele në automatikun e kapitenit gjerman. Ndërkaq ai doli përballë mureve të kështjellës dhe shokët e panë me një alamet karakatine të gjatë në dorë.

— Po atë shul, ç'e ke, ku e gjete?

— Shul! Ç' thua, Dardan, ky është dyfek, ore.

— Po automatikun ç'e bëre?

— U nxeha, më plasi shpirtin, ore, hë të bëja zjarr e s'ka, më ngeci dhe më ikën nëpër duar disa ballistë. Do të isha turpëruar për hiçgjë, por i lumtë Vocos, që ja la vejushë gruan ballistit dhe me fishekun e parë e mbajti në vend, ndërsa unë u hodha e i rrëmbeva pushkën e fishekët dhe këtë grykëflamosurin, që më ngeci, e hodha krahaqafë. Tani e tutje s'kam për ta hequr më dyfekun nga dora, këtë automatik do ta dorëzoj dhe ta marrë kush të dojë. Pastaj Refati shkoi më tutje, ndërsa Vocua i kishte mbërthyer sytë andej nga u panë disa

lëvizje. Ata, pasi këmbyen vështrimet, drejtuan grykët e armëve andej nga menduan se ishin ushtarët gjermanë.

— Nuk dorëzohen burrat aq kollaj, o këlysh komunist! — foli një zë nga shtëpia.

— Oj, — tha Manoli i Gole Përmetarit — qenkan ballistë në këtë shtëpi. O burra, mbi ta! — u thirri shoqëve dhe humbi midis ullishtës. Ai doli në anë të një ledhi prapa shtëpisë, por ja prenë hovin plumbat.

— Manol, ki kujdes!

Manoli e uli mitralozin me shpejtësi, i shtrëngoi këmbët mirë në tokë dhe zbrazi karrikatorin e parë.

Partizanët zënë vend nëpër trungjet e ullinjve dhe qëllojnë. Në dritaren e shtëpisë del një flamur i bardhë.

— U dorëzuan!

— Ki kujdes, shoqe, ki kujdes, Bukuri, mos luaj nga vendi.

U thirrën:

— Dilni përjashta, dorëzohuni!

Në derën e shtëpisë doli një burrë me duart përpjetë. Gjashtë të tjerë e ndiqnin pas.

— Merruni shulet e pushkëve. Hiquni bombat nga xhepat!

Shtatë burrat qëndronin me duar lart e vështronin partizanen, që u kishte drejtuar armën.

Ndërsa në fshatin Mërgëllëç po vraponte një varg partizanësh që komandohej nga zëvendëskomisari i batalionit, Bardhi, komunistët dolën në radhët e para të sulmit. Në pozicionet e armiqve hidheshin granata dore. Zëvendëskomisari i batalionit, Bardhi, u plagos. Plumbi ja bëri copë krahun, por ai vazhdonte të ecte me partizanët dhe të thërriste:

— Përpara!

Skuadra partizane e Refatit kaloi midis shtëpive të kreut të fshatit. Edhe zëvendëskomisari, sado që i plagosur, shkonte andej.

Një ballist u largua duke vrapuar. Refat Arapi e qëllloi me pushkë dhe e goditi. Ballisti i plagosur hyri në një shtëpi. Partizani u vu në kërkim të tij. Refat Arapi

arriti atje pas disa minutash dhe, si tufan, hyri në shtëpi. Ishte i lodhur e diaste. Si pushoi cazë, vendosi armën në parmakun e dritares dhe qëlloi në drejtim të kalasë. Kur po i ndërronte armës krehërin e fishekëve, dëgjoi një rënkim, që vinte nga një vozë e madhe, që gjendej në anë të derës së shkallmuar të dhomës.

— Po ti këtu?! — ju drejtua atij, që rënkonte. Refati i drejtoi pushkën sikur do të qëllonte. I foli:

— Po ti, ç'bën këtu?!

Ballisti dëgjonte i topitur. E vështronte në sy partizanin dhe kërkonte mëshirë.

— Ku të ka marrë plumbi? Do të qe mirë që të të kishte marrë në të majtë, të të kishte çarë zemrën. E pse të rrosh?

Prapë i shkrepën sytë, ju ngrit damari midis ballit, lëvizti në duar pushkën; i vuri në gojë plumbin...

Megjithatë Refat Arapit i ra zemërimi dhe i erdhi ndoht nga ballisti i mbledhur kruspull në vozë, që ishte zbehur e bërë dyllë i verdhë në fytyrë, ca nga plaga e ca më tepër nga frika.

Refat Arapi i foli prerë:

— Besoj se ky plumb të ka shtënë mendtë në kokë.

— Pastaj e la ballistin atje dhe doli te dritarja.

— Oh, harrova, Voco, hiqja pushkën birut të dreqit.

3

Në kryqëzimin e rrugëve të fshatit, në perëndim të kalasë, u panë dy njerëz të armatosur, që vinin me vrap.

— Tanët duhet të jenë — tha Bukuria, që ishte veçuar nga të tjerët dhe mbajti këmbët. Një nga ato hije, që vraponte sokakut, u rrëzua. Partizanja pa flakën e një arme, pastaj dëgjoi që dikush po i thërriste. E njohu nga fjalët që nuk ishte nga partizanët. Dhe e mori me mend që ato dy hije ndiqnin vetëm atë, Bukurinë. Si i shkrepëtinë sytë vajzës! S'qe e zonja atë kohë të fliste

një fjalë, a të bënte gjë. E mbërtheu hutimi. Kjo ndodhi vetëm një çast, pastaj ajo vrapoi dhe u hodh prapa le-
dhit. Një nga ushtarët e ndoqi pas dhe Bukuria, pa ma-
rrë shenjë qëllloi. Ushtari bëri disa hapa dhe u përplas
me fytyrë në kalldrëm. Bukuria, që atë kohë i kishte
vënë në gojë fishekun tjetër pushkës, u ngrit nga vendi.
«Më duket se e vrava» tha me vete. Kaloi dhe një ledh e
mori sokakun përjetë. Atje prapë ushtarët i thirrën
të dorëzohej dhe e qëlluan me armë. Ajo, si një sorkadhe
e trembur nga pushkët, vrapoi nga kalaja, andej nga
kishin shkuar shokët e skuadrës së saj.

— Prit, moj Bukuri, ku shkon?

Zërin e Dardanit e solli era deri tek ajo. Pa që Dar-
dani u hodh e zuri vend dhe ajo vrapoi pranë tij. Ai
fliste dhe pastaj qëllonte me automatik, ndërsa Bukuria
me pushkë.

— Ndërrojmë pozicion, Dardan?

— Jo! Ki kujdes e mos dil mbi ledh.

Përlëshja bëhej nga afër, por Bukuria, për çudi,
ndjente një siguri të madhe. Atje, në krah të saj, qën-
dronte Dardani.

— Ti qëndro këtu!

— Ku po shkon, Dardan?

— Duhet të dal më lart, tek ai ulliri në anë të kësh-
tjellës. Që andej mund t'i ndihmoj shokët. — Dhe u ngrit,
po e qëlluan sapo u shfaq. Në fillim qëlluan me mitraloz,
pastaj edhe me pushkë. Megjithatë ai shkante përpara
në mes të plumbaëve.

«Po sikur të vritet, a të plagoset?!» mendoi ajo.

Dardani shkoi disa metra më tej dhe u ul për një
çast në një gropë.

— U vra! — tha e trembur Bukuria, kur nuk e pa
më me sy. Për pak klithi, por sytë i vanë te Dardani,
që zbrazti armën duke u ngritur. Edhe ajo shkoi prapa tij.
I dhimbsej ai njeri, të cilin në ditët e operacionit e kishte
mbajtur dhe ajo në shpinë, mal më mal. Dëshira e saj
atëhere ishte një e vetme: ta shpëtonte Dardanin e pla-
gosur. Po ai prapë që në rrezik, përsëri mund të merrte

në trup shtatë a më shumë plagë. Sa të rënda e rrëqethëse i dukeshin në ato çaste krismat e armëve të nazistëve. Qëlloi me armë kësaj radhe pa marrë shenjë dhe u hodh përpara e thirri:

— Dardan! Dardan! — po nuk mori përgjegje.

Dëgjonte vetëm krismat... Kalonte anës murit të kështjellës, andej nga kishte kaluar edhe Dardani. Po pse nuk po ja dëgjonte krismen pushkës së tij?! Mos ishte plagosur?! Do të donte më tepër ta merrnin atë plumbat, se sa Dardanin. Pas pak e pa që ai i kishte vënë krahun trungut të një ulliri dhe qëllonte me automatik. Kjo e qetësoi.

— Dardan! Dardan! — thirri dhe vrapoi andej nga kishte ikur ai nën breshërinë e plumbave, që vinin nga drejtime të ndryshme. Ajo vazhdonte të ecte përpara duke lëvizur këmbadoras.

Dardani atë kohë pa se si një ushtar gjerman, që u hodh si një top futbolla, kapërceu një gur, kaloi disa shkurre dhe i preu rrugën Bukurisë. Priste gjermani që t'i vinte partizanja në grykë të pushkës. Dardani s'pati kohë as të fliste, as të qëllonte me armë, po u hodh drejt fashistit, dhe, pasi u panë sy në sy për një çast, u sulën kundër njëri-tjetrit. Kush do të ishte tani robi? Dardani u hoq anash, dredhoi dhe, duke përfituar nga lartësia, u hodh mbi të. Muskujt ju tendosën. Atje që mbledhur tërë forca e njeriut, që hidhej drejt zjarrit për të mbrojtur idealin dhe për të shpëtuar njeriun, që e donte aq shumë, Bukurinë. U hodh mbi të si një shqiponjë.

— Dardan, Dardan! — foli Bukuria.

Me sa dukej, partizani e përfshiu ushtarin, sepse e shtrëngonte në fyt fort e më fort. Fytyra e fashistit u zbe si dylli, sytë ju errën. Dësh të thërriste, të kërkonte ndihmë. Po edhe zërin më të lartë e mbysnin krismat e armëve dhe nga buzët e zbeta e të fishkura, që dridheshin nën peshën e trupit të Dardanit, doli vetëm një rënkim i mbytur. Bukuria e vështronte drejt në sy si një kunadhe e gëzuar dhe e trembur njëkohësisht. I thirri:

— Dardan, Dardan!

Në fillim majorit nazist i qe dukur sikur s'do të kishte forcë që ta ngrinte nga Margëllëçi. Po, kur i thanë që nga ana e majtë kishin dalë partizanët, u bë xhind e mend ja numëroi në ballë ushtarit, që i solli lajmin. U ngrit dhe doli përjashta. Kurrë nuk kishte besuar që të binin në duar të partizanëve aq shpejt ato qendra zjarri. Po ja, andej drejt bregut, po vinin partizanët.

— Plumbi e pret, plumbi! — tha për kryetarin e çetës balliste, pasi nuk e dinte që beun Margush e kishte marrë plumbi që në pushkët e para. I rrëmbyer nga zemërimi, ashtu siç u ngrit në çastin kur sulmuan partizanët, me rripin ende të pambërthyer dhe me fytyrë të prerë, kaloi sa nga një anë e kalasë në tjetrën dhe ulërinte si ujk i plagosur:

— Jo, kjo s'më besohet! Kaq shpejt u ngjitën në kala?! Si është e mundur kaq shpejt?!

Urdhëroi që në drejtim të shtëpive të vendoseshin dy mitraloza të tjerë. Në pozicionet e para u dërguan kasa të tjera me granada dore. Të gjithë ushtarët i nxori në pozicione. Urdhëroi të digjeshin trupat e disa ushtarëve, që ishin vrarë. Pastaj komandanti i kalasë, nazisti Diter Grebner, u fut në bunker e kërkoi përsëri në telefon. Sa doli andej, dëgjoi predhën e topit, që kishte plasur diku afër. Nga shpërthimi u drodh vendi. Ishte topi i kalibrit të madh. Doli të shikonte me dylbi. Dy predha të tjera ranë po atje. Predhat binin në pozicionet e partizanëve. Krismat drithëruan ajrin.

— *O sehr gut!* 1) — tha komandanti gjerman i Margëllëçit.

Përsëri qëllonin topat.

Sulmi i brigadës partizane ju duk në fillim i shpejtë dhe i papërmbajtur, i ngjante me turrin e një shqiponje, por tani që rreth kështjellës goditnin topat dhe mijëra plumba të ushtarëve të tij, ai u bind se shqiponjës do t'i thyheshin krahët nga predhat e plumbat dhe do të për-

1) Shumë mirë (Gjerm.)

pëlitej atje poshtë, në fund të kështjellës. Nuk dyshoi më, u bind që ushtarët e tij do t'i bënin ballë sulmit të brigadës partizane, ndaj, kur në formacionin luftarak të brigadës ranë breshëri predhash artilerie, majori Diter Grebner i gëzuar tha:

— Atje! Lajmëroni me telefon që të hapë vazhdimisht zjarr artileria në atë vend.

Një nënoficer shkurtabiq vrapoi te bunkeri që të fliste në telefon.

* * *

Nazisti Diter Grebner e dinte që gjer atje sipër në majë, ku ishte vendosur ai me ushtarët e tij, do të ishte vështirë që të ngjiteshin partizanët. Ai vetë e kishte provuar disa herë dhe gjithnjë i qe sosur fryma dhe e kishin mbuluar djersët; kishte pasur frikë nga ai vend i thepisur. Humnerë i qe dukur vendi dhe, për çudi, drejt kësaj humnere po sulmonin partizanët e Marenglenit. Kjo i dukej më shumë një vetëvrasje. Asaj ane kështjella ishte e paarritshme.

Ai nuk e dinte që disa partizanë natën ishin ngjitur në kala, sapo kishin nisur pushkët e para dhe ishin fshehur nëpër kaçube. I ngjiten Meleq Gësnishti me shokë ato pjerrësi me duar e këmbë dhe tani ata u qëndronin mu pranë fortinave.

Atë kohë Manoli i Gole Përmetarit doli në pullazin e një shtëpie. Në horizontin pa re, kalaja, si gjithnjë, dukej si një masë e zezë amorfe. Nga ai vend i lartë Manoli vrojtonte përpara; dallonte pozicionet ku ende qëndronin ushtarët armiq. Manoli s'e rreshti zjarrin me mitraloz. Brigada e njihte krismën e mitralozit të Manolit. Sa e dëgjonte këtë krismë Refat Arapit, i kujtohej Çerçiz Fejzua dhe murmuriste me vete: «Ç'djalë e për kokë të djalit që ishte!»

Në pozicionin e ushtarëve gjermanë bien plumba e bomba. Topat godasin edhe më dendur... shpërthejnë predha të rënda në tokë, ndërsa në qiell shpërthejnë sha-

rapnelat. Disa partizanë plagosen, por qëndrojnë në rresht, i durojnë dhembjet. Kalaja mësyhet nga afër. Qëndresa e armikut lëkundet. Përsëri komisar i brigadës, Marengleni, thërret:

— Me dorë, me dorë! — Dhe ngrihet në këmbë, zbraz armën... sulmon!

5

— Kur i bie armikut në të tilla vende, është njësoj sikur e godit në zemër, — u thoshte Marengleni partizanëve — prandaj me çdo kusht duhet t'i përzëmë gjermanët nga Patosi e t'u marrim kalanë! T'u marrim pusët!

Komisari i brigadës, Marengleni, erdhi në afër vijës së parë dhe e ndiqte me interesim këtë sulm, duke e vështruar me dylbi... Merrej një lartësi nga partizanët e brigadës, apo të grupit të Mallakastrës dhe ai e shëmonte atë në hartë...

— Çdo gjë shkon në rregull, ashtu si u mendua, si e planifikuam, shoku Marenglen!

Ky nuk fliste derisa ende nuk qenë marrë ato dy fortinot sipër kalasë, se ende nuk qenë shkukur nga pozicionet ushtarët gjermanë. E dinte që do të qëndronte deri në fishekun e fundit nazisti Diter Grebner, pastaj nuk ishte lehtë të ngjiteshe në kala. Shpresonte Marengleni në forcat e Bardhit që kishin dalë nga ana e fshatit, shpresonte në grupet e sulmit të komandantit Meleq.

Pse vallë nuk ja dëgjonte zërin Meleq Gosnishtit? Mos qe vrarë? Jo, këtë nuk e besonte. Sa e sa herë qe futur midis armiqve Meleqi dhe qe kthyer shëndoshë e mirë, sa herë në çastet më kritike ai qe hedhur si skifter midis tyre dhe luftimet papritmas kishin ndërruar në dobinë e partizanëve. Po kësaj here pse s'po ndihej ende Meleqi me shokët e tij? Kishte ardhur koha apo jo, kur aty, në gur e në shkëmb të kalasë, të jepej goditja?! Kjo nuk po bëhej.

— Ja, një e papritur e luftës — mendoi Marengleni.

Po mbusheshin disa orë që përleshjet në Margëllëg bëheshin nga afër.

Marengleni u mundua t'i zotëronte ndjenjat, që e shtynin të shkonte më afër vijës së parë.

— Duhet të drejtosh luftën, ç'vlen një automatik më shumë në vijën e luftës? Asgjë! Ndryshe qëndron puna e të drejtuarit. Lufta nuk kërkon vetëm trimëri, do edhe mend. — Kështu e këshilluan. Po ku ishte guximi dhe heroizmi?! Ku? Ai e ndjente veten ende larg nga vijat e para të sulmit, larg nga predhat e plumbat.

Marengleni gjithmonë u thoshte shokëve që në marrjen e vendimit gjyko pa vepro, mat pastaj pre, por, për zbatimin e atij vendimi që merr, shkathtësohu, bëhu më i guximshëm! Ndaj u ngrit në këmbë e u hodh përpara. Kaloi përmes plumbave e shkoi nga kompanitë, që ngjiteshin në kala. Arriti në vijën e parë.

— Guxim, o vëllezër, guxim!

Partizanët e shikojnë. Fjala u jep zemër. Komisari i brigadës ishte me ta, në sulm. E shihnin, e dëgjonin Marenglenin dhe besonin që punët do t'i kishin edhe më mirë.

Ndërmorën edhe një sulm tjetër...

6

Në shpatullën e majtë të lartësisë, përmes shkurreve e gjetheve, sulmonte partizani i skuadrës së Refat Arapit, Zhul Fushbardhasi. Ai ecte në krah të një mitralieri, në krahun e komandantit të kompanisë, Saminit, në një radhë me komisarin e brigadës.

Zhuli priste një çast sa mbaronte breshëria e mitralozit armik dhe ngrihej, sulmonte nëpër plumbat e thërriste:

— Para, partizanë!

Borizani i brigadës, Nauni, i binte borisë me të gjitha forcat. Sinjali i sulmit i çoi peshë zemrat e partizanëve dhe e rrëqethi edhe më shumë armikun.

Zhul Fushbardhësi u ngrit përsëri nga pozicioni, thirrri dhe u hodh përpara.

Ishte duke u ngjitur përpjetë kalasë. Pranë pa komisararin e brigadës, që sulmonte, qëllonte me automatik dhe ndërkohë ndalej, u vinte veshin krismave të armëve e mundohej të dallonte vijën e luftimeve. Në kala vështronte herë partizanë e herë ushtarë nazistë. Me zë të lartë komisarari komandonte:

— Përpara, vëllezër!

«Komisari! Komisari!» murmuriti Zhul Fushbardhasi dhe më me energji u hodh përpara. Ecte nëpër tym e plumba dhe, sa ndalej, shikonte në krah të tij komisararin, që zbrazte automatikun ose qëndronte e shikonte vendet, dallonte krismat, shikonte ku ndodheshin forcat e brigadës, sepse ai e di që peri i ngatërruar nuk zgjidhet duke u ngutur, ndaj mendohet.

Kompania ku bënte pjesë Zhul Fushbardhasi arriti në afërsi, në themelet e kalasë... Ushtarët gjermanë hidhnin granada dore. Shumë afër pozicioneve të armikut ai zbrazti gjashtë herë me radhë pushkën. Nga të gjashtë plumbat, njërin e pa që nuk i shkoi bosh. Atë çast e pati pisk Zhul Fushbardhasi... një ushtar gjerman e kishte marrë në shenjë. Ky e vështronte partizanin me sy të zgurdulluar e të skuqur. Një çast Zhuli u drodh. Ndjeu në gjoks një dridhje të çuditshme e të paprovuar ndonjëherë. U bë dyllë i verdhë. Në këto çaste ju kujtua fjala që i kishte thënë Refati. «Po u zbehe si ftua nga plumbi, do skuqesh nga fjalët, prandaj zgjidh e merr, bir i xhaxhait». Mendoj t'i vinte pushkës ballin tjetër me fishekë... S'kishte kohë. Gjermani ja kishte drejtuar grykën e automatikut në gjoks. Një çast ai mbeti si në një kllapi të vërtetë... Dëgjoi breshërinë e automatikut pes hapa në krahun e majtë të tij, pastaj pa duart e gjermanit, që e lëshuan automatikun, dhe ushtarin që ra. Ktheu kokën.

«Komisari, Marengleni!» murmuriti.

Dhe u ngrit e hodhi me forcë një granadë dore. Granada shpërtheu. I vuri pushkës ballin me fishekë.

Komisari i brigadës pyeti:

— Ku është komandanti e komisari i kompanisë?

Lefteri dhe Damini rrëshqitën drejt tij.

— Do të sulmojnë me bomba — tha komisari. — Mundet?

— Urdhërat do të zbatohen, shoku Marenglen — ju përgjegjen të dy njëherësh.

— Atë kohë nisi të qëllonte përpara tyre mortaja e brigadës.

— Jepini, trima, jepini! — thërriste. Në këto çaste të përlëshjes Marengleni mendoj se vetëm guximi ishte leva që mund ta përmbyste fortesën e armikut në Margëllëç, ndaj u ngrit dhe u hodh përpara.

— Pas meje! — tha Marengleni dhe, si hoqi sigurëcën e bombës, që mbante në dorën e djathtë, u turr ta lëshonte mbi armiqt.

— O burra, mbi ta — thirri si i xhindosur Damini. Lefteri zbrazti automatikun, pastaj vuri dorën te mesi të nxirrte bombën...

Krisma... Ngado krisma dhe zëra...

Kur u ngjitën në lartësi, Zhuli pa përsëri Marenglenin, që vështronte përpara fushën pa mbarim dhe Fierin. Zhuli vuri re që komisari i brigadës hera-herës kthente vështrimin në bregun tjetër të Vjosës. Andej shihej një qiell i ndezur dhe vinin jehona krismash. Forcat e tjera të brigadës që drejtoheshin nga Vogli dhe Goliku sulmonin... Brigada të tjera sulmonin...

Zhul Fushbardhasi vështroi si Marengleni shënoi diçka në blok dhe mbylli çantën. Ai vuri re sytë e shkruar të komisarit të brigadës e buzëqeshjen e tij të ëmbël.

— E, si të duket Zhul? Grusht të fortë po u japim dhe kësaj radhe.

Partizani nuk u përgjegj. Fjalët i ikën nga goja, veç zemra i gufonte sa herë e shikonte komisarin në vijën e parë. Shqetësohej gjithnjë se mos i ndodhte gjë; luftë ishte, e midis plumbave kalonin.

— Si nuk ruhet?! Po sikur...?!

Mbas dështimit të operacionit, gjenerali Fon Gajb mblodhi disa komandantë të reparteve që mbanin pikëmbështetjet me rëndësi të veçantë që do të ndalonin vërshimin e forcave partizane në drejtim të qyteteve bregdetare. Majori Diter Grebner e dëgjoi me vëmendje të madhe gjeneralin. Ai thoshte fjalë të tjera nga ato që nazisti Grebner i kishte dëgjuar disa kohë më parë në luginën e Përmetit. Atëhere Fon Gajbi kishte qeshur dhe, duke përbuzur forma e luftimit të ushtrisë italiane, kishte thënë: «Vetëm fortino dinin të bënin, ndërsa ne kemi taktikën tonë të sulmit, të ndjekjes...» Ndërsa kësaj radhe, sikur të mos qenë mendimet e tij ato që kishte thënë disa javë më parë, theksoi: «Kërkoj t'i forconi pikëmbështetjet, të vini para tyre sa më shumë pengesa xheniere; të ndërtoni sa më shumë fortino!» Frazën e fundit gjenerali e theksoi disa herë dhe kjo e detyroi majorin Diter Grebner që krahas fortinave të derdhura në çimento nga ushtarët italianë të ngrinte edhe disa të tjera. Ato ditë hodhi shtat mbi të tjerët në kalanë e Margllëcit një bunker që shikohej që nga Fieri, një fortino me shumë mitraloza. Atje dërgoheshin vazhdimisht gurë, gëlqere e çimento për të ndërtuar të tjerë. Dhe bunkeri i lartë, që ndodhej në sheshin mbi kala, ishte i vetmi pozicion ende i pastronditur. Një nga «sharëset» që dilte nga ai bunker qëllonte mbi kompaninë, që sulmonte bashkë me komisarin e brigadës. Diter Grebner e kuptonte se besimi që kishte për ta mbajtur kështjellën po treqej nën krismat e armëve partizane; të tërhiqej nuk kishte mundësi. Kjo e bëri edhe më energjik, më të egër. Doli të shikonte pozicionet, donte në këto çaste kritike të hetonte pulsën e ushtarëve të tij. Këndej vështroi rreth trupin e rëndë të kështjellës. Ajo tani i dukej një diçka e ftohtë, e ngrirë që më shumë i fuste në shtat frikën se sa shpresën për të zbrapsur brigadën partizane. Dëgjonte krismat e mitralozëve te bunkeri i madh.

Komandant Meleq Gosnishti shikonte nga afër herë flakën e mitralozit e herë mitralierin gjerman që, sa herë qëllonte, shtrembëronte fytyrën e ngërdheshej. I dha heshtaz shenjë Çeços. U çudit Meleqi kur pa se me sa shpejtësi u morën vesh ata të njëzetë njëri me tjetrin.

— Zjarr! Zjarr! — gërthiste komandanti i kalasë, majori Diter Grebner.

Flakë nxjerrin nga tytat pushkë e mitraloza.

Oshëtimë luftime në Fier, në Mallakastër dhe në Myzeqe...

Ushtarët e majorit Diter Grebner vështronin si ngjiteshin drejt tyre partizanët. Po as ushtarët, as komandanti i tyre s'kishin mundur të zbulonin që, disa metra afër bunkerëve, ndodheshin partizanët e Meleqit të maskuar aq mirë, sa që ngjanin edhe ata vetë si kaçube të vogla.

Kishte diçka të veçantë Meleqi i Gosnishtit, ish-punëtori i minierave të Francës, djaloshi më i bëshëm në trup në gjithë brigadën, me gjoks dhimplare e tipare të veçanta që i shikoje vetëm tek ai. Si trupi, ashtu edhe zemra e kishin bërë Meleqin të dashur për të gjithë, e kishin bërë simbol të trimërisë. Kjo e bëri atë, punëtorin e thjeshtë, që të komandonte në luftë një batalion partizan. Kur mblidheshin rreth zjarreve partizanët, tregonin për Meleqin si i ra me bombë në shpinë një ballisti, si tërhoqi nga fusha e luftës mortajën dhe një partizan të plagosur në shpinë, tregonin se si me një grup shokësh në Luginën e Përmetit kishte kapërcyer Vjosën me not dhe kishte goditur në shpinë ushtarët e armikut. Çdo ngjarje që tregonin për komandantin e tyre partizanët e partizanet e zbukuronin dhe Meleqi u bë figura më e dashur për ta. Edhe këtu në kështjellën e lashtë diçka prisnin prej tij.

Meleqi lëvizi ngadalë përpara, lëvizën edhe njëzetë tjerët.

— Në suim! — foli komandant Meleqi dhe u ngrit nga vendi, u hodh drejt bunkerit. Të njëzetë partizanët dhe informatori partizan, Çeçua i Lale këmbëzbathurës

nga Margëllëçi, zbrazën armët. Meleqi ngriti zërin:

— Goditni me granada, me granada!

Kështjella u drodh nga granadat e dorës që shpërthyen te bunkerët. Komisari i brigadës, nga afër, i shikon partizanët dhe Meleqin. Shtie edhe ai mbi armikun. Ngrihet dhe hidhet përpara.

Mitralieri gjerman, që deri atë kohë qëllonte vendin, ku sulmonte Marengleni, u zbe në fytyrë. Një çast mbeti i hutuar. Nuk mundi të qëllonte, ngaqë ju duk sikur plasi toka dhe mbinë në sheshin e kalasë partizanët. Ai nuk dinte që atë kohë kishte vënë në shenjestrën e armës së tij komisarin e brigadës, por edhe po ta dinte, s'do të mundej, ngaqë Meleqi ju afrua grykës së mitralozit dhe foli:

— Atë kërkon të qëllosh, atë do të na vrasësh?! Na! — tha ai duke flakur granadën.

Ushtari nazist ktheu vështrimin nga ai dhe pa afër një burrë të pashëm, të bëshëm, me vetulla e flokë të zes, të prerë sarakaçançe, me një gunë të bardhë hedhur kraheve dhe u habit, u zbe më shumë në fytyrë... Dëgjoi afër çapet e njeriut me gunë, i dëgjoi zërin, mandej sytë verbues dhe dorën e tij, që i dërgoi drejt e në fren-gji granadën,

— Me dorë, me dorë! — u flet shokëve Meleqi.

Kulla nxori tym. Mitralozi në fortino mbeti i kaca-vjerrur një çast, pastaj atë e mori në dorë një partizane dhe e vuri në përdorim.

— Kështu duhet. Le ta shikojë tani gjermani! U mor kalaja. E dëgjoni si këndon atje mitralozi? U hyri ai gunëbardhi i Gosnishtit prapa (kështu i fliste Refat Arapi komandant Meleqit) dhe hë, mori vrapin gjermani.

U duk një çast sikur çdo gjë heshti, por kjo zgjati shumë pak. Nga bunkeri i nëndheshëm, nga vendi ku flinin rojet, doli me rrëmbim një oficer gjerman, një burrë i gjatë. Ai u pa sy më sy me njeriun me gunë të bardhë dhe të dy flakë në flakë këmbyen zjarrin e armëve të tyre. Asnjëri nuk mori në trup plagë. Gjermani i gjatë, me ata sy si të maces, u hodh në buzën perëndi-

more të kalasë dhe mori vrapin nëpër shkurret. Njeriu me gunë të bardhë ju qep pas. Ishte i vetëm. Shokët e tij përlesheshin ende në kala me ushtarë të tjerë, që dolën nga bunkerët, kurse ai ndoqi prapa atë nazist të gjatë si kërcyell thekre dhe s'i ndahej. Donte ta kapte të gjallë, e zuri nga zverku, por gjermani u kthye dhe të dy u rrokën, u kacafytën mbi bokërimë. Meleqi nuk kishte mundësi të përdorte malisherin, as nagantin s'mund ta nxirrte nga këllëfi. Dora e tij e madhe rrëmbeu një gur dhe, pasi e ngriti lart, e vërviti me forcë në kokën e gjermanit. Atë kohë arriti Marengleni. Meleqi, që shpeshherë kritikohej se rrëmbehej në luftë, uli sytë si të qe kapur në faj. Pastaj pyeti:

— Po shokët e tjerë ku janë?..

Marengleni kishte dalë në një bregore në fund të fshatit dhe vrojtonte. Pyeti se kush ishte ai partizani, që u kishte prerë rrugën armiqve.

— Është Manoli, shoku komisar.

— Djali i Gole Përmetarit?

— Po!

— I lumtë!

Në kala pushkët zunë të pritëshin. Edhe zërat nuk dëgjoheshin si në fillim. Marengleni e kishte tani zemrën valë. Gëzimi e kishte bërë të harronte dëshpërimin, lodhjen dhe sëmundjen. Nxori nga çanta hartën dhe nënvizoi mbi të edhe një shenjë tjetër asgjësuese, shënoi edhe emrin e Manolit.

Brigada bëri edhe një hap tjetër përpara, në drejtim të Fierit.

8

Kishte gjashtë orë që vazhdonte sulmi. Dita ishte pa re dhe dielli ndriçonte kodrat përreth, por kështjellën e kishte mbuluar tymi. Përleshja zgjati mjaft; shenjat po tregonin se kudo armiku ishte thyer.

— Fituam, Meleq — i tha Marengleni.

Meleqi i dha pak majtas gunës së bardhë për të lënë të lirë supin ku do të mbështeste pushkën.

— Kujdes, Marenglen, aty...

Ishte fshehur pas trugjeve të ullinjve disa automatikë, tejet në bregun për karshi një snajper gjerman kishte vendosur kryqin e dylbisë së pushkës mbi trupin e Meleqit. U dëgjua krisma e thatë e pushkës.

Brigada i mori edhe pozicionet e fundit.

— I thyem, Meleq, i thyem edhe kësaj radhe.

Një diçka e bardhë u hap rrëmbimthi si të donte të mbështillte kështjellën. Ishte guna e Meleqit që, si s'mundi të ngrihej në fluturim, u mbështet mbi trupin e komisarit.

Në gjoksin e tij buloi dhe mbiu një si lule e kuqe.

— Meleq! — i thirri komisar i brigadës.

Tjetri u mundua të përgjigjej, por e ndjeu kotësinë e përpjekjeve që bëri, liroi trupin dhe shtrëngoi armën.

Marengleni, si skifteri që i kundërvihet erës dhe qëndron në qiell, u ngrit dhe e rrëmbeu shokun e goditur. Qëndronte pranë tij i heshtur me sytë të mberthyer mbi ballin dhe fytyrën e tij dhe vuri re që nuk kishte fuqi të ndahej nga fytyra e tij.

— Meleq, Meleq — shqiptoi ngadalë emrin e komandant Meleqit. Trupin e tij ja rrëmbyen nga duart menjëherë dy partizane sanitare. U ngrit edhe ai nga vendi. I ishte mpirë i gjithë trupi dhe një çast as shikonte dhe as dëgjonte, veç ngiste vrap, shkante përpara me një dëshirë të vetme që të ngulte dhembët mbi cilindro nazist që do t'i dilte përpara. Ajo diçka si krismë midis ballit që i shkaktoi dhembja e humbjes së shokut ende ja mbante të veshur pamjen dhe nuk pa se si disa ushtarë qëlluan drejt tij, nuk pa as kur Zhul Fushbardha si u hodh e zuri vend për ta mbrojtur duke qëlluar mbi armiqtë. Ai ndjeu një dhembje të paduruar, ndaj donte ta mposhte atë duke vrapuar e duke derdhur plumba në drejtim të ullishtës.

Ajo që ndodhi në zemër të kështjellës, goditja që dha Meleqit me shokët e tij, ishte për armikun sa e pa-

pritur, aq edhe shkatërruese. Fill pas saj, qëndresa e armikut e humbi forcën. Megjithatë krismat e armëve qenë të shpeshta, të afërta, të forta e shurdhuese. Mbi gungën e bunkerit u ngjitën disa partizanë. Dalloheshin vetëm nga tytat e pushkëve, që dilnin një e nga një në murin e vjetër të kalasë. Zhul Fushbardhasi, habitshëm, shikonte tytat e pushkëve. Fytyrat e njerëzve që poshtë, nga vendi ku ishte ai, nuk shikoheshin.

Dëgjoi zërin e Marenglenit:

— Janë tanët ata, janë tanët, djalosh!

Përsëri krisma armësh dhe zëra:

— Ikën!.. Ikën!.. — Dhe partizanët që dolën sipër te bunkerët, u vunë prapa tyre.

Krismat u bënë edhe më të dendura. Një kompani me ushtarë gjermanë bëri tutje, në Jug.

Rruga i çoi gjermanët më afër kompanisë së krahut të majtë. Komisari i brigadës, Marengleni, që ndodhej atje, u hodh mbi nazistët dhe zbrazti automatikun. Shtiu më këmbë. Edhe Zhul Fushbardhasi shtiu... Tre gjermanë mbetën në vend, të tjerët bënë poshtë... Në krye të ullishteve u këmbye zjarr armësh nga të dyja palët. Sulmonte brigada partizane. Sulmonte në vijën e parë komisarit. Zhul Fushbardhasi ishte në krah të tij. Gjithnjë po ai shqetësim.

— Po sikur?..

Donte t'i fliste komisarit, të thoshte një fjalë.., por nuk foli..

Përsëri krisma. Në tymin e bombave, partizanët shikonin komisarin, që shtinte dhe jepte urdhër:

— Përpara, shokë, përpara!

Dëgjohej nga ana tjetër krisma e armës së Dardanit, zëri i Bukurisë. Sulmonte Refat Arapi. Binte boria e Nانيت, dëgjohej zëri i Vocos: «Përpara, kompania jonë!»

Këndonte si gjinkallë mitralozi i të birit të Gole Përmetarit. Si në çdo luftim, edhe këtu çdo krisëmë shoqërohej me fjalë:

— Të lumtë, Manol!

— Hajde, hajde: Ku ishim e ku jemi! — u tha Refat

Arapi shokëve, ndërsa po zbriste që nga kalaja e shikon-te pyllin me ullinj dhe livadhet.

— Ku jemi, xha Refat?

— Lozim valle në tokat e beut, ja ç'bëri lufta, ja ç'bëri Partia! Mori tatëpjetën gjermani, s'ka për ta ngri-tur më kokën.

9

Sado që kështjella u mor, nëpër pozicione të ndrysh-me kishin mbetur ushtarët të shkëputur nga shokët e tyre, që s'kishin asnjë lidhje me forcat e tjera që tërhi-qeshin dhe prapëseprapë qëndronin dhe vdisnin se cili për hesapin e vet

Diter Grebneri në fillim u përpoq të ndalonte tër-heqjen u doli përpara ushtarëve, u kap me ta, por ushta-rët vazhdonin të largoheshin vjedhuraz. Reparti ushta-rak sapo thyhet, pushon së qeni repart i organizuar; çdo ushtar hutohet dhe nuk kërkon më të gjejë se ku e ka vendin, veç ikën me vrap. Kështu nazisti Diter i egërsuar dhe tërë inat u largua edhe vetë nga kështjella, megjithëse disa çaste më parë kishte thënë: «Do të dë-shiroja të më merrte në zemër një nga këta plumba», por, i rrëmbyer nga instikti për të jetuar, vrapoi sa mundi nëpër pyllin në perëndim të kështjellës. U fshihej zërave dhe plumbave të partizanëve. Megjithatë Refat Arapi ja ndjeu erën dhe ju vu prapa me gjithë skuadrën e tij.

Përparimi i partizanëve nuk ishte i njëlojtë, disa kompani kishin shkuar me përpara e disa të tjera kishin mbetur më prapa. Vija e luftës shtrihej gjithandej me zigzake të panumërta.

Një nga kompanitë që sulmonte me Bardhin po shkante gjer në fund të kodrave, aty ku fillonte fusha. Në kodrat e bukura të Patosit të ri u dukën partizanë. Rruga automobilistike gumëzhinte nga tankset e auto-blindat. Kjo u dha zemër një grupi mercenarësh që vra-

ponin luginës për t'i shpëtuar rrethimit. Kur iknin, nga frika nuk pyesnin për baltën e ujët e moçaleve, ndaj partizanët nuk e kishin aq lehtë që t'i arrinin. Po, nëse nuk i arrinte njeriu, plumbi shkonte gjer aty ndaj, Manoli, nga kodra që të zbriste në fshat shtinte me mitraloz. Një çast edhe mitralozi i Manolit heshti, kur heshte mitralozi, shokët shqetësoheshin. Topat në veçanti gjuajnë në mbi mitralierët dhe disa prej tyre në këtë përleshje mbetën të vranë. Edhe në pozicionin e Manolit qëllonin disa topa. Nga këmbimi i zjarrit të armëve u vranë disa nga ballistët që tërhiqeshin. I lanë në vend të vranët. Të plagosurit u kapën, kur ishin duke u larguar. Të tjerët gjetën një shteg e vrapuan nëpër të për të shpëtuar.

Marengleni vuri buzën në gaz e i tha Lefterit:

— Kot përpëlitën. Rjeta është hedhur mirë e s'kanë si të dalin prej saj.

— Në pozicionet e armikut kishte mbetur kali me shalë e yzengji i beut Margush. Atij doriu të kuq, që turfullonte, ju hodh sipër Manoli. Kur e panë, shokët e skuadrës së tij i folën:

— Ku shkon andej, more, more kokëkrisur, ndal, ore, ndal!

Po ku ndalej Manoli. E bëri erë kalin... Ecte me revar rrugës, që të çonte në Patosin e ri. Ecte ai, po ecnin më shumë nëpër baltë ballistët e gjermanët. Do të kishin shpëtuar nja tridhjetë veta nga rrethimi, po të mos kishte dalë Manoli që t'u zinte shtegun dhe t'i goditte, t'i shtrëngonte të hidhnin armët e të grinin duart.

10

Komandanti nazist i kështjellës, majori Diter Grebner më në fund ua dha këmbëve. Ai me katër ushtarë të tjerë, që ndiqeshin këmba-këmbës e goditeshin nga plumbat e skuadrës së Refat Arapit, ikte me vrap... Pasi zbritën murin dhe ranë kollotumba afër shtegut, vrapuan drejt gropës me ullinj.

— Na shpëtoi — tha i dëshpëruar Dardani. Të gjithë mbetën atje dhe vështruan; pylli i fshehu ushtarët. Marengleni, që ndiqte me vëmendje veprimet e armikut, e dalloi, u hodh më përpara e zuri pozicion. Priti gjersa nazisti Diter Grebner të dilte nga pylli. Mori shenjë. U mundua të shënonte mirë. Duhej medoemos që plumbat të binin në shenjë.

Majori nazist Diter Grebner me të parë partizanin me xhakëtë ngjyrë bezhë dhe me rripa të kryqëzuar në gjoks, ndaloi. Nazisti Diter Grebner e ndjeu veten si gozhda, që kapet nga dara. Me forcën e fundit që merr njeriu për t'i shpëtuar vdekjes, u hodh në bokërimë, deshte të ikte. E pamundur! Marengleni qëllloi... Gjermani i nguli në tokë këmbët si shtylla. Mbeti një cast ashtu. Trupi i nazistit Diter Grebner kishte muskuj të fuqishëm, por të pargjur nga puna dhe mundimi. Plaga, që kishte marrë, i dhembte. Hodhi në sulm fuqitë e tij të fundit, donte të qëndronte. Kot... prapë këmbët ju drodhën, nisi të gjunjëzohej... Ushtarët, që ishin me nazistin Diter, u fshehen në trungjet e ullinjve; tytat e automatikëve të tyre nxirrnin flakë. Zhul Fushabardhasi hodhi një bombë... Midis tymit u mundua të dallonte njerëz. Nuk pa gjë. Ngado tym.

Kur u ngrit tymi mbi ullinjtë, ai pa atje, në vend të ushtarëve armiq, komisarin e brigadës, Marenglenin, që shtinte kundër armiqve. I shkoi përsëri afër. Shqetësohet Zhul Fushbardhasi për komisarin, thërret:

— Para, partizanë!

Marengleni shkoi edhe më përpara. Kaloi përmes plumbave dhe doli ballë për ballë me një ushtar tjetër. U ndal, ra në gjunjë, ndërroi krëhërin e automatikut, u ul barkas dhe shënoi. Zhul Fushbardhasit ju duk sikur po zgjatej koha që Marengleni po përpiqej të merrte shenjë, ndaj vuri armën për faqe që të qëllonte nazistin; ndërkohë automatiku i Marenglenit u drodh dy-tri herë nga breshëritë e shkurtëra. Përsëri foli Marengleni:

— Përpara, brigadë partizane!

Krismat e armëve dëgjoheshin më në afërsi të Fierit.

Brigada përparon...

U zbatua urdhëri i partisë, u mor Patosi, u çlirua Mallakastra. Duhej që komisari të njoftonte këtë. Ulet mbi trungun e një ulliri të rrëzuar nga një predhë, hedh sytë rreth, vështron Mallakastrën e çliruar dhe brigadën, që sulmon në drejtim të Fierit, vështron edhe kalanë e Margëllëcit dhe thotë:

— E shkulëm më në fund nga vendi edhe këtë lis, sado që rrënjët i kishte të thella.

Është i gëzuar që brigada i mori armikut kalanë e Margëllëcit; është i gëzuar që ajo e plotësoi detyrën luftarake. Shkruan në fletore:

«Shokut Enver Hoxha!

Brigada...»

Përsëri vështron me dylbi. Përpara ka brigadën partizane, puse dhe fushat e mbjella, që janë shkëlur nga çizmja armike. Sodit dhe mendon:

«... Shumë grurë do të bëjmë në vitet që do të vijnë; më shumë naftë do të rrjedhë nga kjo tokë, sepse do të dimë ta qeverisim djersën tonë. Sikur Shqipërinë të tërë ta mbjellësh me grurë, e gjitha do të mbijë, do të rritet nëpër këtë tokë të njomur me gjak. Përsëri vështron tym. Armiku tërhiqet dhe djeg, masakron njerëz, hedh në erë puse. S'ka ç'i bën flaka këtij vendi, s'mposhetet revolucioni, nuk shterojnë radhët tona... Edhe shtëpi të reja do të bëjmë, edhe puse të reja do të çelim, edhe njerëz të rinj do të rritim që të mbushin radhët. Ne nuk do të thahemi, nuk do të zhdukemi kurrë!»

U ngrit e shkoi më përpara.

I shkau këmba dhe u pengua në një gropë. Sapo ra në tokë, një e therur në gjoks i shkoi gjer në zemër. U kollit. Përsëri, si u mbush me frymë dhe ju pakësuan dhembjet, u ngrit dhe zuri të ecte. Ndjente ngrohtësinë e diellit dhe të naftës. Lëndina, që kishte përballë, bleronte, toka kishte plasur e kudo kishin shpërthyer lule.

— Pranverë! — pëshpëriti. — Pranverë partizane!
— dhe shkoi më përpara.

Pranverë ishte. Kishin shkrirë akujt e dimrit, po

shkrinte dëbora dhe njerëzit shikonin si vërshonin me rrëmbim lumenjtë.

— Zhul! — tha komisari.

Djaloshi vështroi andej. «S'ka për të ma harruar kurrë emrin» tha me vete Fushbardhasi.

— Po shkrin bora. Ikën ngricat, Zhul, po vjen pranvera.

Dhe eci komisari nëpër pellgjet me naftë, nëpër barin e gjelbër.

Tutje, nga fusha e kodrat brigada sulmonte...

11

Një çast ju desh Marenglenit të ndalej, qëndroi aq sa të thithte pak ajrin e ngrohtë që vinte nga deti. Një çast! Po ku i mbushej gjoksi Marenglenit!

— Ç'po qëndronte ashtu si fidan lisi midis luadheve komisar Marengleni?

U dëgjua zhurma e një autoblinde. Ajo i doli Marenglenit papritmas, afër. Qëlloi autoblanda me mitraloz; goditi me plumba kompaninë partizane.

— Ndal! — dha komandën me zë të lartë Marengleni.

Një zinxhir me plumba rrëmbeu nga cepi në cep lëndinën. Dikush u plagos. Komisari i brigadës u ngrys në fytyrë, rrudhi vetullat.

Autoblinda sërish qëlloi mbi partizanët. Plumbat rrëmbyen edhe një herë vendin ku qëndronte skuadra e Refatit. Edhe Marengleni e qëlloi atë. Plumbat rrëshqitën në kullën e autobлиндës. Prapë qëlloi komisari dhe, i zemëruar, shtiu së treti. Por autoblanda sërish qëllonte.

— Po na vret shokët, Zhul!

Zhul Fushbardhasi, me granada në duar, ishte larguar. Shkonte tej tek autoblanda. Marengleni i thirri:

— Zhul, ki kujdes, ki kujdes!

Sa u ngjit gjer atje Zhuli, autoblanda lëvizi nga vendi, dredhoi nëpër livadh dhe doli nga e djathta e ju

afrua më shumë Marenglenit. U gjendën afër, ballë për ballë, përbindshi i hekurt dhe njeriu. Marengleni e ndjeu rrezikun, por nuk u tërhoq. Jo çdo njeri e mbledh veten në çaste të tilla të papritura, por energjitë e Marenglenit vërshonin kur i turrej rreziku dhe kurrë s'kishte patur forcë që ta gjunjëzonte për të mos i dalë përpara të papriturave, ndaj sytë i shkrepëtinin, damarët e qafës ju ngritën, gjoksi, i munduar nga sëmundja, i gufoi. I doli përpara autoblindës, u sul drejt saj. Hodhi bombën e parë, nxori të dytën... tre plumba njëri pas tjetrit e dogjën në gji. Eci disa hapa me këmbë të dridhura. Dëgjoji zërin e drithëruar të partizanit Zhul, që u foli shokëve:

— Komisari, Marengleni!
Të gjithë sulmuan andej, drejt autoblindës.

Marengleni mbështeti gjoksin mbi autoblindën e djegur, dhe ngriti dorën që t'u jepte shenjë shokëve.

Refat Arapi rrëmbimthi ju gjend pranë.

— Muço, Muço! — E ngriti, i fshiu ballin. Refatit i iku çehrja e fytyrës, i ranë mbi ballë flokët, ju mblodh i tërë hidhërimi në gjoks e në zemër, ju derdhën lot.

— Muço, bir, Muço! — i foli.

Një çast Marengleni i hapi sytë. Në atë vështrim të fundit, që humbiste larg, ju shfaq brigada, që përmes krismave çante përpara. U mundua të buzëqeshte. Ju hijeshuan tiparet e bukura të fytyrës, rimblodhi forcat. Deshte të fliste, të thoshte diçka. S'mundi... Mblodhi vetëm dorën grusht, e shtrëngoi fort...

— Të vranë, Muço, të vranë qentë!

Fjala e Refatit e bëri të dridhej cilindo partizan. Zhul Fushbardhasi u bë baltë në fytyrë: qe goditur në zemër nga një hidhërim i madh.

— Komisari... Marengleni!

Atë kohë zëra të fortë erdhën në veshin e tij:
— U vra! U vra!

Këto zëra nuk deshte t'i besonte, sado që e shikonte me sy komisarin e goditur në gjoks nga plumbat. Po zërat: U vra! Vdiq! i bëhej sikur i rrihnin fort timpanet e veshëve dhe u mbi, u zbe, nga sytë i ranë lotët çurg.

— Nuk vdes komisari ynë, jo!

Të gjithë shtrëngonin armët, shtrëngonin grushtet.
Në vijim të luftës po atë ditë njoftohet Shtabi i Përgjithshëm:

«... Mbas shumë luftimesh të ashpra, më në fund operacioni, që udhëhoqi komisari i brigadës sonë, Marengleni, në drejtim të Mallakastrës mund të quhet i përfunduar. Urdhëri i komisarit të Shtabit të Përgjithshëm, shokut Enver, u zbatua. Heroizmat e komisarit tonë të dashur të brigadës, Marenglenit, na nxisin të gjithëve në luftë që të plotësojmë në kohë çdo detyrë që do të ngarkojë Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm.»

Këtë njoftim korrierët e çuan drejt maleve.

... Dhe, ndërsa brigada sulmonte në drejtim të Fierit, lindi në vijat e para të luftës një këngë e re partizane, një këngë për Marenglenin, këngë për Muço Matohitin.

Ishte pranvera e vitit dyzet e katër, kur kënga, së bashku me brigadën partizane, u përhap në të gjitha anët e Shqipërisë.